



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

**T R A N S K R I P T**

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,  
E MBAJTUR MË 12 PRILL 2019**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,  
ODRŽANE 12. APRILA 2019. GODINE**

**PRILL - APRIL  
2019**

## Rendi i ditës

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbaleve nga seancat e mëparshme,
4. Shqyrtimi i Propozim-Amendamentit nr. 26 në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, të propozuar nga 80 deputetë të Kuvendit,
5. Votimi në parim i Projektligjit për mbrojtjen e vlerave të luftës së UÇK-së,
6. Shqyrtimi i Propozim-programit të Punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës për vitin 2019,
7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 06/L-081 për qasje në dokumente publike,
8. Interpelanca e ministrit të Punës dhe Mirëqenies Sociale, z. Skender Reçica, sipas kërkesës së deputetit Faton Topalli, mbështetur edhe nga 11 deputetë nga GP i PSD-së, në lidhje me vdekjet dhe lëndimet e punëtorëve në vendin e punës,
9. Debat parlamentar, sipas kërkesës së deputetes Teuta Haxhiu, mbështetur edhe nga 9 (nëntë) deputetë nënshkrues, në lidhje me të drejtat e pensionistëve kontributëdhënës,
10. Debat parlamentar, sipas kërkesës së deputetit Faton Topalli, në lidhje me mosekzekutimin e Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. KI 08/09, dt. 17 dhjetor 2010, Vendimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, nr. 04-V-799, datë 19 mars 2014, Vendimit të Qeveris së Republikës së Kosovës, nr. 08/186, datë 29 prill 2014 i hyrë në fuqi më 12 maj 2014 dhe të dy (2) udhëzimeve të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, nr. C-V-14-4099 dhe nr. C-V-14-4332, datë 13 qershor 2014,
11. Debat parlamentar, sipas kërkesës së deputetit Korab Sejdiu, lidhur me nevojën urgjente për vendosje të sanksioneve ekonomike (përfshirë embargon) dhe sanksioneve politike kundër Serbisë, si masë reciprociteti,
12. Debat parlamentar sipas kërkesës së deputetit Ismajl Kurteshi, mbështetur edhe nga 7 deputetë të GP të LVV-së, në lidhje me përgjegjësinë e Qeverisë së Kosovës dhe institucioneve përgjegjëse mbi organizimin e arsimit parauniversitar në Kosovë,
13. Raporti i Komisionit Hetimor Parlamentar në lidhje me shpenzimet për lobim nga Presidenca dhe Qeveria e Republikës së Kosovës,
14. Zgjedhja e anëtarëve të Bordit të Ndërmarrjes Publike Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut - "KOSTT" sh. a.,
15. Kërkesa e Komisionit Hetimor Parlamentar në lidhje me shpenzimet për lobim nga Presidenca dhe Qeveria e Republikës së Kosovës për kompensimin e anëtarëve të këtij Komisioni,
16. Propozimi i GP të Listës serbe për emërimin e zëvendëskryetarit të dytë në Komisionin ad hoc për përpilimin e Kodit për rregullimin dhe menaxhimin e fushës së pensioneve dhe benificioneve nga sigurimi social,
17. Shqyrtimi i kërkesës së Komisionit Hetimor Parlamentar në lidhje me gjendjen në PTK dhe Vala, për zgjatjen e mandatit dhe për emërimin e zëvendëskryesuesit të këtij komisioni hetimor.

## Dnevni red

1. Vreme za izjave van dnevnog reda,
2. Vreme za parlamentarna pitanja,
3. Usvajanje zapisnika sa prethodnih sednica,
4. Razmatranje Predlog amandmana br. 26. Ustava Republike Kosovo, predložen od 80. Poslanika Skupštine,
5. Glasanje u načelu N/zakona o zaštiti vrednosti borbe OVK-a,
6. Razmatranje Predlog-programa rada Skupštine Republike Kosovo za 2019. godinu,
7. Drugo razmatranje N/zakona br.06/L-081 o pristupu javnim dokumentima,
8. Interpelacija Ministra za rad i socijalna pitanja Skender Reçica, na zahtev poslanika Faton Topalli, podržan od 11 poslanika PG PSD, u vezi smrti i povreda radnika na radnim mestima,
9. Parlamentarna debata, na zahtev poslanice Teuta Haxhiu, podržan od 9. (devet) poslanika - potpisnika za održavanje parlamentarne rasprave o pravima penzionera platiša doprinosa,
10. Parlamentarna debata, na zahtev poslanika Faton Topalli o neizvršenju Presude Ustavnog suda Republike Kosovo, br. KI 08/09, od 17. decembra 2010. godine, Odluke Skupštine Republike Kosovo, br. 04-V-799, od 19. marta 2014. godine, Odluke Vlade Republike Kosovo, br. 08/186, od 29. aprila 2014. godine koji je stupio na snagu 12. marta 2014 i dva (2) uputstva Posebnog veća Vrhovnog suda Republike Kosovo br. C-V-14-4099 i br. C-V-14-4332, od 13. juna 2014. godine,
11. Parlamentarna debata, na zahtev poslanika Korab Sejdiu o hitnoj potrebi uspostavljanja ekonomskih sankcija (uključujući embargo) i političkih sankcija protiv Srbije, kao mera reciprociteta,
12. Parlamentarna debata u vezi zahteva poslanika Ismajl Kurteshi, uz podršku 7 poslanika PG - LVV u vezi odgovornosti Vlade Kosova i odgovornih institucija o organizovanju pred univerzitetskog obrazovanja na Kosovu,
13. Izveštaj Parlamentarne istražne komisije u vezi sa troškovima za lobiranje od strane Predsednika i Vlade Republike Kosova,
14. Izbor članova borda Javnog preduzeća operator sistema, transmisije i tržišta - "KOSTT" sh. a.,
15. Zahtev Parlamentarne Anketne Komisije vezano za troškove lobiranja od strane Predsedništva i Vlade Republike Kosova, za nadoknadu članova ove Komisije,
16. Predlog PG SL za imenovanje drugog zamenika predsednika Ad hoc komisije za izradu Zakonika o regulisanju i menadžiranju penzija i beneficija socijalnog osiguranja,
17. Razmatranje zahteva parlamentarne istražne Komisije u vezi situacije u PTK i Vala, za produžetak mandata i imenovanje zamenika predsedavajućeg ove istražne Komisije.

## **Mbledhjen e drejtoi nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.**

KRYESUESI: Të nderuar deputetë,

I hap punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, sipas rendit të ditës të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 28 mars 2019.

Siç është e rregulluar edhe me Rregullore, edhe si praktikë, pika e parë e rendit të ditës:

### **1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës**

E dini që zgjat 30 minuta, i dini minutazhin në emrin e grupeve, është pesë minuta dhe deputetët kanë të drejtë të diskutojnë tre minuta. Ata që paraqiten në emër të grupeve, është mirë që në start ta thonë vetë që janë në emër të grupit, me qëllim që të rregullohet minutazhi sipas rregullave nga regjia.

Për të diskutuar është paraqitur zoti Nait Hasani.

NAIT HASANI: Faleminderit, nënkryetar!

Përshëndetje për kolegë deputetë,

Për çështjet jashtë rendit të ditës kam një kërkesë që i kemi drejtuar kryetarit të Kuvendit, kryeministrit, ministrit të Drejtësisë, ministrit të Administratës, ministrit të Punëve të Brendshme, ministrit të Kulturës, kryetarëve të komisionit, të gjithëve, që në kërkesën tonë të dalë edhe nga Komisioni për Barazi Gjinore, të Drejtat e Njeriut, është që Burgu i Prishtinës, i cili tashmë është transferuar në burgun e ri atje në paraburgim te Pallati i Drejtësisë, burgu i vjetër, burgu që ka qenë në Prishtinë, të shpallet Burg Muze.

Kërkesa jonë është bazuar në trashëgiminë, në të kaluarën, vuajtjet e popullit tonë, njerëzit që kanë kaluar nëpër këtë burg edhe historia e këtij burgu që njerëzit të arrijnë atë pjesë si kërkesë e jona që ky burg të shpallet Burg Muze, burg i vuajtjeve, burg i sakrificave, burg i mundimeve, burg i vdekjeve që ka ngjallur vdekjen, që ka bërë krimet, domethënë njerëzit që kanë kaluar aty pari, duke përfshirë Adem Demaçin, vdekjen e Fazli Grajçevcit, Rexhep Malën, Kadri Osmanin, Hydajet Hyseni, Bajrush Xhemajlin, Ali Aliun, Sejdi Veselin, Rrahmon Bahtirin, Rrahman Dini e shumë e shumë të burgosur të tjerë për vite e vite, që është një histori i dhimbshme, një histori e dinjitetit e krenarisë, e qëndresës, por edhe e burgjeve.

Prandaj, kërkesa jonë u është drejtuar kryeministrit, presidentit, është drejtuar te kryetari i Kuvendit që ky burg të shpallet muze që ta kem një trashëgimi tonën, të kaluarën tonë, një histori tonën, ta dimë që nga kemi ardhur dhe nga po shkojmë.

Nëse nuk e kemi këtë burg muze, cilat do të jenë arsyet që do të na thonë nesër fëmijët tanë kah keni kaluar ju.

Ne kemi dëshmi që ky burg është propozuar nga Ministria e Drejtësisë të ndahet për agjenci të ndryshme, të cilën do ta zhdukim edhe këtë trashëgimi. Kërkojmë në emër të kolegëve deputetë, kryetarit të komisionit që kryeministri apo kryetari i Kuvendit apo ky Kuvend, cilido që të jetë, ta shpallin muze të trashëgimisë të vuajtjeve të popullit tonë që kanë kaluar nëpër këto burgje.

Prandaj, ky burg do të jetë pjesë që do t'i mbledhë gjithë trashëgimin e burgjeve të Kosovës dhe do të jetë një ekspozitë po ashtu që do të dëshmojë për krimet, gjenocidin që e kanë bërë ndaj të burgosurve regjimi serb prej '45 e këndej.

Edhe një herë po kërkoj që t'i drejtohem nga kjo foltore, nga kjo seancë kryeministrit...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zonja Besa Gaxherri.

BESA GAXHERRI: Të nderuar kolegë deputetë,  
Lidhja Demokratike e Kosovës reagon dhe shpreh indinjatën e vet ndaj veprimit të presidentit Thaçi, me rastin e largimit nga përdorimi i vulës presidenciale me simbole të presidentit historik të Republikës së Kosovës, doktor Ibrahim Rugova.

Zoti Thaçi, i cili pretendon të zhdukë çdo zhurmë të historisë së gjatë dhe të dhimbshme të kombit tonë, është e papranueshme.

Me këtë rast edhe një herë po i drejtohem zotit Thaçi, historia e këtij kombi nuk ka filluar me ju dhe as nuk do të përfundojë me ju. Historia e kombit tonë ka heronjtë e vet dhe tradhtarët e vet.

Populli është ai që i vlerëson figurat dhe vlerat kombëtare, ju nuk do të mundeni kurrë të zhvlerësoni veprat dhe vlerën e presidentit historik doktor Ibrahim Rugova. Po as të figurave të tjera që dhanë gjithçka, edhe jetën për pavarësinë e Kosovës.

E kotë është kur ju paguani miliona euro nga buxheti i shtetit autorëve të huaj që të verifikojnë figurën tuaj, ndërsa ta fyeni presidentin Rugova.

Vepra dhe vlera e presidentit Rugova është e pavdekshme, vetëm njerëzit që kanë mungesë të kulturës dhe të vlerave njerëzore mundohen që vlerat kombëtare t'i shfrytëzojnë për qëllimet e tyre personale, e pastaj t'i përdhosin e t'i zhbëjnë ato, duke treguar edhe injorancën e tyre. Sepse

vlerat kombëtare ju nuk mund t'i dëmtoni kurrë, ato jetojnë lart në qiellin tonë, atje mund të arrijnë vetëm shqiponjat, ndërsa sorrat e korbat krokasin poshtë.

Lidhja Demokratike e Kosovës që nga sot do të fillojë procedurën e amendamentimit të Ligjit për simbolet e shtetit dhe Ligjin për presidentin.

Simbolet e presidentit Rugova do të jenë të paprekshme nga kushdo qoftë në këto institucione. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Molliqaj e ka fjalën.

DARDAN MOLLIQAJ: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar qytetarë,

Kolegë deputetë,

Sigurisht që sot do të flas për një temë, e cila nuk ka qenë as e përzgjedhur nga unë e as e dëshiruar nga unë, por ka qenë e imponuar nga ish-kolegët e mi, me të cilët kemi kaluar shumë kohë bashkë dhe pas shumë hipokrizive dhe pas shumë të pavërtetave që janë thënë, siç e kemi thënë edhe më herët, na duhet që të ballafaqomi me të vërtetën, e jo me shpifje.

Deklarata ime në këtë sallë të Kuvendit që njëri nga ish-kolegët e mi, përkatësisht Glauk Konjufca, ka qenë për një periudhë si shërbyes dhe anëtar i SHIK-ut, më duhet t'i jap edhe informatat e tjera, të cilat e konfirmojnë një deklaratë të tillë.

Vitin në të cilin Glauk Konjufca ka shërbyer në SHIK është viti 2000-2001, paga është 150 marka, rekrutimin e ka bërë Fadil Lepaja, sektori në të cilin ka punuar është përpunimi i të dhënave.

Vetë letrat që kanë ardhur nga terreni, një prej letrave të cilën Glauku e kishte ndarë me neve si histori, ishte edhe të dhëna që vinin nga Lugina e Preshevës se kush ku po ndalet dhe të gjitha ato letra që vinin me shkrim të dorës, Glauku me kolegët e tjerë i përpunonin dhe i futnin në të dhënat e SHIK-ut.

Arsyeja e largimit të Glaukut nga SHIK-u ishte paga e ulët dhe pastaj vazhdoi diku tjetër.

Këtu dhe shumë fakte të tjera tregojnë që Glauk Konjufca në këtë periudhë ka qenë zyrtar në strukturat e Shërbimit Informativ të Kosovës.

E kam parë që Glauku bashkë me bashkëpunëtorët e tij të parë po hezitojnë të ballafaqohen me të vërtetën.

Në vetvete nuk e kam problem që dikush ka qenë në SHIK.

Unë besoj që SHIK-u si organizatë ka kryer veprime kriminale, por nuk besoj që secili njeri në SHIK ka bërë gjë të tillë. Por, arsyeja pse i kam thënë këtu, edhe po i përsëris sot është që dikush që akuzon dikë, e vetë ka qenë, është hipokrizi, e dikush që nuk guxon ta pranojë të kaluarën e vet e dikush që fshihet mbrapa të kaluarës së vet, ai person është i rrezikshëm në politikë, sepse ai person sigurisht që bën edhe veprimin tjetër duke e fshehur të parin.

Glauk, nuk të mbron Kadriu, e di që tash po sillesh si shefi yt e po të mbron edhe kur po del në emision, Glauk, nuk të mbrojnë as njerëzit e tjerë të SHIK-ut. Glauk, të mbron veç e vërteta. Duhesh pasur guximin të dalësh e të bësh një gjë të tillë.

Glauk, ta kanë lëshuar Burdushin prej burgut dhe mund të shkosh ta...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESI: Faleminderit! Unë thashë, deklarohuni kur jeni në emër të grupit. Vazhdojani edhe dy minuta në emër të grupit.

DARDAN MOLLIQAJ: Pra, Glauk, janë kujdesur kolegët e tu të SHIK-ut ta lëshojnë Burdushin, mund të shkosh prapë, po nuk të shpëton, është gjykata, Glauk, nuk të mbron, sepse ti e di, sikurse edhe unë, që kjo është një send i vërtetë, të cilin ti vetë e ke konfirmuar. Mua, Glauk, më vjen marre prej teje, se janë dhjetëra deputetë të këtij Kuvendi që e dinë që ke qenë në SHIK. Deri dje e kanë pasur njëfarë respekti për ty, hajde këtu ka njerëz që s'e dinë, ka edhe qytetarë që mund të mos besojnë, po kredibiliteti yt politik ka rënë tërësisht, për shkak se në krahun tënd të djathtë e të majtë, e mbrapa e para, ka njerëz që e dinë me saktësi krejt këto që i thashë dhe paramendo çka i ke bërë vetit. Tash ti më, qysh do ta kritikosh Kadri Veselin ose Ilmiun që e ke aty afër, ose dikë tjetër, Glauk, sepse krejt ne këtu e dimë që ti ke qenë në SHIK, Glauk. E tash mund të shkosh te Burdushi, ndoshta të ndihmon Burdushi dhe e kalon këtë krizë sikurse krizat e tjera. Faleminderit.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka Liburn Aliu, në emër të grupit.

LIBURN ALIU: Fjala ime sot ka të bëjë me autostradën. Po, para se të filloj te çështja e autostradës, më duhet një përgjigje të shkurtër t'i jap Dardanit.

Edhe më herët në këtë Kuvend ka pasur akuza ndaj Lëvizjes Vetëvendosje, ndaj deputetëve të saj, për dallim prej atëherë, tash po mungojnë qejfet dhe rakia, po nuk është vetëm dy dallim.

Dallimi është se kjo dëshiron të duket si diçka personale, sikur diçka që buron nga një debat i humbur, po nuk është ashtu, është një projekt shumë më i thellë.

Dhe, meqenëse është projekt shumë më i thellë, unë premtoj që për këtë projekt do të flasim shumë hapur dhe detajisht. Ky është një projekt i rrezikshëm dhe i hidhur.

Projekt i dështuar, prej të cilit kanë mbetur vetëm piskamat, por meqenëse është i dështuar, s'është edhe relevant të merremi tash me këtë punë.

Prandaj, unë po merrem me të çka është më urgjente, po merrem me varfërinë e këtij vendi dhe me qytetarët që po ikin jashtë dhe me një çështje që është mjaft me rëndësi, është çështja e vendimit për ta ndërtuar autostradën e Dukagjinit.

Ajo çka kërkoj nga Qeveria është që ta tërheqë këtë projekt. Sado që quhet autostradë e Dukagjinit dhe lihet përshtypja që është investim për Dukagjinin, ky është një projekt i dëmshëm.

Unë jam dakord që të investohet në Dukagjin, ne jemi dakord të gjithë që të investohet në Dukagjin, mbase Dukagjini ka mbetur mbrapa zonave të tjera, të cilat janë zhvilluar më tepër dhe është investuar më tepër. Por, shumë më mirë është që ato një miliard euro e më tepër që janë të dedikuara për autostradën në Dukagjin, të investohen në zhvillim ekonomik në Dukagjin. Imagjinoni çka do të ndodhte në Dukagjin në rast se për secilën komunë në të cilën përfshihet autostrada ato investime në autostradë, ta zëmë, një miliard euro, nëse 200 milionë do të investoheshin në Gjakovë për autostradë, ato 200 milionë euro të hyjnë në investim ekonomik, në zhvillim ekonomik në Gjakovë, në Rahovec, Deçan, në Istog e në Prizren, imagjinoni çka ndodh për pak vjet në ato komuna, pra do të kemi zhvillim tamam ekonomik. Në momentin kur kemi një dëshpërim tepër të madh të qytetarëve, të cilët po donë të ikin jashtë.

Dhe, pastaj pasi që të investojmë ato një miliard euro në Dukagjin, në zhvillim ekonomik, në bujqësi e në tjera e në pika industriale, pastaj e bëjmë edhe autostradën e Dukagjinit, po nuk ka sens të shkohet drejtpërdrejtë në autostradë në ndërkohë që paralelisht me autostradën janë miratuar edhe projektet e zgjerimit të rrugëve ekzistuese.

Pra, rruga Prizren-Gjakovë është projekti për zgjerim rruga ekzistuese, pse duhet dhënë tash një miliard euro për të ndërtuar rrugë paralele me këtë.

Nëse në rrugën Prishtinë-Podujevë po zgjerohet rruga, pse duhet bërë projekt për ta bërë autostradën deri në Merdar, pse duhet humbur paratë, kur po e dimë shumë qartë që këto projekte të autostradave ekonominë e Kosovës e “kanë qitë në dy gujt” dhe Kosova është para falimentimit.



Të mos harrojmë, kjo autostradë parashihet të shpronësojë toka bujqësore, të cilat janë në komasacion dhe nën ujitje, ato janë të mbrojtura me ligj.

Qytetarët e Rahovecit janë të shqetësuar për këtë, kanë bërë peticion dhe ne i mbështesim.

Sot isha te berberi dhe a e dini çka më tha? Më tha që çdo i dyti i ri që po vjen, po më thotë kjo është e qethja e fundit që po e bëjnë këtu, se nuk kthehem më në Kosovë. Ta marrim seriozisht këtë dhe ato një miliard euro që i keni ndarë për autostradë, drejtoni kah investimi, po ashtu në Dukagjin, në Gjakovë, në Deçan, në Rahovec, në Prizren, në Klinë, në Istog, atëherë do të kemi zhvillim, atëherë ka sens autostrada pas kësaj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! E harrove Pejën, nëse të dëgjojnë.  
Fjalën e ka zonja Teuta Haxhiu.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, nënkryetar!

Si çdo kund në Kosovë, edhe Dukagjini jo vetëm pse meriton, por do të ndodhë, do ta ketë autostradën dhe do të përfundojmë me autostradat fatmirësisht në kohën më të shpejtë, që të mos veprohet e neglizhohet me vite të tëra një kilometër autostradë dhe të shpenzohen qindra miliona euro.

Pos që do të ndodhë autostrada, unë kërkoj që jeta e qytetarëve, kudo, në çdo fshat, në çdo komunë të tentojmë ta bëjmë jetën më të mirë për ta. E që njerëzit edhe nëpër komuna, po edhe nëpër fshatra kanë nevojë të kenë një jetë më të mirë, janë pikërisht edhe ato fshatra ku nuk kanë mjek, ku nuk kanë teknik medicinal e nevojat e tyre të përditshme janë të udhëtojnë me kilometra larg.

Unë po e ngre një shqetësim, të cilin e kemi marrë nga takimi ynë i grupit të grave deputete në komunën e Prizrenit, nga gratë e komunës së Dragashit që ishin shumë të shqetësuara, ngase nuk e kanë edhe një mjek të vetëm dhe kërkesa e tyre është që ne ta shtrojmë në Parlament një kërkesë që ata të kenë mjek, gjinekolog dhe kërkesa e tyre është gjinekologe femër. Megjithatë, ata nuk kanë as femër, as mashkull mjek, gjinekolog.

Dhe kërkesa e tyre që femrat atje të mos udhëtojnë me kilometra, 30, 40 apo 50 kilometra nga fshatrat e ndryshme të komunës së Dragashit deri në Prizren, vërtet ishte një shqetësim që u ngrit para neve.

Kjo kërkon për një jetë më të mirë për secilin qytetar, por edhe një kërkesë tjetër e tyre ishte që nuk e kanë edhe një femër të vetme police dhe është shumë me interes që të kenë edhe femra, femra police në komunën e Dragashit.

Prioritetet kudo dhe infrastruktura atje në Dragash po shkon falë Qeverisë Haradinaj, mirëpo janë edhe shumë arsye të tjera, të cilat e bëjnë qytetarin të ndihet mirë dhe i sigurt, duke intervenua edhe në fushat e tjera, në arsim, shëndetësi, e të tjera.

Një kërkesë që më herët ishte e Naitit, vërtet ka qenë kërkesë e grupit tonë të Komisionit për të Drejtat e Njeriut dhe jo vetëm të shpallet Muze Burgu i Dubravës, po të ngritet lapidari, siç është kërkesa familjarëve, në vendin ku ka ndodhur masakra. Pra, të ngrihet lapidari në vendin ku ka ndodhur masakra, kjo është kërkesë e familjarëve dhe ne u kemi premtuar që do ta ngremë në Kuvend, por njëkohësisht edhe si komision do t'i dërgojmë të gjitha shkresat qoftë te kryetari i Kuvendit, qoftë te kryeministri...

*(Ndërprerje nga regjia)*

**KRYESUESI:** Faleminderit! Fjalën e ka zoti Hoti.

**ENVER HOTI:** Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Mendoj dhe e ndaj bindjen se është dashur këtu të jetë Qeveria në këtë seancë, por po mungojnë. Unë nuk e di arsyen, por bëj thirrje që ministrat, kryeministri dhe Qeveria të jenë më prezentë në seancat e Kuvendit.

Një temë që dua ta trajtoj sot këtu, ka të bëjë me sektorin e bujqësisë. Ne jemi dëshmitarë që tani për tani në një situatë nëpër të cilën po kalon vendi, bujqësia ka mbetur thuaja i vetmi sektor ku mund të investohet dhe mund të kthehet në punësim, zhvillim dhe në hapje të vendeve të reja të punës. Është i vetmi sektor, i cili mund të rrisë prodhimet vendore dhe përpunimin e atyre produkteve, të cilat mendoj që do të hapin perspektivë të re për shumë njerëz, për shumë fermerë, të cilët kanë gatishmërinë dhe punën e tyre të zellshme ta kurorëzojnë në përfitime dhe të krijojnë një jetë më të dinjitetshme nga puna e tyre. Por, shtrohet pyetja: a është duke ndodhur kjo në mënyrën reale dhe në fakte? Unë mendoj se jo, dhe bëj thirrje nga Kuvendi, Qeveria dhe nga Komisioni për Bujqësi dhe Zhvillim Rural që të shtojë masat e monitorimit dhe të kontrollit në Ministrinë e Bujqësisë, në ASHB, lidhur me grantet dhe subvencionet dhe me destinimin e tyre, ku po shkojnë ato grante, si po shpërndahen dhe a po realizohen në qëllimin e destinacionin e duhur.

Mendoj që ka mjaft të dhëna, kemi mjaft ankime nga qytetarët e ndryshëm, nga fermerët e ndryshëm, të cilët shprehin pakënaqësi, vërejtje edhe me destinimin e tyre, por edhe me përcjelljen e këtyre projekteve deri në fund për t'i realizuar.

Dua t'i bëj thirrje Qeverisë, meqë jemi në fazën e hershme të planifikimit buxhetor mendoj dhe bëj thirrje që Qeveria të ketë një kujdes të shtuar dhe të dyfishojë buxhetin për investimet në bujqësi. Është momenti i fundit kur qeveria duhet t'i ndryshojë projeksionet buxhetore dhe unë po mendoj që tani është koha e fundit që në projeksionin, për buxhetin 2020, qeveria të dyfishojë fondet dhe investimet në sektorin e bujqësisë. Është e mirë e madhe që në buxhetin 2019, 16% e investimeve kapitale janë për mbrojtje të ambientit në Ministrinë e Planifikimit dhe Mbrojtjes Hapësinore, mirëpo mendoj që ky trend tani duhet të kalojë, po përmbyllen mbase autostradat dhe rrugët, për të cilat po bëjmë vërejtje dhe kemi arsye që shprehim shqetësimet tona, është momenti i fundit që sektori i bujqësisë të përforcohet, viti 2020 kujtoj që duhet të jetë një vit, i cili duhet ta bëjë kthesën e madhe në sektorin e bujqësisë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zonja Mimoza Kusari-Lila.

MIMOZA KUSARI-LILA: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Sot jam këtu para jush të bëj një njoftim, njoftimi është për themelimin e Grupit Joformal të deputetëve të gjelbër të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Ndryshimet klimatike të shkaktuara kryesisht nga ngrohja globale paraqesin kërcënim serioz për njerëzimin, ndërkohë që në disa vende veç kanë nisur të ballafaqohen me pasojat shëndetësore, mjedisore, ekonomike dhe politike të këtyre fenomeneve.

Në rrafshin global janë disa konventa dhe procese që janë duke u zhvilluar, Konventa e Kombeve të Bashkuara për ndryshime klimatike, pastaj lansimi i Protokollit të Kiotos dhe Marrëveshja e Parisit. Në formësimin, e veçanërisht në zbatimin e politikave publike që synojnë mbrojtjen e mjedisit, rol të rëndësishëm kanë parlamentet nacionale.

Deputetë të nderuar,

Ne e dimë se në Kuvendin e Kosovës ekzistojnë komisionet e përhershme, është Komisioni për Bujqësi dhe Mjedis, dhe çështjet mjedisore, megjithatë themelimi i këtij grupi synon të përfshijë të gjithë deputetët, të cilët e kanë angazhim, pasion dhe natyrisht besojnë në proces që është i domosdoshëm për ngritjen e masave, mbikëqyrjen e legjislacionit dhe, në veçanti ndikimi në draft ligjet e reja që vijnë në Kuvendin e Kosovës, në aspekt reflektimi i çështjeve mjedisore. Se sa është e rëndësishme kjo, mund të shohim edhe vetë në aspektin global, në nominimin e Greta Thunberg, 16-vjeçare, nga Suedia, një nxënëse, e cila për një ditë thirri në 100 vende të botës dhe është protestuar për çështjet e ndryshimeve klimatike. Përderisa, nuk është e rëndësishme a jemi të kuq, a të kaltër, të djathtë apo të majtë, është e rëndësishme të besojmë dhe të kemi një agjendë të mirëfilltë.

Muaji prill është gjithashtu muaji i Ditës së Tokës, më 22 prill, përderisa në këtë muaj do të ketë edhe aktivitete nga ky grup. Më lejoni që t'ju lexoj edhe emrat e deputetëve themelues: nga grupet parlamentare: Armend Zemaj, LDK, Sala Berisha Shala, PDK, Saranda Bogujevci, Lëvizja Vetëvendosje, Dardan Sejdiu, PSD, Muharrem Nitaj, AAK, Veton Berisha nga Grupi Nisma, Albert Kinolli, 6+ dhe natyrisht unë, Alternativa, këtu me letra të Kuvendit, deputete e pavarur.

Tash, sa i përket themelimit, takimi i parë konstituiv mbahet më 6 prill nga deputetët, të cilët i përmenda, por kjo ftesë u bëhet të gjithë deputetëve të tjerë të interesuar që të jenë pjesë e Grupit Joformal të të gjelbërve, takimi është në Kuvendin e Republikës së Kosovës në orën 13:30. Përderisa takimi hapur me deputetët dhe grupet e interesit mbahet, më 26 prill, ora 10:00, në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Mbështetje për këtë proces kemi nga Instituti Demokratik i Shteteve të Bashkuara, NDI, dhe ju ftoj tash, pas këtij paralajmërimi, të gjithë ata që nuk janë ose nuk ua lexova emrat që të më lajmërojnë që të jenë pjesë e këtij grupi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Zemaj e ka fjalën, s'është zoti Zemaj. Zonja Flora Brovina e ka fjalën.

FLORA BROVINA: Gjatë takimit me qytetarët në Javën e demokracisë parlamentare, të përkrahur nga Instituti Demokratik Amerikan, patëm rastin të njihemi për të satën herë me problemin madhor të qytetarëve të Kosovës Lindore, të cilët jetojnë dhe punojnë në Kosovë, në qytete të ndryshme.

Ata janë qytetarë pa të drejta qytetare dhe pa të drejta juridike, për shkak të mungesës së dokumentacionit, qoftë nga Serbia, qoftë të Kosovës. Kjo është një e padrejtë që po u bëhet atyre, familjeve të tyre dhe është e sata herë që ngremë zërin, tani edhe përmes meje, besoj, do të marrin vesh e gjitha ndodh për shkak të procedurave burokratike dhe të paimteresuara që t'u zgjidhin këtë problem madhor. Disa janë shpërngulur më herët pas përfundimit të luftës, për shkaqe të sigurisë, disa për shkaqe të papunësisë, pra për shkaqe ekonomike, për shkak të shkollimit, martesave dhe të tjera. Kërkesa është në emrin tim, por edhe në emër të tyre. Ajo i drejtohet Presidentit të Republikës së Kosovës, kryeministrit, ministrit të Jashtëm, ministrit të Punëve të Brendshme dhe Komisionit për Bisedime me Serbinë. Kërkoj që sa më shpejt të zgjidhet kjo çështje dhe në bazë të reciprocitetit me Serbinë, të zgjidhet edhe në bazë të ligjeve të Republikës së Kosovës.

Çështja që është si e tillë të prezantohet edhe në takimet ndërkombëtare, por edhe në takimet me Serbinë. Ju që jeni kompetentë për ta zgjidhur këtë çështje, nëse kjo nuk zgjidhet me kohë, shpejt dhe si duhet, do ta keni fajësinë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Hoti e keni fjalën.

AVDULLAH HOTI: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Çështja që do të ngre edhe unë lidhet me projektin e autostradës së Dukagjinit, siç po quhet. Më lejoni të them që kjo nuk është ide e sotme, e këtij mandatit qeverisës, por është para 7-8 vjetëve që është diskutuar si ide. Kur kemi ardhur ne në qeveri në fillim të vitit 2015, është angazhuar BERZH-i për të bërë studimin e fizibilitetit për këtë projekt nga Istogu deri poshtë në Prizren dhe pas disa muajve punë, ata kanë ardhur në konkludim që nuk ka fizibilitet për të ndërtuar autostradë nga Istogu-Pejë-Deçan-Gjakovë e deri në Prizren. Atë që kanë sugjeruar ata është ndërtimi i rrugëve transit që i eviton qytetet nëpër të cilat kalon kjo rrugë, ndërtimi i rreth rrotullimeve në vendbanime dhe ndërtimi i përpjetave dhe tatëpjetave për të evituar kolonat në pikat që janë më problematike që rëndojnë komunikacionin.

Dhe, si rezultat ne patëm filluar atëherë negociatat me BERZH-in për një kredi për riparimin e kësaj rruge komplet që nuk shkon më shumë se 80 deri në 100 milionë. Tash ka një petition nga qytetarët e komunës së Rahovecit, të cilët e kundërshtojnë trasenë e kësaj autostrade. Tash a duhet të ndërtohet kjo autostradë, sigurisht se po, sepse e lehtëson qarkullimin dhe cilësinë e jetës së qytetarëve në atë pjesë. A është momenti për të ndërtuar edhe një autostradë tjetër që shkon mbi 1 miliard euro? Jo! Pse jo? Sepse, ka plot e plot prioritete në atë pjesë të Kosovës. Ne patëm filluar projektin me Bankën Botërore për studim të fizibilitetit, për zgjerim të sistemit të ujitjes së Radoniqit, i cili për momentin mbulon rreth 10 mijë hektarë tokë, prej të cilave vetëm 5 mijë janë në shfrytëzim, mbuluar pra me sistem të ujitjes, për dyfishimin e tokave bujqësore nën sistem të Radoniqit, për të rritur produktivitetin deri në 6 herë në të dy anët e lumit Drini i Bardhë që shkon deri në kodra që prek edhe vreshtat që mbulohen me sistem të ujitjes nga Gjakova deri poshtë afër Prizrenit. Plus impiantet e ujërave të zeza që gjithashtu janë bërë studime të fizibilitetit mbështetur nga Qeveria austriake përmes kredive të buta, disa për projektet, të cilat i kemi kaluar në këtë Kuvend. Kështu që unë besoj që kjo çështje duhet të shqyrtohet më me seriozitet, jo me popullizën dhe sigurisht që duhet të merren deri në fund parasysh kërkesat e qytetarëve të asaj pjese.

Nuk mund të ndërtohet asnjë projekt, i cili vjen në kundërshtim me kërkesat dhe interesat e qytetarëve të atij regjioni. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Besoj që edhe qytetarët nuk janë dakord që të rrinë të izoluar për shkak të dy arave diku. Fjalën e ka zoti Kurti.

ALBIN KURTI: Të nderuar qytetarë të Republikës,  
Deputetë të Kuvendit,  
Kabinet i Qeverisë,

Në Kosovë korrupsioni kurrë nuk ka qenë më transparent. Të gjithë ankohen për korrupsionin, askush për mungesën e transparencës. Ideja e pavarësisë dhe Republikës kanë mbetur pa institucione të politikës. Shtetrrënimi është Presidenti, zhvatja është Kryeministri. Shtetrrënimi

është në vend të shtetndërtimit, ndërkaq zhvatja është në vend të zhvillimit. Dhe, shtetrrënimi nuk është çfarëdo, është shtetrrënim presidencial dhe njësoj edhe zhvatja nuk është çfarëdo, është zhvatje qeveritare.

Pazari ku ndodhet ky pushtet është i trefishtë: pazar me Gjykatën Speciale, pazar me territorin e Kosovës dhe pazar me shpronësimet për asfalt e me punësimet në ndërmarrje.

Për president e për kryeministër, Kosova ka dy bajraktarë fisesh. Këto fise janë të ndryshme, por janë të njëjta, sepse shikohen veçse në pasqyrë. Ata janë të papublikueshëm, janë turpi ynë për paturpësinë e tyre. Nuk na e bëjnë dot as shtetin e as zhvillimin, andaj edhe nuk e duan as shtetin e as zhvillimin. Duhet t'i heqim nga qafa e popullit, sepse s'ua heqim dot pasqyrën nga dora.

Në vjeshtën e vitit 2017 kryeministri e mbronte Nenad Rikallon, duke e shkarkuar vetëm tani në shkurt të vitit 2019. Ivan Todosijeviqin, për deklaratën e 24 marsit, e shkarkoi me mbi dy javë vonesë. Këto dëshmojnë se vetëm kur ngrihen akuza nga mediat për korrupsion qeveritar, ose kur ngrihet vala qytetare kundër hajnisë sikurse tani, kryeministri e bën ndonjë gjest patriotik, sepse ky tanimë e konsideron qeverisjen lojë me letra, me ç 'rast patriotizmi është "xhoker nën mëngë".

Janë mbushur sot 9 muaj të rezolutës së 12 korrikut të vitit të kaluar për mbrojtjen dhe shpëtimin e Telekomit të Kosovës. Mirëpo, në vend se të zbatohet ajo rezolutë, u shpall intenca qeveritare për privatizimin e Telekomit, e ku me shpejtësi po i punësonin familjarët e tyre njerëzit e partisë së kryeministrit.

Prandaj, nuk ka zgjidhje tjetër përveçse të bashkohemi kundër korrupsionit institucional dhe krimin qeveritar. Ky është patriotizmi i ri, sepse është në pyetje, është në pikëpyetje gjithçka: shteti e buxheti, demokracia e ardhmëria. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Fjalën e ka, në emër të grupit të AAK-së, Daut Haradinaj.

**DAUT HARADINAJ:** Faleminderit, nënkryetar!

Me të vërtetë është mirë të falënderohen të gjitha qeveritë e kaluara, domethënë që janë interesua edhe një herë për rrugën e Dukagjinit dhe është e çuditshme sot kur shprehin shqetësim pse mbi 600 mijë banorë duhet të trajtohen prej institucioneve të nivelit qendror. Kur flasim 600 mijë banorë, i bie 1/3 e Kosovës, dhe në rast se i marrim edhe me qytete, përpos atyre raporteve, se ne i dimë sa raporte janë bërë, por kurrëgjë konkrete nuk ka ndodhur. Unë e shkrova këtu, në vitin 2011 është nisur rruga për Pejë dhe akoma ajo rrugë, kush i bie andej e shihni në çfarë gjendje është, e shihni në çfarë kolone është, e dini që prej këtu e deri në Shkup shkohet për 40 minuta, ndërsa në Pejë 1 orë e gjysmë, në Gjakovë 1 orë e gjysmë.

Nëse një qytetar i Kosovës nga Istogu e merr drejtimin për Prizren, në Shqipëri, kjo është arterie që e lidh edhe pjesën e Malit të Zi, rrafshin e Dukagjinit, Prizren edhe del lartë në Qafë Morinë. Nëse një qytetar prej Istogut, qysh e thashë, niset nga Istogu për Shqipëri e është qytetar i Kosovës i bën rrafsh 2 orë e gjysmë. Ndërsa, unë prej Prishtinës në Tiranë shkoj për 2 orë e gjysmë. Ka kaluar koha kur qeveritë janë sjellë për dikë nënë, për dikë njerë. Regjioni i Dukagjinit do ta ketë autostradën e vet dhe lirisht mund t'i përgëzoj se kjo do të bëhet. Edhe qeveritë e tjera kur vijnë, kurdo dhe kushdo, duhet t'i gëzohen këtij projekti, se pa infrastrukturë nuk ka zhvillim ekonomik. Harrojeni që vjen dikush të investojë në atë regjion pa ia krijuar kushtet. I kemi Alpet tona, ne mburremi me to, Bjeshkët e Nemuna, vende turistike, vende atraktive që në të ardhmen mund të jenë pista skijimi, është Borea në ndërtim e sipër, si të jetë ajo potencial për zhvillim ekonomik, kur ne e dimë shumë mirë që pa infrastrukturë s'vjen kurrkush. Do të thotë me miliona jemi duke investuar për një teleferik, ose një projekt që e kemi përkrahur edhe ne qysh kur kemi qenë edhe në opozitë, Borean, për ta zhvilluar atë pjesë, ndërsa sot thuhet nuk ka nevojë për një autostradë.

Miku im, Albin, shumë po kritikon, po thotë që po fshehën patriotizmat kur ka kriza, nuk është ashtu. Unë kam protestuar për ta shkarkuar Jabllanoviçin me javë dhe me muaj, ndërsa sot është dashur t'i dërgohet një sms ministrit dhe t'i thuhet "shko te shtëpia se e ke fyer popullin". Bile unë mendoj që ju sot këtu është mirë ta nxirrni një rezolutë, me të cilën sanksionohet fyerja e luftës sonë për liri, sot të propozohet, ne e japim votën për dhe kushdo që e fyen përpjekjen tonë për liri kur ka filluar, luftën e fundit, sakrificën tonë, ne jemi të gatshëm ta votojmë. Dhe, jo domethënë tash të luajmë nga foltorja, sepse është e pandershme, ne i kemi marrë masat për aq sa kemi kompetenca dhe do të jemi gjithmonë të gatshëm të veprohet njëjtë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Dërguti ka një njoftim shtesë që është me interes për Kuvendin.

AIDA DËRGUTI: Po, faleminderit kryesues!

Ju siç e dini, sot kemi pasur në pikën e katërt të rendit të ditës amendamentin për Konventën e Stambollit, siç quhet shkurtimisht, mirëpo siç e dini, për ndryshimet kushtetuese na duhen edhe 2/3 e pakicës. Me këtë rast, meqë Lista Serbe nuk është prezentë në sallë, kërkohet që ta tërheqim nga rendi i ditës dhe ta vendosim në një seancë tjetër. Qenkan këtu, kryesues.

KRYESUESI: Kur të vijë rendi i ditës, e diskutojmë. Faleminderit! I fundit është zoti Bilall Sherifi.

BILALL SHERIFI: Kryetar, unë për rend dite e kam një mocion procedural.

KRYESUESI: Në rregull, atëherë konsideroj që pika e rendit të ditës: Koha për deklarime jashtë rendit të ditës është shteruar, është tejkaluar bile me kohë.

## 2. Koha për pyetje parlamentare

Fillojmë nga deputeti Topalli, pyetje për kryeministrin Ramush Haradinaj. As deputeti Topalli nuk qenka këtu, as zoti Haradinaj nuk është.

Pyetja e dytë është e deputetit Andin Hoti, pyetje për ministrin Ekrem Mustafa. Andini nuk është këtu, as zoti Ekrem Mustafa nuk është.

Pyetja e tretë është e znj. Safete Hadërgjonaj, pyetje për ministrin Ekrem Mustafa. Zonja Hadërgjonaj nuk është këtu dhe as zoti ministër nuk është këtu.

Pyetja e katërt është e deputetes Mimoza Kusari-Lila për kryeministrin Ramush Haradinaj. Zonja Lila nuk dëshiron ta bëjë pyetjen, për shkak se nuk është kryeministri këtu.

Deputetja Mimoza Kusari-Lila, pyetje për ministrin Uran Ismajli. Zoti Ismajli nuk është këtu. A dëshironi ta bëni pyetjen? Jo, a? Nuk dëshiron ta bëjë pyetjen, meqenëse s'është ministri.

Deputeti Naser Rugova, pyetje për kryeministrin Haradinaj. Zoti Rugova nuk është këtu, as zoti kryeministër nuk është.

Deputeti Sami Kurteshi, pyetje për Kryeministrin Haradinaj. Zoti Kurteshi, dëshironi ta bëni pyetjen? Zoti Kurteshi e ka fjalën.

**SAMI KURTESHI:** Faleminderit, zoti kryesues!

Unë i kam dy pyetje që i kam shtruar qysh në muajin janar, edhe nuk përgjigjen. D.m.th. nuk përgjigjet Qeveria. Hajde dje e kishim seancë të jashtëzakonshme, nuk është Qeveria këtu sepse është e pamundur brenda ditës. Po për këtë seancë Kryeministri bashkë me ministrat e kanë ditur që një javë që kjo seancë është, edhe nuk vijnë.

Prandaj unë po e shtroj pyetjen e parë që ka të bëjë me çështjen e hapjes së vendkalimit kufitar ndërshtetëror midis Republikës së Kosovës dhe Republikës së Maqedonisë në aksin rrugor Gjilan-Kumanovë, në pikën kufitare Stanaj-Bellanoc.

Unë para gjashtë muajsh, tash janë bërë nëntë muaj që e kam bërë këtë pyetje, edhe në atë kohë, sipas hierarkisë në kuadër të kësaj Qeverie, e mori përsipër të përgjigjet zëvendëskryeministri Hoxhaj. Edhe ai zëvendëskryeministri Hoxhaj kishte dalë të bëjë hajgare se nuk e dinte për çka po flitej, ose donte ta gënjente publikun. Është diçka që duket, është fizike, është objektive. Thoshte jo, jo, ajo u hap vendkalimi kufitar moti, po s'po e di ti. Prandaj, unë po e pyes zotin kryeministër kur do të ndërmerren veprime konkrete për hapjen e vendkalimit kufitar midis Republikës së Kosovës dhe Republikës së Maqedonisë në vendkalimin kufitar Stanaj-Bellanoc,



që lidh dy vendbanime të mëdha, Gjilanin dhe Kumanovën, në të vërtetë lidh dy rajone që përfshin një numër shumë të madh të banorëve e në të dy anët janë vetëm shqiptarë.

Nga ana maqedone është afruar rruga, është rregulluar infrastruktura, pse nuk hapet ai vendkalim kufitar? Kjo është pyetja ime. Edhe kur do të hapet? Faleminderit!

**KRYESUESI:** Dy pyetje i ke Sami, vazhdo edhe me tjetrën.

**SAMI KURTESHI:** Pyetja e dytë është përsëri për kryeministrin. Edhe është çështja e mbylljes apo shuarjes së Institutit për Hulumtimin e Krimeve të Luftës në Kosovë. unë mendoj se zoti kryeministër është dashur ta dijë ose është dashur të informohet se Institutit për Hulumtimin e Krimeve të Luftës në Kosovë është mbyllur me vendim të ministrit të Drejtësisë. Ky institut është krijuar me vendimin e Qeverisë në vitin 2011. D.m.th. pas gati shtatë vjet ekzistence, Qeveria e Kosovës e mbyll këtë institut dhe e hap një të ashtuquajtur Departament për Drejtësisë Tranzicionale. Natyrisht emrat është lehtë të vihen, po askush nuk e di çka do të thotë ajo.

Edhe qëllimet e këtyre dy instituteve janë krejtësisht të ndryshme. D.m.th. Instituti për Krime të Luftës kishte për mandat t'i analizojë dhe verifikojë krimet dhe ngjarjet e tjera të rëndësishme, me qëllim të zhvillimit të një baze të dhënash, shënimeve dhe rasteve për ndjekje penale të cilat pastaj mund të shfrytëzohen nga institucionet e tjera të specializuara. Shumë me vend.

Departamenti për Drejtësi Tranzicionale, sipas Ministrisë së Drejtësisë, krijohet me idenë që të plotësojë tri çështje: për të vendosur në binarë të shëndoshë me një burokraci funksionale, pas njëzet a 15 vjet, të ndërtohet një data-bazë që do të ketë kredibilitet institucional dhe do t'u shërbejë të gjitha organeve të drejtësisë. Çfarë data-baze nuk tregon.

Unë edhe krejt deputetët e Kuvendit, edhe qytetarët e Republikës së Kosovës, kemi dëgjuar shpeshherë se ka krime të luftës, ato nuk po hulumtohen, nuk po hetohen. Edhe tash Qeveria e mbyll Institutin për Krime të Luftës, kush ka interes t'i humbë gjurmët e krimeve të luftës?

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zonja Kollçaku, pyetje për ministrin Mustafa. Zonja Kollçaku s'është këtu, as ministri jo.

Zonja Drita Millaku, pyetje për ministrin Uran Ismajli. Zonja Millaku, a dëshironi ta bëni pyetjen? Zonjës Millaku, fjalën! Regjia, zonjës Millaku fjalën! A e ke shtypur?

**DRITA MILLAKU:** Faleminderit!

Meqenëse dy çështje të cilat i kam adresuar, asnjëri prej ministrave nuk janë sot prezent, do t'i bart në seancë e ardhshme.

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Albulena Haxhiu, pyetje për ministrin Abelard Tahiri. Zonja Haxhiu, dëshironi ta bëni pyetjen?

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Ka kohë që e kam parashtruar këtë pyetje, ndoshta që katër muaj dhe nuk kam marrë përgjigje dhe në fakt kjo është problem se është shndërruar në normalitet kjo mungesa e ministrave në kohën e pyetjeve parlamentare. Le që nuk vijnë edhe në pikat e tjera, po as në kohën kur janë thirrur për t'iu përgjigjur pyetjeve të deputetëve.

Arsyeja se pse po e bëj pyetjen, ndonëse ministri mungon, është për shkak rëndësisë që e ka kjo pyetje.

Më 4 korrik 2018, rreth dy mijë punonjës të administratës së gjyqësorit dhe të prokurorisë patën hyrë në grevë. Disa nga kërkesat e grevistëve ishin ngritja e pagave, rregullimi i statusit të tyre, si dhe përvoja e punës.

Më 11 korrik, përfaqësuesit e sindikatës së punëtorëve të judikaturës zhvilluan takime me ministrin e Drejtësisë, ish-kryesuesin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, zotin Nehat Idrizin dhe kryesuesin e Këshillit Prokurorial, në fakt ish-kryesuesin zotin Blerim Isufaj.

Pas tetë ditësh, punonjësit e administratës së sistemit të drejtësisë e ndërprejnë grevën për shkak se atyre iu premtua nga ministri, nga ish-kryesuesi i KGJK-së dhe ish-kryesuesi i KPK-së që kërkesat e tyre do t'i marrin parasysh. Dhe çfarë kemi parë ne, është që ndonëse janë bërë gati një vit prej kur janë bërë premtime në drejtim të realizimit të kërkesave të tyre, Ministria e Drejtësisë nuk e ka ndërmarrë asnjë veprim sa i përket ngritjes së pagave dhe sidomos statusit të veçantë të administratës gjyqësore.

Në momentin kur janë rritur pagat për gjyqtarët dhe prokurorët, ata janë lënë me paga jashtëzakonisht të ulëta. Prandaj duhet të adresohet sa më parë dhe sa më shpejt.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Konjufca, pyetje për ministrin Lluka. Dëshironi ta bëni pyetjen?

GLAUK KONJUFCA: Jo, meqenëse nuk është ministri këtu, nuk ka kuptim kjo.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Xhelal Sveçla, pyetje për kryeministrin Ramush Haradinaj. Xhelali nuk qenka këtu, as kryeministri nuk është.

Po vazhdojmë me pyetjen e parashtruara për herë të parë: Zoti Korab Sejdiu, pyetje për ministrin Uran Ismajli. Zoti Sejdiu, a dëshironi ta bëni pyetjen?

KORAB SEJDIU: Duke pasur parasysh që nuk janë këtu ministrat, nuk po e shoh të arsyeshme ta bëj pyetjen.

KRYESUESI: Zoti Bekim Haxhiu, pyetje për ministrin Uran Ismajli. Zoti Haxhiu!

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Mendoj që pasi që ministri nuk është këtu, unë po e lexoj pyetjen, sepse ka një kohë që është bërë kjo pyetje, prej muajit janar. Ka të bëjë me personat e prekur me sindromën Down, me sklerozën multiple dhe janë 1 400 persona të evidentuar me sklerozën multiple, po aktualisht vetëm 100 prej tyre përfitojnë shërbime falas nga Ministria e Shëndetësisë.

Deri më tani, medikamente për trajtimin e kësaj sëmundjeje nuk janë përfshirë në listën e barnave esenciale. Pra, personat e prekur të moshës së re, njëzet deri dyzet vjet me sklerozë multiple, që është një sëmundje autoimune, që atakon sistemin nervor qendror, nuk mbulohet nga Ministria e Shëndetësisë. Derisa Ministria e Shëndetësisë është në fazën e përpilimit apo të revidimit të listës së barnave esenciale, është kërkesë e shoqatës së personave me sklerozë multiple, që kjo terapi për këta 1 400 persona të prekur nga kjo sëmundje të jenë pjesë e listës së barnave esenciale.

Pra, këtë pyetje e kam parashtruar në fillim të muajit janar, me qëllim që të trajtohet në këtë fazën që është duke e trajtuar Ministria e Shëndetësisë, trajtimin e listës së barnave esenciale, dhe që pjesë e kësaj liste të jetë edhe personat në fjalë.

KRYEUESI: Faleminderit! Zoti Bekim Haxhiu, pyetje për ministrin Bytyqi.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit!

I nderuar ministër,

Pasi këto ditë ne e kemi pasur në shqyrtim Ligjin për arsimin e lartë dhe duke pasur parasysh që ky ligj kërkon një dakordim, edhe një votim të dy të tretave të komuniteteve, bukur vështir e arritshme për situatën aktuale. Dhe, prejse janë hapur universitetet publike, ato janë duke punuar me statutet e tyre, prej fillimit do të thotë të hapjes së tyre, të pandryshuara të paplotësuara.

Në mandatin e kaluar, në fund të mandatit të kaluar, ne kishim në diskutim në Komisionin Parlamentar për Arsim, të gjithë rektorët e universiteteve dhe ishte kërkesë edhe e tyre dhe e jona si deputetë që të bëhet ndryshim i statuteve të këtyre universiteteve, që ato ndryshime të nevojshme për avancimin e arsimit të lartë të bëhen përmes ndryshimit të statuteve dhe ato të jenë në shërbim të studentëve dhe të personelit mësimor për avancimin e mëtutjeshëm të dijes.

Prandaj, pyetja ime parlamentare është se a jeni duke planifikuar që të bëni ndryshimin e statuteve të universiteteve publike?

KRYESUESI: Faleminderit. Zoti Ministër, e keni fjalën!

MINISTRI SHYQIRI BYTYQI: I nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar minsitra,

Deputet, faleminderit për pyetjen! Pa dyshim, siç e theksuat edhe ju, ka një kohë të gjatë që universitete publike, shumica e universiteteve publike vazhdojnë që të menaxhohen nga statuti i vjetër, statuti i përkohshëm që ishte në momentin e themelimit të tyre. Pra, ideja e zgjatjes ka qenë edhe në të kaluarën, por edhe në këtë periudhë, që të kemi Ligjin e ri të arsimit të larë, në mënyrë që t'i nënshtrohen pastaj ndryshimeve bazuar në ligjin që do të ishte në fuqi, e nuk do të kishte nevojë më për ndryshimet në statutin e tyre.

Por, pasi rrethanat aktuale të cilat janë në Parlamentin e Kosovës do ta vështirësonin miratimin e ligjit të ri, ne ato statute të cilat i kemi marrë tash si propozim për ndryshim, kemi filluar që t'i rishikojmë dhe t'i aprovojmë. Aktualisht e kemi vetëm Universitetin e Gjilanit i cili ka prurë një statut me ndryshime dhe që Komisioni pranë Ministrisë së Arsimit, të Shkencës dhe Teknologjisë është duke e rishikuar dhe pritet shumë shpejt që të miratohet dhe të kalojë në Qeveri.

Statutet e tjera, ne do të organizohemi tash me universitetet e tjera në mënyrë që edhe këto universitet t'i sjellin dhe të fillojnë ndryshimet bazuar në Ligjin e arsimit të lartë, pra në ligjin e vjetër i cili është në fuqi, në mënyrë që të mos pengohet puna e tyre në zhvillimin e tyre sipas kërkesave që tashmë i kemi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë, zoti Haxhiu?

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar ministër!

Nëse, dua në kuptimin që të jem edhe më i qartë do të thotë. Ndryshimet të cilat janë të parapara me Ligjin e Arsimit të Lartë, janë shumë ndryshime pozitive dhe unë mendoj që një pjesë e madhe e tyre mund të akceptohen nëpërmjet ndryshimit të statuteve, prandaj edhe ju takon si personi kryesor, përgjegjësi kryesor, për arsimin në Kosovë, që ju të merrni iniciativën dhe të mos lejoni këtë që ajo të zhvillohet në mënyrë stihike, sipas vullnetit apo dëshirës së universiteteve publike, sepse ndoshta ndonjëri prej tyre nuk e ka dëshirën dhe vullnetin të ndryshojë, sepse i konvenon ajo aktuale që është.

Krejt në fund, nëse ka mundësi të na njoftoni se çfarë po ndodh në Zyrën për nostrifikim, sepse aty nuk është duke punuar askush, sipas informatave, dhe lëndët janë duke u zvarritur për procedim.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti ministër e keni fjalën!

MINISTRI SHYQIRI BYTYQI: Deputet,

Siç e theksova, nuk është çështje të mbetet çështje stihie. Është çështje që ne duhet të kemi në program të përbashkët me universitetet, pasi që ligji i ri aktualisht nuk mund të futet në fuqi për shkak të rrethanave të caktuara.

Kjo pyetje e dytë ka të bëjë me diçka krejt të re që s'ka të bëjë me pyetjen reale, por nuk ekziston, e keni informatën e gabuar, zyra vazhdon të punojë dhe punon me shumë përgjegjësi. Nga ajo që ka qenë në pritje të të kaluarës me vite të tëra, tani një individ mund të presë 60 ditë maksimalisht.

KRYESUESI: Zoti Ismajl Kurteshi, pyetje për ministrin Bytyqi. Urdhëro!

ISMAJL KURTESHI: Faleminderit!

Zoti ministër, duke pasur parasysh numrin e madh të mërgimtarëve shqiptarë në botë, sidomos në Evropën Perëndimore, duke pasur parasysh obligimin ligjor dhe moral për të organizuar për fëmijët e mërgimtarëve tanë mësim plotësues në gjuhën shqipe, në lëndët që atyre u ndihmojnë t'i mësojnë gjërat esenciale që duhet t'i dinë si shqiptarë, që janë e sidomos mësimin e gjuhës shqipe, kemi këtë pyetje: sa janë të përfshirë fëmijët e mërgatës tonë në shkollat shqipe në vendet ku jetojnë dhe punojnë shqiptarët, sa shkolla të tilla sot janë funksionale, sa mësues nga Kosova punojnë në këto shkolla, a bashkëpunon Ministria e Arsimit të Kosovës me Ministrinë e Arsimit të Republikës së Shqipërisë në këtë fushë, a ka forma të tjera të përkrahjes së fëmijëve të mërgimtarëve tanë nga ana e MASHT-it dhe çka do të ndërmarrë MASHT-i në këtë drejtim gjatë vitit 2019? Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti ministër Bytyqi e keni fjalën!

MINISTRI SHYQIRI BYTYQI: Faleminderit deputet për pyetjen tuaj!

Një pyetje shumë e rëndësishme. Siç dihet Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe Teknologjisë ka bërë një punë dhe një angazhim për shkollat shqipe në diasporë. Për shifrën e saktë, në fakt ka vështirësi të marrim informacione, pasi që nuk kemi një formë zyrtare të futjes së të dhënave që t'i kemi në çdo kohë, qoftë numrin e nxënësve, qoftë numrin e shkollave. Pra, ajo që shihet në vitin 2018 kemi një rënie të pjesëmarrjes së fëmijëve në mësimin plotësues të gjuhës shqipe. Pra, ne sipas informacioneve, vitin e kaluar kanë qenë rreth 25 mijë fëmijë, pra që është një rënie nga vitet e kaluara, sepse në vitin 2016 mendohet që kanë qenë rreth 30 mijë

Ajo që është bërë nga Ministria, përveç se janë të përpiluar testet e reja të cilat janë përdorur për mësimin shtesë, vitin e kaluar së bashku me Ministrinë e Arsimit në Tiranë ne i kemi kurrikulat unike, pra të përbashkëta për Diasporën, dhe për të cilat është bërë një marrëveshje e përbashkët e të dy ministrive që të zbatohen në territoret ku zhvillohet gjuha shqipe, gjegjësisht mësimi plotësues për mërgimtarët. Mbetet një angazhim i përbashkët edhe i mësimdhënësve vullnetarë të

cilët janë të angazhuar në këto shtete, që të bëjmë një propagandë më pozitive të nxitjes së mërgimtarëve tanë për t'i qar fëmijët në shkollat shqipe.

Përveç që tashmë e kemi një kurrikulë finale, ne mendojmë që bazuar në kurrikulën e përbashkët të dy vendeve, të kemi edhe tekste të reja, të cilat do t'i përshtaten kurrikulës, e cila është miratuar vitin e kaluar. Ne i kemi dy grupe punuese, Shqipëri dhe Kosovë bashkë, për t'i parë që tekstet të cilat kanë qenë deri tash, a janë në përputhje me kurrikulat, apo ka nevojë për ndryshim.

Shto kësaj, në marrëveshjen e përbashkët të Republikës së Kosovës dhe të Shqipërisë është miratuar që i tërë procesi mësimor për shkollat shqipe në mërgim të jetë pjesë e sistemit arsimor. Fatkeqësisht, në Ligjin e arsimit parauniversitar, siç e dini edhe ju, nuk është kompetencë e Ministrisë së Arsimit çështja e mësimin plotësues, është pjesë e Ministrisë së Diasporës, dhe që megjithatë ne kemi një bashkëpunim të mirë dhe po ia dalim që ta mbajmë gjallë gjuhën shqipe nëpër diasporë, me vështirësitë të cilat ekzistojnë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë, zoti Kurteshi?

ISMAJL KURTESHI: Ministër!

S'di a e kuptoni sa e rëndë është barra e përgjegjësisë për ata që në çfarëdo mënyre kontribuojnë në asimilimin e të rinjve tanë.

Mosveprimi i MASHT-it, edhe i ministrive të tjera, edhe i qeverie të tjera, në çfarëdo forme, bart përgjegjësi tepër të rëndë, edhe morale, edhe ligjore.

Edhe një çështje, përgjigja se nuk e dini sa shkolla, nuk na jepni informata të sakta, nuk është përgjigje që duhet të vjen nga Ministria. Këso përgjigjesh i marrim edhe nga mjetet e informimit, ose nga kushdo qoftë, po pres që ju të na dërgoni informata të sakta për numrin e shkollave, për numrin e mësuesve, për numrin e fëmijëve që shkojnë në këto shkolla, në mënyrë që të krijohen mundësi që të marrim masa në vijim për mbulimin e nevojave të të gjithë fëmijëve në diasporë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti ministër, e keni fjalën!

MINISTRI SHYQIRI BYTYQI: I nderuar deputet,

Atë të cilën e ka obligim Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe Teknologjisë është duke e bërë. Ajo çka theksova në fillim është vështirësi që fëmijët të marrin pjesë në mësimin shtesë të gjuhës shqipe. Kjo nuk është që mund ta bëjë Ministra. Është çështje vullnetare e vetë mërgimtarëve sesa janë të interesuar t'i dërgojnë fëmijët e tyre. Ne jemi duke u krijuar kushte.

Atë të cilën e theksova se kemi problem në numër, është arsyeja sepse të gjithë fëmijët shkojnë në mënyrë vullnetare, të gjithë mësimdhënësit i kemi vullnetarë. Nuk e kemi pasur deri sot një sistem ku mund të regjistrohen informata të sakta për secilin vend se sa kemi nxënës nëpër këto vende dhe sa kemi mësimdhënës. Mirëpo, nga statistikat të cilat ne i kemi, sepse ne bëjmë trajnime të mësimdhënësve, kemi informata në ato shkolla shqipe që bashkëpunojnë me Ministrinë e Arsimit dhe del që numri i nxënësve është 25 mijë. Po që mund të ndryshojë, sepse shpesh kemi lëvizje të largimit të nxënësve nga këto mësim shtesë.

*(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetarja e Kuvendit, znj. Aida Dërguti.)*

KRYESUESJA: Pyetja e deputetit Korab Sejdiu për ministrin Pal Lekaj. Nuk do të bëjë pyetje, meqë ministri nuk është prezent.

Deputeti Ismajl Kurteshi, pyetje për ministrin Shyqiri Bytyqi.

ISMAJL KRTESEHI: Faleminderit!

Ministër,

Jam informuar edhe zyrtarisht nga Drejtoria e Arsimit në Komunën e Gjilanit që shkolla e mesme e mjekësisë në këtë qytet ka hapur dy paralele të reja në muajin nëntor. Po, këto paralele janë hapur në koordinim me MASHT-in. Për këtë çështje, edhe ju ministër jeni të njoftuar që një kohë të gjatë. Tani, ajo që më intereson është se a është e vërtetë se këto paralele janë të hapura në koordinim me MASHT-in dhe çfarë keni ndërmarrë ju që këto paralele që janë hapur në kundërshtim me ligjin të sanksionohen. Ata që i kanë hapur natyrisht, këto paralele.

KRYESUESJA: Zoti ministër, e keni fjalën.

MINISTRI SHYQIRI BYTYQI: E nderuara kryesuese,

Të nderuar deputetë,

I nderuar deputet Kurteshi,

Ajo që ju e ngrehët si çështje është një kërkesë e cila neve na ka ardhur nga drejtoria komunale për të cilën pastaj Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë e ka shqyrtuar si kërkesë dhe ka dalë në terren për ta verifikuar situatën nëpërmjet Inspektoratit të Arsimit.

Është konstatuar që në momentin kur kanë konkurruar nxënësit në këtë shkollë, përveç që është pranuar një klasë një paralele e cila ka qenë e lejuar nga Ministria e Arsimit, kemi pasur 118 nxënës të cilët nuk janë pranuar, por që të gjithë kanë qenë nxënës të shkëlqyeshëm.

Pas fillimi të mësim, këta nxënës i kanë tërhequr dokumentacionet dhe nuk janë regjistruar në një drejtim tjetër, dhe si rrjedhojë është krijuar një situatë jo e këndshme në atë shkollë dhe pastaj ka ardhur kërkesa nga drejtoria dhe nga shkolla.

Të gjithë këta nxënës të cilët kanë konkurruar në këtë drejtim kanë vazhduar të shkojnë në shkollë, t'i dëgjojnë mësimet edhe pse ka pasur tentativa edhe nga mësimdhënësit, por edhe nga drejtori të largohen nga mësimi. Si pasojë e kësaj që mos t'i lëmë nxënësit e shkëlqyeshëm jashtë bankave shkollore, atëherë Ministria e Arsimit e ka marrë një vendim që t'ju lejohen edhe dy paralele shtesë për këta nxënës.

Pra, si rrjedhojë nuk kemi pasur humbje të mësimit sepse këta nxënës kanë vazhduar rregullisht t'i dëgjojnë mësimet, dhe në anën tjetër nuk kemi pasur ndonjë implikim financiar, sepse me mësimdhënësit e njëjtë është plotësuar normativi i këtyre mësimdhënësve.

**KRYESUESJA:** Deputet, ke pyetje shtesë? Po!

**ISMAJL KURTESHI:** Ministër!

Besoj që këta nxënës që në nëntor kanë qenë të shkëlqyeshëm, të njëjtit kanë qenë të shkëlqyeshëm edhe në qershor. S'kanë kaluar në nëntor, por e kanë kryer klasën në qershor. Pse atëherë nuk lejuar që në shtator të fillohet viti shkollor, po është hapur me dy muaj vonesë, pra në kundërshtim me ligjin.

Për këtë duhet të marrë përgjegjësi ose ministria e cila nuk ka lejuar të hapet në shtator ose kushdo që është fajtor. Por, në këtë mënyrë jo po lejoni shkeljen e ligjit dhe po e mundësoni korrupsionin edhe të gjitha të këqijat që mund të ndodhin, po edhe po i maltretoni nxënësit.

E keni hapur me dy muaj vonesë, ndërkaq keni mundur që ta hapni në shtator. Kështu që përgjegjësia bie mbi ju që s'keni lejuar që të hapet me kohë, pra në shtator të dyja paralelet.

**KRYESUESJA:** Ministër, fjala për ju!

**MINISTRI SHYQIRI BYTYQI:** I nderuar deputet,

Që të bie përgjegjësia mbi Ministrinë e Arsimit është dashur që kërkesa nga DKA-ja të vinte në shtator që ne ta lejojmë.

Ne nuk kemi pasur kërkesë në shtator nga DKA-ja. Kërkesa e DKA-së ka ardhur në nëntor, pas situatës së krijuar. Pra, nxënësit nuk i kanë tërhequr dokumentet që të shkojnë në një drejtim tjetër dhe ne kemi marrë vendim në të mirë të nxënësve.

Ata të cilët mund të quajnë qoftë korrupsion ose çfarë do formë tjetër, janë organet tjera të cilat mund t'i rishikojnë mund t'i hetojnë dhe mund ët vendosin. Por, Ministria e Arsimit ka marrë vendim në momentin kur i ka ardhur kërkesa nga DKA-ja. E ka shqyrtuar situatën dhe mbi bazën e situatës ka marrë vendim pro nxënësve, në mënyrë që nxënësit e shkëlqyeshëm të mos mbesin jashtë bankave shkollore.



KRYESUESJA: Deputeti Glauk Konjufca, pyetje për ministrin Valdrin Lluka. A dëshiron ta bësh pyetjen, Glauk?

GLAUK KONJUFCA: Jo, se kjo kur nuk po janë ministrat këtu me të vërtetë nuk po ka kuptim ta bësh pyetjen. Faleminderit!

KRYESUESJA: Pra, dy pyetje kanë qenë. Asnjërin nuk dëshiron ta bësh? Në rregull. Deputeti Armend Zemaj, pyetje për ministrin Ekrem Mustafa.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryesuese!

Ministri nuk është këtu. Unë do ta lexoj pyetjen edhe do ta mbaj të drejtën që edhe herën tjetër nëse është i pranishëm.

Pyetja ime konsiston në vullnetin tonë, mbi të gjitha edhe dëshirën që Policia e Kosovës në raport me perceptimin dhe besueshmërinë e opinionit publik ishte në nivel më të lartë para ardhjes së kësaj Qeverie në pushtet.

Me ndërhyrjet e dyshimta për motive politike, kjo besueshmëri çdo ditë e më shumë po zvogëlohet. Pyetja ime është e drejtpërdrejt; çka po bën ky ministër, tash aktual, që Policia e Kosovës të jetë e pavarur e besueshme për qytetarët e vendit dhe në zbatim të plotë të ligjit?

KRYESUESJA: Deputeti Armend Zemaj, pyetje për kryeministrin Ramush Haradinaj.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryesuese!

Kryeministri nuk është këtu. Qeveria e Republikës së Kosovës në programin e saj qeverisës, një ndër objektivat kryesore ka proklamuar fuqizimin e subjektivitetit ndërkombëtar të Republikës së Kosovës, si njohje të reja dhe anëtarësim në organizatat ndërkombëtare dhe rajonale.

Pyetja ime është; sa njohje ka marrë Kosova prej që është mandatur kjo Qeveri? Po ashtu, në cilat organizata ndërkombëtare dhe rajonale është anëtarësuar Kosova gjatë këtij mandati qeverisës? Për tërheqje të njohjeve e dimë, po për këto dy pyetjet tjera, kjo është drejtpërdrejt kryesuesit të Qeverisë.

KRYESUESJA: Deputetja Luljeta Veselaj-Guta, pyetje për ministrin Shyqiri Bytyqi. Regjia, fjalën e ka deputetja Luljeta Veselaj-Gutaj.

LULJETA VESELAJ-GUTAJ: Faleminderit e nderuar kryesuese!

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Është një çështje që është diskutuar disa herë në Kuvendin e Republikës së Kosovës, po që nuk është ndërmarrë, mendoj që nuk është ndërmarrë asgjë deri me tani. Kjo ka të bëjë me peshën e rëndë të çantave të shkollës që është një ndër shkaktarët kryesor dhe me të shpeshtë zoti ministër, të lakimeve të boshtit kurrizor të fëmijëve.

Pasojat e një çante të rëndë që nga hulumtuesit në terren konsiderojnë që është 10 kilogram e sidomos për fëmijët që janë gjashtë dhe shtatë vjeç, ka pasoja të rënda të cilat nuk mund t'i vërejmë ndoshta tani, por ato pasoja do t'i përcjellin këta fëmijë gjatë gjithë jetës. Pra, do të kenë lakim të boshtit kurrizor.

Zoti ministër, cilët janë hapat konkret që ju i keni ndërmarrë gjatë qeverisjes suaj me Ministrinë e Arsimit, për këtë problem që është shumë shqetësues për prindërit po edhe për mësimdhënësit dhe që ndikon drejtpërdrejt në shëndetin e fëmijëve?

**KRYESUESJA:** Ministër, fjala për ju!

**MINISTRI SHYQIRI BYTYQI:** E nderuar deputete, faleminderit për pyetjen!

Konsideroj që është një pyetje e rëndësishme dhe shqetësuese. Siç e theksuat edhe ju është një çështje që ka shumë vite që diskutohet dhe nuk është ndërmarrë ndonjë masë që të eliminohet një çështje kaq e rëndësishme për fëmijët dhe nxënësit tanë.

Ne aktualisht si ministri jemi duke i ndërmarrë tre hapa sipas koherencës në mënyrë që ta eliminojmë këtë ngarkesë të nxënësve që mund të ndikojë direkt në shëndetin e tyre.

E para, presim që tekstet e reja të cilat do të jenë në fuqi në vitin e ri shkollor 2019-2020, do të jenë tekste përtej anës cilësore do të jenë edhe në formë më të lehtë dhe më të organizuar që t'i përshtaten moshës së fëmijëve edhe presim që ky do të jetë hapi i parë që do ta eliminojë peshën e rëndë të çantave.

Hapi i dytë do të jetë për pjesë të tjera të cilat nuk do të kemi tekste të reja, pra për disa klasë. Ne do të organizohemi me të gjitha DKA-të që të kemi një bllok të orëve, pra që të mos ngarkohen me shumë orë fëmijët dhe të kenë shumë peshë të rëndë në çanta, por t'i kemi një bllok të orëve që ta lehtësojmë çështjen e çantave.

Ndërkaq, ndërmarrje afatgjate është çështja e mësimin tërë ditor që do ta eliminojë në tërësi problematikën edhe të peshës së çantave, pro edhe të cilësisë në arsim. Faleminderit!

**KRYESUESJA:** Pyetje shtesë? Po, ka pyetje shtesë.

LULJETA VESELAJ-GUTAJ: Faleminderit!

Kisha pyetje shtesë, po përgjigjja erdhi paraprakisht nga ministri, dhe e falënderoj. Shpresoj që këta hapa të cilët i potencuat tani, të jenë të realizueshëm dhe ta largojmë, ta evitojmë këtë problematikë e cila po përcillet që disa vite nëpër shkollat tona. Faleminderit!

KRYESUESJA: Deputetja Mexhide Mjaku-Topalli, pyetje për ministrin Skënder Reçica.

MEXHIDE MJAKU-TOPALLI: Faleminderit, nënkryetare!

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Unë kam parashtruar këtë pyetje parlamentare që disa muaj. Kjo çështje është diskutuar me vite. Është një temë shumë e ndjeshme. Fjala është për ndarjen e ndihmës sociale familjeve që kanë fëmijë nën moshën pesë vjeçare.

Nëse i referohemi raportit të Avokatit të Popullit të viti 2018. Po ashtu, tani më e kemi në duar secili deputet edhe përmbledhjen e raporteve të Avokatit të Popullit, ku është përsëritur e njëjta kërkesë nga Avokati i Popullit.

Është diskutuar dhe është kërkuar nga shumë deputetë në tryeza në komisione e kështu me radhë. Çështja është përkitazi me ndryshimin dhe plotësimin e nenit 4 të Ligjit nr. 04/L-069 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 2005/15 për Skemën e Ndhmës Sociale në Kosovë.

Neni 4 i këtij ligji kushtëzon ndarjen e ndihmës sociale familjeve që kanë fëmijë nën moshën 5-vjeçare e që me këtë kufizim po rëndohet shumë jeta dhe mirëqenia e qytetarëve të cilët janë në gjendje të rëndë ekonomike.

Ne e dimë se Neni 4 i këtij ligji është në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, standardet ndërkombëtare, veçmas Konventën për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve e cila është drejtpërdrejt e zbatueshme në Republikën e Kosovës.

Andaj, i nderuar ministër pyetja për juve është; çfarë keni ndërmarrë deri më tani, çfarë hapash keni ndërmarrë apo ku keni arritur me proceduar me plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për Ndhmën e Skemave Sociale në Kosovë, në mënyrë që kufizimi i moshës 5-vjeçare të fëmijës të ngrihet në moshën 18-vjeçare në pajtim...

KRYESUESJA: Ministër, fjala për ju!

MINISTRI SKENDER REÇICA: Faleminderit, zonja nënkryetare e Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Kolegë ministra,

E nderuar Mjaku-Topalli, faleminderit për pyetjen!

Çështja që në fakt ju ngrini sa i përket mbështetjes apo asistencës sociale të qytetarëve të Republikës së Kosovës është ashtu siç e cekët edhe ju, edhe në pyetjen tuaj, është e rregulluar me Ligjin për Financimin e Skemave të Asistencës Sociale.

Pikërisht një nga normat ligjore të kësaj kategorie e cila rregullon fushën e skemës së ndihmave sociale është edhe neni i cili i përcakton kriteret se cilat familje mund të gëzojnë të drejtën për mbështetje të asistencës sociale.

Po është e vërtetë, atje kemi një ligj një nen që përcakton si kriter që familjet të cilat do të mbështeten me asistencë sociale, një nga kriteret për ta marrë atë duhet ta kenë një fëmijë më të vogël se 5 vjeç.

Me të marrë mandatin, ne e kemi konstatuar se kjo është një normë ligjore që shikuar në esencë është edhe kundër të drejtave të njeriut. Është edhe antikushtetuese. Mu për këtë, ashtu siç kemi filluar me reforma në shumë fusha të tjera të cilat i mbulon Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, po ashtu në këtë vit në agjendën legjislative të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale e kemi reformën sa i përket sistemit të ndihmës sociale në vend.

Për këtë çështje ne e kemi krijuar grupin punues për ta hartuar koncept-dokumentin nga i cili do të burojnë më pastaj ligji për skemat e ndihmës sociale, ku me kujdes të veçantë do të trajtojmë të gjitha kriteret të cilat përcaktojnë familjet të cilat do të gëzojnë të drejtën për mbështetje të asistencës sociale.

Mund t'ju siguroj që ky kriter, me miratimin dhe plotësimin ose me ligjin e ri, me reformën e re të sistemit të ndihmës sociale nuk do të jetë më pjesë e kësaj fushe e cila e rregullon çështjen e përfitimit të të drejtave në asistencë sociale.

Sikur që do të kemi kujdes që gjatë reformës së skemës së ndihmës sociale t'i eliminojmë edhe mangësitë tjera të cilat i kemi hasur në ligjin aktual i cili rregullon fushën e ndihmës sociale në vend. Faleminderit!

KRYESUESJA: Pyetje shtesë? Po, urdhëro!

MEXHIDE MJAKU-TOPALLI: I nderuar ministër, ne jemi dëshmitar se në vendin tonë një numër i fëmijëve merren me aktivitete punuese që nuk janë për moshën e tyre dhe konsideroj se dëmtojnë zhvillimin e tyre social.

Po ashtu, krijojnë edhe një mundësi potenciale që të jenë subjekt fatkeqësisht pa dashjen e tyre të dukurive negative, por edhe i rrezikut për jetën. Konsideroj se është një çështje me prioritet e cila duhet të trajtohet shumë shpejt.

Nëse i referohem procesverbalit 14 shkurt të vitit 2018, kur ju kemi ftuar në komision, pikërisht e ka ngritur këtë çështje që ka qenë shqetësim si për mua po edhe për të gjithë qytetarët e Kosovës, kemi marrë të njëjtën përgjigje që e thua edhe sot.

Jemi duke punuar në draft-koncept. I kemi krijuar grupet. Domethënë është 1 vit që jeni duke punuar në draft-koncept, i keni formuar grupet. A ka ndonjë lëvizje tjetër, ju lutem?

KRYESUESJA: Fjala për ministrin.

MINISTRI SKENDER REÇICA: Faleminderit, deputete!

Në fakt nëse është përcjellë puna e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, vërehet që për gjatë gjithë vitit 2018, ne kemi ndërmarrë një serë reformash të fushave të cilat ne i mbulojmë në kuadër të përgjegjësive tona.

Për vitin 2018 në bazë të agjendës të punës që e kemi ne, kemi filluar me reformën e skemës së ndihmës së asistencës sociale dhe po është e vërtetë ka zhvillime konkrete.

Deri në fund të pjesës së parë të këtij viti, gjegjësisht deri në fund të qershorit ne do ta kemi të përfunduar koncept-dokumentin dhe nga qershor deri në fund të vitit unë ju siguroj se do ta keni ligjin si Parlament, ligjin e ri për skemat e ndihmës sociale, ku do të eliminohen të gjitha mangësitë që i kemi me ligjin aktual.

*(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.)*

KRYESUESI: Zonja Besa Baftiu, pyetje për ministrin Uran Ismajli.

BESA BAFTIU: Faleminderit, nënkryetar!

Unë pyetjen ministrit Ismajli ia kam parashtruar me 25 shkurt të këtij viti, mirëpo mos mbajtja e seancave të rregullta dhe mos prezenca e ministrave po bën që ne si të zgjedhur të popullit të mos i ngremë çështjet apo pyetjen të shtyhen prej një seance në seancën tjetër.

Pyetja ka të bëjë me studentët e Luginës së Preshevës, të cilët i kanë përfunduar studimet në lëmine e mjekësisë dhe infermierisë në Universitetin e Prishtinës të cilëve nuk po iu mundësohet marrja e licencës nga odat e profesionistëve shëndetësorë.

Pajisja me licencë siç dihet është obliguese për të filluar punën, qoftë si mjek apo infermier.

Mjekët dhe infermierët nga Lugina e Preshevës shumë herë iu kanë drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë për të bërë një zgjidhje në këtë drejtim, por ka vite që po presin.

Prandaj, ne kërkojmë nga ministri që t'ju bëjë zgjidhje këtyre studentëve të cilët po janë të diskriminuar si në Luginën e Preshevës po ashtu edhe në Kosovë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Ismajli nuk është këtu. Në rregull. Atëherë i kemi dy pyetje nga zonja Maloku-Kastrati. Një për ministrin Ekrem Mustafa dhe një për ministrin Abelard Tahiri. Zonja Maloku, e keni fjalën.

DORUNTINË MALOKU-KASTRATI: Faleminderit, nënkryetar!

Atëherë të dy ministrat nuk janë prezentë sot në seancë, megjithatë unë po i lexoj të dyja çështjet që i kam ngritur nëpërmjet pyetjes parlamentare.

Çështja për ministrin Ekrem Mustafa është se muajve të fundit në Kosovë janë shtuar grabitjet e armatosura, me ç' rast janë shënuar edhe viktimat. Qytetarët janë shumë të shqetësuar për uljen e nivelit të sigurisë, për shkak se grabitësit nuk i kanë kursyer as pronat private.

Pyetja do të ishte se, çfarë plani ka Ministria e Punëve të Brendshme për uljen e nivelit të grabitjeve dhe çfarë masash do të ndërmerren lidhur me këtë?

Ndërkaq pyetja për ministrin Abelard Tahiri ka lidhje me mungesën e noterëve në Komunën e Istogut e cila komunë i ka rreth 50 mijë banorë, të cilët po përballen me probleme të shumta për shkak të mungesës së noterëve për t'i kryer shërbimet e noterisë?

Banorëve të Istogut do t'u duhet të udhëtojnë mbi 20 kilometra sepse noterët e autorizuar për të kryer shërbimet për istogasit ndodhen në Pejë.

Ministria e Drejtësisë disa herë ka premtuar që menjëherë pas miratimit të ligjit do ta bëjë zgjidhjen e këtij problemi, por kjo nuk ka ndodhur ende. Pyetja do të ishte; Pse po diskriminohen banorët e Istogut nga kjo e drejtë ligjore? Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Aida Dërguti, pyetje për ministrin Ekrem Mustafa. Aida nuk është këtu. Zonja Sala Berisha-Shala, pyetje për ministrin Shyqiri Bytyqi. Nuk është këtu. Zoti Haxhi Avdyli, pyetje për ministrin Uran Ismajli. Zoti Avdyli nuk është këtu, po ashtu edhe ministri nuk është këtu.

Zonja Mexhide Mjaku-Topalli, pyetje për kryeministrin Ramush Haradinaj. Zonja Topalli e keni fjalën.

MEXHIDE MJAKU-TOPALLI: Faleminderit, nënkryetar!

Pasi që nuk e kemi kryeministrin sot këtu prezent, dëshiroj ta parashtoj pyetjen në seancën e radhës, sepse është çështje që është një projekt shumë i rëndësishëm strategjik dhe zhvillimor për Kosovën dhe dua të marr përgjigje nga kryeministri. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Veselaj-Gutaj, pyetje për ministrin Skender Reçica.

LULJETA VESELAJ-GUTAJ: Faleminderit, i nderuar kryesues!

I nderuar zoti ministër, siguria në vendin e punës po vazhdon të jetë shumë shqetësuese edhe pse kjo çështje rregullohet me dy ligje, me Ligjin e Punës dhe me Ligjin për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, mirëpo në Kosovë, në vendin tonë niveli i sigurisë në punë është shumë i ulët.

Edhe këtë vit për dy muaj nga lëndimet kanë gjetur vdekjen disa persona në vendin e punës. Të drejtat e punëtorë dhe lëndimet, si dhe humbja e jetëve në vendin e punës po mbetet sfidë sidomos në sektorin privat.

Jemi dëshmitarë të një numri të lartë të aksidenteve në vendin e punës dhe fundin tragjik të disa prej këtyre punëtorëve.

Ne e kemi të ditur që pasojat janë si mungesë e pajisjeve të duhura nëpër vendet ku punojnë dhe e ushtrojnë aktivitetin e tyre në punë dhe shumë prej tyre janë edhe të diplomuar, por që nuk punojnë në vendet përkatëse ku atyre u takon.

Siguria dhe mbrojtja në punë zoti ministër nuk është vetëm obligim ligjor, por kjo është nevojë thelbësore për përmasimin e produktivitetit dhe progresin ekonomik të vendit.

Pyetja ime është: më intereson të di se cilët janë hapat konkret që ju i keni ndërmarrë si ministër dhe si ministri për sigurinë në punë dhe çfarë keni bërë për familjet e viktimave? Çfarë masash keni ndërmarrë si ministri ndaj atyre kompanive, të cilat nuk i kanë plotësuar kushtet? Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti ministër, e keni fjalën.

MINISTRI SKENDER REÇICA: Faleminderit, zoti nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

E nderuar deputete Veselaj-Gutaj, faleminderit shumë për pyetjen tuaj.

Në fakt siguria dhe shëndeti në punë është vërtetë një sfidë për institucionet e Kosovës, për të gjithë ne, ngase ka të bëjë me shëndetin dhe sigurinë e punëtorëve në vendin e punës.

Për ta pasur një ambient të sigurt në punë, ju njoftoj se në vitin e kaluar si ministri dhe Inspektorati i Punës kemi ndërmarrë një serë masash si legislative po ashtu edhe vetëdijesuese e inspektuese.

Kemi nxjerrë një serë rregulloresh për siguri dhe shëndet në punë në të cilat janë transpozuar disa direktiva të Bashkimit Evropian. Kemi realizuar disa fushata vetëdijesuese në të cilat kemi vizituar vendpunishtet në ndërtim të lartë si sektor i cilësuar me rrezikshmëri më të lartë, me ç'rast iu kemi kërkuar punëdhënësve dhe punëmarrësve zbatimin e standardeve minimale për sigurinë dhe shëndetin në vendin e punës.

Meqenëse këto forma dhe fushata nuk dhanë efektin e tyre, në muajin tetor dhe nëntor të vitit të kaluar kemi ndërmarrë një fushatë inspektive në sektorin e ndërtimit të lartë në disa qytete të Republikës së Kosovës, ku është cilësuar se është shkalla më e lartë e ndërtimit, si në Prishtinë, Ferizaj dhe Gjilan.

Me këtë rast të gjitha vend-punishteve të cilat nuk i kanë përmbushur standardet për sigurinë dhe shëndetin në punë iu është ndërprerë puna. Kanë qenë mbi 100 vend-punishte që brenda javës iu është ndërprerë puna për shkak të mos zbatimit të kriterëve që kanë të bëjnë me sigurinë dhe shëndetin në punë.

Të njëjtat, brenda një afati kohor që u është shqiptuar gjoha nga Inspektorati i Punës, në masë mbi 80% prej tyre i kanë plotësuar kriteret minimale dhe pastaj u është lejuar vazhdimi i punës, pra pas plotësimit të kriterëve. Të njëjtën gjë jemi duke e bërë edhe në këtë vit.

Deri më tani në disa qytete të Republikës së Kosovës, vetëm këta dy muajt e parë kur ka filluar sezoni i ndërtimit u është ndërprerë puna në mbi 40 vendpunishte. Të gjitha e kanë një vendim nga Inspektorati për pezullim të punës së tyre deri në përmbushjen e kriterëve të cilat janë të parapara me Ligjin për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë.

Natyrisht, në momentin kur inspektorët bëjnë vizitat kthyesë, vizitën e dytë, dhe konstatojnë se punëdhënësit në sektorin e ndërtimit ose dhe në sektorët tjerë kanë filluar t'i aplikojnë masat të cilat janë të parapara, natyrisht që Inspektorati jep vendimin për fillimin apo lejimin e vazhdimit të punës.

Dua t'ju informoj se, përpos ndërtimit të lartë si industri me rrezikshmëri të lartë, Kosova ka probleme të cilat ndërlidhen me sigurinë dhe shëndetin në punë dhe ato janë sëmundjet profesionale në vendin e punës. Ne nuk kemi ende një listë të sëmundjeve profesionale nga Mjekësia e punës dhe gjithashtu nuk kemi një mënyrë se si të edukojmë apo vetëdijesojmë punëdhënësit dhe punëmarrësit... *(Ndërprerje nga regjia)*



KRYESUESI: Edhe një minutë, të lutem!

MINISTRI SKENDER REÇICA: Po gjithashtu këtë edukim ta kemi të pranishëm edhe në shkolla dhe në universitete, si çdo vend tjetër të Bashkimit Evropian.

Si ministri, si asnjëherë më parë, jemi duke trajtuar çështjen e sigurisë dhe shëndetit në punë shumë seriozisht dhe për këtë e kemi paraparë të startojmë strategjinë ndërsektoriale për siguri dhe shëndet në punë, në bazë të së cilës do të trajtojmë sigurinë dhe shëndetin në punë në nivel të vendit, duke koordinuar veprimet edhe me ministrinë e linjës, e po ashtu edhe me institucione të tjera.

Sa i përket marrëdhënies së punës, këtë vit jemi duke zhvilluar një projekt për luftimin e punës së padeklaruar.

Dua t'ju informoj se edhe ky projekt është duke u realizuar në koordinim me institucione të tjera, si ATK, inspektorate, por gjithashtu në këtë projekt do të involvohen edhe aktorë të tjerë.

Ne kemi ndërmarrë edhe masa të tjera legjislative, si hartimi i Projektligjit të punës, Projektligji i inspektorit të punës, gjithashtu këtë vit do të kemi një rritje të inspektorëve të punës dhe tash jemi në procedura të rekrutimit mbi 20 inspektorë të rinj.

Mirëpo, pavarësisht të gjitha këtyre masave, ne si shoqëri duhet të kemi një vetëdijesim së pari si punëdhënës dhe punëmarrës, për të zbatuar legjislacionin...

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër! Pyetje shtesë? Po!

LULJETA VESELAJ-GUTAJ: Faleminderit, zoti ministër për përgjigje!

Po çfarë keni bërë për familjet e viktimave që kanë pasur fundin tragjik në vendin e punës?

KRYESUESI: Zoti, ministër fjala juaj!

MINISTRI SKENDER REÇICA: Faleminderit, nënkryetar!

Fare shkurt, sa i përket çështjes që u ngrit tash së fundit po të shihet koncepti dokumenti, të cilin ne e kemi hartuar rreth reformës së sistemit pensional, kemi paraparë që të gjithë qytetarët e Kosovës, të cilët pa dëshirën e tyre, për fatin e keq, mund të lëndohen në vendin e punës, qoftë edhe me lëndime që mund të sjellin vështirësi në kualitetin e jetës së tyre, natyrisht do të trajtohen dhe do të gëzojnë të drejtat e tyre, sikur edhe në rastet kur punëtori ynë do të pësojë me fatalitet në vendin e punës, familjarët e tyre do të gëzojnë një të drejtë në mbështetje në bazë të skemës dhe reformës së sistemit pensional që e kemi paraparë që tashmë është në duart e Kuvendit dhe të deputetëve.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Reçica! Zoti Sali Zyba, pyetje për ministrin Abelard Tahiri. Zoti Zyba, a dëshironi ta bëni pyetje, ministri nuk është këtu.

SALI ZYBA: Faleminderit, kryesues! Meqenëse pyetja ka më shumë se pesë javë që është shtruar dhe mungon ministri, e shoh të nevojshme për shkak të rëndësisë së saj të bartet në seancat e radhës.

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Besa Baftiu, pyetje për ministrin Uran Ismajli, herën tjetër, ministri nuk është këtu.

Zonja Drita Millaku, pyetje për ministrin Fatmir Matoshi.

DRITA MILLAKU: Ministër, çështja ka të bëjë me një deponi që po derdhen ujërat e zeza në fshatin Landovicë të Prizrenit, po paraqesin rrezik për shëndetin e qytetarëve. I njëjti fenomen po ndodh edhe për mbeturina të ngurta në fshatin Zhur, ku qëllimisht hidhen edhe mbeturinat e natyrave të tjera.

Ministër, çfarë do të ndërmerrni në lidhje me këtë çështje?

KRYESUESI: Zoti ministër, e keni fjalën.

MINISTRI FATMIR MATOSHI: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Të nderuar deputetë,

Ministra,

E nderuara deputete,

Rreth pyetjes që keni parashtruar rreth ujërave të zeza që rrjedhin nga deponia, Inspektorati nga inspektimet e bëra e ka obliguar KMDK-në që të intervenojë në sanimin e problemit të ujërave të zeza që rrjedhin herë pas here nga kjo deponi nga laguna në ujërrjedhën e fshatin Landovicë.

KMDK sipas urdhëresës së Inspektoratit ka ndërmarrë masa, duke ndërtuar edhe një lagunë tjetër për të penguar a eliminuar rrjedhën e ujërave të zeza kohë pas kohe nga laguna.

Ky sistem i menaxhimit të ujërave të zeza bëhet jofunksional sidomos gjatë reshjeve të mëdha sezonale, sepse nuk ka mundësi të mbahet ujë në riqarkullim nëpërmjet sistemit të pompave brenda deponisë ose lagunave për shkak të sasisë së madhe të ujit.

Ju njoftojmë gjithashtu se kjo deponi tashmë ka aplikuar dhe është në procedurë për marrjen e lejes së integruar në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Ndërsa, sa i përket pyetjes tuaj për deponitë e mbeturinave inerte në Zhur, ju njoftoj se kjo është në mbikëqyrjen e Inspektoratit komunal, por edhe përkundër kësaj, Inspektorati i Ministrisë së Mjedisit ka intervenuar dhe tashmë e ka dërguar në gjykatë KRM Ekoregjonin. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë, zonja Millaku?

DRITA MILLAKU: Ministër, kemi raste të ndryshme të personave, qytetarëve, të cilët janë lajmëruar në spitalin e Prizrenit sepse kanë vuajtur nga shëndetit, domethënë shkaku i ujërave të cilat janë ndotur në fshatin Landovicë.

Konkretisht, cilat janë preventivat apo masat të cilat do t'i ndërmerri.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti ministër!

MINISTRI FATMIR MATOSHI: E nderuar deputete, Edhe një herë po e përsëris, që KMDK-ja e ka në përgjegjësi menaxhimin e këtyre deponive. Ajo që unë dua t'ju them është se ata janë në proces të marrjes së lejes së integruar për deponin dhe këtë leje do ta marrin në Ministrinë e Mjedisit vetëm kur të sigurohemi që këto ujëra më nuk do të rrjedhin në ujërrjedhën e Landovicës, sepse edhe për neve, po ashtu sikurse edhe për juve është shqetësues edhe ndotja e ujërave që mund të ndodhë në rrjedhën e Landovicës pas kësaj.

Kështu që masa të tjera ne si ministri nuk mund të marrim, përveç që mund ta përcjellim gjithmonë me inspektime të rregullta të inspektorëve tanë edhe deponinë e Landovicës, po edhe atë të mbetjeve inerte në Zhur, sepse asnjëra nga këto nuk janë në përgjegjësi të plotë të Ministrisë së Mjedisit, pra secila ka një menaxher tjetër dhe nuk e ka Ministrinë e Mjedisit.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Arbër Rexhaj, pyetje për kryeministrin Ramush Haradinaj.

ARBËR REXHAJ: Kryeministri nuk është këtu, unë kam dy pyetje, të cilat do t'i bëj kur është ai i pranishëm në Kuvend.

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Albulena Haxhiu, pyetje për kryeministrin Ramush Haradinaj.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit! Më 29 maj Qeveria Haradinaj ka marrë vendim, përmes të cilit lejohet ndërtimi i objektit për ruajtjen e mbeturinave dhe materialeve të rrezikshme në Fushë-Kosovë, më saktësisht në fshatin Halilaq.

Nga takimet e shumta që kemi pasur me qytetarë dhe banorët atje, por po ashtu edhe banorët e fshatit Halilaq, kemi kuptuar që Qeveria Haradinaj, kryeministri, ministrat kompetentë nuk janë

konsultuar fare me ta dhe kjo është në kundërshtim me nenin 28 të Ligjit për mbrojtjen e ambientit, sipas të cilit një projekt që ka ndikim ambiental e shoqëror mund të bëhet vetëm me konsultim dhe në pajtueshmëri të plotë me banorët që potencialisht preken nga kjo.

Pyetja për zotin Haradinaj është se a kanë bërë ndonjë analizë paraprake se çfarë ndikimi ambiental ka kjo deponi dhe si mund të vazhdoni punimet, duke qenë në kundërshtim me ligjin, përmes të cilit theksohet qartë se vendime të tilla nuk mund të merren assesi pa pëlqimin e banorëve.

Natyrisht, unë dua ta shfrytëzoj të drejtën time që edhe në seancën e ardhshme ta bëj këtë pyetje parlamentare, sepse besoj që është problem kryesor për qytetarët, banorët e Fushë-Kosovës. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zonja Fatmire Kollçaku, pyetje për ministrin Uran Ismajli, ministri nuk është, Fatmirja nuk është.

Zonja Arbërie Nagavci, pyetje për ministrin Valdrin Luka, Arbëria nuk është, as Valdrini nuk është.

Deputeti Avdullah Hoti, pyetje për kryeministrin Ramush Haradinaj, zoti Hoti. Nuk është kryeministri, nuk dëshiron ta bëjë pyetjen.

Zoti Avdullah Hoti, pyetje për ministrin Skender Reçica.

**AVDULLAH HOTI:** Faleminderit, zoti ministër!

Në buxhetin e vitit 2019 janë paraparë disa projekte në veri të Mitrovicës, të iniciuara nga grupi ynë parlamentar. Unë vazhdimisht pranoj pyetje nga ata se ku kanë mbërritur këto projekte.

Një ndër to është ndërtimi i 10 shtëpive në lagjen “Kroi i Vitakut”, kanë qenë edhe në buxhetin e vitit 2018, ju kisha lutur që të kujdeseni nga afër për këto, e kam parasysh që keni kërkuar që të barten në komunën e Mitrovicës veriore, por asgjë nuk ka ndodhur deri më tash.

Unë ju lus që të merrni parasysh këtë çështje, të na informoni ku është procedura dhe të kërkojmë nga ju që në emër të atyre banorëve që ju si ministri të merrni përsipër realizimin e këtyre projekteve të parapara në buxhet. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Zoti ministër Reçica, e ke fjalën.

**MINISTRI SKENDER REÇICA:** Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Faleminderit deputet Hoti për pyetjen!

Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale në kuadër të buxhetit për vitin 2019, në kategorinë ekonomike investime kapitale i janë ndarë mjete për realizimin e projektit të ndërtimit të 10 shtëpive për çdo vit në lagjen “Kroi i Vitakut”, kodi i projektit 18494.

Ashtu siç keni potencuar, ky projekt ka qenë pjesë e planifikimit edhe për vitin 2018, për të cilin projekt Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale i kishte drejtuar shkresë kryetarit të Komunës së Mitrovicës së Veriut për sigurimin e dokumentacionit të nevojshëm për familjet të cilat kanë nevojë.

Lokacioni ku është paraparë të realizohen këto projekte i takojnë pjesës së komunës të Mitrovicës së Veriut.

Andaj, kjo ka ndikuar që për fillimin e zbatimit të këtij projekti të konsultohemi me përfaqësues të institucioneve lokale në atë pjesë të vendit.

Zyrtarët e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, edhe gjatë këtij viti kanë bërë përpjekje për të rënë në kontakt e diskutuar me përfaqësues të Komunës së Mitrovicës së Veriut me qëllim të identifikimit dhe përzgjedhjes së përfituesve, po ende nuk kemi pranuar një përgjigje edhe nga dorëheqja e kryetarëve të komunave tani të pjesës veriore, janë krijuar akoma më shumë vështirësi për realizimin e këtyre kontakteve.

Zbatimi i këtij projekti kërkon bashkëpunim të ngushtë me organet komunale gjatë dhe pas realizimit të projektit, sepse nevojitet respektimi i disa procedurave ligjore siç janë: lëshimi i lejes ndërtimore.

Ndërsa me rastin e përfundimit të projekteve duhet të bëhet edhe bartja e pasurisë në nivel komunal, pasi që kemi të bëjmë me projekte kapitale.

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale do të jetë e angazhuar maksimalisht që sa më parë të fillohet me realizimin e këtij projekti sapo të jenë të plotësuar kushtet ligjore dhe administrative për ndërtimin e këtyre shtëpive. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Pyetje shtesë? Jo!

Zonja Ganimete Musliu, pyetje për ministrin Endrit Shala, zonja Musliu e keni fjalën.

**GANIMETE MUSLIU:** Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Më vjen mirë që ministri Shala është këtu për t'iu përgjigjur pyetjes, e vlerësoj që i ka marrë në konsideratë pyetjet parlamentare.

I nderuar ministër,

Ka tre muaj që kur Kosova vendosi taksë doganore, vërtet tash janë bërë katër muaj, se pyetjen e kam bërë para një muaj, pikërisht sot një muaj e kam bërë pyetjen.

Që kur ka vendosur taksë doganore 100% për importet nga Serbia dhe Bosnjë e Hercegovina, nga ajo kohë importi nga këto vende ka rënë tërësisht, po në tregun e Kosovës nuk vërehet shumë mungesa e produkteve nga Serbia.

Në anën tjetër, edhe zëvendësi i doganave vazhdimisht raporton se për gjatë këtyre tre muajve nuk ka pasur rritje të kontrabandës as në veri të vendit, e as në pjesë të tjera të Kosovës.

I nderuar ministër Shala,

Pyetja ime konkrete është: A mund të na tregoni se çka po ndodh, që raftet kurrsesi nuk po zbrazen nga këto produkte serbe, si po hyjnë këto mallra dhe cili është efekti real i takës 100% ndaj këtyre mallrave?

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti ministër, e keni fjalën.

MINISTRI ENDRIT SHALA: Faleminderit!

I nderuar kryesues,

Të nderuar deputetë,

E nderuar deputete zonja Musliu,

Më lejoni që në emër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë t'ju njoftoj që nga data 21 nëntor 2018, kur edhe është nxjerrë vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës për vendosjen e masës 100% për produktet e importuara nga Serbia dhe Bosnjë e Hercegovina, ministria ka ndërmarrë të gjitha veprimet për zbatimin e këtij vendimi, natyrisht në pajtim me mandatin dhe kompetenca e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë.

Si rrjedhojë e këtij vendimi MTI-ja, respektivisht Inspektorati i Tregut në kuadër të kësaj ministrie ka regjistruar afro 1000 inspektime të operatorëve ekonomikë, të cilët veprojnë në tërë territorin e Republikës së Kosovës dhe me këtë rast janë verifikuar në hollësi të gjitha produktet e importuara, e sidomos nga këto dy shtete.

Inspektimet në gjithë Republikën e Kosovës janë bërë dhe po bëhen në bashkëpunim të ngushtë edhe me inspektoratet komunale.

Po ashtu Inspektorati i Tregut të MTI-së ka realizuar afro 540 inspektime, kurse Inspektorati komunal i Tregut afro 400 inspektime, e këto në përgjithësi do të thotë rezultojnë me 1000 inspektime te operatorët ekonomikë me qëllim të monitorimit të zbatimit të dispozitave ligjore për vendosjen e flamurit të origjinës së produktit.

Me qëllim të heqjes së çdo dyshimi për kontrabandë, por edhe për të verifikuar produktet në tregun e Republikës së Kosovës, unë gjatë muajit shkurt të vitit 2019 kam nxjerr urdhëresë për Inspektoratin e tregut, të cilët e kanë për obligim dhe janë të urdhëruar të verifikojnë dokumentacionin e importit dhe tregtimin e produkteve sidomos me origjinë nga Serbia dhe Bosnjë-Hercegovina. Me fokus me këto importe të cilat janë të realizuara pas hyrjes në fuqi të vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Kjo urdhëresë është edhe sot edhe kësaj dite në fuqi.

Dhe e them me kompetencë të plotë se çdo ditë inspektorët e tregut të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, por edhe inspektoratet komunale po vazhdojnë monitorimin e secilit produkt me origjinë nga këto vende.

Gjatë realizimit të këtyre aktiviteteve...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESI: Përfundo diskutimin, zoti ministër, i keni minutat, i dini. Po përgjigje, nuk është debat ky, është pyetje dhe përgjigje konkrete. Zonja Musliu, pyetje shtesë?

GANIMETE MUSLIU: Ministër, unë të përgëzoj për të gjithë hapat që keni ndërmarrë dhe ju përgëzoj për vendimet, inspektimet, të gjitha.

Pyetja ime ishte shumë konkrete, nëse e dëgjuat me vëmendje. Thjesht, çka është duke ndodhur që nuk po zbrazen raftet nga mallrat serbe dhe cili është efekti real i taksës 100%. Me një fjali mund të japësh një përgjigje për këtë çështje. Nëse themi që mallrat nuk po blihen, a do të thotë që kemi mallra me afat të skaduar në rafte, thjesht ku është problemi që raftet i kemi plot dhe cili është efekti real i taksës 100%? Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti ministër, fjalën e keni.

MINISTRI ENDRIT SHALA: Përgjigjja në emër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, ju e di Parlamenti i Republikës së Kosovës e ka miratuar edhe Ligjin për mbrojtjen e konsumatorit, në kuadër të këtij ligji unë e kam nxjerrë edhe Udhëzimin administrativ për vendosjen e flamurit të

originës të secilit produkt dhe kjo ka sjellë edhe vetëdijesimin e qytetarit të Republikës së Kosovës, i cili nuk po i blen më produktet e Republikës së Serbisë dhe Bosnjë e Hercegovinës.

Secili produkt ka afat. Ne jemi të vetëdijshëm që masa është vendosur më 1 nëntor të vitit 2018, do të thotë ka produkte në tregun e Kosovës të cilët kanë afat më shumë se njëvjeçar.

Përgjigjja e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë është kjo. Me hyrjen në fuqi të Ligjit për mbrojtjen e konsumatorit, respektivisht nenit për vendosjen e flamurit të originës, ne me këtë ligj i kemi ndihmuar qytetarët e Republikës së Kosovës në vetëdijesimin e tij se çfarë produkti po blen, dhe qytetari i Republikës së Kosovës nuk është duke e blerë, nuk është duke i konsumuar mallrat nga këto dy shtete. Dhe kjo është një arsye pse këto mallra janë në raftë.

Edhe një herë po e ripërsëris. Në asnjë inspektim nga këto 1000 inspektive në kompetencë të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë nuk është hasur asnjë mall në tregun e Republikës së Kosovës, i cili nuk është i pajisur me dokumentacionin siç e përcakton ligji në fuqi.

Do të thotë me dokumentacionin doganor, me krejt procedurat ligjore që ka kaluar një mall. Faleminderit!

Efkti i taksës, po, mund t'ju them. Në periudhën 22 nëntor 2017 deri më 10 prill 2018 importi nga Serbia ka qenë 163 milionë euro.

22 nëntor 2018 deri më 10 prill 2019 është 8 milionë euro. Nga Bosnjë-Hercegovina nëse e krahasojmë 22 nëntor 2017 deri në prill 2018 ka qenë 28 milionë euro, 28 nëntor 2018 deri më 10 prill 2019 ka ra në 2 milionë euro.

Për këtë jeni të vetëdijshëm edhe ju, edhe ne. Edhe unë mendoj që kjo masë e Qeverisë së Republikës së Kosovës do të mbesë në fuqi dhe do të vazhdojë të mbetet në fuqi. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Deputetja Ganimete Musliu, pyetje për ministrin Skender Reçica.

**GANIMETE MUSLIU:** Faleminderit, nënkryetar!

Po ashtu prapë e falënderoj zotin Reçica që është sot këtu për t'iu përgjigjur pyetjes që unë e kam parashtruar.

Të punësuarit në sektorin privat në Kosovë flasin për shkelje të mëdha të drejtave të tyre në punë.

Orari i stërzgatur i punës, punësimi pa kontratë pune, pagesa jo e rregullt, pasiguria në punë janë disa nga shkeljet në të cilat përballen këta punëtorë.



I nderuar ministër Reçica,

Inspektorati i Punës së Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale e ka për detyrë parësore të bëjë mbikëqyrjen e Ligjit të Punës, Ligjit për sigurinë në punë, mbrojtje të shëndetit të punësuarve dhe ambientit të punës.

A mund të na thoni sa po arrini përmes këtij organi të mbikëqyrni zbatimin e këtyre ligjeve dhe çfarë keni bërë konkretisht për të përmirësuar gjendjen e punëtorëve dhe mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve në sektorin privat, edhe pse një pjesë të përgjigjes e morëm nga pyetja paraprake që u bë nga deputetja Luljeta Veseli-Gutaj, po megjithatë, më intereson të di për punën e inspektoratit se sa po arrini përmes inspektoratit që të mbikëqyren këto ligje dhe a kemi ndonjë reagim nga ata ose ndonjë shenjë që këto ligje duhet të plotësohen ose të ndryshohen, çka duhet të bëjmë edhe ne si deputetë në këtë drejtim?

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zoti ministër Reçica, e keni fjalën.

**MINISTRI SKENDER REÇICA:** Faleminderit, zoti nënkryetar i Kuvendit!

E nderuar deputete Musliu,

Faleminderit, shumë për pyetjen!

Në fakt, që të mos përsëritëm nga përgjigjja që kisha me deputeten Veseli Gutaj, dua të shtoj.

Inspektorati i Punës është organi i cili mbikëqyrë zbatimin e Ligjit të punës, ligjin që ka të bëjë me sigurinë dhe shëndetin në punë. Në fakt, është organi i cili duhet të monitoroj të gjitha të drejtat të cilat burojnë nga këto ligje që prekin punëtorët tanë.

Realisht ne e kemi trashëguar këtë institucion në gjendje çfarë e kemi trashëguar.

Dhe unë dua t'ju sugjeroj një gjë, që nga momenti kur unë e kam marrë mandatin ky institucion ka rritur angazhimin e vet, është duke punuar me përkushtim dhe po të futet në analizë dhe shikohet puna në të kaluarën e këtij institucioni dhe puna e tanishme e këtij institucioni, shifrat flasin vetë. Është dyfishuar numri i inspektimeve, është dyfishuar, numri ndoshta trefishuar numri i inspektimeve në terren i daljeve në terren, po kjo nuk po mjafton.

Ne jemi të vetëdijshëm që nuk e kemi prej më të mirë situatën as sa i përket sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës, as sa i përket të drejtave të punonjëse.

Dhe ne po përpiqem brenda mandatit që e kemi bashkërisht me inspektoratin që ta ngremë shkallën e vetëdijesimit tek punëdhënësi dhe punëmarrësit.

Ne kemi marrë një sërë fushatash vetëdijesuese që ta ngremë vetëdijen e punëdhënësve që në rastet kur vërehen se nuk ka siguri dhe shëndet në vendin e punës, të denoncojnë, të paraqesin

ato raste, sikur që po përpiqemi tani që me fushata, me bashkëbisedime, me takime, me vizita nëpër vende të ndryshme punuese që t'i bindim punëdhënësit që në rast se nuk respektohen të drejtat e tyre, nuk është marre të paraqiten ato në organet kompetente, të cilat janë të thirrur për t'i mbrojtur të drejtat e tyre.

Dhe së fundit kemi dalë bashkërisht me inspektoratin, kam dalë edhe vetë në terren për të parë nga afër, për t'u informuar nga afër. Vërehet një hezitim publik i punëdhënësve për të raportuar shkeljet, të cilat mund t'i kenë nga punëmarrësit, dhe ne vazhdimisht po përpiqemi dhe po u bëjmë thirrje që nuk duhet të ketë hezitim në këtë drejtim.

Nuk duhet të ketë fare hezitim...

*(Ndërprerje nga regjia)*

**KRYESUESI:** Çdo herë nga një minutë. Pyetje shtesë?

**GANIMETE MUSLIU:** Faleminderit, ministër!

Nuk ka vend më i mirë se nga kjo foltore të bëhet sensibilizimi dhe të jepet një apel për punëtorët.

Është lehtë t'u thuhet punëtorëve ankohuni dhe flisni për këtë çështje. A keni bashkëpunuar si ministër ndonjëherë me gjykatat e Kosovës që të kërkonin që ankesat që vijnë nga punëtorët e sektorit privat të trajtohen me prioritet, sepse asnjë punëtorë nuk mund të presë 2, 3 e 6 vjet pa u trajtuar lënda e tij, e para.

E dyta, më intereson të di, shpeshherë jeni ankuar për numrin e vogël të inspektorëve, a është rritur numri i inspektorëve të punës?

Edhe tjetra, më vjen shumë keq nëse t'i merr krahasime dhe thua: "Ka qenë më herët keq, e tash është më mirë". Jo, nuk është mirë, as nuk ka qenë atëherë, as nuk është tash dhe duhet të bëhet shumë më mirë, ministër, sepse njerëzit po vdesin në vendet e punës dhe ne s'po japim përgjegjësi, askush s'po jep përgjegjësi për jetën e tyre.

**MINISTRI SKENDER REÇICA:** Deputete, në fjalën time thashë që nuk e kemi prej më së mirë situatën sa i përket as sigurisë në vendin e punës, e as respektimit të drejtave të punonjësve.

Ne po përpiqemi maksimalisht që ta ndryshojmë këtë gjendje dhe ka ndryshime pozitive. Nëse futet në analizë, ka ndryshime pozitive.

Sa i përket numrit të inspektorëve, realisht kemi një numër çfarë e kemi, jemi në procedurë të rekrutimit të mbi 20 inspektorëve, procedurat e rekrutimit në shërbimin civil i kanë rregullat e veta, procedurat e veta dhe ne jemi duke punuar në rekrutimin e tyre.

Sa i përket lëndës që presin në gjykatë për drejtat, të cilat punëtorët ankohen në gjykatë, është sistemi i drejtësisë ai që i ka rregullat e veta dhe natyrisht, një ide jashtëzakonisht e mirë që ndoshta me ministrin e Drejtësisë ne mund të bashkëpunojmë me qëllim që kjo procedurë të përshpejtohet dhe të drejtat e punonjësve, kur vërehet se ka shkelje, të kemi edhe vendime gjyqësore për t'i vërtetuar ato shkelje të mundshme.

Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Dardan Sejdiu, pyetje për ministrin Ekrem Mustafa.

DARDAN SEJDIU: Faleminderit, kryesues!

Ndonëse ministri nuk është këtu, çështja është edhe aktuale, edhe tepër problematike. Unë po e lexoj pyetjen dhe ministri kurdo që është këtu, besoj që do të gjejë kohë që të përgjigjet.

Numri i aksidenteve në komunikacion, të cilat po rezultojnë me humbje të jetës së njerëzve çdo ditë e më shumë është në rritje dhe çdo ditë e më shumë po shpërfaqet para nesh. Rastet e raportuara për humbje të jetëve njerëzore si pasojë e aksidenteve rrugore po bëhen tepër shqetësuese për të gjithë. Pyetja ime për ministrin është kjo: a ka ndonjë raport vjetor për arsyet e shkaktimit të aksidenteve me vdekje dhe a e ka ministri idenë edhe informacionin e saktë për shkaktarët e fatalitetit? Pra, çka, në fakt, është shkaktari kryesor i fataliteteve në aksidentet rrugore? Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Driton Selmanaj, pyetje për kryeministrin Ramush Haradinaj. Driton a je këtu? Po!

DRITON SELMANAJ: Faleminderit!

Unë këtë pyetje e kam bërë shumë moti dhe tash po ndodhin dy arsye: e para, kemi dalë prej rrjedhës normale të punimeve të Kuvendit dhe pyetjet po vonohen me muaj të tëra, dhe e dyta, kur po vjen pyetja, kryeministri s'është këtu. Unë kam ardhur në përfundim që kjo Qeveri s'meriton as pyetje t'i bëhet, kështu që pyetja ime tërhiqet krejt. Mos e bartni për seancën e ardhshme, tërhiqeni krejt!

KRYESUESI: Tani toleranca e deputetëve ndaj Qeverisë është e madhe, realisht ne mund të marrim masa ndaj Qeverisë, ajo ndaj neve s'munde të marrë masa. Kështu mendoni masat që mund t'i marrim ne si deputetë dhe Qeveria renditet këtu në secilën karrige, se ne bëhemi pastaj të padëgjueshëm. Ju me deklarata, këta s'po marrin vesh, përveç disave që janë të ndërgjegjshëm edhe vijnë, të tjerët nuk vijnë.

Nënkryetarja e Kuvendit, Aida Dërguti, pyetje për zëvendëskryeministrin dhe ministrin e Punëve të Jashtme, zotin Behxhet Pacolli. Zonja Dërguti, a dëshironi ta bëni pyetjen? Ministri s'është këtu.

AIDA DËRGUTI: Faleminderit, kryesues!

Mirëpo, meqë ministri nuk është prezent, po e lë për seancën e radhës.

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Shqipe Pantina ka pyetje për kryeministrin Ramush Haradinaj, edhe zonja Pantina, në mungesë të kryeministrit, dëshiron ta lërë pyetjen për seancën e ardhshme.

Besoja që edhe pyetja tjetër që është e zonjës Pantina po për kryeministrin, në mungesë të kryeministrit shtyhet për seancën e ardhshme.

Deputeti Xhelal Sveçla, pyetje për ministrin Rrustem Berisha, Xhelali nuk është këtu, ministri nuk është këtu.

Deputeti Shemi Syla, pyetje për ministrin Shyqiri Bytyqi. Shemi, fjala është juaja.

SHEMSI SYLA: Zoti ministër,

Degradimi i arsimit shqip në Kosovë është rezultat i reformave të fokusuara në formë dhe jo në përmbajtje. Këtë rend të reformës në arsim e kemi hasur që nga paslufta, fillimisht nga të huajt, por edhe pas themelimit të Ministrisë së MASHT-it është eksperimentuar në këtë drejtim. Përpjekja për të kopjuar modelet e arsimit nga vendet e zhvilluara, ligjet, rregulloret, e tjera, pa i përshtatur fare me nevojat tona gjendjen e përgjithshme ekonomike, kulturore, sociale, etno-psikologjike dhe shkallën e zhvillimit të përgjithshëm, është vetëm një nga parregullsitë që na është shitur nën logon e reformës.

Dihet se pedagogët nga shkollat tona u larguan nga përbërja e parë e udhëheqjes së MASHT-it 2002-2004, pa u bërë një analizë konkrete, por të themi se me një urdhër të çastit të një këshilltari të ministrit. Asokohe u tha se pedagogët do të zëvendësohen me psikologët nëpër shkolla, pavarësisht se pedagogu ka tjetër rol, e psikologu tjetër, mirëpo shkollat tona mbetën në shumicën absolute pa pedagogë dhe psikologë. Zoti ministër, lind pyetja: mungesa e pedagogëve dhe psikologëve ka sjellë pasoja të rënda për shkollat tona. Kur pritet që në shkollat tona të kemi pedagogë dhe psikologë?

KRYESUESI: Zoti ministër Bytyqi, e keni fjalën.

MINISTRI SHYQIRI BYTYQI: Faleminderit, kryesues!

I nderuar deputetë,

E para, koha e kaluar më nuk kthehet, tash jemi këtu, nuk është që shkollat tona nuk kanë pedagogë e psikologë, shkollat tona kanë pedagogë e psikologë, por nuk kanë të mjaftueshëm, për arsye se sipas Udhëzimit 26/2013 të vitit 2013, është përcaktuar numri i psikologëve dhe i pedagogëve bazuar në numrin e nxënësve, ku në 1 mijë e 500 nxënës duhet të jetë një pedagog ose psikolog, që iu ka lënë në dispozicion komunave sipas Ligjit parauniversitar të përcaktohen për pedagogët ose psikologët.

Ajo çka ka ndodhur në realitet kemi një mosrealizim të punësimit të pedagogëve ose psikologëve nga komunat, duke punësuar mësimdhënës në vend të pedagogëve dhe psikologëve. Këtë vit ne jemi duke i marrë informacionet se ku janë zëvendësuar psikologët ose pedagogët në mësimdhënës në mënyrë që të eliminohet një. Dhe, hapi i dytë, në vitin 2020 tashmë në kornizën afatmesme të shpenzimeve ne i kemi futur që për 1 mijë nxënës të kemi një pedagog apo një psikolog. Do ishte shumë më e arsyeshme që të kemi shumë më shumë pedagogë e psikologë, por ju e dini që nuk është lehtë që ta shtojmë numrin për shkak të buxhetit dhe lejimin që kemi nga Ministria e Financave për shkak të implikimeve buxhetore.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Sylja, pyetje shtesë?

SHEMSI SYLA: Mungesa e pedagogëve mund të jetë arsye tjetër shtesë për vënien e cilësisë, mësimdhënësit duhet të kishin një adresë për këshillat, por edhe një monitorim të vazhdueshëm të performansës. Në anën tjetër, rezultatet e hulumtimeve nga Organizata Botërore e Shëndetësisë na tregojnë që nxënësit tanë kanë nivel më të lartë të ngacmimeve, dhunës në mesin e 44 shteteve të ndryshme.

Ju lutem, a ndjeni përgjegjësi si ministër prej kohës kur keni ardhur në këtë post që nuk keni bërë në këtë drejtim më shumë për të ndikuar që të jenë pedagogët dhe psikologët, për shkak të devijimeve të shumta që kemi në shkollat tona nga nxënësit, ku është shtuar përdorimi i narkotikëve, vetëvrasjeve, vrasjet, ngacmime të tjera, e tjera, e tjera. A ndjeni ju përgjegjësi si ministër në këtë post se nuk është bërë mjaft?

KRYESUESI: Zoti ministër, e keni fjalën.

MINISTRI SHYQIRI BYTYQI: I nderuar deputet,

Kjo pyetje që nuk është bërë mjaft është pak hipotetike, se duhet të dimë se çka nuk është bërë mjaft. Nuk varet nga Ministria e Arsimit se sa duhet të jetë numri i pedagogëve e psikologëve dhe mundësia e Ministrisë së Arsimit. Po të pyetj vetëm Ministria e Arsimit dhe vetëm ministri, ne do të kishim shumë më shumë pedagogë dhe shumë më shumë psikologë, por kjo varet nga aprovimi që duhet të vijë për shkak të implikimeve buxhetore dhe nga Ministria e Financave dhe Ministria e Administratës Publike. Ajo çka është e mundur, ne e kemi bërë, dhe nuk janë faktorët e vetëm për gjendjen në arsim psikologët dhe pedagogët.

KRYESUESI: Faleminderit! Prapë zoti Shemsi Syla, pyetje për ministrin Bytyqi. Fjala është e zotit Syla!

SHEMSI SYLA: Zoti ministër!

Është bërë mirë që nxënësit me aftësi të kufizuara gjithnjë e më shumë po shkojnë në shkolla të rregullta, me qëllim që ata të socializohen dhe të mos ndjehen të marginalizuar dhe kjo është anë e mirë. Mirëpo, kudo në botë që aplikohet kjo praktikë dihet se mësuesi e ka ndihmësmësuesin ose mësuesen apo asistentin që merret me këta nxënës. Kurse, në shkollat tona nuk po veprohet kështu dhe mësuesi është vënë në pozitë të vështirë.

Ajo që më shqetëson akoma më shumë është fakti që ne nuk kemi bërë fare analizë të numrit të fëmijëve me aftësi të kufizuara në sistemin tonë arsimor. Pyetja: sa prej tyre janë përfshirë në edukimin e rregullt? Sa ndihmësmësues kemi në shkollat tona, nëse ka ndonjë dhe kur pritet të zgjidhet ky problem?

KRYESUESI: Zoti ministër, e keni fjalën!

MINISTRI SHYQIRI BYTYQI: Faleminderit, kryesues!

I nderuar deputet, e para ekzistojnë statistikat e sakta, kemi 3 mijë e 768 nxënës, të cilët janë të inkuadruar në shkollat e rregullta dhe kemi disa qendra burimore, të cilat i kemi për shkak të paaftësive të këtyre nxënësve të shkojnë në shkolla të rregullta.

Ministria e Arsimit e ka për obligim dhe po vazhdon që të gjithë nxënësit e mundshëm të integrohen nëpër shkolla të rregullta dhe mbi këtë bazë po punohet që të kemi edhe asistentë shtesë. Është bërë një punë e jashtëzakonshme nga ministria që nga momenti kur unë kam ardhur si ministër. Deri më tani i kemi 83 mësues mbështetës të këtyre fëmijëve, ndërsa në këtë vit ne kemi realizuar që të kemi 100 asistentë shtesë që komunat do t'i punësojnë sipas nevojave dhe sipas kërkesave dhe po ashtu kemi planifikuar që për 3 vjetët e ardhshme të kemi edhe 300 asistentë shtesë, pra për çdo vit nga 100 asistentë shtesë do t'i përgatitim dhe do t'i punësojmë në këto shkolla, aty ku kemi nevojë. Përveç kësaj do të kemi edhe 25 asistentë shtesë nëpër qendrat burimore.

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë?

SHEMSI SYLA: Në të kundërtën, faktet flasin ndryshe, se ende nuk është shpallur konkurs për t'u pranuar këta asistentë dhe ende është mungesë e tyre. Prandaj, promovimi gjithëpërfshirës pa krijuar kushte është fare, nëse nuk janë bërë konkurset, nëse nuk janë parapërgatitur kushtet për t'u bërë ajo punë, kjo është ende në mangësi.

Unë mendoj se është një lloj farse ndoshta e kësaj qeverie, por edhe e qeverive të tjera, të cilat nuk e kanë realizuar këtë segment shumë të rëndësishëm të jetës arsimore. Këtu shihet qartë që mungon vullneti për ndryshim, shpeshherë janë vetëm deklarata, të cilat bëhen në ditë promovimi ose deklaratave për autizëm të manifestimeve të ndryshme, ku qahet halli i këtyre fëmijëve, të cilët kanë mangësi në përkujdesjen e tyre. Mungesa e ndihmës...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESI: Zoti ministër, e keni fjalën.

MINISTRI SHYQIRI BYTYQI: I nderuar deputet,

Unë nuk e kam idenë se nga po i merr informacionet, unë po t'i jap informacionet zyrtare, 83 janë të punësuar, ndërsa në vitin 2019 do të punësohen 100 asistentë, tashmë komunat kanë filluar t'i hapin konkurset, kemi Ferizajn, Kaçanikun, Shtimen, Skënderajn, Suharekën që i kanë hapur konkurset për asistentë, të tjerët do t'i hapin gradualisht dhe deri në fundin e vitit 2019 ne do të kemi 183 asistentë të punësuar, sepse tash e kemi të miratuar edhe në buxhetin e vitit 2019.

KRYESUESI: Faleminderit! Konstatoj që edhe kjo pikë e rendit të ditës me kaq shumë pyetje, me pak përgjigje është shterur.

Vazhdojmë me pikën e tretë të rendit të ditës, lus regjinë që t'i bjerë ziles për të pasur kuorumin! Në qoftë se duan ta miratojnë procesverbalin, në qoftë se jo, vazhdojmë me pikat e rendit të ditës.

### **3. Miratimi i procesverbaleve nga seancat e mëparshme**

Tani e kemi kuorumin e duhur për ta votuar. Për rend të ditës, sa ta votojmë këtë procesverbalin, pastaj.

Pyes në qoftë se keni vërejtje në procesverbalet e seancave të mbajtura më 2 shkurt dhe më 7, 22 dhe 28 mars 2019. A ka ndonjë vërejtje? Nuk ka!

Konstatoj se Kuvendi i miratoi procesverbalet e seancave të mbajtura më 2 shkurt dhe 7, 12, e 28 mars 2019.

Për rendin e ditës janë lajmëruar deri tash 3 diskutues. Zoti Memli Krasniqi e ka fjalën.

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Unë e mora fjalën për të propozuar plotësimin e rendit të ditës me pikën shtesë, Formimi i Komisionit ad hoc për përmirësimin dhe forcimin e procesit zgjedhor dhe nëse e merr miratimin

e shumicës së deputetëve, siç parashihet me Rregullore që të vendoset si pika e parë e ardhshme në rend të ditës.

Më datë 11 prill, ne kryetarët e grupeve parlamentare nënshkruam një deklaratë të përbashkët, ku shprehëm gatishmërinë dhe zotimin për përmirësimin dhe forcimin e procesit zgjedhor, duke adresuar fillimisht çështjet e rekomanduara nga misionet e vëzhgimit të zgjedhjeve të Bashkimit Evropian, të nxjerra që nga viti 2013, e në veçanti në zgjedhjet e përgjithshme dhe lokale të vitit 2017. Jemi dakorduar si kryetarë të të gjitha grupeve parlamentare që të krijojmë një Komision parlamentar ad hoc për përmirësimin dhe forcimin e procesit zgjedhor, në të cilin marrin pjesë kryetarët e grupeve parlamentare dhe, po ashtu grupet e mëdha parlamentare, që në këtë rast janë PDK, LDK dhe Vetëvendosje, që u takojnë nga dy anëtarë, jemi marrë vesh që të kemi parasysh edhe aspektin e përfaqësimit gjinor, por edhe pozicionimin në nivelin mundësisht të udhëheqjeve të komisioneve të rëndësishme në Kuvend.

Prandaj, në bazë të nenit 42, pika 2 të Rregullores së Kuvendit, kërkojmë që pikë shtesë e rendit të ditës për seancën e sotme të jetë formimi i Komisionit parlamentar ad hoc për përmirësimin dhe forcimin e procesit zgjedhor, sipas nenit 71 të Rregullores së Punës së Kuvendit. Komisioni parlamentar ad hoc për përmirësimin dhe forcimin e procesit zgjedhor do t'i shqyrtojë rekomandimet dhe do të përgatisë ndryshimet ligjore të nevojshme për të përmirësuar dhe forcuar procesin zgjedhor, me qëllim që të krijojë një ambient për zgjedhje të lira, të drejta dhe transparente, në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe praktikrat e mira, pa paragjykuar mbajtjen e zgjedhjeve kurdo që ato do të mbahen.

Përbërja e Komisionit ad hoc është në këtë drejtim: Avdullah Hoti është kryesues i komisionit, Memli Krasniqi, unë jam zëvendëskryesues i parë, Glauk Konjufca, anëtar, Dardan Sejdiu, anëtar, Ahmet Isufi, anëtar, Sasha Milosavljeviq, anëtar, Bilall Sherifi, anëtar, Albert Kinolli, zëvendëskryesues i dytë dhe besoj që grupet parlamentare LDK dhe Vetëvendosje do të propozojnë edhe nga një emër, siç e paralajmërova, ndërsa anëtari i dytë nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës është deputetja Blerta Deliu Kodra.

Kërkoj nga deputetët meqenëse tashmë e kemi dakorduar që një kohë këtë çështje që ta mbështesin këtë mocion për ta përfshirë në rend të ditës dhe për ta vendosur si pikën e radhës. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Tani kërkesa po dihet, që ta fusim në rend dite menjëherë si pikë të radhës që mund të quhet pikë e parë pas miratimit të rendit të ditës. Unë e hedh mocionin në votim, në goftë se duhet ose a ka dikush kundër, ose po votojmë me elektronikë, si po doni?

A ka kundër dikush këtij mocioni? A jeni dakord të gjithë? Në sallë janë 67 deputetë, nuk ka kundër. Atëherë, seanca vendosi që në kuadër të propozimit për plotësimin e rendit të ditës si



pikë e parë e rendit të ditës të jetë: Formimi i Komisionit ad hoc për përmirësimin dhe forcimin e procesit zgjedhor, si pikë e parë e rendit të ditës.

Miratohet nga seanca propozimi i kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, zotit Krasniqi.

Për mocion është paraqitur edhe kryetari i Grupit Parlamentar, zoti Visar Ymeri.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryesues!

Unë kam një propozim, jam dakorduar edhe me pjesën më të madhe të grupeve parlamentare që pikën 17, që e kemi në këtë rend dite, ta bartim, ta vendosim si pikë për t'u votuar menjëherë pas pikës 4, që është Shqyrtimi i Propozim amendamentit në Kushtetutë, është fjala për kërkesën për zgjatje të mandatit të Komisionit Hetimor për gjendjen në Telekomin e Kosovës, sepse ne si komision kemi filluar punën dhe pastaj, meqë është përvjedhur një gabim në momentin kur është votuar, është votuar me mandat vetëm 1-mujor. Është e qartë që ky mandat ose kjo kohë nuk mjafton për punën e këtij komisioni dhe këtë kërkesë do të kishte qenë mirë që ta përfundojmë sa më shpejt që është e mundur, në mënyrë që të mund ta vazhdojë punën komisioni, pra nga e hëna, siç i kemi pasur mbledhjet e rregullta.

Kërkoj mirëkuptimin e deputetëve që ta zhvendosin këtë pikë nga 17 në pikën, po i bie tash 5, në mënyrë që ta votojmë zgjatjen e mandatit të këtij komisioni. Faleminderit!

KRYESUESI: Atëherë, a ka dikush kundër këtij propozimi? Zoti Nait Hasani, a do ta marrësh fjalën, ta arsyetosh pse je kundër, apo veç je kundër? Zoti Hasani e ka fjalën.

NAIT HASANI: Faleminderit, nënkryetar! Unë jam kundër, jo kundër Komisionit për Hetime, por jam që të krijohet një Komision Hetues për të gjitha bordet dhe për të gjitha ndërmarrjet publike pikërisht për këtë çështje.

KRYESUESI: Është shumë, për secilën ndërmarrje publike mund të krijohet një komision, por sa ndërmarrjet publike janë, Nait, as Hetuesia e Policisë së Kosovës nuk mund t'u bie në fund, e lëre më deputetët.

Atëherë, a ka dikush kundër kësaj, përveç Naitit? Nuk ka! Në sallë janë 63 deputetë, me shumicën absolute të gjithëve, përjashtuar zotin Hasani, 62 vota janë për, futet në rend dite edhe propozimi i Grupit Parlamentar të PSD-së, respektivisht i kryetarit Ymeri.

Zoti Zeka, e ke për rend ditës fjalën apo? Zoti Milaim Zeka e ka fjalën.

MILAIM ZEKA: Thashë, në qoftë se mundemi kur të vijë momenti i propozimit të kryetarit të komisionit, Visar Ymeri, na duhet thjesht për formalitet, të plotësohet edhe vendi i nënkryetarit. Kryetarin e kemi, Visarin, por komisioni nuk ka nënkryetar dhe po u dashka të propozohet dikush. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Besoj që kjo është e zgjedhur se kujt i takon, pastaj grupi parlamentar që i takon nënkryetari, le ta propozojë vetë. Mendoj që nënkryetari s'ka nevojë të votohet, i takon grupit parlamentar që ta propozojë dhe s'e besoj që dikush është kundër, përveç nëse ka ndonjë vërejtje të madhe dikush.

Atëherë, me këto dy vërejtje po fillojmë seancën me rendin e ditës që u propozua, atëherë po fillojmë me pikën e rendit të ditës:

#### **- Formimi i Komisionit ad hoc për përmirësimin e forcimin e procesit zgjedhor**

Ju njoftoj se kryetarët e të gjitha grupet parlamentare kanë propozuar formimin e Komisionit ad hoc për përmirësimin e forcimin e procesit zgjedhor. Zoti Krasniqi e tha fjalën, më duket, në emër të të gjithëve, apo dëshiron prapë ta marrë fjalën. Zoti Krasniqi e ka fjalën.

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Faleminderit deputetëve që e mbështetën mocionin, vetëm sa për formalitet procedural, unë po e lexoj edhe një herë përbërjen e komisionit dhe shpresoj që do të kemi plotësimin edhe me nga një kandidat shtesë nga LDK-ja dhe Vetëvendosje.

Pra, përbërja e Komisionit ad hoc për përmirësimin dhe forcimin e procesit zgjedhor është si vijon: Avdullah Hoti është kryesues i komisionit, Memli Krasniqi zëvendëskryesues i parë, Glauk Konjufca, anëtar, Dardan Sejdiu, anëtar, Ahmet Isufi, anëtar, Sasha Milosavljeviq, anëtar, Bilall Sherifi, anëtar, Albert Kinolli, zëvendëskryesues i dytë, Blerta Deliu Kodra. Besoj që pas plotësimit edhe me dy anëtarë të tjerë, mund të procedojmë në votim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk e di a ka nevojë, a duan të diskutojnë kryetarët e grupeve parlamentare. Atëherë, ka të paraqitur, sipas rregullave që i kemi. Zoti Avdullah Hoti e ka fjalën në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së.

AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryesues!

Grupi ynë parlamentar dakordohet me formimin e këtij komisioni. Unë gjej rastin që këtu para deputetëve të falënderoj edhe Zyrën e BE-së dhe të OSBE-së në mbështetjen e punës së këtij komisioni në të ardhmen.

Unë propozoj që anëtar i dytë nga grupi ynë parlamentar të jetë deputeti Arben Gashi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Sherifi, urdhëro!

BILALL SHERIFI: Faleminderit!

Më lejoni që edhe unë të deklaroj që në takimin së bashku me OSBE-në dhe Zyrën e BE-së, kur kemi biseduar që të krijohet ky komision ad hoc për përmirësimin e infrastrukturës zgjedhore, ideja ka qenë që grupi, apo komisioni të formohet nga kryetarët e grupeve parlamentare dhe në funksion të prezantimit apo të pjesëmarrjes edhe të gjinisë femërore të deputeteve, ka qenë e paraparë që tri grupet më të mëdha parlamentare, kandidatin e dytë apo anëtarin e dytë, deputetin e dytë, ta kenë deputete, jo deputet.

Prandaj ata kanë marrë nga dy, dhe partitë e tjera nga një. Nëse, natyrisht që është e drejtë e LDK-së që të propozojë këdo qoftë, por kjo del nga marrëveshja që e kemi pasur së bashku, dhe atëherë rishqyrtohet gjithçka, se pse duhet të ketë pra dy një parti, nëse të dy do të jenë deputetë. Mendoj se ka shmangie nga marrëveshja në parim që e kemi pasur dhe nëse ka shmangie, atëherë le të mbetet secili grup parlamentar ta ketë vetëm nga një përfaqësues në komisionin ad hoc. Ose siç e propozoi Memli konform marrëveshjes, zoti Memli Krasniqi, njëri nga ta, kryetar i Grupit dhe Blerta Deliu-Kodra, deputetja Blerta si deputete. Faleminderit!

KRYESUESI: Këtu merruni vesh mes vete, unë s'përzihem. As s'kam ndonjë obligim ta frenojë votimin. Meqenëse duhet ta votoni të gjithë, atëherë po e lë që të diskutojë edhe Vetëvendosjes, znj. Albulena Haxhiu.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Edhe shefi i grupit tonë parlamentar, zoti Glauk Konjufca ka marrë pjesë në këtë takim dhe e ka nënshkruar deklaratën në fjalë. Pra, arsyeja se pse e kemi nënshkruar deklaratën, është pikërisht për shkak se duam të japim dhe të tregojmë vullnetin tonë në raport me adresimin e vërejtjeve, rekomandimeve të misionit të vëzhguesve ndërkombëtarë në zgjedhjet e vitit 2017. Madje, këtu ndoshta është e rëndësishme të theksohet se në kuadër të Komisionit për MSA, ka qenë një amendament i propozuar pikërisht nga Vetëvendosje, ku u përfshi që duhet t'i adresojmë vërejtjet e vëzhguesve ndërkombëtarë, se kanë qenë vërejtje jashtëzakonisht të drejta.

Prandaj, ne e kemi mbështetur edhe këtë iniciativë, dhe përveç Glaukut, anëtarin e dytë në këtë komision do të jem unë. Meqë s'është Glauku këtu po e bëj propozimin unë. Pra, përveç Glaukut, edhe unë si deputete e Vetëvendosjes. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjala është e zotit Sejdiu.

DARDAN SEJDIU: Faleminderit, kryesues!

Në emër të Partisë Socialdemokrate, ne jemi dakorduar dhe në takimin me përfaqësuesit e Bashkimit Evropian dhe Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim që të formojmë këtë komision ad hoc dhe si Parti Socialdemokrate, meqë e kemi vetëm një përfaqësues, unë kërkoj që të zëvendësohet emri im me deputeten Shqipe Pantina, e cila gjithashtu e di temën mirë.

KRYESUESI: Zoti Ahmet Isufi, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së.

AHMET ISUFI: Faleminderit, kryesues!

Në parim jemi marrë vesh si grupe parlamentare dhe kemi nënshkruar marrëveshjen që të bëhet edhe përfaqësimi adekuat gjinor siç edhe u tha, atëherë edhe emrin tim dua ta zëvendësoj me emrin e deputetes Donika Kadaj-Bujupi.

KRYESUESI: Faleminderit! Unë mendoj që sa i përket kësaj çështjeje, e keni gabim edhe ju edhe Partia Socialdemokrate, për faktin se ju keni një marrëveshje që të jenë kryetarët e grupeve parlamentare, edhe tash po e prishni marrëveshjen që e keni bërë në prezencë të OSBE-së dhe të BE-së.

Dhe e dyta, edhe te çështja e pjesëmarrjes së zonjave në këtë komision, keni dalë nga marrëveshja, Grupi Parlamentar i LDK-së. Kështu që unë po e shoh se rrezikohet edhe votimi i kësaj marrëveshjeje në Kuvend, në qoftë se lëvizim nga marrëveshja. Ose gjejini një rrugë të merreni vesh mes vete, ose unë nuk di çka të bëjë.

Zoti Hoti e ka fjalën, e pastaj zoti Sherifi.

AVDULLAH HOTI: Mendoj që Grupi Parlamentar i PSD-së ka dalë prej marrëveshjes, e tash edhe i AAK-së.

Ne kemi respektuar plotësisht marrëveshjen. Jemi dakorduar që për aq sa është e mundur, për aq sa është e mundur, pra është e nënshkruar, është në tekst, të respektohet përfaqësimi gjinor.

Unë kërkoj nga kryetarët e gupeve parlamentare që të qëndrojnë në këtë komision, ashtu si jemi marrë vesh, duke qenë se vendimmarrja ka për të qenë në nivele politike dhe mandej ky komision do të mbështetet nga një grup tjetër profesional, ku prapë të gjitha grupet parlamentare do të kenë mundësi të çojnë njerëzit e tyre që kanë përvojë në këtë lloj pune. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Sherifi e ka fjalën.

BILALL SHERIFI: Faleminderit, zoti kryesues!

Unë tash po e sjell këtu para jush dhe para publikut edhe momentin se pse edhe si erdhi deri te propozimi që këto tri grupe parlamentare të kenë nga dy.

Është kërkuar që në takimin e parë që kemi pasur me Zyrën e BE-së dhe zyrën e OSBE-së është kërkuar që komisioni ad hoc të përbëhet nga kryetarët e grupeve parlamentare për t'i dhënë rëndësi Komisionit. Pra për të treguar se grupet parlamentare e kanë seriozisht formimin e këtij komisioni dhe punën e këtij komisioni. Dhe kanë kërkuar që përpos që duhet të jetë nga kryetarët e grupeve parlamentare, të kemi parasysh edhe përkatësinë gjinore në komision.

Atëherë unë kam propozuar, unë kam thënë që për të plotësuar të dy kriteret, edhe kryetarët e grupeve të jenë pjesëtarë të komisionit, anëtarë të komisionit, edhe përfaqësimi gjinor, atëherë po pranojmë në grupet më të vogla parlamentare, po pranojmë që tri grupet më të mëdha të kenë nga një plus, por me kusht që i dyti të jetë deputete.

Kështu ka qenë që e kemi biseduar në takim me ta. Tash, këta mund ta interpretojnë si të duan, që për aq sa është e mundur, po unë nuk besoj që nuk është e mundur te LDK-ja. Se kanë, ne e kemi një deputete, ata i kanë shtatë a tetë. Pra, nuk është se nuk është e mundur, por po mungon vullneti. Është e drejtë e tyre, por në këtë moment dalin nga marrëveshja dhe kur dalin nga marrëveshja dhe kur të dalin nga marrëveshja do të ndalemi vetëm te kryetarët e grupeve dhe ne nuk do të votojmë që LDK-ja t'i ketë dy, as PDK-ja dy, as Vetëvendosja dy. Nëse nuk plotësohet kushti që ka të bëjë me marrëveshjen natyrisht në parim, jo marrëveshje e shkruar, që i dyti, anëtari i dytë të jetë deputete. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit. Zoti Memli Krasniqi, a e deshe fjalën?

MEMLI KRASNIQI: Zoti kryesues!

Për mua me të vërtetë është e dhimbshme mos të them diçka tjetër, qysh edhe për diçka që jemi dakorduar, edhe jemi marrë vesh, e kemi diskutuar, e jemi takuar, vijmë në seancë edhe ad hoc këqyrim ta prishim. Kjo mendoj unë është ta prishim. Ne në rregull, e kemi nënshkruar deklaratën e jemi pajtuar, por po më duket s'paska vullnet ta kryejmë.

E para e punës, arsyeja pse janë shefat e grupeve parlamentare është për t'i dhënë peshë politike këtij komisioni. Nuk është ajo çështje e ekspertëve. Ne asnjë këtu s'jemi ekspertë të zgjedhjeve. Për këtë arsye, do të jetë grupi këshillëdhënës që përbëhet prej ekspertëve të partive politike, të shoqërisë civile, edhe të organizatave ndërkombëtare. Kështu që, asnjë argument s'është që të thuhet valla kemi ekspertë më të mirë. Kemi edhe ne ekspertë më të mirë sesa unë, por jemi pajtuar që shefat e grupeve të jenë pikërisht për shkak të relevancës politike të Komisionit.

E dyta, komisionet ad hoc e kanë formulën, i kemi nga dy anëtarë për shkak të vullnetit të mirë të askujt. Çdo komision në këtë kuvend i ka 11 anëtarë, ku tri grupet më të mëdha u takojnë nga dy. Kjo vlen edhe për komisionet e rregullta në Kuvend, edhe për komisionet ad hoc. Ne s’kemi zbuluar formulë të re. Çka jemi pajtuar, meqenëse krejt ne, d.m.th. jemi meshkuj, jemi burra në udhëheqjen e grupeve parlamentare, që ta kemi njëfarë minimumi të bilancit gjinor. Dhe nuk është as për mendimin tim, janë punë të brendshme të secilit grup parlamentar, po s’është arsytim që të thuhet brenda mundësive nuk e kemi gjetur askënd. Po, është e vërtetë, aty shkruan brenda mundësive, sepse ne s’kemi mundur legalisht ta obligojmë askënd, të themi duhet të jetë e gjinisë së kundërt. Kemi thënë jemi pajtuar të jetë e gjinisë e tjetër, edhe jemi dakorduar që së paku të jenë tri zonja kolege deputete në këtë komision.

Tash edhe LDK-ja këtë s’e respektoi, PSD-ja dhe AAK-ja deshën të tërhiqen. Unë nuk po besoj që janë kushtet për ta votuar këtë komision. Por nëse s’mund të merren vesh për një komision që merret veç me adresimin e çështjeve kryesisht teknike, që janë gjetur nga misionet vëzhguese të BE-së në zgjedhje prej 2013-ës e këndej, unë për vete jam i zhgënjyer për arsyen që nuk po e shoh qysh kemi për të bërë ndonjëherë komision për reformë zgjedhore përnjëmend.

Ju kisha lutur kolegë të grupeve parlamentare, të kthehemi te marrëveshja që e kemi. E keni të nënshkruar të gjithë. E kemi nënshkruar bashkë dje. Të jenë anëtarë shefat e grupeve parlamentare, edhe të ketë përfaqësim gjinor në tri grupet e mëdha që u takon t’i kenë nga dy anëtarë, sipas formulës së ndarjes së vendeve që e kemi në secilin komision. Nëse mund ta bëni këtë, po e qesim në votim. Nëse s’mund ta bëjmë këtë, s’po e qesim në votim hiç, sepse nuk kalon edhe po shkojmë veç duke u bërë horë prej ditës në ditë.

KRYESUESI: Po, kërkoj falje, po unë nuk e di, nuk e njoh, s’e kam parë as s’kam pasur njoftim të marrëveshjes. Por, ky unë mendoj që nuk është komision parlamentar me formula të komisioneve të tjera. Ky është një komision bipartizan i një marrëveshjeje të quajtur, i cili do të funksionojë për disa kohë, herë pas herë do të mblidheni dhe nuk do të jetë i futur në shemën e financave të Kuvendit të Kosovës, sepse prezantimi në këtë rast qysh po bëhet ndonjëherë është thuaja që po formojmë komision të ri dhe të formojmë komision të ri, pastaj ne duhet t’i kryejmë disa procedura të reja, të cilat ju i dini cilat janë.

Por, tani meqenëse ka të interesuar për të diskutuar për këtë çështje, unë po jua jep me radhë sipas paraqitjes që e keni bërë. I pari është në radhë Ahmet Isufi.

AHMET ISUFI: Kryesues!

Ne një marrëveshje e kemi nënshkruar si kryetar të Grupeve Parlamentare. Komisioni të udhëhiqet nga anëtarët e grupeve parlamentare, shefat e grupeve parlamentare në këtë rast dhe të respektohet barazia gjinore siç u tha me përfaqësimin e tri grupeve më të mëdha parlamentare, edhe kjo duhet të bëhet. Dhe nëse ka pengesë që tani të mos kemi problem rreth përfaqësimit, për

të mos u ndryshuar, atëherë le të mbeten shefat e grupeve parlamentare dhe tre anëtarë të gjinisë femër të jenë nga tri grupet më të mëdha.

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zoti Arben Gashi e ka kërkuar fjalën, meqenëse është i apostrofuuar për kandidat.

**ARBEN GASHI:** Të nderuar kolegë deputetë,  
Propozimi për këtë komision ad hoc parlamentar në grupin parlamentar të LDK-së ka ardhur si ide meqenëse unë kam qenë kryetar i Komisionin për Legjislacion në vitin 2011-2014 dhe është punuar në reformën zgjedhore. Ne e kemi bërë një projektligj, e kemi dorëzuar në Kuvend, ka kaluar në lexim të parë. Për arsye se kemi shkuar në zgjedhje të jashtëzakonshme, nuk ka arritur të përfundohet.

Për hir të memorien institucionale, kolegë gra dhe burra të Grupit Parlamentar të LDK-së kanë menduar që duhet shtyrë atë proces përpara unë. Unë nuk kam asnjë lloj interesi personal të merrem me këtë punë. Ideja është e një memorie institucionale. Nuk ka të bëjë as me përkatësi gjinore, me asnjë lloj problemi tjetër. Kështu që për mua është krejt në rregull që grupi parlamentar i LDK-së t'ia besojë kujtdo tjetër këtë proces ta çojë përpara sepse ne jemi kolegë. Besojmë se mund të bëjmë diçka më mirë, dikush e ka një përvojë më shumë, dikush më pak, nuk pritet të bëhet diçka e jashtëzakonshme me këtë komision, kështu që mendoj që secili prej kolegëve të mi mund ta marrë përsipër këtë proces. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Fjalën e ka zoti Dardan Sejdiu.

**DARDAN SEJDIU:** Faleminderit, kryesues!

Pas fjalës së kolegut Isufi dhe pas fjalës së deputetit Arben Gashi, unë po e shoh që ekziston një vullnet që t'i kthehemi marrëveshjes siç ka qenë dhe ecim përpara. Nëse ky vullnet nuk ekziston dhe jemi te ekspertiza apo njohuria e temës, atëherë zëvendësshef i Grupit Parlamentar të PSD-së është një grua. Pra, nëse kështu veprojmë, atëherë po shkojmë me ekspertizë, por marrëveshja është e qartë. Jemi në marrëveshje, vazhdojmë tutje sipas marrëveshjes.

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zonja Albulena Haxhiu e ka fjalën.

**ALBULENA HAXHIU:** Faleminderit!

Unë e kam deklaratën përpara që është nënshkruar dhe po mundohem vetëm t'i referohem, sepse tri pikat e kësaj deklarate theksojnë që ky komision ad hoc do të formohet në pajtim me Rregulloren e punës së Kuvendit. Pika e parë. Pastaj pika e dytë flet për një trup tjetër si këshillëdhënëse dhe pika e tretë flet Kuvendi i Kosovës duhet të ofrojë mbështetje financiare dhe teknike, logjistike për komisionin zgjedhor ad hoc. Pra, kjo është ajo çfarë kanë nënshkruar shefat e grupeve parlamentare, të cilën e kanë para vetes.

Tjetra? Në fillim pata në bindje që janë marrë vesh. Tash qartazi po duket që s'qenkan marrë vesh, nuk ka marrëveshje. Dhe dilema fillestare e jona ka qenë pse duhet komision ad hoc për adresim të këtyre vërejtjeve, duke qenë që është Komisioni për Legjislacion kompetent për të adresuar plotësim-ndryshimin e ligjit të zgjedhjeve. Shumë mirë e kishim adresuar, qysh kemi adresuar dhe amendamentuar shumë projektligje të tjera, kishim bërë dhe këtë, dhe s'kishte pasur nevojë për buxhet shtesë, ngarkesa shtesë.

Por, unë besoj që ne pavarësisht kësaj kemi qenë korrektë me marrëveshjen të cilin edhe shefi i grupit parlamentar i joni e ka nënshkruar. Përndryshe, po është e vërtetë, ka pasur tri vite proces të reformës zgjedhore dhe të zgjidhet presidenti nga populli, nga të gjitha ato punë që janë bërë, në fund nuk është kapitalizuar ajo, sepse s'ka pasur vullnet politik për ta adresuar. Prandaj, reforma zgjedhore përnjëmend bëhet po për mandatin e ardhshëm. Nuk mund të bëjmë reformë zgjedhore përnjëmend me një Qeveri të pakicës dhe me një Kuvend jofunksional.

Prandaj, ne e kemi shprehur thjesht një vullnet tonin sa i përket adresimit të rekomandimeve të Bashkimit Evropian. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Po dua t'i referohem fjalëve të dikujt që njihet. Thotë kur dua që një punë të bëhet, merrem vesh me të, domethënë me punën, edhe e kryej. Kur nuk më intereson, formoj komisione ose grupe pune. Tani, ne i dimë të metat e ligjit. Të metat e Ligjit të zgjedhjeve ne i dimë, e dimë fatin edhe të atij komisioni të famshëm që është formuar për të mos u bërë ligji dhe ka punuar për të mos u bërë ligji po ka shëtitur prej Kosove e nëpër dynja duke parë përvojat e dynjasë, ku secili shtet në botë që ka ligj për zgjedhje është në internet, dhe s'keni nevojë askund të dilni të shihni. Po kjo praktikë uroj që të mos përsëritet. Unë mendoj që secili subjekt politik i di të metat e këtij ligji dhe meqenëse keni dhënë zotimin para atyre institucioneve të mëdha, ta merrni seriozisht këtë punë, propozoni çka të bëhet.

Kemi edhe dy diskutues. S'po dua t'ia marrë fjalën asnjërit. Zoti Sherifi e ka kërkuar fjalën, edhe zonja Flora Brovina, edhe pastaj po e hedhim në votim ose s'po e hedhim fare.

**BILALL SHERIFI:** Faleminderit, kryesues!

Disa sqarime. Nuk po bëhet fjalë për një komision ad hoc për reformë zgjedhore, të cilës iu referua kolegu Arben Gashi. Po bëhet fjalë për një komision ad hoc, i cili do t'i adresojë vetëm dhe vetëm rekomandimet që kanë dalë nga misionet vëzhguese gjatë zgjedhjeve që nga viti 2013 e deri më sot, dhe në veçanti vërejtjet e vitit 2017. Pra, janë diku 30-35 rekomandime, të cilat në mënyrë eksplicite jemi marrë vesh që t'i trajtojmë dhe t'i adresojmë.

Pra, pse jo përmes Komisionit për Legjislacion? Jo sepse ai komision nuk është kompetent, apo ai komision nuk e di, por për faktin se Zyra e OSBE-së dhe zyra e BE-së kanë menduar që për t'i dhënë peshë politike, kjo çështje duhet të bëhet përmes një komisioni ad hoc ku do të jenë



kryetarët e grupeve. Dhe meqë, tash kolegut Memli Krasniqi po i them, meqë aty u tha që duhet të jenë kryetarët e grupeve, po gjithsesi edhe gjinia femërore, duhej të nisej një iniciativë të shkarkohen disa kryetarë të grupeve, të emërohen femra, pastaj të plotësohet kriteri gjinor. Dhe aty unë kam propozuar, ndoshta Memli ka harruar, po është Ahmet Isufi e janë të tjerët që kanë qenë prezentë. Unë kam propozuar që për të plotësuar dy kriteret, edhe kryetarët e grupeve, edhe përkatësia gjinore për aq sa është e mundur në kuptimin e kandidatit të dytë, e deputetit të dytë, kam propozuar le ta propozojnë nga një partitë më të mëdha. Edhe kështu i plotësojmë të dy kriteret.

Pra, kështu ka qenë rrjedha e bisedës në takim me zyrën e BE-së, dhe zyrën e OSBE-së, përkatësisht me zonjën Apostolova dhe me shefin e OSBE-së. Pra, niveli i përfaqësimit të tyre ka qenë shumë i lartë dhe prandaj unë kam propozuar një gjë të tillë dhe tash na del po na krijohet një komision i rregullt, prandaj duhet të ketë 11. Mund të ketë edhe shtatë, edhe nëntë grupe sa janë, gjashtë të grupeve të partive politike shqiptare, edhe tri të tjera, tetë-nëntë deputetë pa asnjë problem mund të funksionojnë dhe të gjithë deputetët e partive politike që kanë njohuri, që mund të japin ekspertizë natyrisht që janë të thirrur të ndihmojnë komisionin në punën e tij.

Por, nëse nisemi nga ekspertiza, atëherë pse duhet të jetë Avdullah Hoti, kryetar, jo Arben Gashi, pasi qenka ekspert, e pse duhet të jetë Memli dhe jo Blerta, që besoj është shumë më e familjarizuar me temat e reformave zgjedhore. Pse, siç tha edhe Dardan Sejdiu, pse duhet të jetë Dardani dhe jo Shqipja që e njohka më mirë. Pra, nuk kemi kërkuar nga grupet parlamentare ekspertin, deputetin ekspert, por kemi kërkuar deputetin që jep garanci, punës së Komisionit për nga përfaqësimi i lartë politik. Këto janë arsytet që na kanë shtyrë të vijmë deri te kjo formulë. Tash ose do të respektohet formula, marrëveshja dhe formula në tërësi, ose Nisma tërhiqet nga marrëveshja. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zonja Brovina e ka kërkuar fjalën. Arben, prapë?

**FLORA BROVINA:** Faleminderit për fjalën!

Komisioni u quajt jo aq i rëndësishëm, edhe pse ky është ndër komisionet për mua të rëndësishme, sepse po flet për reformën zgjedhore. Në anenë tjetër, u tha se në të vërtetë ky nuk do të punojë për reformën zgjedhore këtu nga diskutantët, por do të referojë konkluzionet e vëzhguesve gjatë zgjedhjeve të vitit 2017. Këtu diçka për mua është një konfuzion.

Faleminderit shumë për ata që thanë se neve na kanë rezervuar tri vende. Unë e them këtë faleminderit me shumë ironi, sepse ne kemi Ligjin për barazi gjinore dhe grave në këtë komision u takojnë edhe më shumë vende. E në të kundërtën, le të bëjnë çka të duan burrat. Ne do të mbledhemi në Komisionin ad hoc për barazi gjinore dhe do ta japim mendimin tonë. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Gashi, urdhëro!

ARBEN GASHI: Faleminderit! I nderuar zoti Sherifi unë nuk kam qenë as anëtar dhe as kryetar i komisionit ad hoc. Komisioni ad hoc ka punuar dy vite dhe i ka skaduar mandati dhe e ka dorëzuar punën te Komisioni për Legjislacion.

Nuk kemi bërë asnjë udhëtim jashtë objektit të Kuvendit të Komunës. Kemi punuar, e kemi dorëzuar punën në Kuvend, Kuvendi e ka proceduar në lexim të parë, në lexim të dytë është shpërbërë Kuvendi dhe kemi shkuar në zgjedhje dhe është mbyllur kaq kjo punë.

Unë mora përgjegjësi, sepse ma kërkoi grupi parlamentar. Unë nuk kam interes personal, politik që të jem në atë komision. Nëse partia e kërkon, unë e marr përgjegjësinë. Nëse jo, unë jam i gatshëm që t'ia jap mandatin, përgjegjësinë kujtdo prej kolegeve të mia në Grupin Parlamentar të LDK-së.

Kemi gra jashtëzakonisht të fuqishme që mund ta marrin përsipër këtë punë. Kaq! Shumë e thjeshtë është kjo punë. Nuk ka nevojë që të debatohet për këto çështje se ky debat është kot. Krejt kot po shkon ky muhabet. Akuza, kundër-akuza, gjëra të parëndësishme.

Po ia përsërisë edhe njëherë zoti Bilall Sherifi, kam qenë kryetar i Komisionit për Legjislacion, i cili e ka përfunduar këtë punë. Nuk është bërë asnjë udhëtim jashtë Kuvendit të Kosovës. Ka përfunduar puna. Dy muaj kemi punuar rreth 10 deri në 12 orë në ditë. Janë të gjitha provizionet teknike të cilat kërkohen aty, të cilat janë paraparë në atë dokument.

E ka Kuvendi në arkiv. Mund ta marr kushdo që shkon në atë komision atë arkiv dhe mund ta shohin dhe çka është me interes e marrin dhe çka nuk ka interes për ta e lënë edhe kryhet kjo punë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Replikë, zoti Sherifi.

BILALL SHERIFI: Faleminderit, zoti kryesues!

E falënderoj kolegun Arben Gashi që ma dha mundësinë me përdorë një shprehje që s'desha ta përdor. Vërtetë është debat kot, por e niset ju kot, sepse marrëveshja ka qenë një plus një (1+1) tri partitë e mëdha t'i keni 1+1 dhe ai plus njëshi të jete deputete. Ju e shkelët këtë. Pra, kot është filluar kjo.

Duhet të kthehem ta ajo që nuk është kot, te marrëveshja. Nëse nuk jeni të gatshëm ta mbani marrëveshjen, duhet t'i thoni zonjës Apostolova dhe zonjës Brathu që ju kemi thënë, por nuk jemi në gjendje ta mbajmë këtë premtim dhe pastaj e rikthejmë çështjen në pikën zero. Faleminderit!

KRYESUESI: Atëherë, konstatoj që s'ka diskutues të tjerë. Unë ia jap fjalën edhe njëherë zotit Hoti në qoftë se ka ndonjë ndryshim në propozim. Nuk ka. Qëndrimet tuaja, të gjithë mund t'i mbani siç dëshironi.

Domethënë, propozimet kanë ngelur ashtu siç kanë qenë në marrëveshjet për kryetar të grupeve parlamentare që të jenë anëtarë të komisionit; Avdullah Hoti, Memli Krasniqi, Glauk Konjufca, Ahmet Isufi, Dardan Sejdiu, Sasha Milosavljeviq, Bilall Sherifi, Albert Kinolli.

Tri përfaqësueset zonja janë; nga Grupi Parlamentar i PDK-së është propozuar Blerta Deliu, Lëvizja Vetëvendosje Albulena Haxhiu, Grupi Parlamentar i LDK-së ka propozuar Arben Gashin.

Në sallë janë 66 deputetë, ju ftoj që t'i zini vendet dhe t'i vendosni kartelat për të votuar. Në qoftë se dikush nuk ka kartelë, ju lus që të paraqiteni paraprakisht. Pra, ata që janë pa kartelë.

Atëherë kemi 70 deputetë. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Edhe njëherë, Arben a po ulesh që të votosh. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tani.

Kemi 49 vota, kështu që situata është e bllokuar realisht. Nuk kalon.

Sipas mocionit të miratuar nga deputetët e kemi pikën:

### **17. Shqyrtimi i kërkesës së Komisionit Hetimor Parlamentar në lidhje me gjendjen në PTK dhe Vala për zgjatjen e mandatit dhe për emërimin e zëvendëskryesuesit të këtij komisioni hetimor**

Kush e ka kërkuar fjalën dhe për çka. Unë kam folur shqip, kam mundur ta përsëris edhe serbisht. Kush s'ka kartelë le të paraqitet. E thashë.. Punon si jo. Pse mua po më punon e juve jo. Këto janë shaka. Kthehen pas pauzës e përsërisnin me mocion.

Komisioni Hetimor Parlamentar i formuar nga Kuvendi më 7 mars 2019 në lidhje me gjendjen në PTK dhe Vala, ka kërkuar zgjatjen e mandatit dhe emërimin e zëvendëskryesuesit të komisionit hetimor.

Ftoj kryesuesin e Komisionit Hetimor Parlamentar, zotin Visar Ymeri që ta paraqesë dhe ta arsyetojë kërkesën. Zoti Ymeri e keni fjalën.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryesues! Pra, e shpjegova edhe atëherë kur kërkova mocionin për ta zhvendosur pikën. Komisionit hetimor realisht i ka skaduar mandati më 6 prill.

Ne i kemi mbajtur disa mbledhje dhe jemi dakorduar për fushëveprimin e komisionit dhe i kemi shtruar kërkesat për dokumentacionin e nevojshëm në Telekom dhe në PTK, ose në Postën e Kosovës.

Ato dokumentacione tashmë kemi filluar t'i marrim, mirëpo aktualisht jemi pa mandat të Kuvendit dhe rrjedhimisht duhet që sa më shpejt ta vazhdojmë punën e këtij komisioni në mënyrë që të mund të vazhdojmë ne si deputetë, anëtarë të këtij komisioni me punën aty.

Ndërkohë, që për sa i përket zëvendëskryesuesit, besoj që propozuesi i këtij i komisioni Milaim Zeka, i cili do duhej të ishte këtu në seancë do ta propozojë emrin për zëvendëskryesues dhe t'i votojmë të dyja bashkë. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Kush ka për të propozuar vëlla, zëvendëskryesues? Ku është Milaimi? Atëherë, zonja Albulena Haxhiu e ka kërkuar fjalën.

**ALBULENA HAXHIU:** Faleminderit!

Në fakt ajo për çfarë e mora fjalën është po natyrisht që dakordohemi për ta zgjatur afatin edhe pesë muaj, për shkak se për një muaj është e pamundur të hetohen të gjitha ato kontrata dhe të gjitha dokumentacionet tjera që i kemi kërkuar.

Por, e mora fjalën për të bërë një ndërhyrje për faktin se e kam ngritur edhe në komisionin hetimor, por s'kemi mundur ta adresojmë për shkak se kështu ka vendosur seanca.

Për të tërhequr vëmendjen tuaj, Kuvendi ka votuar për Komisionin Hetimor Parlamentar në lidhje me gjendjen në PTK dhe Vala, kështu emërtohet.

Tashti, ndërmarrje publike me emrin PTK më nuk ka dhe e njëjta është shpërbërë nga ku kanë dalë Telekomit në njërin anë dhe Posta e Kosovës.

Prandaj, për të qenë të saktë në këtë drejtim, ne po propozojmë që ky emërtim, besoj që është e drejtë e Kuvendit që ta bëjë këtë ndryshim që nuk e ka kundërshtuar asnjë anëtar i komisionit atë ditë kur e kemi adresuar, pra të jetë PTK, Telekomit i Kosovës, Posta e Kosovës.

Vala është në kuadër të Telekomit, prandaj kur të përmendet Telekomit pa dyshim që hynë edhe Vala aty.

Unë i kam marr këto informacione nga ekspertët e kësaj çështjeje dhe prandaj e kam adresuar edhe sot në Kuvend në emër të grupit. Nuk ka pasur ankesa nga anëtarët e komisionit atë ditë, vetëm se Kuvendi meqë ka votuar ne e kemi pasur të pamundur ta ndryshojmë.

Sa i përket nënkryetarit të komisionit, do të ishte shumë e vlefshme që ky komision të ketë edhe kryetarin edhe nënkryetarin nga opozita.

Ne kemi pasur kontakte me deputetin Zeka për të kërkuar nga ai që ta propozojë deputetin Liburn Aliu. Nuk e di se si do të veprojë në këtë drejtim, por megjithatë duke e pasur parasysh ndjeshmërinë që ka ky komision, do të ishte shumë më e besueshme në qoftë se opozita do ta drejtonte, në këtë rast edhe kryetarin edhe nënkryetarin siç ka qenë më duket rasti për dëbimin e shtetasve turq nga Kosova. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Kërkesa është për vazhdimin e mandatit të komisionit hetimor. Meqenëse zoti Zeka paska veç ai kompetencë që ta propozojë, unë s'kam çfarë të them, vetëm se t'ia jap fjalën edhe Fatmir Xhelili. Ndërkaq, kur të vijë Milaim Zeka na propozon një emër.

Nuk do duhej të ishte kështu, po sidoqoftë rregullat nuk i kam shkruar unë dhe kështu janë. Zoti Xhelili e keni fjalën.

**FATMIR XHELILI:** Faleminderit, nënkryetar! Përshëndetje për deputetët.

Atë që desha ta adresoj, pajtohem me zonjën Haxhiu, se desha ta definoj ose së paku kryetari i komisionit zoti Ymeri ta definojë se për cilën ndërmarrje publike është fjala.

A është fjala për Postën e Kosovës që është e regjistruar me emrin Posta e Kosovës prej vitit 2012 diku apo është fjala për Telekomin apo është fjala për të dyja ndërmarrjet. E para, të definohet kjo.

E dyta, do të caktohet një mandat kohor dhe mos të vihet prapë që të dalë që komisioni nuk ka kohë të mjaftueshme që ta përfundojë punën. Kështu që kryetari i komisionit do të propozojë mandatin kohor se sa i nevojitet për ta kryer këtë hulumtim. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zoti Zemaj e ka fjalën.

**ARMEND ZEMAJ:** Faleminderit, kryesues! Sa për sqarim meqë jam pjesë e këtij komisioni hetimor. Ne kemi dalë me disa përfundime dhe arsytimi ishte shumë i qartë edhe nga kryesuesi i këtij komisioni.

Ajo që po e kërkojmë është zgjatja e mandatit, pasi që Kuvendi në letrën e adresuar nga iniciuesi i debatit ka qenë e parashkruar vetëm një muaj. Që është jo normale, sepse mandati i çdo komisioni hetimor zgjat deri në gjashtë muaj.

Për nevojën tonë dhe nevojën që është lëndë hetimore shumë e zgjeruar, arsyeshmëria është e saktë që kërkojmë afat maksimal prej gjashtë muajve. Nëse arrijmë ta përfundojmë punën ashtu siç na ka mandatur Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Sa i përket emërimit, emërtimi është shumë i qartë sepse ka të bëjë me PTK dhe Vala, Postë-Telekomin e Kosovës. A është ndarë, a është bashkuar, a është ndërmarrje publike apo shoqërore komisioni hetimor e përfshinë të gjithë veprimtarinë prej vitit '99 deri në vitin 2019. Është shumë i saktë dhe nuk e kemi asnjë dilemë në këtë drejtim.

Ju kisha lutur që të vazhdohet mandati. Është çështje me rëndësi. Është shumë e rëndësishme edhe për opinionin publik edhe për shoqërinë kosovare. Kjo është tema të cilën po e kërkojmë. Për këtë arsye është adresuar edhe si pikë e jashtëzakonshme, domethënë me prioritet që të votohet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Tani janë paraqitur edhe disa të tjerë. Prapë Xhelili. E ke replikë, apo? Zoti Xhelili, replikë!

FATMIR XHELILI: Një fjali të mos keqkuptohemi. Edhe unë kërkoja që t'i zgjatet mandati dhe të ketë afat edhe periudhë kohore të mjaftueshme që të bëhet hetimi. Domethënë jemi në të njëjtat valë.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Haxhiu e ke fjalën. Ndërkaq ua jap fjalën në fund Visar. Zoti Bekim Haxhiu e ka fjalën, regjia!

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Si pjesë e këtij komisioni hetimor, ne i kemi mbajtur disa takime dhe arsye pse kërkohet vazhdimi i mandatit e tha edhe propozuesi, është për shkak se në përshkrim është bërë gabimisht, është bërë për 30 ditë. Ndryshe, maksimumi i këtij komisioni është gjashtë muaj.

Kërkesa e të gjithë anëtarëve të komisionit në mënyrë unanime ka qenë që të vazhdohet edhe për pesë muaj. Pra, nga sot edhe pesë muaj kërkohet afat kohorë.

Propozimi i propozuesit për komisionin hetimor është për PTK dhe Vala-n me nënshkrimet e deputetëve sipas Rregullores së Kuvendit dhe ne nuk kemi të drejtë ta ndryshojmë më këtë emërtim dhe kërkesë, sepse janë ata që e kanë nënshkruar dhe e kanë kërkuar.

Komisioni ose Parlamenti ose kushdo tjetër, mund të kërkoj hetim për ndonjë ndërmarrje të re ose për ndonjë ndërmarrje publike, me nënshkrime me procedurë, por kjo pa pëlqimin e propozuesve, atyre që e kanë nënshkruar nuk besoj që mund të ndryshohet. Edhe pse mendojmë që e përfshinë fushëveprimin për të cilin ne jemi të mandatuar nga Kuvendi deri më 6 kur na ka

skaduar mandati dhe tash vendos seanca sesi duhet të procedohet më tutje. Por, sa i përket emërimit nuk besoj që mund ta ndryshojë më seanca.

**KRYESUESI:** Zoti Ymeri, e ke fjalën.

**VISAR YMERI:** Faleminderit, kryesues!

Edhe anëtarët e komisionit e shprehen një pjesë të diskutimit që e kemi pasur në komision. Mendoj që është e shkruar në kërkesë shumë qartë, por po ia vlen të përsëritet edhe një herë.

Çka kërkojmë ne është së pari zgjatja e mandatit për pesë muaj. Kjo ka qenë kërkesa për pesë muaj shtesë meqë kemi përfunduar një muaj. Pra, që ta kemi si komision hetimor mandatin maksimal që na e lejon ligji për ta trajtuar këtë çështje.

Përgjatë diskutimit në komision për sa i përket fushëveprimit të hetimit dhe çështjeve në të cilat do të përqendrohemi gjatë punës së këtij komisioni, është e domosdoshme që t'i kemi ndërmarrjet edhe ndryshimin që ka ndodhur përgjatë kohës në këto ndërmarrje.

Pra, natyrisht që duhet ta kemi që të figurojë aty edhe PTK-ja meqë një pjesë të konsiderueshme të çështjeve të cilat i hetojmë bien në kuadër të ndërmarrjes sa ka qenë ajo bashkë, pra Posta dhe Telekomu dhe pastaj kryesisht përqendrimin do ta kemi në Telekom.

Mendoj që emërimi aktual i komisionit, edhe pse do të ishte me mirë të ishte ndryshe, nuk është se e pengon punën e komisionit. Kështu që në këtë drejtim, unë të paktën si kryesues jam i hapur që edhe nëse e ndryshon seanca edhe nëse nuk e ndryshon, nuk mendoj që kjo do të paraqesë ndonjë pengesë punës së komisionit. Mirëpo, moszgjatja e afatit e pamundëson absolutisht punën e këtij komisioni dhe e paralizon atë që në fillin e saj.

Prandaj, kërkoj nga deputetët që ta votojnë zgjatjen e mandatit të këtij komisioni hetimor. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Atëherë, edhe për këtë çështje po e presim zotin Zeka. U kërkuar më herët që të votohet edhe njëherë. Edhe pse s'pati nëpërmjet diskutimeve, por unë mund ta hedh edhe njëherë në votim çështjen e komisionit.

Jo, jo mandatin. Është fjala për këtë...A dëshironi ta vendosni vetëm mandatin, pa e emëruar zëvendësuesin? A jeni dakord se mos nuk po e votojnë. Unë e hedh në votim menjëherë. Nuk kam ndonjë problem. Detyra ime është ta hedh në votim.

Atëherë, të nderuar deputetë pas diskutimeve, po dihet që propozuesi për zëvendëskryesues nuk është këtu. E hedh në votim vazhdimin e mandatit të komisionit hetimor për ndërmarrjen publike PTK dhe Vala.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. A po ju punojnë kartelat juve PSD-së? Votojmë tani!

Faleminderit! 67 deputetë kanë votuar. 66 vota janë për. 1 është kundër. Konstatoj që Kuvendi miratoi zgjatjen e mandatit edhe për pesë muaj të Komisionit Hetimor Parlamentar në lidhje me gjendjen në PTK dhe Vala nga dita e miratimit të kërkesës si dhe pret për ta emëruar zëvendësuesin e këtij komisioni hetimor.

Është edhe një votë e Dardan Sejdiut shtesë me dorë, pa kartelë. Faleminderit!

Zonja Mjaku e ka fjalën. S'e kam parë, më fal Mexhide.

MEXHIDE MJAKU-TOPALLI: Faleminderit, nënkryetar!

Është me të vërtetë se e kam kërkuar disa herë fjalën, duke vepruar edhe gjeste trupore.

KRYESUESI: Sot, nuk e ke kërkuar asnjëherë.

MEXHIDE MJAKU-TOPALLI: Po, po!

KRYESUESI: Sa herë e kërkuar që e ke pasur emrin këtu e ke marrë fjalën. Më fal! Kur i keni kartelat mos e kërkonit me duar fjalën se nuk e di se çfarë kërkonit.

MEXHIDE MJAKU-TOPALLI: Është me interes ta ngre çështjen që po dua ta ngre tani.

Diskutuan me radhë shefat e grupeve për përbërjen e grupit. U diskutua po ashtu edhe përcaktimi plus një (+1) i grave deputete. Është deklaruar po ashtu edhe kolegu Arben që kemi të zonja, kolege deputetë që mund të jenë pjesë nga subjekti i LDK-së i këtij grupi punues, komisioni ad hoc, më vjen keq.

U pa edhe e patëm një mesazh me 48 vota në ekranin përpara vetës. Ky ishte i mesazhi për ju i nderuar zoti Hoti që gratë deputete nuk e votuan këtë përbërje të këtij ekipi. Kështu që do të ishte e rrugës, do të ishte e mirë, do të ishte e ndershme që të mblidheni ju si subjekt dhe të vendosni në emër të një koleges sonë që të jetë pjesë e këtij komisioni ad hoc. Kështu që, po qe se e qitni edhe njëherë në votim këtë përbërje, sigurisht që nga gratë deputete nuk do ta keni votën.

KRYESUESI: Atëherë, shkojmë në pauzë deri në orën 15:00. Ju kisha lutur që të vini në orën 15:00 dhe jo në 15:30.



*Vazhdim i mbledhjes, pas pauzës*

*Mbledhjen e drejton nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.*

#### **4. Shqyrtimi i Propozim-amendamentit numër 26 në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, të propozuar nga 80 deputetë të Kuvendit**

Siç e dini, për këtë çështje duhet të kemi 80 vota, përfshirë këtu 14 vota të komuniteteve të tjera.

Ne s'i kemi 80 vota dhe nuk po shihet që janë komunitetet e tjera, nuk është as propozuesi këtu.

Unë po e lë anash për më vonë, në qoftë se bëhet kuorumi. Nuk kemi as kuorum për t'i votuar amendamentet e pikës shtatë të Projektligjit numër 06/L-081 për qasje në dokumente publike.

Ashtu siç nuk kemi kuorum për të filluar dhe realisht për ta përfunduar pikën e gjashtë, që është Shqyrtimi i Propozim-programit të Punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës për vitin 2019.

Unë mendoj që duhet ta fillojmë aktualisht me pikën e nëntë të rendit të ditës:

#### **9. Debat parlamentar sipas kërkesës së deputetes Teuta Haxhiu, mbështetur nga nëntë deputetë nënshkrues, në lidhje me të drejtat e pensionistëve kontributdhënës**

Për pikën tetë, dikush ka thënë që nuk është propozuesi Faton Topalli këtu, nuk është as ministri këtu, kështu që nuk vlen, për këtë propozimin e Aidës, meqenëse këtu e ka thënë mendimin e vet më herët. Nëse je për ta futur në diskutim në këtë gjendje, ok-ej, ama nuk arrihet asgjë kështu.

Po fillojmë pra debatin parlamentar, sipas kërkesës së deputetes Teuta Haxhiu, që është pika e nëntë e rendit të ditës, mbështetur nga nëntë deputetë nënshkrues, në lidhje me të drejtat e pensionistëve kontributdhënës.

Deputetja Teuta Haxhiu, e mbështetur nga nëntë deputetë nënshkrues, ka parashtruar kërkesë për debat parlamentar lidhur me të drejtat e pensionistëve kontributdhënës.

Zonja Haxhiu, e keni fjalën dhe po vazhdojmë tutje.

**TEUTA HAXHIU:** Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Kërkesa për debat parlamentar për pensionet kontributdhënëse, e bërë nga tetë kolegë deputetë që më kanë mbështetur, është e muajit tetor të vitit të kaluar. Megjithatë unë konsideroj që është temë me rëndësi, prandaj, është mirë që secili prej deputetëve të japë kontributin e tij, në mënyrë që në fund të dalim me disa pika të një rezolute që do t'i harmonizonim edhe me grupet e tjera, e unë jam e gatshme që ta kemi vërtet një koordinim të plotë.

Në këtë rast kjo temë që na u ka adresuar shpeshherë, qoftë si deputetë, apo edhe si grupe parlamentare, çështja e pensioneve kontributdhënës nga pensionistë të caktuar, por njëkohësisht edhe nga takimet që i kemi pasur me Shoqatën e Pensionistëve të Kosovës, personalisht kam marrë shumë herë edhe nga ta sugjerime dhe kërkesa që ata u kanë bërë në vazhdimësi institucioneve të vendit.

Pensionistët kontributdhënës vazhdojnë të kërkojnë nga autoritetet vendore dhe ato ndërkombëtare kthimin e Fondit Pensionit të Kosovës, i cili për më shumë se 19 vjet në mënyrë joligjore mbahet në Serbi.

Që nga përfundimi i luftës së fundit në Kosovë kjo kategori e shoqërisë ka realizuar disa nisma, madje në mënyrë individuale, por asgjë nuk ka përfunduar në favorin e tyre.

Megjithatë Qeveria e Republikës së Kosovës, nëpërmjet Ligjit për skemat sociale të financuar nga shteti, të gjithë të pensionuarve kontributdhënës dhe atyre jokontributdhënës pensionin bazik, që më shumë është një mbështetje sociale për këtë kategori.

Të drejtën në pensionin kontributdhënës të moshës e realizojnë të gjithë personat, të cilët kanë shtetësi të Kosovës dhe të cilët kanë mbushur moshën 65-vjeçare, pastaj duhet të kenë stazh pensional kontributdhënës sipas Ligjit për sigurimin pensional dhe invalidor numër 011/24-83, Gazeta Zyrtare e asaj kohe, e KSAK numër 26/83, para datës 1 janar të vitit 1999.

Pika tre, pastaj ofrojnë dëshmi të vlefshme mbi pagesën e kontributeve sipas dispozitave të Ligjit për sigurimin pensional dhe invalidor numër që e ceka më herët para kësaj date të vitit 1999, në Ligjin 04/L-131 për skema pensionale të financuara nga shteti neni 8.

Mirëpo, deri këtu është pothuajse gjithçka në rregull. Por më vonë Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale ka nxjerrë Udhëzimin administrativ 9/2015 për kategorizimin e pensionit kontributpagues sipas strukturës kualifikuese dhe kohëzgjatjes së pagesës së kontributeve, stazhit pensional, me të cilin janë rregulluar të gjitha kushtet dhe kriteret për përfitimin e këtij pensioni.

Udhëzimi administrativ duket si ka rregulluar në detaje disa kushte për përfitimin e këtij pensioni, megjithatë në këtë Udhëzim administrativ ka diçka që është shumë diskriminuese dhe pa bazë logjike, të ketë stazh kontributdhënës së paku 15 vjet para datës 1 janar 1999, sipas Ligjit të SPI-së të Kosovës, numër 26/83, neni 6, paragrafi 2-3.

Duke ditur në këtë kohë që të gjithë shqiptarët kanë qenë të diskriminuar në mënyra të ndryshme në kohën e ish-Jugosllavisë dhe nga Serbia e atëhershme, përcaktimi i stazhit në 15 vjet është periudhë shumë e gjatë.

Shumë pensionistë kontributdhënës para vitit 1999 e shohin si shumë diskriminuese këtë periudhë 15-vjeçare të stazhit për shumë arsye.

Duke ditur dhe duke pasur parasysh që kosovarët, shqiptarët janë larguar me dhunë nga puna rreth viteve të '90-ta të shekullit të kaluar periudha dhjetëvjeçare të viteve '90, kush mund të punojë dhe rrjedhimisht ata që kanë punuar e shfrytëzojnë sot këtë stazh, që do të thotë të gjithë ata që janë larguar nuk e gëzojnë, kurse kanë punuar ata thjesht fatkeqësisht në këtë periudhë ka pasur ndoshta të tillë që kanë punuar gjatë kohës së regjimit.

Si rrjedhojë e këtyre fakteve, ka shumë pak kontributdhënës të cilët mund të plotësojnë periudhën 15-vjeçare të stazhit për arsye komplet dekada të viteve të '90-ta. Dhe, gjithashtu gjashtëmbëdhjetë vjet derisa ky Udhëzim administrativ ka hyrë në fuqi.

Pra, është një periudhë prej 26 vjetëve që rrjedhimisht 26 gjeneratave nuk ua njohim këtë të drejtë, normalisht nëse ka pak prej tyre që janë ende gjallë.

Për të qenë më objektiv dhe të drejtë, Qeveria e Kosovës me këtë kategori, propozoj që periudha prej 15 vjetësh sipas Udhëzimit administrativ 9/2015 për kategorizimin e pensionit kontributdhënës, sipas strukturës kualifikuese dhe kohëzgjatjes së pagesës së kontribut stazhit pensional, neni 6, paragrafi 2-3 të ndryshohet mendoj ose të hiqet komplet ose të ndryshohet në 10 vjet.

Në rezolutën që unë kam paraparë janë tri pika, megjithatë unë pres në fund të debatit që t'i harmonizojmë, po megjithatë po i përmend pikat që unë i kam menduar.

1. Të ndryshohet paragrafi 2-3 i nenit 6 i Udhëzimit Administrativ 9/2015 të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale nga 15 vjet në 10 vjet.

2. Të njoftohen të gjithë pensionistët, të cilët nuk i plotësojnë kushtet me udhëzimin e mëparshëm për shkak të paragrafit 2-3 të nenit 6.

3. Të obligohet Qeveria e Republikës së Kosovës që t'u japë pensionin kontributdhënës të gjithëve që kanë punuar 10 apo më shumë vjet. Megjithatë, është shumë më mirë që fare të mos ketë një periudhë kohore, të gjithë ata që kanë punuar, të marrin pensionin për aq sa kanë punuar.

Por kjo mbetet në fund, besoj shumë, pas një gatishmërie të të gjitha grupeve parlamentare për të harmonizuar rezolutën.

Dhe në fund unë besoj që nuk do ta lëmë në një kohë të pacaktuar për ta votuar këtë rezolutë, ngase vërtet është një periudhë e gjatë kohore, ku të gjithë pensionistët presin nga ne që të marrim hapin konkret, duke ndryshuar këtë Udhëzim administrativ. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Radha është e grupeve parlamentare. Është paraqitur Flora Brovina, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së.

FLORA BROVINA: Faleminderit!

Unë mendoj se kur është vënë në rend dite kjo pikë është dashur të konsultohemi, sepse edhe para jo shumë larg kohe ky Kuvend ka zgjedhur Komisionin ad-hoc për të njëjtën çështje, për pensione të cilat financohen nga buxheti i shtetit.

Dhe në këtë Komision ad hoc marrin pjesë përfaqësuesit e të gjitha grupeve parlamentare, madje edhe nga Komisioni për Çështje Sociale, Shëndetësore dhe për Pensione.

Prandaj, kujtoj që është një debat i panevojshëm derisa Komisioni ad hoc t'i sjellë rezultatet, të cilat është në vazhdim e sipër duke diskutuar dhe debatuar.

Ne jemi shumë në harmoni, ai komision duhet të plotësohet prej përfaqësuesve të opozitës, por jemi në harmoni me ministrinë, e cila gjithashtu ka përgatitur materialet dhe dokumentet për reformën pensionale.

Kemi pasur tanimë takime shumë të frytshme edhe me Bankën Botërore, edhe me ministrin, edhe me ministrin e Financave dhe besoj deri në korrik ju do ta keni raportin dhe të dhënat shumë të sakta, korrigjimet e shkeljeve të të drejtave të njeriut në këtë Ligj për pensionet, qofshin edhe ato në baza të viteve të punës.

Është fakt dhe është thënë në këtë Kuvend shumë herë që vërtet Kosovës i mungon fondi i pensioneve, për dallim prej ish-republikat e tjera të Jugosllavisë, të cilat e kanë pasur bazën pensionale nga fondet e tyre dhe kemi nisur prej zeros.

Prandaj, ka pasur edhe pensione të paverifikuara mirë, sepse në fondin janë vjedhur edhe të dhënat statistikore për vitet e punës, që gjithashtu ka të meta.

Prandaj, nuk dua të marr pjesë më tutje në këtë debat, por i njoftoj koleget dhe kolegët se për këtë çështje po merret Komisioni ad hoc, të cilin ata vetë e kanë votuar. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Arban Abrashi, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së.

ARBAN ABRASHI: Faleminderit, kryesues!

Parimisht në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së ne i përkrahim iniciativat e tilla, të cilat prekin pensionistët dhe të gjitha grupet ose, të themi, moshën e tretë me ide, propozime se si të përmirësohet kjo punë.

Unë kam pasur edhe fatin të punoj edhe ministër në dy vjet e pak në këtë fushë dhe bazuar në obligimet ligjore ne veç kemi filluar në atë kohë propozimet tona për plotësim-ndryshimin e Ligjit të skemave pensionale, ku është paraparë një numër i madh i masave që duhet të ndermirren në mënyrë që të preken këto kategori.

Ne së pari kemi filluar me kategorizimin, ashtu si ka parapa ligji. Gjithashtu kemi bërë ngritjen e pensioneve bazike dhe fillimin e skemave të reja pensionale.

Tek çështja në fjalë pensionet kontributdhënëse, ne kemi filluar reformën e parë, që ka qenë kategorizimi i këtyre pensioneve, dhe besoj që është bërë një punë e mirë në kuadër të mundësive tona buxhetore të atëhershme.

Si ministri gjithashtu kemi filluar së bashku me grupet e interesit të shoqatave, Lidhjet e pensionistëve, në bashkëpunim të ngushtë atëherë edhe me FMN-në dhe Bankën Botërore, se si t'i bëjmë ndryshimet e nevojshme në mënyrë që t'i prekim këto grupe edhe më mirë, për shkak të pabarazive të cilat i kemi hasur në atë kohë.

Një prej pabarazive ka qenë që të njihet kontributdhënia e atyre që kanë punuar në vitet e '90-ta, në sistemin jugosllav atëherë, kurse nuk njihet për ata që kanë mbetur jashtë punës ose që kanë punuar në sistemin tonë atëherë paralel kosovar.

Ne kemi filluar hapat e parë që të bëjmë ndryshimet e kësaj kategorie ose të kësaj periudhe, realisht në idenë që të kemi një pagesë proporcionale për ata që kanë punuar deri në 15 vjet.

Prandaj, kjo ka qenë ideja e Qeverisë së kaluar që të hyjmë në këtë kategori duke prekur që ata nuk e mbërrijnë 15-vjeçarin, ashtu që pritet të paguhen për 14 vjet apo të paguhen për 13 apo për 12 apo deri në 10, ashtu si kanë qenë mundësitë buxhetore.

Tanimë mirëpresim çfarëdo iniciative që prek këtë kategori, në mënyrë që gjithë ata që janë larguar nga puna vitet e '90-ta ose ata që nuk i kanë 15 vjet punë ashtu qysh parasheh Ligji për skema pensionale, që të kenë një pagë meritore.

Përkundër që ngritja e fundit e pensioneve për kontributdhënëse është e mirë, e kam përkrahur, unë mendoj që kjo e ka rritur pabarazinë të kjo kategori.

Është dashur të mendohet që kjo mosha e 15 vjetëve të ulet dhe ai buxhet të shfrytëzohet më mirë për këta që nuk e arrijnë për një muaj, për një ditë apo për një vit, se sa të rritet vetëm për ata.

Sidoqoftë, ky debat i sotëm le të shërbejë që të nxisim edhe më shumë Qeverinë, edhe ministrin që e kemi këtu pranë, që të sjellë plotësim-ndryshimin e ligjit, në mënyrë që këta persona pensionistë, të cilët nuk e mbërrijnë moshën 15-vjeçare, në proporcion, aq sa kanë punuar në atë sistem, të marrin pensionet në kuadër mundësive buxhetore që i kanë.

Prandaj, të mos mbesin jashtë ata që nuk e arrijnë 15-vjeçarin për një muaj ose për dy ditë apo për 3-4 vjet.

Ne do të mirëpresim edhe debatet e mëvonshme, do të nxjerrim edhe rezolutë dhe çfarëdo mënyre tjetër që të kontribuojmë në këtë drejtim. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zoti Sami Kurteshi, në emër të Vetëvendosjes.

**SAMI KURTESHI:** Faleminderit, zoti kryesues!

Ne si grup parlamentar natyrisht që jemi jashtëzakonisht të interesuar që kjo çështje të rregullohet. Unë e dëgjova edhe propozimin e koleges propozuese.

Çështja e parë që dua ta theksoj është: çdo kontribut i paguar në Fondet Pensionale kudo qofshin, ajo është pronë private e secilit, pronë që mbrohet me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Udhëzimi administrativ që e kemi ne këtu në të vërtetë ka qenë krejt i kundërligjshëm, se në asnjë normë ligjore apo kushtetuese të Republikës së Kosovës nuk është i bazuar.

Ne kemi kufizimet, të drejtat ligjore që janë të përcaktuara në ligje të ndryshme, qoftë me rastin e punësimit, qoftë në përcaktimin e kontratave të punës dhe në çdo moment ku ka pasur kontratë pune të një punëmarrësi, në cilindo sektor që ka qenë dhe ka paguar kontribute, ato nuk mund të preken nga askush, as nga shteti, sepse ajo është pronë e secilit në vete, ky është problemi kryesor.

Prandaj, ne edhe nuk do ta diskutojmë këtë çështje, nuk jemi të interesuar që ta diskutojmë çështje a po e zbresim në 10 vjet apo në 8 vjet.

Ne këtë të drejtë të njerëzve nuk mund ta prekim, nuk kemi të drejtë ligjore dhe kushtetuese, ky është problemi ynë. Pa marrë parasysh kush e arsyeton, me çfarë fondesh e arsyeton dhe në cilën mënyrë përpiket ta bëjë një kufizim të tillë, sepse këtë të drejtë s'e jep askush, as shtetit ta prekë

pronën private pa pasur ndonjë obligim ligjor ose ndonjë vendim ligjor të shtetit për interesa madhore.

Kurrë nuk është treguar, nga asnjë ministri, as nga asnjë Qeveri, cili ka qenë interesi madhor që e kanë bërë këtë kufizim. Por, shihet që është bërë në mënyrë arbitrare, dikujt iu ka tekë të thotë ne nuk kemi fonde, nuk kemi mjete dhe prandaj ata që i kanë më pak se 15 vjet s'mund ta marrin, s'u njihet e drejta për kompensim në bazë të kontributeve që i kanë paguar.

Prandaj, kjo nuk mund të kufizohet në mënyrë arbitrare, aq më pak me një Udhëzim administrativ që nuk ka mbështetje në ligj, as në Kushtetutë.

Është e vërtetë se Kushtetuta e Republikës së Kosovës nuk përmban një dokument ndërkombëtar që do ta obligonte Republikën e Kosovës që këtë çështje ta rregullojë ashtu si rregullohet në çdo vend, ku ka shtet ligjor, edhe kjo është Konventa për të Drejtat Ekonomike dhe Sociale, kjo është kërkuar shumë herë.

Unë e di personalisht se është kërkuar nga Avokati i Popullit në disa rekomandime, kurrë nuk është futur, për arsye se dikush në qeveritë e kaluara në mënyrë arbitrare ka konstatuar se ne nuk kemi mjete. Kjo është e vërtetë për pjesën e kontributeve që janë vjedhur nga Republika e Serbisë dhe në vend se të trajtohet çështja e nxjerrjes së fondeve nga Republika e Serbisë, të fondeve ku janë derdhur mjetet e punëmarrësve, punonjësve kontributdhënës nga Kosova, në të vërtetë është ndërmarrë veprimi tjetër kundërligjor që ka bërë kufizimin arbitrar të afatit, kjo është një çështje.

Çështja tjetër është se çdo njeri që ka punuar në një shtet ligjor, e siç duket shumica e shteteve në Evropë janë pak më ligjore se ne, e njeh kontributin e secilit njeri që ka qenë i punësuar dhe ai kontribut mbetet në fondet e tyre dhe në moshën 65-vjeçare, në marrëveshje me Republikën e Kosovës, të gjitha ato mjete që janë derdhur për kohë të caktuar edhe vende të ndryshme e kanë të rregulluar po ashtu me ligj, cili duhet të jetë ai afat, ato bashkohen me një pension të vetëm në bazë të marrëveshjeve ndërshtetërore që i lidhin shtetet mes vete.

Në këtë drejtim problemi jo i njëjtë, po ka qenë edhe me Zvicrën, po është edhe me shtetet e tjera, kemi numër jashtëzakonisht të madh të njerëzve tanë që kanë punuar edhe në republikat e tjera, në vende të tjera për kohë të caktuar dhe kanë probleme mandej me tërheqjen e mjeteve të tyre për arsye të ndryshme.

Prandaj, ne si grup parlamentar, si parti politike jemi jashtëzakonisht të interesuar dhe do të bëjmë çdo përpjekje që kufizimet e tilla, që janë arbitrare, vërtet nuk ka asnjë mbështetje as në ligj, as në Kushtetutë qëndrimi, vendimi, norma në Udhëzimin administrativ 9/15 për këto çështje.

Një gjë që duhet ta diskutojmë në lidhje me këtë çështje, është me të vërtetë vjedhja e Fondit pensional nga Republika e Serbisë.

Komisioni për Legjislacion i Kuvendit të Republikës së Kosovës ka vënë kontakte me federatat e pensionistëve të Kosovës që e kanë hapur këtë çështje.

Komisioni më ka caktuar mua si person që do të duhej të merrej me trajtimin e kësaj çështjeje në lidhje me mundësinë e kthimit të Fondit Pensional nga Serbia ose të fitimit të drejtës së pensionistëve kontributpagues nga Fondi Pensional i Serbisë.

Unë kam marrë kontakte me personat apo institucionet përgjegjëse, kam kontaktuar federatat, kam kontaktuar Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, kam kontaktuar edhe me Institucionin e Avokatit të Popullit që e ka përcjellë këtë çështje, sidomos sa u përket vendimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e cila ka nxjerrë vendime me të cilat obligon Republikën e Serbisë, Fondin Pensional të Serbisë të qytetarëve që kanë paguar kontribute në Fondin Pensional që ata e kanë vjedhur, e kanë tjetërsuar apo e kanë tërhequr në Serbi, sido që ta quajmë, janë të obliguar që ato mjete t'ua paguajnë njerëzve, ashtu siç janë kontributet e tyre. Unë natyrisht jam duke punuar në këtë drejtim, nuk dua t'i përziej këto dy gjëra, jam duke punuar, jam duke kontaktuar në emër të komisionit me të gjithë personat dhe institucionet relevante dhe sigurisht në një moment të caktuar, kur të vijmë në pikën që është e domosdoshme, unë do ta informoj edhe komisionin, nëse komisioni kërkon edhe Kuvendin e Republikës së Kosovës, këtu është edhe ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, që ka treguar gatishmëri për rregullimin e kësaj çështjeje.

Edhe një herë, Lëvizja Vetëvendosje është e interesuar dhe do të përpiqet, do të bëjë çdo përpjekje që çdo kufizim që nuk është i ligjshëm sa u përket pensioneve dhe stazhit apo periudhës që nuk njihet, edhe është hequr në mënyrë arbitrare, që të hiqet nga ligji dhe nga çdo akt tjetër nënligjor që kufizon të drejtat që janë të patjetërsueshme dhe të garantuara me Kushtetutë. Prandaj, ne do të përkrahim çdo përpjekje që e trajton këtë çështje drejt, bazuar në Kushtetutën dhe në ligjin, duke i hequr të gjitha kufizimet dhe duke e bazuar çdo normë në këtë drejtim në garanci kushtetuese dhe ligjore. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Kush e ka fjalën nga AAK-ja në emër të grupit? Zoti Ahmet Isufi.

**AHMET ISUFI:** Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Inicimi i një çështjeje të tillë, siç është e drejta e pensionistëve kontributdhënës, është mendoj një veprim shumë i mirë edhe Parlamenti sa më shpejt duhet të marrë vendim në mënyrë që të bëhet edhe baza ligjore, e cila e ndryshon këtë gjendje të pensionistëve kontributdhënës.



Ajo që dua ta them si pikë e parë është që çështja e pensionistëve kontributdhënës nuk është zgjidhur deri më tani, kanë kaluar 20 vjet e kusht i parë që të shkohet në bisedime me Serbinë është dashur të bëhet kthimi i fondeve, jo vetëm i pensionistëve kontributdhënës, por edhe i qytetarëve, të cilët kanë pasur kursimet e tyre në bankat që janë grabitur dhe dëmet e tjera që i ka shkaktuar Serbia, por gabimet tani ne po i paguajmë edhe më tutje duke shpenzuar buxhetin e Kosovës, a në të vërtetë është dashur që bisedimet të fillojnë nga ato obligime që i ka pasur Serbia ndaj Kosovës. Po ashtu, kemi të bëjmë edhe me një fazë kur është bërë kufizimi në 15 vjet, e që konsideroj që duhet të shikohet mundësia që çdo kontributdhënës të realizojë të drejtën e vet, qoftë edhe për minimumin e kohës kur ka pasur marrëdhënie pune, sepse kështu i kthehet e drejta qytetarit të Kosovës. E di që në qeverinë e kaluar është bërë ky kufizim, por që mendoj që qeveria e tanishme duhet ta bëjë këtë ndryshim dhe të ofrojë ligjin, i cili i përcakton skemat pensionale jo vetëm në këtë rast, por në të gjitha rastet, duke e përmirësuar pozitën e qytetarëve të Kosovës, të cilët kanë kontribuar në këtë vend.

Kemi edhe vendimin e Qeverisë që ka bërë ngritjen prej 20% të pensionistëve kontributdhënës dhe ky është një veprim i mirë, por megjithatë duhet baza ligjore të krijohet në mënyrë që të kemi mundësi të funksionojmë ashtu si duhet. Është një obligim yni që gjeneratave, të cilat kanë kontribuar në shoqërinë tonë vërtet t'ua kthejmë një nder dhe një respekt, duke i pasur parasysh si kontributdhënës, të cilët kanë ndikuar në ndryshimin e jetës tonë. Prandaj, ne e përkrahim dhe do të kontribuojmë normalisht edhe në përmirësimin e skemës sociale, në mënyrë që të kemi një pension të dinjitetshëm për të gjithë ata që kanë kontribuar dhe normalisht që kontributin tonë do ta japim në komision. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Në emër të PSD-së, zonja Baftiu e ka fjalën.

**BESA BAFTIU:** Faleminderit, nënkryetar!

Edhe unë jam njëra ndër nënshkrueset e kësaj iniciative të këtij debati parlamentar, por siç dihet, kjo iniciativë që është marrë nga deputetja Haxhiu është bërë më 29 dhjetor 2018, ndonëse në diskutim e sipër me Teutën i kam thënë që edhe ne si komision jemi të interesuar që sa më parë të bëhet plotësim-ndryshimi i nenit 8, i cili është nen diskriminues, siç u tha edhe nga parafolësit.

Mirëpo, meqenëse tanimë Kuvendi ka vendosur, ka votuar Komisionin ad hoc, i cili do të merret me rregullimin e Kodit pensional, i cili do të përfshijë të gjitha kategoritë, unë tani e shoh si të paarsyeshme që ne me vetëm këtë iniciativë të rregullojmë vetëm një çështje, që do të bëjë ndoshta padrejtësi edhe për grupet e tjera. Ne si komision kemi pasur kontakte të shumta me përfaqësues të sindikatave, të shoqatave, të cilat janë mbrojtës të të drejtave të pensionistëve dhe kërkesë e tyre ka qenë që të bëhet ky plotësim-ndryshim sa më parë i këtij ligji. Po ashtu, edhe me ministrin, i cili ka qenë i gatshëm dhe në agjendën legjislative të komisionit, pikërisht në këtë muaj kemi pasur plotësim-ndryshimin e Ligjit për skemat pensionale të financuara nga shteti. Mirëpo, duke pasur parasysh, edhe një herë po e potencoj, që komisioni i hartuar, i votuar nga

Parlamenti është duke e bërë punën e vet. Ne shpresojmë dhe i bëjmë thirrje këtij komisioni që sa më parë të bëjë punën e tij, për çka edhe është përzgjedhur dhe që sa më parë një herë e përgjithmonë të gjitha kategoritë, të cilat kanë qenë të diskriminuara, të gjejnë veten në këtë Kod pensional. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka në emër të Nismës zoti Enver Hoti.

ENVER HOTI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Është mirë që po debatohet kjo temë për disa arsye, unë do të filloja nga ajo që një e padrejtë e madhe iu ka bërë kontributpaguesve, të cilët janë diskriminuar dy herë. Një herë kur para luftës ata janë larguar nga administrata pushtuese serbe nga vendet e tyre të punës dhe një herë pas luftës, me ligjin e miratuar, i cili ka privuar për pak vite, duke e kufizuar mundësinë që t'u njihet e drejta kontributdhënësve apo kontributpaguesve vetëm në këtë kohë 15-vjeçare.

Mendoj se çdo kufizim i tillë është i padrejtë ndaj çdokujt që ka dhënë kontribut në skemën e tyre pensionale. Po ashtu, mendoj që nuk është bërë mjaft apo është bërë shumë pak në kërkimin e të drejtës së kthimit të atyre fondeve, të cilët i ka vjedhur Serbia nga Kosova, Fondin e kontributdhënësve dhe institucionet e Kosovës njëra nga temat që është dashur të diskutohet edhe në bisedime ka qenë kjo dhe është dashur të jenë këmbëngulës në të drejtën tonë dhe në të drejtën e të gjithë atyre njerëzve që iu ka mohuar kjo e drejtë dhe ai fond që është vjedhur dhe grabitur nga Serbia. Po ashtu, mendoj që tani jemi në një fazë tjetër, të cilën duhet ta trajtojmë këtu, ministri aktual, Ministria e Punës dhe ministri Reçica ka përgatitur një koncept dokument për reformimin e sistemit pensional dhe nga ajo që ne e kemi dhe posedojnë, janë diku 8 ligje, të cilat kanë një kolizion të madh mes vete dhe jo vetëm kjo kategori, por në këtë drejtim kemi padrejtësi të mëdha, të cilat janë bërë edhe nga ligjet aktuale në fuqi dhe nga kolizionet që kanë këto ligje mes vete dhe ne jemi një komision i krijuar nga ky Kuvend, Komisioni ad hoc, jemi duke punuar, e kemi marrë edhe koncept dokumentin e ministrisë dhe mendoj që ky koncept dokument është një bazë e mirë, i cili do të na ndihmojë që ta shtyjmë edhe më tutje punën dhe t'i trajtojmë këto tema, të cilat janë të ndjeshme jo vetëm për këta kontributdhënës, për këtë kategori, por edhe shumë kategori të tjera, të cilat janë pjesë e këtyre skemave sociale dhe pensionale.

Kështu që kam edhe një thirrje shtesë këtu, deputetët e opozitës, të cilët nuk po marrin pjesë, është mirë që të jenë pjesë e këtij komisioni dhe ta japin kontributin aty, sepse mendojmë dhe jemi të bindur se është një detyrim yni që këto padrejtësi dhe këtë reformë të kësaj skeme pensionale të filluar nga ministria dhe ministri Reçica ta shtyjmë deri në fund dhe të kemi vullnetin politik dhe profesional që një herë e mirë ta organizojmë dhe ta sistemojmë dhe secilit t'i njihet dhe t'i mundësohet shfrytëzimi i të drejtës, secilës kategori dhe secilit individ në Kosovë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Pacolli, pa grup parlamentar e ka fjalën.

ISLAM PACOLLI: Përshëndetje, kryesues! Faleminderit për fjalën, se edhe më herët nuk munda të marr fjalën, se si i pagrup, s'të vjen rendi kurrë.

Me të vërtetë po bëhen disa tema, edhe pse kam pasur dëshirë që ne të bëjmë tema më shumë për ekonomi, por megjithatë kjo është e rëndësishme se kontributdhënësit kanë qenë prindërit tanë, natyrisht që iu kanë shkelur të drejtat dhe është një padrejtësi e madhe. Shpresoj që ne të mos humbim kohë vetëm me debate, por të arrijmë një rezultat që të marrim një hap të caktuar për një veprim më të mirë, sadopak me t'ua plotësojmë atë kontribut që e kanë dhënë prindërit tanë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti ministër, fjala është juaja, zoti Reçica e ka fjalën.

MINISTRI SKENDER REÇICA: Faleminderit, zoti nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Çështja e pensioneve kontributpaguese tashmë është një preokupim i përbashkët i të gjithë neve, këtë çështje e kemi identifikuar menjëherë me të marrë mandatin, por para se të flas për masat që kemi ndërmarrë dhe të cilat duhet të ndërmerren, po ju prezantoj në mënyrë kronologjike se si ka rrjedhur procesi i sistemit pensional në Kosovë, veçanërisht atij kontributpagues.

Sistemi pensional në Kosovë ka pasur ndërprerje të plotë në fund të vitit 1998 dhe deri në vitin 2001. Pensionet në Kosovë nuk janë trajtuar me ndonjë ligj apo edhe rregullore të veçantë. Kështu që në dhjetor të vitit 2001 UNMIK nxjerr Rregulloren 2001/35 mbi pensionet në Kosovë, ku trajton vetëm pensionet obligative, të cilat kanë përfshirë dy forma të pensionit: pensionin bazë dhe pensionet e bazuara në kursimet individuale, Trust, në bazë të së cilit nuk është parë pensioni kontributiv ose nuk janë njohur kontributet e paraluftës. Për të vazhduar në vitin 2007 me nxjerrjen e Udhëzimit administrativ nr. 11/2007 për zbatimin e Vendimit Nr. 13/277 të Qeverisë së Kosovës të asaj kohe, i cili ka pas për qëllim rritjen e shumës së pensioneve dhe në nenin 3 të këtij udhëzimi janë përcaktuar kushtet dhe kriteret e përgjithshme për përfitimet në rritje të pensionit bazë.

Shfrytëzuesit aktualë të pensionit bazë dhe personat, të cilët në të ardhmen do të aplikojnë për këto pensione për të përfituar në këtë rritje, sipas vendimit të Qeverisë nr. 13/277 të asaj kohe, duhet përmbushur këto kushte dhe kriteret e përgjithshme, citoj:

1. Parashtruesi i kërkesës duhet të ketë moshën 65 vjet dhe minimumi 15 vjet stazh të sigurimit pensional.

Dhe në fakt këtu ka qenë pikënisja e ndarjes së pensioneve në bazik dhe atë kontributiv. Gjithashtu, edhe Udhëzimi administrativ 15/2009 për rritjen e pensioneve, për zbatimin e

Vendimit të Qeverisë nr. 02/51, neni 3, kushtet dhe kriteret e përgjithshme për përfitimin në rritje të pensionit bazë, pika 1.1, citoj:

“Parashtruesi i kërkesës duhet të ketë moshën 65-vjeçare dhe minimumi 15 vjet stazh të sigurimit pensional, sipas dispozitave të sigurimit pensional dhe invalidor, prej tyre së paku 7 vjet e 7 muaj stazh pune në Kosovë”. Në vitin 2014, kur ka qenë mundësia të rregullohet kjo punë mirë e si duhet, kam përshtypjen që është ikur prej realitetit.

Me Ligjin e aprovuar 04/L-131 për skemat pensionale të financuara nga shteti dhe po ashtu me këtë ligj, sipas nenit 3, pika 1.5. citoj: “Pensionet kontributpagues i moshës, pensioni i rregullt mujor për qytetarët e punësuar në Republikën e Kosovës, të cilët kanë paguar kontributet në ish-Fondin Pensional të Kosovës para datës 1 janar 1999, sipas dispozitave të Ligjit për sigurimin pensional invalidor nr. 011-24/83 Gazeta Zyrtare e KSAK-së nr. 26/83 dhe të cilët i plotësojnë kriteret e parapara me këtë ligj”.

Në fakt, as në këtë ligj nuk ekziston ky kriter. Kuvendi i Kosovës në vitin 2014 me nxjerrjen e këtij ligji ka shkuar përtej këtij ligji, sepse ky ligj e ka burimin te Ligji federativ, ku ka rregulluar sistemin pensional të asaj kohe. Neni 8 thotë: “Kushtet dhe kriteret për njohjen e të drejtës në pension kontributpagues të moshës pika 1, 1.1, 1.2 dhe 1.3 citoj me radhë: “Të drejtën e pension kontribut pagues të moshës e realizojnë të gjithë personat, të cilët kanë shtetësi të Kosovës dhe të cilët, pika 1.1. ka mbushur moshën 65 vjeç duhet të kenë stazh pensional kontributpagues sipas Ligjit për sigurimin pensional dhe invalidor nr. 011-24/83 Gazeta zyrtare KSAK nr. 26/83 para datës 1 janar 1999”, 1.3.: “Ofrojnë dëshmi të vlefshme mbi pagesën e kontributeve sipas dispozitave të Ligjit për sigurimin pensional të cekur më lart”.

Prandaj, baza ligjore e Ligjit për skemat pensionale të financuara nga shteti nr. 04-L/131 për pensionin kontributpagues të moshës është i thirrur sipas dispozitave të Ligjit për sigurimin pensional dhe invalidor nr. 011-24/84 Gazeta zyrtare KSAK nr. 26/83 dhe i cili ligj është amendamentuar më vonë, ku kjo bazë ligjore nuk është propozuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, por është vendosur në atë kohë në vitin 2014 nga Kuvendi i Kosovës. Sipas Ligjit për sigurimin pensional dhe invalidor nr.011-24/83 dhe të amendamentuar, kriteri për përvojën e punës apo stazhin e punës është minimumi 15 vjet. Për të zbërthyer më detajisht nenin 8 të këtij Ligji për skema pensionale kur flitet për pensionin kontributpagues, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale e ka rregulluar me një Udhëzim administrativ që mban datën 09.2015 të nënshkruar nga ish-ministri zoti Abrashi. Ky kriter i zbërthyer me këtë Udhëzim administrativ është në përputhje me Ligjin për sigurimin pensional dhe invalidor, 011-24/83 Gazeta Zyrtare KSAK.

Në rezolutën e Kuvendit, të cilën deputetja Haxhiu e paraqiti ndaj kërkesës për të ndryshuar Udhëzimin administrativ nr. 09/2015 për kategorizimin e shfrytëzuesve të pensionit

kontributpagues sipas strukturës kualifikuese dhe kohëzgjatjes së pagesës së kontributeve dhe stazhit pensional, ministria si organ sponsorizues nuk e ka atë të drejtë të ndryshojë, ngase nuk është sponsorizues, nuk mund të ndryshojë kriteret, përkatësisht periudhën prej 15 vjetësh, pasi që konsideron se baza ligjore, pra ligji është i vetmi i cili përcakton këtë kriter, e ky kriter është neni 8 i Ligjit për skemat pensionale i caktuar sipas Ligjit për sigurimin pensional dhe invalidor të cekur më lart.

Prandaj, për të ndryshuar periudhën e njohjes së stazhit të punës, siç është kërkuar nga 15 vjet në 10 vjet, ne konsiderojmë se duhet të ndryshohet baza ligjore. Pra, neni 8 i Ligjit për skemat pensionale të financuara nga shteti dhe definicioni përkatës, ku përshkruhet dhe Ligji për sigurimin pensional invalidor, i cekur më lart. Gjithnjë, duke u ballafaquar me këto vështirësi dhe analizat e bëra kemi vendosur të fillojmë me reformën pensionale në vend, ku edhe do të instalohej sistemi i sigurimeve sociale. Për këtë qëllim Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale gjatë vitit të kaluar ka hartuar koncept dokumentin për rregullimin dhe menaxhimin e fushës së pensioneve dhe beneficioneve nga sigurimi social. Objektivi i përgjithshëm i reformës së propozuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale është ofrimi dhe garantimi për të gjithë qytetarët kosovarë që kanë nevojë për mbrojtje sociale, duke reformuar dhe modernizuar sistemin pensional dhe invalidor sipas standardeve ndërkombëtare dhe nevojave socio-ekonomike të vendit. Përmes draft koncept dokumentit kemi synuar që të krijojmë një kornizë të përgjithshme ligjore dhe të qëndrueshme të sistemit pensional dhe invalidor dhe fushat e tjera nga sigurimi social, për të cilat është përgjegjëse Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale. Ky proces synon të ketë ndikim në rritjen e barazisë në mes të kategorive të ndryshme të përfituesve në aspektin e përfshirjes sociale dhe stabilitetit financiar.

Ndërsa, sa u përket kriterëve për periudhën kontributive, punonjësve të viteve të '90-ta në bazë të këtij koncept dokumenti do t'u njihet stazhi i punës për vitet, të cilat kanë qenë të dëbuar me dhunë nga puna, por gjithsesi duke marrë parasysh kriteret, të cilat duhet të caktohen me ligj se kujt duhet t'i pranohet ky stazh dhe kujt jo. Dhe, me këtë rast do të adresohet qartë preokupimi ynë i përbashkët sa u përket viteve të kontributeve për pensionet kontributpagues. Unë pres që ky koncept-dokument të përkrahet nga komisioni, i cili ka marrë mandatin e këtij Parlamenti për të hartuar Kodin pensional, ashtu siç është quajtur, sepse është një dokument, i cili në mënyrë të përgjithshme dhe shumë profesionale adreson çështjet me të cilat ballafaqohet Kosova sa i përket fushës së pensioneve dhe beneficioneve. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Po vazhdojmë me diskutime të mëtutjeshme, radhën e ka zonja Hykmete Bajrami.

**HYKMETE BAJRAMI:** Faleminderit, kryesues!  
Të nderuar qytetarë të Kosovës,

Me të vërtetë po diskutojmë me një çështje mjaft me rëndësi, edhe unë e mora fjalën vetëm për të thënë se i bashkohem opinionit të kolegëve se neni 8 i Ligjit për skemat pensionale të financuara nga shteti, pikërisht paragrafi 1, pika 1.2, janë shumë diskriminues dhe në fakt nuk e di se pse ende ne kemi udhëzime administrative, të cilat thirren në këto ligje, të cilat janë diskriminuese.

Natyrisht që një ligj i tillë nuk ka qenë diskriminues në kohën kur ne kemi qenë si pjesë përbërëse e Jugosllavisë, por është tepër diskriminues tani, për shkak se sot, i nderuar ministër, ju keni persona, të cilët dëshirojnë ta marrin pensionin kontributdhënës dhe mund të dokumentojnë 14 vjet e 11 muaj të përvojës së tyre para luftës dhe për një muaj ata diskriminohen.

Mirëpo, këtu ne sot nuk po flasim vetëm për ata, të cilët diskriminohen për një muaj dhe për dy muaj, por duhet të flasim edhe për ata, të cilëve u mungojnë 10 vjet. Unë besoj që ju si Qeveri duhet ta keni parasysh që në fakt ta eliminoni një nen të tillë kudo që e keni dhe referencën që i bëni në Ligjin e Jugosllavisë së atëhershme dhe pensionet kontributdhënëse t'u njihen të gjithëve në mënyrë proporcionale me vitet e përvojës së punës, sepse ne e dimë Fondi Pensional i Kosovës është vjedhur, është grabitur nga Serbia edhe nuk e di se pse dikush që ka bërë 15 vjet punë ka meritë që sot të paguhet prej taksave të qytetarëve të Republikës së Kosovës, kurse dikush që i ka humbur 10 vjet ose 4 vjet nuk e ka domethënë këtë të drejtë të kompensimit. Unë besoj që kjo duhet të fuzionohet me pensionet që vijnë nga Trusti, t'i jepet një vlerë, një koeficient dhe faktikisht në reformën, kurdo që ajo vjen, e unë, ministër, ju bëj thirrje që ju të mos prisni nga Kuvendi, sepse me të vërtetë për të bërë një kod pensional, unë jam skeptike që në këtë legjislaturë do të mund të bëhet, por të paktën t'i eliminojmë nenet, të cilat janë tepër diskriminuese, joligjore dhe janë jokushtetuese.

Unë besoj që ne me këtë nen po bëjmë shkelje të të drejtave të njeriut dhe besoj që kushdo që do t'ua mësynte gjykatave ndërkombëtare, do ta fitonte rastin, mirëpo ne e dimë që shkuarja në gjykatë kushton më shumë se krejt kumulativi i pensionit. Andaj, ministër, ju bëj thirrje që, në fakt, sa më shpejt të merrni iniciativë dhe nëse jo, domethënë të marrim ne si deputetë iniciativë që këtë nen në Ligjin për skemat pensionale të financuara nga shteti ta largojmë, në mënyrë që t'u njihet kontributi të gjithëve, proporcionalisht me përvojën e punës që ata e kanë para luftës dhe të mos vendosim asnjë kufizim, besoj që këtu me krejt grupet parlamentare jemi njëzëri. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zoti Xhelili e ka fjalën.

**FATMIR XHELILI:** Faleminderit, nënkryetar!

Përshëndetje për ish-ministrin Abrashi dhe për ministrin e tashëm për kontributet që kanë dhënë, i pari në skemat pensionale dhe tentimin e përmirësimit të këtyre skemave, por edhe përkushtimin e ministrit Reçica për punën dhe përkushtimin që e bën në tentimin për të përmirësuar këto skema. Ka shumë ankesa që prej tyre u cekën prej pensionistëve

kontributdhënës dhe një prej atyre kryesore është 15-vjeçari. Te pesëmbëdhjetëvjeçari ne faktikisht jemi duke i dëmtuar ata që janë larguar prej punës dhe gjithsesi propozimi është që t'u llogaritet stazhi i punës deri me 31 dhjetor të vitit 2001. Pse po them 31 dhjetor 2001? Sepse ka mbetur ka mbetur i pambuluar edhe viti 1999, edhe viti 200, edhe viti 2001, kur është marrë vendim që të formohet Trusti dhe të kalohet në formën kur gjenerata e mban vetveten e jo si në formën e mëparshme në ish-Jugosllavi ku gjenerata e ka mbajtur gjeneratën paraprake ose gjeneratat paraprake.

Prapa këtij stazhi të llogaritur duhet pasur parasysh shumë edhe një diskriminim shtesë që është bërë nga ish-shteti ose ish-organizatat punëdhënëse. Për shkak të krizave financiare që kanë pasur shumë organizata dhe ndërmarrje atëherë, ata i kanë ndërprerë pagesën e kontributeve për punëtorë të cilët kanë vazhduar ende të punojnë, edhe pse punëtorët nuk kanë qenë të lajmëruar dhe të informuar që u është ndërprerë pagesa e kontributeve pensionale në fondin pensional. Faktikisht punëtorët kanë punuar pa pasur mundësinë që ta kenë në pasqyrën e vet ose në pasqyrën e të ardhurave të tyre sa kanë kontribuar për pensione, sepse ato janë ndërprerë. Në disa ndërmarrje janë ndërprerë në vitin 90 disa në vitin 91, disa 92 e për të tjerat edhe më tutje. Për këtë kam informacione prej punëtorëve që kur kanë shkuar të shohin kontributet e tyre në pasqyrat e pagesave për kontribute, shumica prej tyre nuk i kanë gjetur pagesat prej vitit '90 e tutje, edhe pse ata kanë punuar disa prej tyre edhe deri në '94-tën, '95-tën, '96-tën dhe një prej propozimeve është që t'u llogaritet pagesa edhe atyre, ani pse ato ndërmarrje dhe ato organizata nuk i kanë paguar kontributet për pensionet.

Kjo është e para. E dyta është pak pagesa uniforme për të gjithë ata që e kanë atë stazh pune, qoftë 15 vjet, 10 vjet apo më tutje. Unë besoj që duhet të përdoret një formulë tjetër. Të përdoret formula e dhjetëvjeçarit të fundit ose e pesëvjeçarit të fundit, nxirret mesatarja e pesëvjeçarit apo e dhjetëvjeçarit dhe paguhet pensioni karshi kontributeve që i ka dhënë ai me metodat konvertuese të vlerave të tanishme për valorizimet e atyre të pagesave të asaj periudhe kohore.

E treta, disa shtete evropiane me plotësimin e moshës 65-vjeçare, apo 63-vjeçare si e kanë disa shtete, ata në qoftë se kanë punuar edhe tri vjet, edhe në qoftë se për tri vjet kanë bërë pagesa për kontributet pensionale, për ato tri vjet i marrin pagesat dhe faktikisht nuk duhet caktuar ne as dhjetë vjet, as pesë vjet as pesëmbëdhjetë vjet, mirëpo të merret periudha kohore për të cilat janë paguar kontributet në atë fazë.

Unë, propozimi kryesor i imi është që ta autorizojmë Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale që të formohet grupi punues dhe të gjitha ato që dalin propozime prej Kuvendit të shkojnë si propozime dhe rekomandime për Ministrinë, sepse e vetmja ministria është që i ka kapacitetet edhe profesionale, edhe mundësinë për të hartuar dhe për të përmirësuar Ligjin për skemat pensionale, po edhe me i përmirësuar lëshimet që janë bërë deri tash. Kështu që nuk besoj që Komisioni pa dashur ta nënçmojë askënd ka kapacitete për të dalë me një propozim të mirë për

plotësim ndryshimet, se nuk është e mjaftueshme të plotësohen dhe ndryshohen vetëm një a dy udhëzime administrative, por do ndërhyrje më të thellë të ligjit. Ju dëshiroj sukses në punë zoti ministër dhe besoj që do të gjej mirëkuptimin te deputetët e tjerë që këtë autoritet dhe këtë autorizim ta bartim te Ministria. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zonja Millaku!

DRITA MILLAKU: Faleminderit!

Të nderuar qytetarë,

Të nderuar kolegë deputetë,

Pensionet kontributdhënës janë kategori e veçantë sociale, e cila duhet të trajtohet me kujdes të veçantë dhe dinjitetshëm nga institucionet tona shtetërore. Duke i ofruar mundësinë e gëzimit të të drejtave të tyre që u takojnë, pasi që dihet shumë mirë që janë gjeneratat e kësaj shoqërie, që me punën, mundin dhe sakrificën, kontributin e tyre shumëvjeçar meritojnë një përkujdesje të rregulluar me legjislacion dhe me skemë sociale dhe pensionale aktuale.

Këto gjenerata kanë të bëjnë me prindërit tanë dhe prindërit e secilit prej nesh, të cilët punuan dhe na ofruan një të ardhme të ndritshme dhe të sigurt, të cilët në të njëjtën kohë dhanë nga ajo pagë që merrnin kontributin dhe mjetet të cilat, ato mjete u grabitën nga regjimi okupues serb, shifra të cilave kalojnë mbi dy miliard euro. Pra, kjo kategori shoqërore përveçse ka qenë e diskriminuar dhe e plaçkitur në sistemin e vjetër, vazhdon të lihet anash dhe duke mos u përkrahur edhe nga qeveritë aktuale, por edhe rrjedhimisht nga secila qeveri.

Përkundër memorandumit të nënshkruar ndërmjet këtij koalicionit qeverisës dhe Shoqatës së Pensionistëve të Kosovës në kohën e fushatës elektorale për rritjen e pensioneve kontributdhënëse, si dhe përfshirjen në skema të tilla pensionale dhe të një pjese të punëtorëve arsimorë e shëndetësorë të cilët punuan pareshtur në kohërat e egra të okupimit të viteve '89 deri në vitin '99, duke ofruar dijen dhe profesionin për t'i dalë në ndihmë popullit në kohërat më të vështira. Kurse tani në ditët e sotme, kjo pjesë e shoqërisë, përveç se në masë të madhe fare nuk është përfshirë në skemat e pensioneve kontributdhënëse dhe ato penisione të cilat i marrin, janë në formë lëmoshe dhe nuk mjaftojnë as për minimumin e ekzistencës.

Reformat e bëra në fushën e skemave pensionale nga Qeveritë paraardhëse si dhe angazhimi i ngathët i kësaj qeverie, në këtë drejtim të vetëm element sadopak pozitiv që do të mund të ketë përmes fondeve, është ai i Trustit Penisonal. D.m.th. aty preken vetëm gjeneratat e reja të ardhshme dhe kurrsesi nuk mund të përfitojnë ato më të vjetrat, të punëtorëve kontributdhënës për dekada me radhë. Përveç reformave dhe mënyra sesi janë kategorizuar pensionistët kontributdhënës, në bazë të kriterëve të ndryshme bëhen edhe më diskriminuese për këtë kategori, ua përdhos gjithë punën e bërë për vitet e tëra.



Pra, mjaft me diskriminim e kësaj kategorie, trajtojeni atë, ndërmerrni iniciativa ligjore për rregullimin e kësaj kategorie njëherë e përgjithmonë, ashtu siç e meritojnë të gjithë kontributdhënësit, duke ua ngritur pensionet dhe duke mos i lënë anash një pjesë bukur të madhe të mësimdhënësve dhe punëtorëve shëndetësorë, të cilët edhe pse të dëbuar nga objektet shkollore dhe shëndetësore vazhduan punën plot vullnet në shërbim të tyre deri në atë masë sa rrezikuan edhe jetën e tyre, andaj duhet të punohet për këtë kategori, të trajtohet ashtu siç duhet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Gani Dreshaj.

GANI DRESHAJ: Të gjithë po thonë se jemi shokë, e mua s'po ma jep fjalën askund.

Unë prej krejt respektit që kam për dy ministrat respekt të veçantë, ministrin Reçica s'e mori kur të shkojë në Vrellë çka t'u them atyre, a e merr ai pensionin a s'e merr. Edhe s'jemi duke e zbuluar Amerikën i nderuar avokat. Njerëzve u takon pensioni një ditë punë, një ditë pension.

Po flasim shumë për pensionet e RSFJ-së. Të gjithë jemi të qartë që duhet t'i marrim ato pensione, po duhet të luftojë Avokati i Popullit, t'ua jep të drejtën t'i nxjerrin pensionet.

Ministër, çka është duke u bërë me pensione tash që po i paguajmë? Ku e kemi rrogën minimale në ndërmarrje private? A e di të ministër shoku im i nderuar që gjysma e marrin në zarf, i paguajnë 150 euro çikave, grave të reja, motrave tona, e të tjerat s'u paguhen.

Ku është Fondi Pensional që po luhet kumar, e po jepet me fajde, ky i tanishmi, mos ta ndjekim Serbinë e Jugosllavinë këta s'na jepin, na kanë faj. Pse marrim ne para me fajde prej bankave me 7.8 për qind, e bixhoz luhen fondi pensional aktual? Të kthehemi pak të shohim çka duam të bëjmë sot, çka duam t'u bëjmë nesër. Ne jemi të detyruar t'i plotësojmë kushtet e Bashkimit Evropian. Për çdo ditë e kemi gojën euroatlantike, demokratike e këtu po ua kushtëzojmë njerëzve sa ditë ka punuar, sa vjet ka punuar. Ai Sali Zeku im, mixha im nuk ka punuar, ka punuar ka 12 vjet e gjashtë muaj. Ministri e di që ka ditur qysh duhet, po s'ka faj as ky ministër, ne deputetët ose Qeveritë, po nuk guxojmë t'i prekim ato të drejta të njeriut.

Duhet t'i marr syzet se s'po shoh bash mirë.

Unë mendoj që nuk e dimë as ku janë fondet e privatizimit dhe s'na kanë dhënë minus, unë kurrë s'kam marrë një rezultat kush është duke luajtur me fondet e pensionit tash. Kaq pata, faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nisma s'paska. Fjalën e ka zoti Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit kryesues!

Kolegë deputetë,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Sigurisht se interesimi shkon për ata pensionistë kontributpagues ta përcjellin këtë debat dhe ta shohin realitetin se çka kanë bërë institucionet e Republikës së Kosovës në favor të tyre dhe çka kanë bërë institucionet e Republikës së Kosovës që nga viti 2000 e deri tash, është për keqardhje, pa dashur ta përjashtoj as individin, as institucionin, as Qeverinë, as Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Edhe pasqyra që e dha ministri aktual tregon qartë ikjen nga përgjegjësia, ashtu siç ka ndodhur edhe në të kaluarën dhe ashtu siç pretendohet, ndodh edhe në të ardhmen, nëse s'ka masa dhe iniciativa konkrete që përkrahen me votën e deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Tash kolegë të nderuar, më lejoni që të marr vetëm dy shembuj nga praktika dhe nga e kaluara se çka ka ndodhur kur është biseduar edhe është trajtuar çështja e kontributdhënësve në Republikën e Kosovës. E para, që nga paslufta, institucionet tona i janë nënshtruar direktivave të UNMIK-ut të padrejta, të cilat nuk kanë lejuar që pensionistët kontributdhënës ta marrin pensionin e merituar.

E dyta, institucionet e Republikës së Kosovës ua kanë mundësuar atyre të cilët kanë qenë pjesë e përkrahjes së aparatit shtetëror serb pas viteve 1990 dhe punën që e kanë bërë në ato institucione. Ndërsa, ua ka mohuar të gjithë atyre mësimdhënësve, personelit shëndetësor, policëve, të gjithë punëtorëve ua ka mohuar të drejtën e pensionit vetëm e vetëm se kanë qenë pjesë e institucioneve të Republikës së Kosovës dhe sistemit paralel në kohën e saj, gjatë viteve 1998-1999.

Kjo është edhe pasqyra më reale edhe sot kur po diskutojmë edhe me kërkesën që të ketë debat parlamentar, kërkesë e cila mendoj duhet të plotësohet me plotësim-ndryshim të ligjit, dhe jo me plotësim-ndryshim të një udhëzimi administrativ. Sigurisht parashtruesja e debatit duhet ta marrë dhe në momentin kur ka harmonizim të qëndrimeve ta paraqesë këtë para ministrit në fjalë.

Kolegë të nderuar deputetë,

Për të dashur të përdorim analogji dhe të jemi të sinqertë ne me njëri-tjetrin me 22 dhjetor të vitit 2017, ku u votua buxheti i vitit 2018, katër deputetë të Lidhjes Demokratike të Kosovës, Vjosa Osmani, Doruntinë Maloku, Arben Gashi dhe unë Armend Zemaj propozuam amendament për përfshirje në buxhet të pagesës dhe heqjes së kufizimit të pensioneve kontributdhënës për kategoritë e punëtorëve të arsimit, shëndetësisë dhe të gjitha lëmive që kanë punuar në sistemin e Republikë së Kosovës 1989-1999.

Kolegë deputetë,

Merreni votimin dhe e shihni votën e juaj të çdonjërit në mënyrë individuale. Amendamenti nuk kaloi, sepse kolegët nga shumica parlamentare e atij viti, përjashto individët, në këtë rast edhe propozuesin e debatit, edhe tri koleget e nderuar nga GP i PDK-së të cilët nuk votuan kundër.

Andaj sot kërkohet një sinqeritet së pari mes neve këtu dhe në raport kërkesën të cilën e obligojmë ministrin e Punës dhe Mirëqenies Sociale jo të na paraqesë koncept-dokumente nga viti 2017, jo të presë çka po bën Komisioni i kushtëzuar për themelimin dhe hartimin e Kodit Pensional, po aty nevojitet vetëm një ndryshim i një neni, neni 8, shumë saktë. Dhe tash, çka është më e keqja, Gjykata Ndërkombëtare e Strasburgut e cila është institucion juridik ndërkombëtar, ia ka njohur të drejtën disa pensionistëve kosovarë me emër dhe mbiemër. Avokati i Populli e di për kë e kam fjalën, mund ta them këtu është zoti Shaban Kelmendi, i cili e ka fituar këtë të drejtë dhe i cili i ka hapur rrugë institucioneve të Republikës së Kosovës që edhe në procesin negociator të bisedojë për këtë çështje. Nuk kanë biseduar, nuk kanë insistuar që të zgjidhet.

Andaj unë sot e kam një lutje, e kam një propozim që të ketë vetëm një deklaratë të shkurtër e cila kërkon votimin dhe plotësim-ndryshimin e Ligjit për skemat pensionale në Republikën e Kosovës, konkretisht neni 8, heqjen e kufizimit. Nuk ka kosto e cila rëndon buxhetin e Republikës së Kosovës, por ka kosto që e rëndon pensionistin kontributdhënës, i cili ka përkrahur institucionet e Republikës së Kosovës, i cili e ka lëshuar punën dhe nuk është bërë pjesë e aparatit shtetëror të dhunës së sistemit të Milosheviqit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në Strasburg ne s'kemi të drejtë, duhet të jemi ose qytetar i Serbisë, të paraqitesh si qytetar i Serbisë ose i Shqipërisë se përndryshe ato ankesa tona s'i merr askush parasysh. Jo, jo!

Zonja Mexhide Mjaku-Topalli, urdhëro!

MEXHIDE MJAKU-TOPALLI: Faleminderit, nënkryetar!

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Fillimisht unë dua ta falënderoj kolegen e nderuar, e cila e ka iniciuar këtë debat për të diskutuar sot me temën për të drejtat e punëtorëve kontributdhënës. Dihet se si Komision për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjimore, Peticione dhe të Pagjeturit e kemi diskutuar këtë çështje në vitin që shkoi disa herë, duke iu përgjigjur kërkesave të cilat na janë adresuar nga sindikatat e pavarura, njëra e administratës së Kosovës, tjetra e Policisë së Kosovës.

Në ato takime kemi pasur të ftuar edhe ministrin e Punës dhe Mirëqenies Sociale, i kemi diskutuar këto çështje, sidomos neni 8 pika 6 e ligjit bazik për të cilin po diskutojmë sot. Është shqetësuese, është thënë edhe atëherë, është thënë edhe nga ministri, është thënë edhe nga përfaqësuesit e sindikatave, e po ashtu edhe nga ne deputetët, po edhe në raportin që e kemi të Avokatit të Popullit, se ky nen është diskriminues, sepse diskriminon punëtorët të cilët në kohën e masave të dhunshme të vendosura në Kosovë, nuk ia njohin stazhin e punës për shkak të largimit nga puna.

Sot kur flasim për këtë temë, qëllimi dhe tërheqja e vëmendjes mbi nevojën e rregullimit të pensionit kontributpagues për kategorinë e qytetarëve të Republikës së Kosovës, të cilët kanë punuar para vitit 1999 dhe nuk e kanë arritur stazhin pensional prej 15 vitesh pa fajin e tyre për shkak të largimit diskriminues nga puna në kohën e masave të dhunshme të vendosura në Kosovë.

Ky ligj, përkatësisht neni 8 ka mundësuar një trajtim të pabarabartë për të punësuarit e viteve të 90-ta. Rekomandimet e Avokatit të Popullit kanë vlerësuar se dispozita e nenit 8 është me përmbajtje diskriminuese dhe e pazbatueshme në praktikë, ku përmes rekomandimit ka kërkuar që të amendamentohet ky ligj, duke i eliminuar elementët diskriminuese dhe konfuzë dhe duke i harmonizuar me dispozitën e nenit 3 të Kushtetutës së Kosovës, e cila qytetarëve iu garanton barazi të plotë. Andaj duhet që sa më parë të ndërmerren hapa konkretë që të amendamentohet ky ligj, sepse, siç e cekta edhe në fillim, për këtë çështje e kemi diskutuar edhe në vitin që shkoi.

Po e shfrytëzoj mundësinë dhe rastin, pasi e kemi edhe këtu ministrin, ta diskutoj edhe çështjen e lajmërimit të pensionistëve, të cilin e kam diskutuar edhe në takimin në vitin që shkoi, kështu që mundësisht ta kem një përgjigje nga ju i nderuar ministër, për shkak se atëkohë, vitin që shkoi, kam marrë një përgjigje nga ti që shumë shpejt do të bëni ndryshimin e udhëzimit administrativ, për të shikuar mundësinë që kjo masë të largohet dhe të zëvendësohet me masa të tjera, kur është fjala për lajmërimin e pensionistëve çdo gjashtë muaj në zyrat e pensionistëve.

Pra, keni thënë se do të gjejnë modalitete dhe si zgjidhje, do të mundohemi të jetë një zgjidhje më e mirë dhe më e drejtë, kështu që mundësisht, gjatë kohës kur do të kesh mundësi, të ma jepni një përgjigje.

Po kthehem prapë te tema. Si rezultat i këtij neni, shumë qytetarë të Kosovës shkojnë me 75 euro në pension, edhe pse ka punuar disa vite, pra për disa ditë nuk i përmbush 15 vjet stazh dhe shkon në pension me 75 euro. Po ashtu, edhe punëtorëve të shëndetësisë, s'po u pranohet të gjithëve ky stazh edhe pse shkruan në ligj.

Në fund, prapë them se ky ligj është diskriminues, sepse i shkel ata që pa të drejtë janë përjashtuar nga puna dhe për këtë arsye i përkras dhe i mbron të drejtat e tyre. Të gjithë e dimë

se askush me dëshirë nuk e ka lëshuar punën, por është përjashtuar në mënyrë të dhunshme dhe nuk duhet ne ta harrojmë sakrificën e këtyre punëtorëve. Ne kemi dy rekomandime nga Avokati i Popullit, një rekomandim vetëm për sindikatën e ish-policëve dhe një rekomandim për të gjitha kategoritë. Andaj, ju lutem të veproni sa më parë në amendamentimin e këtij ligji. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Fjalën e ka Ismajl Kurteshi.

**ISMAJL KURTESHI:** Faleminderit!

Sa i përket ligjit në fjalë dhe sidomos udhëzimit administrativ nr. 09/2015 për kategorizimin e shfrytëzuesve të pensioneve kontributdhënese, e sidomos nenit 6 pika 2,3 e këtij udhëzimi administrativ, mund lirisht të konstatohet se është në kundërshtim me të drejtat e njeriut dhe cenon rëndë të drejtat e njeriut dhe të drejtat të cilat askush nuk mund t'i cenojë, sepse dikush me një vendim që është i paspjegueshëm i pranon kontributet nëse i ke 15 vjet, nëse ke punuar, i ke bërë 15 vjet deri më 1 janar 1999. Po nëse të mungojnë dy ditë, i tërë kontributi që është bërë 14 e 11 muaj e 28 ditë të mohohet.

Askush nuk mund të ketë të drejtë që dikujt t'ia mohojë të drejtën në shfrytëzimin e kontributeve që i ka dhënë gjatë këtyre viteve, prandaj edhe unë i bashkëngjitem kërkesës së grupit të deputetëve të cilët kërkojnë dhe këtë mendoj që duhet ta bëjmë përmes një rezolute, e detyrojmë Ministrinë dhe Qeverinë që menjëherë ta ndryshojë ligjin, edhe udhëzimin administrativ dhe të gjithë kontributdhënësve, edhe atyre që kanë kontribuar vetëm një vit, t'u jepet për aq sa kanë kontribuar. Nuk është e thënë që pensionet të jenë të gjitha lineare, vetëm kaq edhe s'bën ndryshe, po pensionet të paguhen për kontributdhënësit bazuar në shumën që ata kanë kontribuar në këtë fond pensional.

Çështja tjetër që dëshiroj të përmendë është edhe çështja e mosangazhimit të Qeverisë së Kosovës mjaftueshëm për ta tërhequr fondin pensional nga Serbia, sepse kemi raste individuale që kanë fituar në Strasburg, e nëse mund të fitojë një individ, unë nuk e kam të qartë se si është e mundur që të mos e fitojë një Qeveri, po kemi edhe informata se kjo çështje tanimë është e kryer dhe vetëm është neglizhencë e Qeverisë së Kosovës që nuk po realizohet kthimi i këtij fondi që është jashtëzakonisht i madh dhe shumë i rëndësishëm për pensionistët aktual, por edhe për ata të tjerët të cilët gjatë kohës së okupimit serb kanë kontribuar në këtë fond i cili është plaçkitur nga Serbia, e që ajo tash është e obliguar t'ua kthejë kontributdhënësve në Kosovë nëpërmjet Qeverisë së Kosovës. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Më pëlqeu diskutimi i Gani Dreshajt, po nuk e elaboroi sa duhet. Aty e kam hallin se jo tjetër gjë. Fjalën e ka zonja Emilija Rexhepi.

**EMILIJA REDŽEPI:** Zahvaljujem se predsedavajući!

Poštovani kolege poslanici,

Uvaženi ministre,  
Poštovani građani,

Željim da kao narodni poslanik u ovom parlamentu u potpunosti podržim ovu rezoluciju koja se odnosi na promenu administrativnog upustva o penzijskom fondu Kosova, gde su mnogi naši radnici koji su radili po raznim javnim preduzećima i fabrikama u bivšoj Jugoslavije, pre 1999 godine, a sadašnji su penzioneri koji imaju radnog staža ispod 15 godina, jako nezadovoljni. Svi si ti naši građani, odnosno sadašnji penzioneri po sadašnjoj šemi penzionisanja diskriminirani i primaju starosnog penziju od 75 evra, gde se direktno narušavaju njihova ljudska, a pre svega zaslužena dugogodišnja radnička prava.

Mi smo gospodo poslanici u moralnoj obavezi da ovu kategoriju društva podržimo upravo zbog nekoliko meseci radnog staža koji im nedostaje za njihovu penziju, a odnose se na period ispod 15 godina, te im se ograničava njihovo pravo na zasluženu penziju koju trebaju po njihovoj zaslugi dobiti od naše države, odnosno moramo prominiti samo administrativno opustvo, odnosno paragraf 2,3, tačka 6, koji funkcioniše ili je na snazi od 9 meseca 2015 godine Ministarstva za Rad i Socijalnu Politiku, te se radnički staž smanji od 15 na 10 godina, i taku ćemo tu veliku nepravdu prema mnogi našim penzionerima ispraviti, i oni će svoju ličnu penziju dobiti prema svom radnom zasluženom stažu, a ne samo 75 evro, kao što sada primaju.

Koristim priliku i prisustvo ministra za Radi i Socijalnu Politiku koji je danas sa nama da svoje zakonsko pravo iskoristi i promeni ovo uputstvo, i tako spreći zakonske neregularnosti prema ovoj kategoriji društva, odnosno koji nas dugo vremena svi oni zovu i traže od nas da se njihovu pravo na penziju ispoštuje, i mi smo gospodo svi ovde poslanici u obavezi da danas budemo svi solidarni kako Vlada tako i Parlament da se ova nepravda prema ovaj kategoriju društva ispoštuje i zakonski da oni dobiju prema svom radnom stažu i starosno penziju, a ne samo 75 evro kao što sada primaju. Zahvaljujem!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Enver Hoti e ka fjalën.

ENVER HOTI: Faleminderit, kryesues! E mora edhe njëherë fjalën tash si deputet, dhe arsyeja është se shumë kolegë i dëgjova këtu duke ngritur dilema rreth koncept-dokumentit të hartuar nga ministria dhe tani që është duke u trajtuar nga komisioni ad hoc për reformën e sistemit pensional.

Nganjëherë të krijohet përshtypja se që në start të një pune të mirë, dalin disa zëra të cilët duan t'i pengojnë dhe po e përsërisë edhe njëherë se asnjë temë nuk po na bashkon sado që është në interes të qytetarëve të vendit.

Unë dua ta falënderoj ministrin që e ka ofruar mbështetjen e plotë me kabinetin e tij profesional dhe me strukturën administrative të ministrisë që ta mbështesë komisionin. Po ashtu edhe

ministri i Financave dhe administrata e tij janë në disponim të këtij komisioni për ta bërë më të mirën e mundshme, dhe dua ta konstatoj se aty janë tetë ligje të cilat duhet të plotësohen dhe ndryshohen.

Nuk është çështja vetëm e këtij neni, i cili pajtohem plotësisht që është diskriminues dhe nuk duhet të ndodhë, dhe qëndrimi ynë si parti parlamentare dhe si Nismë Socialdemokrate është se nuk duhet të ketë kufizime në vite të kontributpaguesve.

Thjesht nuk duhet të jenë as 15 vjet, as 10 vjet dhe as 1 vit, por duhet ajo se sa paguan kontribudhënësi për atë edhe duhet të shpërblehet.

Mirëpo, ne konsiderojmë që 8 ligje të cilat janë në kolizion të shumëfishtë njëra me tjetrën, sikur po ma krijon përshtypjen se nga e kaluara, kategoritë e futura në këto skema pensionale tani po gjejnë mbështetje të heshtur duke u shmangur nga kontributi për ta plotësuar këtë koncept-dokument edhe më tutje, për t'i ruajtur interesat elektorale brenda kategorive të cilat janë të shumta.

Nuk janë vetëm kontribudhënësit të cilët janë të diskriminuar nga ligjet aktuale, por ka edhe shumë kategori brenda skemave institucionale ashtu sikurse ka shumë kategori brenda këtyre skemave që në mënyrë jomeritore marrin pensione apo mbështetje sociale nga ligjet aktuale.

Unë mendoj që ne duhet të bashkohemi dhe i bëj thirrje edhe njëherë edhe LDK-së edhe Vetëvendosjes që t'i dërgojnë deputetët e vet në komision dhe ta japim kontributin dhe ai dokument apo Kodi Pensional siç po thuhet të jetë pjesë e Qeverisë dhe të miratohet në Qeveri dhe në një afat sa më të shkurtër të miratohet nga Kuvendi, në mënyrë që të ndryshohen këto diskriminime këto plotësim ndryshime të cilat janë të nevojshme për të gjitha kategoritë e skemave pensionale. Faleminderit!

KRYESEUSI: Faleminderit! Zoti Hoti s'pate të drejtë në fjalë, po meqë e more... Dy herë s'ka me fol. Njësoj për të gjithë. Fjalën e ka zonja Vjosa Osmani.

VJOSA OSMANI: Faleminderit zoti nënkryetar i Kuvendit!

Shumë shkurtë, janë tri duhet t'i kemi parasysh. E para që ky Kuvend ka diskutuar e batuar për këtë temë që sa mandate me radhë dhe gati në secilin mandat ka miratuar rezoluta të cilat nuk janë respektuar në praktikë.

Në vitin 2013, kur kjo çështje është diskutuar në mënyrë më ekstensive, sigurisht pas vendimeve të Gjykatës së Strasburgut në rastin Grudiq së pari si qytetarë të Mitrovicës, dhe pastaj disa raste të tjera, është kërkuar qartë nga Qeveria e Kosovës që të formojë komision të përbërë nga

ekspertë të cilët do t'i ndihmonin pensionistëve që t'i përgatisin lëndët e tyre para Gjykatës Evropianë për të Drejtat e Njeriut.

Pra, kjo duhet të bëhet meqë kjo është fushë shumë specifike edhe nuk mund t'i përgatisë cilido jurist pa e pasur ekspertizën në këtë fushë.

Përkundër kësaj kërkesë, ka më shumë se gjashtë vite nga shkurti i vitit 2013 që pensionistët përsëri është dashur që të gjitha këto përpjekje t'i bëjnë tërësisht individualisht, pra pa ndihmën e Qeverisë.

Më vjen keq që nuk e dëgjova ministrin, sepse nuk isha këtu dhe nuk e di nëse e ka trajtuar këtë temë apo jo, mirëpo do ta lusja të na njoftojë në radhë të parë, në qoftë se ka ndonjë departament brenda ministrisë së tij të cilit do të mund t'i drejtohen pensionistët për të marrë ndihmë lidhur me përgatitjen e aplikacioneve.

Tani, natyrisht që Kosova nuk është akoma anëtare e Këshillit të Evropës dhe rrjedhimisht qytetarët tanë nuk mund ta padisin Kosovën, shtetin e tyre për shkeljen e të drejtave të tyre, mirëpo rregullat e gjykatës e sqarojnë që qytetarët e Evropës, dhe ne jemi të tillë, jetojmë në këtë kontinent, mund ta padisin cilindo shtet që i ka shkelur të drejtat e tyre.

Pra, ta zëmë që një qytetar i Kosovës udhëton deri në Greqi apo Turqi apo diku tjetër dhe shkelja e të drejtave të njeriut ndodh aty, atëherë e fiton të drejtën juridike që ta padisë atë shtet. Dhe mbi këtë bazë juridike edhe kanë ndodhur këto raste për të cilat u fol më herët.

Tani, në të gjitha këto raste Gjykata e Strasburgut në radhë të parë ka sqaruar që e drejta për t'ia kthyer Serbia pensionet kontribudhënese qytetarëve të Kosovës bie përbrenda të drejtës në pronë, e drejtë kjo që garantohet natyrisht edhe me Kushtetutën tonë, dhe e dyta ka refuzuar argumentin e Serbisë se kinse nuk mund t'i kthejë ato të holla sepse nuk i di adresat e qytetarëve të cilët kanë qenë kontributdhënës.

Pra, mundësia ekziston përderisa ka ndihmë profesionale nga ana e shtetit për t'i përgatitur këto dosje.

Çështja e dytë, është çështja e dialogut. Për dallim nga disa prej kolegëve që e përmenden këtu, unë jam skeptike që kjo çështje mund të zgjidhet me dialog. Pse po e them këtë? Për shkak se në dialog natyrisht që kjo çështje do të rezultonte me një kompromis. Me njëfarë mesii.

E tash, për të drejtat individuale të qytetarëve, pra për pronën e tyre individuale, ne nuk mund të shkojmë dhe të arrijmë kompromis, t'i themi Serbisë kthej diku 50% dhe diku 50% të tjera mbaji për vete, sepse ajo është pronë e qytetarëve, është pronë individuale.



E tëra çka mund të bëhet në dialog me Serbinë është që vendoset kërkesë e pa ekuivok si lloj parakushti për rikthimin e atyre fondeve, mirëpo jo të ulemi në tavolinë dhe për pronën individuale të qytetarëve tanë të bëhet kompromis apo të bëhet ndonjë lloj pazari.

Çështja e tretë ka të bëjë me legjislacionin aktual që e potencoi edhe kolegu Zemaj dhe disa kolegë të tjerë. Pra, ka vite të tëra që kjo çështje është debatuar përderisa është tashmë e qartë. Neni 8 i Ligjit për skema pensionale tregon që duhet të njihet edhe ajo përvojë e punës, sepse ata qytetarë atëherë janë larguar nga puna padrejtësisht shkaku i një regjimi gjenocidal.

Në qoftë se edhe ne nuk e njohim atë përvojë, e sidomos të mësuesve dhe punëtorëve shëndetësor të cilët kanë punuar edhe shpeshherë duke e rrezikuar jetën e tyre, atëherë po e bëjmë një padrejtësi për herë të dytë.

Prandaj, përderisa ligji parasheh një gjë të tillë, është e papranueshme që mos të zbatohet ai, pastaj duke krijuar rrethana të tjera qoftë nëpërmjet rregulloreve, qoftë duke mos ndarë mjetet e nevojshme buxhetore dhe siç u përmend, ne kemi provuar disa deputetë që të propozojmë amendament në buxhet që t'ju njihet ajo përvojë dhe rrjedhimisht edhe të paguhen pensionistët edhe për ato 10 vjet, pra '89-'99.

Pra, e tëra që duhet të bëhet është që të respektohet ligji.

Kjo natyrisht është edhe në përputhje me përvojën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, sepse siç e thashë, Kushtetuta jonë kërkon që t'i marrim parasysh ato vendime gjatë përcaktimit të rregullave tona shtetërore në fushën e të drejtave të njeriut.

Prandaj, si propozim po e jap që në tekstin final të rezolutës që e propozoi edhe deputetja Haxhiu, të merren parasysh, të modifikohen deri diku shkaku i ndryshimit të rrethanave, por të merret parasysh edhe rezoluta e shkurtit e vitit 2013, e cila qartë e pati obliguar Qeverinë e Kosovës që t'i asistojë pensionistët tanë për përgatitjen e lëndëve dhe e aplikacioneve për gjykatë, gjithnjë duke e pasur parasysh edhe precedentët paraprake ku gjykata qartë e ka urdhëruar Serbinë që t'i kthejë ato prona tek qytetarët e Kosovës.

Pra, po e përsëris nuk është vetëm një rast, ka ca të tilla dhe ata qytetarë nuk janë paraqitur si qytetarë të Serbisë, por e kanë paditur shtetin e Serbisë që është parakushti i vetëm, sepse Serbia është shtet anëtar i Këshillit të Evropës.

Në anën tjetër Serbia akoma mbetet një prej shteteve në top-listë që nuk i respekton dhe nuk i zbaton vendimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, por kjo nuk do të thotë që ne duhet të dorëzohemi dhe të heshtim para një padrejtësie që po vazhdon.

Ato janë prona të qytetarëve të Kosovës dhe i takon secilit prej nesh, që jemi në institucione publike që të luftojmë për to. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Unë desha që të ndërlihem në diskutimet tuaja, por kam përshtypjen që shumë herë po diskutojmë jo për ta zgjidhur problemin po për të krijuar një raport me publikun.

Ne e dimë fare mirë, fare mirë e dimë, kur punëtorët e Kosovës me thirrjen e Sindikatës së Pavarur atëherë, i kanë lëshuar vendet e punës së tyre. Dhe unë nuk e kam të qartë, po flas tani si njëri nga ju që të gjithë jemi të interesuar që në qoftë se ka para të Kosovës ose rezerva që i kanë i kanë paguar taksapaguesit ose i kanë paguar punëtorët e Kosovës dhe ka pasur rezerva të tërhequra nga Kosova të kthehen në Kosovë.

Por, dihet që gjenerata paguan për gjeneratën. Nuk e di sa ka qenë ai intervali i viteve, si janë ndarë të hollat, nga kontributet për gjeneratën tjetër që ka qenë në pension.

Kemi 15 vite ose sa nuk kanë punëtorët, por kemi 15 vjet... Unë nuk e kam të qartë a kanë marrë pensione pensionistët e Kosovës gjatë kohës së regjimit të Milosheviqit në Kosovë.

Pra, sa janë shpenzuar ato fondet rezervë që kanë qenë të Kosovës për pensionistët e Kosovës. Po ashtu nuk e kam të qartë, tani po flitet këtu për shuma marramendëse, ka shumë rezerva, unë nuk e di akoma për vetën time. A ka dikush informatë, me siguri ministri ka më shumë, se sa është e këtyre parave që i takojnë Kosovës dhe që kanë qenë rezerva nga punëtorët e Kosovës në Serbi.

Mbi këtë bazë, unë besoj që do të ketë mundësi, sa i përket anës juridike për ta ndjekur procesin dhe rrugën që mund të ndiqet ligjërisht edhe në institucione ndërkombëtare në variantin që mundemi.

Këtu po thoni se ka shumë, po kjo shumë nënkupton 1 milion, 10 milionë, 100 milionë, 1 miliard apo sa janë? Kush e di?

Edhe unë kam të drejtë të diskutoj, jo vetëm ju. Po mirë de, unë kam të drejtë të diskutoj. Po rri o burrë aty. Po s'po të pyes ty. Unë po diskutoj... Unë e kam diskutimin tim, ti e ke tëndin edhe pak.

Ty s'të pëlqen, mua më pëlqen. Jam në foltoren time. Në mikrofonin tim jam. Ju lutem, unë kam të drejtë të diskutoj ngase jam aktualisht kryeparlamentar këtu. Unë po diskutoj, sepse i kam minutat e mi rrafsh edhe disa minuta që do t'i shfrytëzoj.

Edhe do t'i shfrytëzoj deri në fund. Sikur ti Sami që je kompetent për gjithçka. Ti je kompetent për gjithçka. Unë po dua që të jem realist. Kush mund t'i marrë dhe si mund t'i tërheqim këto para. Pra, sa para na janë grabitur neve nga Serbia, para të Kosovës.

Kur janë grabitur këto dhe në qoftë se ka një shumë të caktuar dhe Qeveria e Kosovës ndërton një mekanizëm ankimor sipas të drejtave të saj në drejtim të mekanizmave ndërkombëtar, atëherë është në rregull.

Në qoftë se duhet që secili individ i cili është dëmtuar, atëherë është mirë që edhe ne sipas kësaj që e tha edhe Vjosa, që secili individ të bëjë kërkesën dhe të bëjë padinë, unë s'jam aq i sigurt, por nëse e ka të drejtën për ta paditur Serbinë si qytetar i Kosovës, por jo si shtetas i Serbisë.

Unë nuk jam dakord për këtë shtetësinë. Për këtë nuk jam dakord. Me diskutimet tona mos i qesim në mal ata që vërtetë kanë nevojë, në mënyrë që të mendojnë se ku ta dimë se çfarë jemi duke bërë, po t'i udhëzojmë saktë për të drejtat e tyre, edhe me rezolutë edhe me diskutime.

Nuk është kjo çështje se kush po diskuton dhe kush po e denoncon Serbinë më shumë me diskutimin e vet. Kjo është një çështje që të gjithë ata që kanë nevojë dhe më së shumti kanë nevojë pensionistët të cilëve pa të drejtë nuk iu jepen pensionet, s'i kemi tërhequr ato para në qoftë se ka pasur, atëherë eja t'i udhëzojmë ata.

Është e njëjta gjë qysh kemi gabuar pas luftës, ku e patëm formuar njëfarë grupi atje që të hetohen krimet e luftës dhe nuk i kemi udhëzuar njerëzit që ta bëjë secili padinë personale, për shtëpinë, për pronën, për vrasjet e familjeve edhe për gjykimet që na i ka shkaktuar Serbia.

Tani është një problem në vete edhe për ta paditur Serbinë nesër edhe në gjykata në ndërkombëtare, por edhe për ta paditur personalisht për dëmet që i ka shkaktuar ajo.

Për atë po them që të jemi më realistë në gjykime dhe në përpilimin e dokumenteve që i miratojmë në Kuvend, dhe të mos jenë ato dokumente siç po na ndodh shumë herë të votojmë rezoluta edhe ata që mendojnë që s'është mirë të votohet ajo rezolutë e kanë të vështirë të votojnë ose të diskutojnë ndryshe, sepse opinioni pastaj po goditet nëpërmjet mekanizmave të ndryshëm, secili prej deputetëve ku njëri nuk po është dakord me tjetrin.

Unë mendoj që kjo çështje do duhej ta kishte një grup punues. U tha, të shihet edhe rezoluta e 2013-ës, në rregull, po bashkë me rezolutën e 2013-ës, bashkë me të gjithë mekanizmat që kanë punuar në drejtim të tërheqjes së fondeve të pensionistëve nga Serbia, për sjelljen e tyre në Kosovë ose në fondet e Kosovës, të tregohen rrugët sesi pensionistët mund t'i marrin pensionet e tyre, dhe a mund t'i marrim ne me rezoluta të Kuvendit të Kosovës.

Unë mendoj që nuk mundemi. Rezoluta bëjmë dhe i lëmë aty palë aty në arkivat tona personale, por edhe të Kuvendit të Kosovës, sepse askush nuk ka ndonjë obligim, po them për ta zbatuar rezolutën, përjashtuar përpyekjeve që mund t'i bëjë Qeveria ose mekanizmat e tjerë.

Unë i inkurajoj specialistët që i kemi këtu në Kuvend, juristë të mirë, edhe ata që s'janë këtu që të krijojnë një mekanizëm dhe hap pas hapi t'i japin udhëzime edhe pensionistëve, po edhe të punojnë sinqerisht me mekanizmat ligjor ndërkombëtar për t'i tërhequr këto të holla.

Përndryshe, ne mund të mbajmë seanca tani edhe në të ardhmen do të mbajmë. Do të kërkojmë që t'i sjellin paratë, por po besoj që ministri do të na shpjegojë edhe sa para kemi në këto fonde. Besoj që e di Qeveria e Kosovës dhe Kuvendi besoj që duhet ta dijë.

Nëse e di Qeveria në rregull, ndërkaq nëse nuk e di, atëherë është problem të diskutohet nesër, mes Kosovës dhe Serbisë para gjykatave ndërkombëtare ose edhe atyre që e padisin Serbinë për mos pagesat e pensioneve. Faleminderit!

Fjala është për deputetin Bekim Haxhiu.

**BEKIM HAXHIU:** Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

I nderuar dhe mirënjohës për sqarimet që i dhe. Është një temë shumë e rëndësishme. E kemi diskutuar në Komisionin Parlamentar për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale.

Pothuajse një vit më parë, kemi pasur në komision të gjithë aktorët që i ka prekur kjo fushë e në veçanti ata të cilëve u është mohuar e drejta në pensionin kontributdhënës.

Debatet janë të mira, po kanë filluar të shndërrohen në një praktikë më shumë vajtimi sesa të zgjidhjes së problemit.

Nëse dëshirojmë që ta zgjidhim këtë problem, është shumë i thjeshtë. Por, para se të vijmë të zgjidhja e problemit, në ato debate që i kemi pasur me aktorët, atyre që u është bërë e padrejtë, ne e kemi thënë edhe në media, e kemi thënë edhe në komision parlamentar, që i është mohuar e drejta një pjese të shoqërisë sonë, kategorive të cilat kanë dhënë kontribut për vendin, por gjithsesi kanë pasur edhe pjesë të kontributeve të tyre pensionale. Kanë përfituar ata që kanë punuar kundër interesave të vendit, por edhe kanë vazhduar ta marrin pensionin duke e marrë rrogën e Serbisë deri në vitin 1999.

Pra, po e marr si shembull një polic i Kosovës në fillim të viteve 1990 kundërshton regjimin e Milosheviqit, largohet nga puna, nuk merr pension as rrogë nga pushtuesi, i bashkëngjitet luftës të Ushtrisë Çlirimtare për çlirimin e vendit dhe një polic tjetër lokal i Serbisë që vazhdoi punën, vazhdoi represionin ndaj popullatës shqiptare, merr pagë prej Serbisë dhe në fund, e merr e

pensionin kontributdhënës prej shtetit të pavarur të Republikës së Kosovës. Pra, ai i cili e kundërshtoi regjimin, ai nuk e merr pensionin kontributdhënës. Ky është më shumë se ligj diskriminues dhe gjatë elaborimit të kësaj problematike ka ardhur në shprehje se kah doli ky 15-vjetshi.

Nëse i referohemi ligjit dhe nenit 8, ato nuk precizohet që është 15 vjet, po aty thotë që këtë të drejtë e përfitojnë ata të cilët kanë siguruar, kanë dhënë kontributet e tyre pensionale sipas Ligjit pensional dhe invalidor të publikuar në Gazetën zyrtare të Krahinës Autonome Socialiste të Kosovës. Me sa e mbaj në mend edhe kam shënuar diku, i referohet Ligjit numër 01-24/83, e shikojmë atë ligj, askund nuk precizohet mosha 15 vjet.

Pra, një sqarim shumë të mirë do të na e jepte ish-ministri Abrashi për këtë, sepse e kemi pasur edhe në Komision Parlamentar në diskutim kah doli ky 15-vjetëshi, sepse në ligj, as në atë të Krahinës Autonome Socialiste të Kosovës, e as në këtë ligjin që e kemi miratuar nuk është kufizim mosha 15-vjeçare. Kush e shpiku këtë kriter dhe ua mohoi të drejtën njerëzve që kanë kontribuar për vendin ta gëzojnë të drejtën e tyre legjitime.

Po i kthehemi zgjidhjes së problemit. Ju kujtohet se ditë më parë brenda ditës e kemi kaluar Ligjin për lojërat e fatit, në procedurë shumë të shpejtë, për ndalimin e lojërave të fatit.

Nëse dëshirojmë ta zgjidhim këtë problem, menjëherë po e sjellim dhe po e ndryshojmë këtë ligj, nenin 8, edhe po e precizojmë se sa kanë të drejtë në pensionet kontributdhënësit të gjithë ata që edhe një ditë kanë dhënë kontributin e tyre pensional.

Shumë shpejt mund ta zgjidhim këtë problem, e adresojmë komisionin përkatës parlamentar, e sjellim në Kuvend, e heqim këtë kriter stagnues, diskriminues për një shumicë të madhe të qytetarëve.

Ne mund të debatojmë, mund të themi që ky ose ai s'e ka votuar, tash edhe brenda të njëjtit subjekt mund të thonë që ministri ynë e ka sjellë këtë ligj, tani thjesht s'e kanë përkrahur, kjo është krejt çështje tjetër.

Por, mendoj nëse duam ta zgjidhim ose të mos i ikim retorikës që ne po duam të flasim këtu për vota, ose t'i mbushet mendjen se dikush prej neve e ka vajtuar këtë kategori më mirë e dikush më pak, po nëse duam, urdhëroni, e zgjidhim, po e sjellim me gjashtë nënshkrime, vetëm ndryshimin e këtij neni, edhe pse ky nen nuk e kufizon, por po e bëjmë të qartë që nuk kufizohet mosha 15-vjeçare, po e bëjmë të qartë që nuk kufizohet kjo moshë edhe le të vazhdojnë, le të fitojnë drejtën e tyre të gjithë ata që duhet ta fitojnë. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Ministri Reçica e ka fjalën.

MINISTRI SKENDER REÇICA: Faleminderit, zoti nënkryetar i Kuvendit!

Dua të ndërlidhem te fjalimi i zonjës deputete Osmani, tha që s'do të bëjmë asgjë, po duhet ta respektojmë ligjin. Dhe, ne si ministri jemi duke zbatuar ligjin që ka të bëjë me skema pensionale të financuara nga shteti, le që e ka miratuar ky Parlament, unë e thashë në fjalimin tim para kësaj here.

Se ky Parlament ka pasur mundësi që në vitin 2014 të ikë nga kjo situatë, sepse nuk janë këto fakte që ne sot i kemi shpikur në 2019-ën dhe po e dimë që '90-të paska pasur dëbim masiv të punëtorëve tanë, ky fakt ka qenë i njohur edhe në vitin 2014.

Madje, po thuhet që nuk ka burim kufizimi 15 vjet, zoti deputet, po. Po Ligji për KSAK e ka burimin te ligji federativ që jeni thirrur, e ka votuar ky Parlament.

Madje, madje, të lutem. Ky ligj, unë do të isha shumë i lumtur sikur të diskriminonte pensionistët tanë vetëm në këtë pikë, vetëm nenin 8 sa i përket stazhit. Po ky ligj është më shumë se një vend diskriminues për pensionistët tanë.

Ky ligj diskriminon një kategori shumë të ndjeshme, pensionistët kontributpagues, të cilët janë familjarë të dëshmorëve, invalidë, përjashtohen nga ajo e drejtë, me këtë ligj përjashtohen, ky ligj i përjashton. Ky ligj i thotë qytetarit tonë që t'i duhesh të lajmërohesh atje çdo gjashtë muaj, çdo një vit. A nuk është diskriminim kjo? Ne asgjë nuk po bëjmë, ne po e respektojmë ligjin, dispozitat ligjore, të cilat rregullojnë fushën e sistemit pensional në vend.

Dhe nuk po ikim përgjegjësisë, e përmendi dikush po i ik kjo qeveri përgjegjësisë, jo, për një vit e kaq muaj është vështirë të zgjidhet problemi i sistemit pensional në vend. Kemi 22 skema pensionale, të cilat rregullohen apo burojnë nga tetë ligje dhe këto tetë ligje, në më shumë se një herë bien ndesh njëra me tjetrën.

Me një ligj një kategorie të caktuar i jepet një e drejtë, me ligjin tjetër i ndalohet dhe ne si ministri dhe stafi i ministrisë jo vetëm sot, po edhe në të kaluarën është ballafaquar me këto situata.

Dhe këto kanë qenë arsyet që ne kemi filluar reformën e sistemit pensional.

Është i vetmi vend që nuk kemi një sistem të mirëfilltë, nuk kemi një ligj unik, i cili rregullon sistemin pensional në vend.

Prandaj, unë po e përsëris për të dytën herë, sikur të kishte qenë vetëm neni 8, i cili përcakton periudhën, kufizon stazhin e punës, natyrisht që e kishim sjellë sonte menjëherë, me procedura të

përshpejtuar. Po ky ligj ka nevojë të ndërrohet komplet, nuk është vetëm një vend diskriminues. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Haxhiu, replikë. Zonja Osmani, replikë. Tjetër kush ka replikë?

BEKIM HAXHIU: Faleminderit!

I nderuar ministër,

Unë të falënderoj për mënyrën sesi e elaborove këtë. Por, absolutisht nuk ofrove zgjidhje. Zgjidhja të takon ty, i nderuar ministër, Enveri ka qenë edhe më herët këtu pjesë e Parlamentit. Bjere ligjin me këto dy ndryshime, po edhe Enveri po thotë, jo more çfarë, sepse s'i intereson ta zgjidhë këtë problem, sepse po duam të bëjmë politikë, jo e ka sjellë ai, jo ky.

Ligji i referohet ligjit të publikuar në Gazetën zyrtare dhe nuk i referohet Ligjit federativ. Kush e ka bërë përbrenda ministrisë një çështje të tillë, hiç nuk po më intereson ajo punë, se kush ka dashur t'i referohet, ndoshta mund t'i referoheni edhe Kushtetutës së Jugosllavisë, mund t'i referohen, po ne e kemi Kushtetutën tonë në fuqi, s'kemi nevojë për Kushtetutën e Jugosllavisë më, as t'u referohemi ligjeve të Federatës Jugosllave, është marre kjo.

Ju lutem, urdhëro, sille projektligjin me këto dy ndryshime, qe një vit e gjysmë po e vajtojmë të njëjtën çështje. Jo do të bëjmë ligj të ri, një vit e gjysmë janë. Urdhëro, bire, t'i ndryshojmë këto dy nene, që i diskriminon kategoritë më meritore të këtij vendit, edhe familjet e dëshmorëve dhe kategoritë e tjera kontributdhënëse, eja t'i ndryshojmë.

Sa i përket çështjes a duhet të lajmërohen brenda gjashtë muajve a brenda një viti, kur duhet të lajmërohen pensionistët, është çështje e cila rregullohet. A do të shkojnë vetë punëtorët e ministrisë të bëjnë verifikimin, a duhen ata të vijnë në ministri, është krejt çështje procedurale, nuk është çështje shumë esenciale në raport me këtë që po bëhet shkelja e të drejtave të njeriut, të kategorive më të merituar të shoqërisë, dhe nuk do ta vajtojmë, po do ta zgjidhim.

KRYESUESI: Kundër-replikë, ministri Skender Reçica.

MINISTRI SKENDER REÇICA: Deputet Haxhiu,

Nuk e kam ndërmend të vajtojmë, po e kemi ndërmend të punojmë dhe po mendoj që jemi duke dëshmuar çdo ditë punën që jemi duke bërë.

Edhe një herë po e përsëris, ne e kemi trashëguar këtë sistem pensional, është e qartë kjo punë dhe kemi filluar ta reformojmë, kjo nuk bëhet brenda ditës, as brenda muajit, është një procedurë, është një proces i tërë, i cili do kohë, i do procedurat e veta.

Dhe po e përsëris për të dytën herë, unë nuk jam fajtor, në vitin 2014 nuk kam qenë as deputet e as ministër, mua nuk më intereson kush e ka votuar. Mua më intereson që sot ligji i cili është në fuqi, unë e kam obligim moral e ligjor ta zbatoj dhe po e zbatoj.

Nga debati, nga çështja që është aq e ndjeshme, unë i kam hyrë historikut të hulumtoj kah e keni nxjerrë atë 15-vjetësh.

Dhe, po, është e vërtetë, në ligjin të cilin ky Kuvend në vitin 2014 e ka miratuar dhe ku nxirret atje stazhi 15 vjet, e ka burimin te Ligji Federativ, e kalon. Po ju e keni votuar, jo unë.

**KRYESUESI:** Zonja Osmani, replikë.

**VJOSA OSMANI:** Faleminderit!

Në radhë të parë sa i përket nenit 8 të ligjit, aty qartë potencohet që duhet t'u njihet edhe gjatë numërimit të stazhit, pra përvojës së punës, duhet t'u njihen edhe ato 10 vjet.

Në qoftë se ndonjë pjesë e atij ligji konsiderohet diskriminuese, ministria ka të drejtë kushtetuese, sipas nenit 24 të Kushtetutës që nuk lejon diskriminim mbi asnjë bazë, qoftë ajo shoqërore, etnike apo diçka tjetër, që ligjin ta interpretojë pa e bërë një diskriminim të tillë. Pra, hapësirën kushtetuese e keni.

E dyta, sa i përket të drejtës për të paraqitur rastin në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, po pajtohem që kjo nuk çështje që është dashur fare të merremi ne si politikanë me to, po nga aspekti praktik është me rëndësi jo vetëm për pensionistët, por edhe për ne si shtet.

Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në qoftë se i shohim interpretimi te neni 8 se kush ka të drejtë të paraqesë raste, por edhe së fundi është interpretuar në rastin 'Lazadu' kundër Turqisë, që secili, pra secila qenie njerëzore që konsideron që i është shkelur një e drejtë e njeriut, po e citoj, nga ana e një shteti që konsiderohet shtet kontraktues apo palë në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, mund të paraqesë aplikacionin dhe me këtë rast thuhet që e vetmja konsideratë që merret parasysh është shteti a është palë, e jo nacionaliteti, rezidenca apo vendbanimi, të cilat nga Gjykata Evropiane konsiderohen si irrelevante për ta determinuar se a është bërë shkelje e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, apo jo.

Pra, unë ju ftoj edhe një herë si ministri që t'i ndihmoni pensionistët me ekspertizë për t'i përgatitur....

*(Ndërprerje nga regjia)*

**KRYESUESI:** Kundër-replikë!



MINISTRI SKENDER REÇICA: Në fakt, nuk kam kundër-replikë, deputete Osmani.

Dua veç ta sqaroj, se më iku më herët në diskutimin e mëhershëm.

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe unë, stafi im, ekipi, tërë administrata e ministrisë do të jenë në shërbim të secilit pensionist për çfarëdo natyre që ata kanë nevojë t'i përgatitin dokumentet me qëllim që këtë çështje ta adresojmë për fitimin e të drejtës së tyre në drejtën e pensioneve, të cilat i ka grabitur Serbia, i ka marrë Serbia.

Çka kemi bërë ne? Komplet listën e të gjithë pensionistëve e kemi bërë në formë të librit, e kemi botuar dhe ia kemi dhënë Lidhjes së Pensionistëve, ata e kanë në dispozicion dhe të gjitha shënimet që i posedon Ministria e Punës, administrata, janë në dispozicion të tyre dhe kujto tjetër që mund të shërbejë dhe të na ndihmojë që pensionistët tanë, nëse kanë mundësi, ta fitojnë të drejtën apo ta kthejnë të drejtën e tyre në pensionet të cilat fondet e tyre janë keqpërdorur nga Serbia. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Hoti ka replikë me zotin Haxhiu.

ENVER HOTI: Dua ta falënderoj, u ngrita këmbë për ta falënderuar zotin Haxhiu që ma dha mundësinë.

I tha ministri disa çështje që shumë të rëndësishme janë, është e vërtetë që duhet pritur dhe të bëhet komplet Kodi unik për reformën pensionale.

E përmendi edhe çështjen e prindërve të dëshmorëve, të cilët janë kontributdhënës dhe po u bëhet një padrejtësi.

Kanë pasur 80 vota mundësi t'i bëjnë ato ndryshime ligjore, tashmë të mos i bimë në qafë ministrit brenda një viti, atëherë me të vërtetë kanë vajtuar e kanë lotuar edhe pak prej lotsjellësit, e pak më shumë prej qyqarllëkut të vet, e s'i kanë kryer detyrat që është dashur t'i kryejnë, tani le të bëhen pjesë aktive e këtyre ndryshimeve dhe hapave të reformës që i ka marrë ministri t'i kryejë për këto skema pensionale.

Janë tetë ligje, të cilat janë në kolizion mes vete, ka të meta dhe defekte të shumta që i atakojnë kategori të ndryshme, qoftë formë meritore, qoftë edhe ata që përfitojnë në mënyrë të pamerituar.

KRYESUESI: Kundër-replikë, zoti Haxhiu.

BEKIM HAXHIU: Unë do ta falënderoj edhe deputeten Mjaku për raportin, i cili është i Avokatit të Popullit dhe dua t'i tregoj edhe Enverit, edhe partisë së tij, sepse këtu në Parlament

vijmë prej subjekteve politike, por qëllimi do të duhej të jetë i gjithëve njëjtë t'u shërbejmë qytetarëve.

Edhe Nisma ka qenë pjesë e Parlamentit të Kosovës dhe bash hiç nuk mund të hiqet prej kësaj përgjegjësie. Unë nuk pretendoj të jem i gjithëdijsëm, në veçanti ta njoh ekstrem ose në maksimum fushën e skemave pensionale.

Dhe, këtu, ata që kanë qenë edhe pjesë e komisionit parlamentar në mandatin e kaluar, e kanë një pjesë të fajit, por një pjesë të përgjegjësisë gjithsesi e ka ish-ministri Abrashi, sepse është ligj i sponsorizuar prej tij dhe, as ky tjetri nuk mund t'i ikë përgjegjësisë pse nuk po i bën këto dy ndryshime, por po vajton edhe ky sikur Enveri.

**KRYESUESI:** Faleminderit! Kush ka replikë, zoti Abrashi.

**ARBAN ABRASHI:** Faleminderit, kryetar!

Ka shumë diskutime që mendoj i shërbejnë kësaj kauze, po e pashë që disa edhe nuk e kanë vlerësuar punën time, jo për juve, nuk po them. Po për dy vjet kam menduar t'i bëj disa reforma.

Më së pari është bërë kategorizimi si obligim ligjor, ku janë rritur edhe pensionet kontributdhënëse deri në 230 euro.

Është bërë pastrimi i listave, nuk po e përmend askush, diku rreth 17 mijë persona që nuk kanë pasur të drejtë ta marrin, i kam larguar, mbi 17 milionë euro janë kursye vetëm me atë.

Është rritur socialia për 25%, janë kryer marrëveshjet me Zvicrën dhe me Belgjikën, domethënë vetë i kam takuar disa herë negociatorët belgë dhe zviceranë në Prishtinë edhe është bërë punë e mirë.

Janë nisur skemat familjare invalidore, paraplegjikëve dhe veteranëve, domethënë janë bërë punë të mëdha, se dikush tha që s'është punuar asgjë hiç. Edhe skema e viktimave të dhunës seksuale që është nisur.

Edhe njohjen e stazhit për punëtorët e arsimit, edhe atë e kam kryer unë sa kam qenë në Qeveri.

Tash për temën e sotme, problemi më i thellë, problemi është më i thellë, se ligjin të cilin ne po e diskutojmë tash e ka pasur një plotësim-ndryshim në vitin 2014, para se unë të bëhesha ministër, po si pikë që është 15-vjeçare kjo që po përmendet është diku, në mos gabofsha më 2005 ose 2006, ajo është...

*(Reagime nga salla)*

Prit, prit veç pak, se ajo është udhëzim, nuk ndreqet me udhëzim kjo punë. Ligji është bërë në viti 2005 dhe ka hyrë në fuqi 2006, ky 15-vjeçari. Ai ligj është i bazuar në Ligjin për sistemin pensional invalidor të Kosovës që ka hyrë në fuqi më '83-në. UNMIK-u nuk e ka zhvlerësuar, sepse nuk kanë parë elemente diskriminuese, duhet të ndërrohet ligji, në qoftë se duhet bërë kjo punë.

Tash, të mos e zgjasim këtë punë, se shpeshherë kur po vjen puna ta ndryshohet një ligj, po ka ndërhyrje nëpër komisione. Në qoftë se duam të bëjmë një pakt, dhe përnjëmend ta ndryshojmë këtë punë, ministri e sjell veç një propozim, neni 8, pika 1.2, kjo ndryshohet dhe mund ta diskutojmë propozimin më të mirë, a ta bëjmë prej 10 vjet proporcion deri 15 apo qysh do, veç kjo duhet të ndryshojë. Ndryshe nuk bëhet, ligji është në fuqi prej 2005-2006 bazuar në Ligjin e Kosovës prej '83-së.

Prandaj, më 2014 është ndryshuar ligji, para se të vij unë, po kanë futur edhe gjëra të tjera.

Edhe e fundit, se u përmend shumë Strasburgu, unë kam takuar ish-gjykatës të Strasburgut që sot punojnë si avokat, edhe ne i kemi iniciuar disa raste. Puna është shumë më e komplikuar se sa qysh po mendohet, kjo puna që është marrë një fond e është dërguar atje është shumë më e komplikuar. Ne kemi nxjerrë disa elemente të drejtave njerëzore, sepse pensioni shihet si pronë, e posaçërisht pse nuk janë paguar pensionet deri në shpallje të pavarësisë, e pse janë paguar për serbët në Kosovë, e jo për shqiptarët, do të thotë, janë nxitur disa elemente të drejtave të njerëzore dhe i kemi dy raste, me të cilat në qoftë se fitohet, hapet rruga për të tjerët, është rasti...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESI: Kryeje, se është interesat kjo që po e elaboron ti, kryeje si diskutim.

ARBAN ABRASHI: Faleminderit!

Jo, realisht desha të tregoj që edhe për Strasburg është punuar, janë paraqitur dy raste, mund t'i shpërndaj edhe letrat prej Strasburgut që janë pranuar rastet dhe kanë hyrë në procedurë, sepse Strasburgu i ka ndryshuar rregulloret kohët e fundit. Vetëm kur ka rast, i pranojnë për t'i trajtuar, në qoftë se s'ka elemente, i refuzojnë menjëherë. Në këtë rast, i kanë pranuar, unë i kam letrat që janë pranuar dhe kanë hyrë në procedurë, tash ku kanë mbetur duhet parë, po është punuar mirë.

Edhe një herë, ky ligj 15-vjeçari ka qenë në fuqi tash e shumë vjet. Në qoftë se duam ta ndryshojmë, edhe unë mendoj se duhet ndryshuar, kam qenë ministër për 2 vjet, të kisha qëndruar katër, deri në fund, edhe ajo ishte rregulluar, po në qoftë se dëshiron ta ndryshosh vetëm atë pikë, ministër, e dini cila pikë, cili nen, mund ta diskutojmë cili është versioni më i mirë dhe më pak i kushtueshëm, bazuar në përvoja të vendeve të tjera, sepse edhe ky 15-vjeçari

është i bazuar në përvoja të Bankës Botërore, FMN-së prej viteve '70-80-ta, domethënë dihet pse ka qenë aty.

Kjo mund të ndryshohet dhe e përkrahim tutje. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti ministër, e keni fjalën sqaruese.

MINISTRI SKENDER REÇICA: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

I nderuar deputet Abrashi,

Ne po flasim që duhet të ndryshohet, në fakt, ne e kemi hartuar një koncept dokument që të gjitha këto probleme, të cilat bashkërisht po i diskutojmë që sa orë, i kemi adresuar në mënyrën më të mirë të mundur.

Një gjë dua t'ju them, koncept dokumenti mbi reformën e sistemit pensional në vend është një dokument që u përgjigjet më së mirë rrethanave socio-ekonomike të tanishme. Nuk ka ndonjë dokument tjetër, i cili mund të adresojë më qartë, më në mënyrë të drejtë dhe të barabartë problemin e sistemit pensional në vend se ai dokument, të cilin ne si ministri e kemi hartuar dhe dërguar në Qeveri për miratim, por marrëveshja politike, e cila rezultoi me krijimin e Komisionit ad hoc për krijimin e Kodit pensional ka bërë që sot ne edhe katër muaj të këtij viti po presim, sikur të mos kishte qenë kjo ndërhyrje, unë dua t'ju siguroj se në agjendën legislative të këtij viti unë e kam pasur në plan që në fund të qershorit, ne si Qeveri t'ju sjellim në Parlament dy ligje, të cilat burojnë nga ai koncept dokument për reformën e sistemi pensional.

Ligjin unik për pensionet dhe Ligjin për krijimin e Fondit të Sigurimeve Sociale, jemi vendi i vetmi rajon që nuk kemi një ligj dhe nuk kemi fond për sigurime sociale, i cili është edhe obligim që buron nga Marrëveshja për Stabilizim Asocim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zonja Mexhide Mjaku Topalli.

MEXHIDE MJAKU TOPALLI: Faleminderit, nënkryetar për mundësinë!

Unë dua t'i referohem fjalës time paraprake dhe nuk e mora një përgjigje nga ministri, e përgëzoj për punën që e ka bërë për hartimin e draft konceptit të grupeve, e kështu me radhë.

E tha edhe vetë që ky ligj nuk është vetëm tek neni 8 që po e diskriminon këtë kategori, po edhe familjet e dëshmorëve kur është fjala tek skemat pensionale që u mohohet e drejta e marrjes së pensionit kontributdhënës dhe njohjes së ndihmës sociale apo si ta quajmë, ndarjes së buxhetit për familjet.

Por, po i referohem prapë edhe një herë fjalës tënde të dhënë në mbledhjen në shkurt të vitit 2018, kur kam parashtruar pyetje direkt juve për lajmërimin e pensionistëve çdo gjashtë muaj në zyrat e pensionistëve.

Aty më është thënë nga ju se jeni duke bërë ndryshime të Udhëzimit administrativ për të shikuar mundësinë që kjo masë të largohet dhe të zëvendësohet me masa të tjera. Domethënë është një vit dhe nuk keni ndërmarrë asnjë ndryshim në raport me Udhëzimin administrativ për të hartuar. Faleminderit!

KRYESUESI: Ministri, sqarim shtesë.

MINISTRI SKENDER REÇICA: Deputete, fare shkurt!

30 nëntor 2017 ne kemi proceduar në Qeveri plotësim-ndryshimin e këtij ligji me dy nene.

Neni që ka të bëjë me diskriminimin që u bëhet pensionistëve kontributpagues, të cilët janë përfitues të skemave të cilat burojnë nga Ligji për kategoritë e dala nga lufta. Sikur që kemi kërkuar që edhe kriteret për përfitimin e pensioneve, i cili nga to është edhe lajmërimi çdo gjashtë muaj, përkatësisht një vit, të ndryshohet dhe të plotësohet.

Duke qenë se kemi trashëguar dhe kemi marrë mandatin në fund të vitit 2017 dhe periudhën kur ne kemi marrë mandatin pothuajse edhe buxhetin për vitin 2018 ka qenë i planifikuar, këtë ua kam sqaruar më shumë se një herë në Komisionin Parlamentar, ka qenë e pamundur që ajo të procedohet tutje për shkak të implikimeve buxhetore. Meqë kemi filluar me reformën e sistemit pensional dhe i identifikua të gjitha këto sfida, të gjitha këto probleme që ballafaqohemi me sistemin pensional, ne vendosëm që këtë çështje ta trajtojmë në kuadër të reformës. Po, kam menduar që mund të ndryshohet me Udhëzim administrativ çështja e lajmërimit, por meqë e ka burimin te ligji dhe meqë është e rregulluar në bazë të ligjit, nuk ka mundësi të ndryshohet ose të nxirret një Udhëzim administrativ, i cili mund të jetë në kundërshtim me ligjin që rregullon atë fushë.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Sami Kurteshi e ka fjalën.

SAMI KURTESHI: Unë i dëgjova krejt, s'po them faleminderit hiç, po i dëgjova krejt dhe po, vonesa është e qëllimshme, po s'ka dert, përsëri na vjen fjala, atë që e mendon, duhet edhe të thuhet, nuk ka frikë këtu.

Një, është çështja se interpretimin e bëtë nga ajo pozitë edhe dëgjojnë krejt, dhe bëni interpretime të gabueshme të ligjeve, një. E dyta, rastet e fituara në Gjykatën Evropiane të Drejtave të Njeriut, shumë foli zonja Osmani, me të drejtë, në ato vendime ka pjesë që thonë: “Këto vendime përdoren si precedent për të gjitha rastet e pensionistëve në Republikën e

Kosovës”, dhe në këto vendime kemi një fjali që thotë: “Republika e Serbisë është e obliguar që të heqë të gjitha vështirësitë dhe problemet që u nxirren administrative pensionistëve nga Kosova”, prandaj këto mund të përdoren si raste precedentë. Por, fajti nuk është te pensionistët, unë s’po them që është te kjo qeveri, fajti është te qeveritë tona të mëparshme dhe te delegacioni që ka këqyrë ta heqë këtë çështje nga rendi i ditës për biseda me Beogradin, sepse kjo është një arsye, kusht që duhet të ndërpriten bisedimet me Beogradin pa u kthyer prona e qytetarëve të Republikës së Kosovës, që është e vjedhur, dhe këtu është Këshilli i Ministrave të Këshillit të Evropës që përcjell zbatimin e vendimeve të Gjykatës Evropiane, edhe Qeveria jonë kurrë, përfshirë edhe këtë Qeveri, nuk e ka bërë një kërkesë në këtë Këshill të Ministrave të shihet a janë zbatuar vendimet e Gjykatës Evropiane.

Kjo është një çështje që duhet diskutuar. Çështja tjetër, unë nuk jam Avokat i Popullit, kam qenë, e kam përcjellë këtë rast, po bisedohet për ligjin dhe për Udhëzimin administrativ që po e përmend edhe ministri dhe po bëhet zhurmë. Po të jem unë pensionist ose person që i është ndaluar marrja e pensionit kontributpagues, me këtë ligj dhe me këtë Udhëzim administrativ, unë shkoj në Gjykatë dhe e fitoj rastin. Dëgjoni pse e fiton rastin, Udhëzimi administrativ është i bazuar në ligjin e tanishëm që është në fuqi, e ky ligj në nenin 8, paragrafi 2 thotë kështu: “Kategorizimi i shfrytëzuesve të pensionit kontributdhënës sipas kohëzgjatjes së pagesës së kontributit”, nuk jep kufizim, po thotë “sipas kohëzgjatjes së pagesës së kontributit”, domethënë ke punuar 3 ditë, i merr për 3 ditë, ke punuar 3 vjet, për 3 vjet. Edhe unë i bëj ftesë çdo qytetari të Republikës së Kosovës, të cilit nuk iu ka njohur e drejta për pension kontributpagues, për shkak të mungesës së periudhës 15-vjeçare, le të shkojë në Gjykatën e Republikës së Kosovës, e fiton rastin dhe e merr pensionin, me këtë ligj edhe një Udhëzim administrativ nuk mund të jetë mbi ligjin.

Prandaj, Udhëzimi administrativ, zoti ministër, po ju them, mund të ndryshohet vetëm nga ju, se atë e ndryshon ministri, jo Kuvendi, ligjin e ndryshon Kuvendi, ligji nuk them që është më i miri, ligji është në rregull dhe të gjithë atyre pensionistëve kontributpagues u jep të drejtë t’i drejtohen gjykatës e ta fitojnë rastin dhe krejt mjetet me i marrë me kamatë. Edhe unë i ftoj të gjithë ata, të cilëve iu është gjetur si arsyetim mosdhënia e pensionit kontributpagues që t’i drejtohen nga dita e sotme Gjykatës Themelore apo çdo gjykatë kompetente dhe e fitojnë rastin, i marrin mjetet, kjo është çështja kryesore.

Një çështje tjetër, qëndrim i kësaj Qeverie që ka krijuar delegacion për bisedime me Serbinë, nuk do të duhej të ishte asnjë tjetër përveç kthimi i pronës së qytetarëve të Republikës së Kosovës në mënyrë të rregullt. Sot janë mbi 82 mijë kontributpagues nga Republika e Kosovës, të cilëve u ka borxh Fondi Pensional i Republikës së Serbisë t’ua paguajë kontributet. Ai fond nuk kthehet në Kosovë deri sa të jetojë kontributdhënësi i fundit me banim në Kosovë mund të marrë pensione nga ai kontribut, atë e ka obligim ta paguajë Serbia, nuk ka nevojë ta sjellë atë fond në Kosovë, por e ka për obligim ta paguajë, dhe këtë duhet ta zbatojë.

Çështja tjetër, ne nuk vajtojmë këtu, kërkesa për rezolutë do të ishte në rregull sikur Kuvendi i Republikës së Kosovës të kishte obligim ta ndërronte ligjin, ky ligj tash për tash nuk ka nevojë të ndërrohet. Në bazë të këtij ligji me një Udhëzim administrativ që është i gabueshëm, i kundërligjshëm, në fillim unë e thashë, është i kundërligjshëm, s'e përmenda, por unë po ju them se ky Udhëzim administrativ nuk thotë kurrëgjë, thotë: "Të ketë stazh pensional kontributdhënës së paku 15 vjet para datës 1.1.1999". Thotë sipas Ligjit të KSA të Kosovës. Me ligjin që është në fuqi në Republikën e Kosovës, të gjitha ligjet e tjera që e rregullojnë çështjen e pensionit nxirren, nuk kanë fuqi veprimi, nuk kanë fuqi, prandaj nuk mund të thirren as në një ligj të KSAK-së, as në ligj federativ, por thirremi vetëm në ligjin që është në fuqi, e ligji që është në fuqi është ky ligj që e kemi tani që nuk e ndalon, nuk e kufizon periudhën kontributpaguese të pensioneve. Zoti ministër, qysh nesër merreni, ndërrojeni Udhëzimin administrativ, paragrafin 2, pikën 2.3. në mënyrë arbitrare ju mund ta bëni atë, siç e ka bërë një ministër i mëparshëm në mënyrë arbitrare, s'keni nevojë ta pyetni Kuvendin, as Qeverinë. Është autoritet i ministrit Udhëzimi administrativ. Ju lutem, bëjeni këtë, edhe një herë po ju them të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës, të cilëve nuk iu është pranuar pensioni kontributdhënës për shkak të mungesës së përvojës 15-vjeçare, që sot le t'i drejtohen gjykatës kompetente në Republikën e Kosovës edhe unë po ju them një rast precedent duhet të jetë, e fitojnë gjykimin dhe e marrin pensionin. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Unë po të them faleminderit! Zoti Reçica, e ke fjalën.

**MINISTRI SKENDER REÇICA:** Zoti deputet, nëse i respektojmë qytetarët për një të drejtë e tyre, është mirë t'i informojmë korrekt, nuk e di a po flasim të dytë për të njëjtin ligj apo jo? Unë e kam në dorë Ligjin për skemat pensionale të financuara nga shteti, Ligji nr. 04/L-131.

Neni 8, kushtet dhe kriteret për njohjen e të drejtës në pension kontributpagues të moshës: 1. Të drejtën në pension kontributpagues të moshës e realizojnë të gjithë personat, të cilët kanë shtetësi të Kosovës dhe të cilët kanë mbushur moshën 65 vjet, 1.1.

1.2. Duhet të ketë stazh pensional kontributdhënës sipas Ligjit për sigurimin pensional dhe invalidor nr. 011-24/83 Gazeta zyrtare KSAK nr. 26/83 para datës 1.1.1999.

Ligji, të cilin ju, ky Parlament, e ka cituar edhe kur e ka nxjerrë si dispozitë, edhe kur është nxjerrë Udhëzimi administrativ, i cili është nënshkruar nga ish-ministri Abrashi, deputeti i tanishëm, është zbërthyer që ky ligj, ky nen burimin e ka te Ligji i KSAK-së, i cili thirret në numër dhe me datë, dhe ne kur jemi futur në detaje, nga e ka burimin, se aty nuk thuhet asnjë gjë, thuhet vetëm në ligjin këtë e këtë, dhe ky ligj të nxjerrë te Ligji federativ që e kufizon 15 vjet, ju e keni votuar, jo unë.

**KRYESUESI:** Sami, mos e pengo, merre për replikë ti, ke të drejtë në replikë.

MINISTRI SKENDER REÇICA: Prandaj, qytetarin duhet ta informojmë saktë, mbi bazën e këtij ligji Ministria e Punës, nuk dua ta arsyetoj këtë udhëzim është i drejtë apo jo, është diskriminues ose jo, po Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale zbaton këtë ligj dhe zbaton këtë Udhëzim administrativ, i cili e ka burimin te ky ligj, e fatkeqësisht ky ligj e ka burimin te Ligji i ish-Federatës Jugosllave.

KRYESUESI: Faleminderit! Replikë ka zoti Sami Kurteshi.

SAMI KURTESHI: Zoti ministër, hajde t'i sqarojmë qytetarët. Ju po i përmendni normat, doni të citoni Ligjin për sigurimin pensional invalidor nr. 011-24/83, ma cekni normën që bën kufizimin, një. Ma cekni normën që thoni se ky ligj thirret në Ligjin Federativ, veç cekeni çka thotë, s'kam asnjë problem. Unë po ju them, nuk ka asnjë normë, në të cilën mund të thirret ky ligj, ky Udhëzim administrativ që e kufizon atë kohë, prandaj po u bëj ftesë qytetarëve, shkoni në gjykatë nëse doni ta fitoni gjykimin dhe t'i merrni të hollat. Kaq!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Bilall Sherifi.

BILALL SHERIFI: Faleminderit, zoti kryesues! Më lejo ta falënderoj Samiun për këto sqarime të gjithanshme, edhe në emër tënd ta falënderoj që nuk të falënderoj. Vërtet këtu u zhvillua një debat bukur i mirë, ku besoj që edhe ne që nuk kemi qenë shumë të informuar për detajet e kësaj çështjeje, besoj që jemi më të informuar tash, sepse nga grupi ynë ka qenë deputeti Enver Hoti më shumë i përfshirë në këtë çështje, por megjithatë gjatë këtij debati unë arrita të kuptoj diçka dhe ajo që unë kuptova është kjo: se ka interpretime të ndryshme rreth asaj se a kufizon apo nuk kufizon legjislatura aktuale, dhe çështja tjetër që ka të bëjë me reformën në skemën pensionale.

Për këtë çështje besoj që ministri e dha një sqarim të mjaftueshëm, kemi të bëjmë me një reformë të gjithanshme, e cila në Qeveri, në ministrinë të cilën e drejton zoti Reçica ka qenë e rrumbullakuar si propozim, por për shkak të një marrëveshje politike me PSD-në, siç e dini ju, është ndërprerë në kuadër të Qeverisë, në mënyrë që të përfshihet edhe PSD-ja me disa ide të saj se si të bëhet më e mirë, më e drejtë dhe më efikase një reformë e skemave pensionale.

Pra, këtu tha që janë disa ligje që i rregullojnë këtë çështje dhe ligjet bien ndesh me njëra-tjetrën. Njëri ligj jep një të drejtë, ligji tjetër e merr. Njëri ligj shkon te krahina socialiste, e njëri shkon te ligjet federative, ku ta di unë, pra një lëmsh, të cilin duhet ta zgjidhim ne deputetët. Po a ka vullnet të zgjidhet kjo? Unë po e shoh që duke pasur parasysh që u tha se partitë opozitare nuk po marrin pjesë, nëse jam gabim, më korrigjoni, në projektin ku është duke u punuar për këtë çështje, unë atëherë e këshilloj ministrin që këshillat e Samiut t'i marrë, se nuk është duke i dhënë në emër të Vetëvendosjes, kur i jep në emër të Vetëvendosjes, mos i merr, se Vetëvendosja është duke e bojkotuar këtë proces të punës për arritjen apo, le të themi, për hartimin e një platforme të përbashkët, e një skeme, vizioni të përbashkët.



Kur të japin në emër të LDK-së, mos i dëgjo, ama kur të flasin në emër të tyre, dëgjo se kanë qëllim të mirë të të ndihmojnë të dilet nga kjo situatë. Unë seriozisht besoj në disa sqarime që i dha kolegu Sami, ndoshta edhe jam subjektiv se e kam mik të vjetër, edhe i besoj kur flet si jurist, kur flet si ekspert i besoj më shumë. Si politikan kam pak telashe tash t'i besoj, po ne jse kjo është çështje tjetër. Unë në emër të Nismës këtu, edhe në emër timin po them, në interes të realizimit të të drejtave të tyre, të gjithë atyre pensionistëve që tani u është mohuar me arsyetimin qoftë me vend, qoftë pavend, ku ta di unë, se një ligj ia jep dhe një ligj nuk ia jep, ia merr një të drejtë, le të ulemi së bashku në dy faza, ky është propozimi im konkret, në dy çështje duhet t'i ndajmë, le të shohim çka është lexuar keq në kuadër të legjislaturës aktuale që i ka penguar njerëzit në realizimin e këtyre të drejtave, t'ua japim e të mos i detyrojmë të shkojnë nëpër gjykata, se nganjëherë kam frikë se orientimi në gjykata ka të bëjë me heqjen e ballafaqimit, se gjykatat pas 5 vjetëve do të vijnë me një verdikt final dhe shpeshherë pensionistët nuk janë këtu kur ta fitojnë rastin.

Pra, pensionistë do të thotë 65 vjet plus, edhe nëse ai është sot 67 dhe e çon në gjykata, ai 72-73 vjet kur t'i bëjë, mund ta fitojë të drejtën. Le të mbetet opion gjykata nëse ka këmbëngulësi në qeveri që të mos shikohet kjo, por unë nuk besoj që ministri Reçica dhe Qeveria është këmbëngulëse në atë që të mos u mundësohet atyre të realizojë një të drejtë që u jep ligji. Prandaj, reforma, siç u tha, e paketës pensionale, të gjitha skemave pensionale, të sillen në një ligj, le të mbetet një, sepse ajo po shihet që do të marrë më shumë kohë, ministër, shih çka mund të bëhet në kuadër të legjislaturës aktuale, përmes udhëzimeve administrative çka mund t'u ndihmohet këtyre njerëzve që sa më shpejt që të jetë e mundur t'i realizojnë të drejtat e tyre, që janë marrja e pensioneve kontributpaguese. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deshe fjalën, Skënder? Në rregull!

MINISTRI SKENDER REÇICA: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Në fakt, unë po dua të besoj që tërë ky debat nuk është personal, por është për një çështje e cila është shumë jetike për qytetarët tanë dhe unë dua ta besoj dhe e marr ashtu. Deputet Kurteshi, dëshiroj ta lexoj ku është thirrur Kuvendi i Kosovës kur është bazuar në Ligjin e KSAK-së.

Me këtë ligj, pika ku është thirrur, me këtë ligj më hollësisht rregullohen të drejtat themelore nga sigurimi pensional invalidor në përputhje me Ligjin mbi të drejtat themelore nga sigurimi pensional invalidor, Gazeta Zyrtare e RSFJ-së nr. 24-82 dhe 77-82 në tekstin e mëtejshëm, Ligji mbi të drejtat themelore dhe rregullon edhe të drejtat e tjera themelore nga sigurimi pensional invalidor. Në këtë është thirrur. Faleminderit!

KRYESUESI: Sami, e ke kërkuar fjalën për Bilallin a qysh? Bilalli ta ka përmendur emrin, dy minuta i ke, merre.

SAMI KURTESHI: Për që ma ka përmendur Bilalli emrin, unë s'kam ardhur këtu personalisht, këto që i thashë, natyrisht që po i them unë, po unë i them në emër të Vetëvendosjes, se as si deputet s'kam ardhur vetë. Kam ardhur si deputet i Vetëvendosjes, në momentin kur kam për të folur diçka e të them s'është për Vetëvendosjen, unë deklarohej hapur e them Vetëvendosja mendon ndryshe, prandaj ky është veç mendim imi personal.

Çështja me ministrin për sqarim, zoti ministër, këtu unë e kam ligjin, po flasim për të njëjtin ligj, çka thotë domethënë edhe në fund, ky ligj thotë: "Ligji hyn në fuqi edhe pas shpalljes së Gazetës zyrtare në Republikën e Kosovës, 15 ditë".

Tregomë, ku, qysh e ka burimin? Ky ligj nuk i bën asnjë kufizim çfarë është në Udhëzimin administrativ në paragrafin 2, pikën 2.3., kjo është çështja. Ne mund ta interpretojmë, edhe unë përsëri po bëj ftesë, mund t'i interpretojmë qysh të doni, shkoni në cilindo gjykatë. Ligji e ka për detyrë të shkruajë norma që janë të qarta, të sakta, të shkurtra, që nuk kanë nevojë për shumë interpretim. Në momentin kur kanë nevojë për interpretim, i çojmë në Gjykatë Supreme ose në Gjykatë Kushtetuese. E, unë prapë po them, ky ligj që është në fuqi nuk lejon në asnjë normë kufizimin që e ka bërë Udhëzimi administrativ, s'ka kurrnjë tjetër, është gjykata, le ta marrë interpretimin, hiç s'e kam unë asnjë problem, gjykata thotë "deputeti Sami Kurteshi ka gabuar plotësisht dhe e dënojmë edhe për këtë", por unë po them që kështu është.

KRYESUESI: Fjalën e ka zoti Korab Sejdiu.

KORAB SEJDIU: Të dashur qytetarë,

Kryesues edhe kolegë të nderuar,

E falënderoj kolegen Teutë që e ka sjellë këtu në Kuvend këtë temë jashtëzakonisht të rëndësishme që prek një segment të popullatës tonë jo aq të vogël dhe të veçantë, besoj që sot duhet t'i ndajmë dy çështje që nganjëherë pak po ndërliken dhe po, si të themi, po përzihen pak gjatë diskutimeve.

E para, ka të bëjë se si i trajton qytetarët tanë kontributpagues shteti i Kosovës dhe, në anën tjetër, ose shtylla tjetër është se si i trajton ata Serbia. Do të thotë, me fondin që e kanë vjedhur dhe mbajnë peng. Lidhur me çështjen e parë, pra atë se si i trajtojmë ne, zoti ministër besoj që nuk ke parë ndonjëherë konsensus më të madh pozitiv-opozitiv se sa atë që po e shoh sot dhe të gjithë po pajtohem se kufizimi arbitrar prej 15 vjetëve mund të ketë edhe implikime shumë të thella kushtetuese, do të thotë po i trajton njerëzit në mënyrë të pabarabartë para ligjit, po diskriminon e kështu me radhë. Nuk besoj që është fare e rëndësishme interpretimin a po ia bën mirë ministri apo dikush tjetër, është e rëndësishme ajo që po zbatohet në praktikë, që do të thotë, kemi një pjesë të kontributpaguesve, të cilëve po u mohohet një e drejtë, të cilën po e përfitojnë disa të tjerë, varësisht a e kalojnë për një ditë atë kufizimin arbitrar apo jo. Unë besoj që ju keni plotësisht të drejtë që është e rëndësishme të kemi një reformë të rrënjësishme të

sistemit pensional në Kosovë. Edhe do t'ju përgëzoja nëse mund t'i dilni zot edhe ta kryeni atë brenda mandatit tuaj që të vijë këtu në Parlament dhe të adresojmë në mënyrën e duhur.

Mirëpo, besoj të gjithë këtu u deklarua edhe e pamë që ekziston një nevojë pak më urgjente që të trajtohet çështja e vetme, do të thotë çështjen e kufizimit arbitrar që është prej 15 vjetëve dhe të shihet prej sot, çka mund të bëni, sa shpejt mund ta bëni atë dhe, në fakt, a keni kapacitet për ta bërë brenda ministrisë qoftë buxhetore, qoftë në aspektin e burimeve njerëzore. Kështu që unë kisha pasur dëshirë prej juve që kur të shkoni në ministri, ndoshta jo sot, po të hënën të mblidhni ekipin tuaj dhe të analizoni çka duhet bërë që të ketë një efekt të menjëhershëm për eliminimin e këtij kufizimi arbitrar. Dhe, kjo në njëfarë mënyre e adreson një çështje problematike që besoj shumica prej nesh e përmendën sot që eliminon edhe nevojën që secili qytetar të shkojë në gjykatë edhe të pret 15 vjet për ta realizuar një të drejtë që ishte dashur t'iu takonte fillimisht, sepse e kemi obligim të gjithë të mos i detyrojmë qytetarët t'i realizojnë të drejtat e tyre përmes gjyqësorit, nëse kemi mundësi.

Veçanërisht këtë po e them duke pasur parasysh që është një segment, i cili nuk mund të presë 15 vjet për shkak të moshës, ndoshta u duhen aktualisht për shkak të problemeve shëndetësore që i kanë, për shkak të moshës së shtyrë, e kështu me radhë. Prandaj, ju kisha lutur që vërtet këto tri çështje t'i adresoni, tri pyetjet ose sugjerimet që i dhashë e të shihni si mund ta bëni këtë, sa shpejt dhe a kemi mundësi me qëllim që ju të na jepni një afat, të thoni që brenda një muaji ose dy vijmë me propozim në këtë Kuvend për t'ju njoftuar që ka përfunduar kjo punë dhe është adresuar.

Sa i përket çështjes së dytë, unë i kom parë ato listat që thatë që i keni përgatitur për pensionistët, pajtohem që ka pasur edhe në vendimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut që ka sugjeruar që Kosova t'i ofrojë Gjykatës edhe Këshillit të Ministrave informatat e plota lidhur me këtë, edhe në Komision për Legjislacion jemi takuar me përfaqësuesit e kontributpaguesve, të cilët në fakt na kanë thënë, s'e di sa është e saktë, por na kanë thënë që janë duke pritur nga Qeveria për raportim zyrtar dhe dërgim zyrtar të këtyre dokumenteve tek organet kompetente në Këshillin e Ministrave në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Kështu që nëse është e mundur edhe ta trajtoni këtë çështje, sepse ne me sa e di në komision e kemi lënë që të merremi dhe të tentojmë që bashkë me Qeverinë ta shtyjmë këtë çështje përpara, mirëpo ju kisha lutur që si ministër kompetent i sektorit të interesoheni ta shtyni përpara këtë çështje.

Kështu që edhe njëherë po e them, ju lutem e di që reforma e përgjithshme është shumë e rëndësishme, po mos ta bëjmë këtë çështje specifike të ngushtë peng i reformës së përgjithshme, po të mundohemi të adresojmë këtë çështje, pasi që po kërkohet prej shumicës prej nesh, edhe besoj ke për të hyrë në histori të kësaj Qeverie si ministër me mbështetjen më të madhe nëse vjen

me një zgjidhje të shpejtë të këtij problemi, e në fakt na e lehtëson pak punën edhe neve që kemi prindër të cilët po diskriminohen dhe të cilët sa herë shkojmë në shtëpi po na thonë pse po diskriminohemi nga shteti në këtë mënyrë. Kështu që të falënderoj paraprakisht për bashkëpunimin dhe shpresoj që e adresoni në kohën sa më të shpejtë të mundur.

**KRYESUESI:** Faleminderit! Për fjalën përfundimtare, të drejtën e ka ministri dhe propozuesi. Zoti ministër, a keni të shtoni diçka?

**MINISTRI SKENDER REÇICA:** Faleminderit!

Në përmbyllje të diskutimit të deputetit, Korabit, natyrisht që ne kemi shprehur që të jemi në dispozicion që të kontribuojnë që e drejta e pensionistëve për të përfitur nga fondi i grabitur të realizohet. Dhe në këtë kontekst, ne jemi në komunikim të ngushtë me Lidhjen e Pensionistëve, me shoqatat që mbrojnë të drejtat e pensionistëve, por edhe me institucionet e tjera të cilat mund të bashkërendojmë aktivitetet, me qëllim që t'i japim rrugë kësaj çështjeje.

Tani në përfundim të këtij debati, duke falënderuar secilin deputet veç e veç për krejt diskutimet dhe duke përsëritur edhe një herë se asnjë diskutim për mua nuk ka qenë personal, por ka qenë në funksion të adresimit të kësaj çështjeje kaq jetike dhe kaq me rëndësi për qytetarët tanë dhe duke pasur parasysh faktin që ne kemi filluar me një proces të reformimit të sistemit pensional dhe kemi mbërritur aty ku kemi mbërritur dhe situata tashmë është krejt e re sa i përket shtyrjes përpara të reformës së sistemit pensional, unë uroj që komisioni i cili e ka marrë mandatin nga Parlamenti të punojë me një dinamikë të shtuar dhe uroj që ky komision së shpejti ndoshta do të dalë edhe me një rekomandim pasi që tash ka edhe mandatin nga Parlamenti, me një rekomandim ku ne si qeveri mund të vazhdojmë me këtë koncept-dokument me qëllim që ta procedojmë tutje në Qeveri për miratim dhe të fillojmë me hartimin e ligjit që natyrisht do të ketë mundësi edhe në fazën e hartimit të ligjeve të cilat burojnë në koncept-dokumentin, pra koncept-dokumentin, Ligji unik për pensionet dhe Ligjit për sigurimet sociale, të bashkëpunojmë edhe në fazën e draftimit të këtyre ligjeve bashkërisht me ju deputetë.

Çfarë ne mund të bëjmë si intervenim emergjent drejtpërdrejt tani për tani, bazuar që me këtë ligj aktual kemi në disa raste, më shumë se një rast kemi, ku me këtë ligj bëhet diskriminim ndaj qytetarëve tanë, duke filluar nga padrejtësia që u bëhet pensionistëve kontributpagues në të drejtën e tyre si pensionist të familjarëve, si përfitues të beneficionit si familjarë të dëshmorëve apo invalidëve të luftës, çka mund të bëjmë me një ndërhyrje emergjente për këtë që e thamë rreth stazhit, njohjes së stazhit, çka mund të bëjmë rreth asaj që ta mënjanojmë atë kriterin që ka të bëjë me lajmërimin e pensionistëve tanë nëpër sportelet dhe zyrat e departamentit të pensioneve anekënd Kosovës. Natyrisht jo për të ulur kriteret që mund ta keqpërdorë dikush të ardhmen, po me qëllim që edhe të vuhet kontroll, por edhe të lehtësohet jeta e pensionistëve tanë. Nisur nga ajo që moshë e tyre dhe kërkesa që të lajmërohen çdo gjashtë muaj, realisht është një maltretim në vete.

Unë besoj që secili ndryshim në këtë fazë në Ligjin për skemat pensionale të financuara nga shteti do të ketë efekt buxhetor, do të ketë efekt financiar dhe natyrisht për secilën ndërhyrje në ligj, ku ka implikime buxhetore, paraprakisht kërkohet një leje edhe nga Ministria e Financave për të parë nëse ka mundësi që ndryshimet të cilat mund të ndodhin dhe mund të rregullohen pas intervenimit në ligj, mund të prodhojnë kosto financiare, duhet parë edhe me Ministrinë e Financave se a ka mundësi të përballohen brenda këtij viti.

Natyrisht që ne do të jemi shumë të hapur që t'i bëjmë disa intervenime aty ku është më se e nevojshme, si intervenime emergjente. Unë këtu po marr zotimin se që nga java e ardhshme, bashkërisht me ekipin tim, unë nuk jam ekspert ligjor natyrisht, jam i thirrur që besoj në opinionet e atyre që e interpretojnë ligjin, dhe dua të besoj në eksperiencën dhe përvojën e tyre, do të shikoj mundësinë që këto që u diskutuan këtu bashkërisht me ju, duke filluar nga stazhi, nga njohja e të drejtës për më shumë se një pension, pra ata që mund të kenë përfitime nga ndonjë ligj tjetër.

Lajmërimi i tyre që të shohim me një intervenim të shpejtë, me një mundësi që të ndërhyjmë në ligj dhe të sjellim në Parlament për të plotësuar dhe për të evituar këto shkelje apo diskriminime të cilat i kemi aktualisht me ligjin në fuqi. Unë ju falënderoj edhe një herë të gjithëve për kontributin. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zonja Teuta Haxhiu. Rregullorja s'ta jep.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Sinqerisht, falënderoj të gjithë deputetët për kontributin e tyre. Duke qenë shumë e vetëdijshme, si jo juriste, po duke konsultuar juristët e kam bërë propozimin, duke e ditur thjeshtë çfarë po propozoj. Pra në ligjin për të cilin gjatë gjithë kohës iu referua, qoftë ministri, qoftë ish-ministri Abrashi, e që problemet në zbatim i kemi me udhëzimin administrativ që e ka vulën e zoti Abrashi, këtu është problemi. Pra, në këtë ligj, Ligjin për skemat pensionale të financuara nga shteti nuk ka asnjë ndalesë, askund nuk ceket kohëzgjatja pra e vitit 15, apo çfarëdo numri qoftë.

Pra, thjesht në rekomandimet që unë i kam thënë në fillim, që një pjesë e madhe e deputetëve që diskutuan nuk ishin, pra kërkoj që të ndryshohet paragrafi 2-3 i nenit 6 i udhëzimit administrativ 9/2015 të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale nga 15 vjet, pra të hiqet komplet. Këtë mund ta bëjë ministri. Prandaj kam qenë e vetëdijshme pse e kam kërkuar. Udhëzimin administrativ e bën ministri, kurse ligjin të cilit po i referohemi, se nuk pretendoj dhe sqerisht nuk mund të kthehem në kohën e ish-Jugosllavisë atje me i pa ligjet e tjera, po në këtë ligj që unë e kam, asnjë vend, asnjë nen të vetëm nuk përmendet pra kohëzgjatja 15 vjet, që ka ardhur me udhëzimin administrativ në kohën e zotit Abrashi. Pra këtu është bërë diskriminimi.

Dhe unë ministër, vërtet edhe nga diskutimet e deputetëve, i lus të gjithë deputetët që ne të kërkojmë pra me një rezolutë, me një nen, me një pikë të rezolutës, që Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, përkatësisht ministri pra të ndryshojë udhëzimin administrativ dhe pikat pra që i përmenda që diskriminojnë skajshmërisht pensionistët, duke e ditur që pensionistët ose punëtorët e arsimit dhe të shëndetësisë janë të rregulluara me ligje të tjera, për çka unë sinjorisht vonë dikur Bekimi e kapi temën pak ma në esencë por vlerësoj shumë kontributin e secilit, por kërkoj që të mos e lëmë e thash në fillim në harresë këtë rezolutë, por është rruga më e shpejtë që ne mund të ikim nga diskriminimi. Për ta ndryshuar ligjin, unë i di praktikën e secilit Kuvend, secilës legjislaturë.

Nëse duam pas një periudhe dhe duke e ditur, duke qenë e vetëdijshme që më vonë pasi e kam thirrur këtë debat, ka ardhur edhe një propozim i Komisionit pra për Kodin Pensional, mirëpo debati kur është thirrur, nuk ka qenë ai propozim. Për mua le të ndodhë kur të dojë ai kod pensional, që nënkupton aktet nënligjore janë pas ligjeve, ligji është akt më i lartë, prandaj këto derivojnë si produkt i ligjit dhe për këtë unë jam shumë e vetëdijshme dhe kërkoj që të ndryshohet ky udhëzim administrativ. Pra pika 2, në fakt 2,3 e pikës 2 në udhëzimin administrativ 2015.

Nëse dikush tjetër ka diçka tjetër në rekomandimet që mund t'i shtojmë atëherë unë jam e gatshme. Përndryshe, nuk e di sa unë kam të drejtë të kërkoj që në seancën e radhës të hidhet në votim, nënkryetar i Kuvendit. Faleminderit edhe një herë. Shumë faleminderit prej secili deputet për kontributin.

**KRYESUESI:** Faleminderit! Shiko, nuk është praktikë pasi të përfundojë diskutimi të fillojë për së dyti. Mos ta bëjmë rrugë. U krye, e ka kryer ajo, seancën e ardhshme kur kemi kuorum e qesim në votim, edhe u mbyll kjo. Detajet...

A doni ta ndërprejmë apo po e vazhdojmë. Ne e kemi edhe një debat që e ka kërkuar Faton Topalli që s'është këtu, e pasi nuk është Fatoni këtu, unë nuk e di pse ta bëjmë. Një debat që e ka kërkuar Korab Sejdiu. Nëse, Korab, nëse je për ta bërë debatin, e fillojmë dhe e përfundojmë. Në qoftë se jo, mund edhe ta tërheqësh krejt, unë s'kam diçka kundër.

Korab Sejdiu e ka fjalën sa i përket debatit të propozuar.

**KORAB SEJDIU:** Kryesues,

Natyrisht që unë jam për ta bërë këtë debat, mirëpo duke pasur parasysh që s'janë njëzet veta këtu, këto çështje të rëndësishme duhet të diskutohen kur ka pak prezencë më të madhe. Prandaj kisha sugjeruar që edhe debati në fakt i propozuar prej Fatonit, edhe ky sot i propozuar nga unë, me deputetë të tjerë përkrahës të shtyhet për seancën e radhës.

KRYESUESI: Zoti Kurteshi e ke edhe ti një propozim për debat? Fjalën zotit Kurteshi!

ISMAJL KURTESHI: Faleminderit!

Po, është debati për arsimin parauniversitar, një çështje jashtëzakonisht e rëndësishme dhe meqë është aq e rëndësishme, përfaqësues të subjekteve politike që janë në Komisionin për Arsim, edhe i LDK-së, PDK-së, edhe i Aleancës dhe Partisë Socialemokrate, jemi pajtuar që ky debat të shtyhet me kërkesën që të jetë pikën e parë në seancën e radhës që do të mbahet të hënën.

A më ke dëgjuar Xhavit çka kam thënë?

KRYESUESI: Të kuptova, a je për ta vazhduar, apo për ta ndërprerë? Edhe një herë Ismajli fjalën, se më fal se më ndërpreu.

ISMAJL KURTESHI: Thash që meqë debati është shumë i rëndësishëm, anëtarët e Komisionit të Arsimit, nga LDK-ja, PDK-ja, AAK-ja, PSDJ-ja dhe Vetëvendosja, kërkojnë që këtë debat ta postojnë të hënën si pikë të parë se është jashtëzakonisht të rëndësishëm. Do të thotë Nisma s'është këtu se do të ishte një pajtim konsensual që debati të mbahet në kohën kur vërtet ka koncentrim. Faleminderit!

KRYESUESI: Më fal, Ismajl, të hënën është e caktuar vazhdimi i seancës së djeshme. Janë 30 pika të rendit të ditës. Në qoftë se dy jeni dakord, ose në qoftë se seanca merr vendim sipas mocionit të juaj, unë s'kam asgjë kundër, po sot s'kemi as kuorum ta qesim në votim për të hënën. Ndoshta është më mirë që kjo seancë pasi ka ngelur sot të caktohen për të martën ose të mërkurën dhe pastaj kishim për të vazhduar. Nëse jeni dakord, nëse jo, ia lëmë Kryesisë pastaj magazinohen qysh janë magazinuar shumë pika të rendit të ditës. Zoti Bilall unë me Ismajlin kam punë, jo me ty. Ismajlin jam duke e pyetur. Jo, njëherë s'dua ta jap, as Bekimin s'ia kam dhënë fjalën. Pritni njëherë. A e ke për propozimin e Ismajlit? Po, mirë de mirë, në rregull, si të doni, ne mund ta ndëprejmë sonte edhe të vazhdojmë diskutimet të hënën. Pastaj të hënën të vendosim kur t'i fusim në rend dite këto çështje. Po si seancë mendoj se është me pika të rendit të ditës që i ka përcaktuar Kryesia dhe që i ka miratuar seanca sot rendin e ditës.

Zoti Bilall e ke fjalën, a deshe diçka të thuash, jo a?

BILALL SHERIFI: Faleminderit, kryesues!

Jo unë po mendoj nuk mund të mbetemi peng i deputetëve që nuk duanë të vijnë në seancë. Ne deputetët që jemi këtu të vazhdojmë punën dhe nuk mundemi për hir të atyre që s'janë këtu të shkojmë edhe ne në shtëpi. Ne kemi 70 pika të rendit të ditës që janë duke pritur të vijnë në rend dite këtu të debatohen, të votohen ku ta di unë. Pra le të vazhdojmë. Përderisa seanca ka filluar, nuk ka nevojë për kuorum për debate. Unë jam dakord që ka disa çështje, disa debate që janë të

rëndësishme dhe mirë është të bëhen paradite, siç është ajo e arsimit, po ka disa debate aty që mund t'i zhvillojmë, t'i vazhdojmë ne që jemi këtu.

Pra, a e di çka po themi ne, duke e ndërpre ne seancën po u japim të drejtë atyre që s'janë këtu. Pra, duke e vazhduar punën ne këtu, ju themi atyre që s'janë këtu se jeni gabim, se këtu e keni vendin dhe duhet të vazhdoni punën e filluar në orën 10. Faleminderit!

KRYESUESI: E di që ia ke qëlluar Bilall tash shumë, kështu që unë të mbështes qind për qind.

Fjalën e ka zoti Bekim Haxhiu.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Plotësisht pajtohem me Bilallin, sepse ne mund të vazhdojmë debatin dhe nuk mund të mbetemi peng i atyre që nuk duan të marrin pjesë në debat. Kush do të marrë pjesë në debat, mund të marrë.

Po i referohem mundësisht vetëm 30 sekonda pikës së kaluar. Një propozim të rekomandimet, që të jenë pjesë e rekomandimeve, që ta ketë parasysh edhe propozuesja, por edhe ministri, që çështja e lajmërimit të pensionistëve, që është e rregulluar sipas ligjit çdo gjashtë muaj, që këto pjesë e rekomandimeve që këto pensione t'i shpërndajë Posta e Kosovës, me çka do t'i zvogëlohej mundësia e maltretim të njerëzve të cilët marrin pensione janë të sëmurë, e duhet të lajmërohen nëpër sportelet e Ministrisë dhe kjo ka mundësi që të rregullohet me një memorandum mirëkuptimi mes Ministrisë dhe ndërmarrjes publike Posta e Kosovës, që këto pensione t'i shpërndante Posta në zyrat e saj për ata që kanë mundësi dhe për ata që nuk kanë mundësi t'ua dërgojë në shtëpi, ku do të kishin mundësi pensionistët të nënshkruhen dhe me një kosto shumë më të vogël buxhetore, sesa kjo që kushton sot përmes bankave që po bëhet aktualisht shpërndarja e pensioneve.

KRYESUESI: Faleminderit! Unë jam i gatshëm të vazhdoj seancën, nuk e kam asnjë problem.

Zonja Bajrami, e keni fjalën.

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit, kryesues!

Unë e kam reagim ndaj zotit Sherifi. 52 pikat e papërfunduara edhe nga pesë seancat e kaluara dhe pikat e papërfunduara prej fillimit të këtij legjislacioni, nuk janë rezultat i mungesës së deputetëve në përgjithësi. Janë rezultat i mungesës së deputetëve të koalicionit qeverisës. Ju jeni duke qeverisur, ju e keni koalicionin, urdhëroni sillni numrat, edhe votoni ligjet që ju kanë mbetur pa votuar. Ne nuk e kemi obligim.



Ne kur thërrasim debat, duam të bisedojmë me Qeverinë. Ku është Qeveria? Ne nuk mund të debatojmë këtu me njëri-tjetrin, sepse nuk kemi thirrur të debatojmë. Të debatojmë me njëri-tjetrin, debatojmë në grupe parlamentare. Duam të debatojmë me ministrin e Arsimit, me ministrin e Punës dhe të Mirëqenies Sociale, me Kryeministrin. Për reciprocitet nuk mund të bisedojmë me njëri-tjetrin, edhe mos u vëni fajin deputetëve në përgjithësi. Ku është koalicioni? Nuk i keni numrat, ejani të shkojmë në zgjedhje.

**KRYESUESI:** Këtu po shkruan në rend të ditës, debat parlamentar dhe nuk po shkruan debat parlamentar-geveritar. A po, zoti Sherifi, pasi ta ka përmendur emrin, tash replikë.

**BILALL SHERIFI:** Faleminderit, kryesues!

Mendoj që kolegja ia huqi krejt, se unë së pari nuk fajësova deputetët e opozitës. Unë thash, as nuk fajësova as ata që nuk janë, deputetët as të pozitës, as të opozitës. Unë thjesht thash nuk po dua që të shkoj pas atyre që s'janë këtu, por po dua të rri këtu të punoj, dhe ata që s'janë këtu le të vijnë, le ta shohin që është duke u punuar.

Një. Dy, debatet parlamentare nuk bëhen me Qeverinë. Interpelancat janë me Qeverinë. Dhe nëse ti ke thirrur interpelancë dhe s'ka ardhur ministri këtu, ke të drejtë kolege. Por kjo, debatet zakonisht përfshihen të gjithë deputetët dhe Qeveria është mirë të jetë, por nëse nuk duan të vijnë, unë me zor s'mund t'i sjellë.

Në fund të fundit, këto janë përgjegjësi të cilat siç e dini ju kanë kosto politike. Qeveritë, asnjë qeveri asnjëherë nuk qenë korrekte në raport fatkeqësisht me deputetët, mirëpo nuk ka ndonjë normë e cila sanksionon. I vetmi sanksion është zgjedhjet, pra humbja apo fitorja e zgjedhjeve, humbja apo shtimi i votave për shkak të të qenit i përgjegjshëm apo i papërgjegjshëm. Tash, ju mbajeni këtë vërejtje, thojeni sa herë të dilni në zgjedhje, mos i votoni këta, sepse nuk po na vijnë në seanca ministrat e këtyre partive, e kësaj Qeverie, por derisa të shkojmë në zgjedhje ne duhet të punojmë. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Fatkeqësisht, Rregullorja jonë nuk i përcakton disa gjëra, por në parlamentet serioze, çështjet diskutohen edhe me tre deputetë dhe kryhet debati, nuk magazinohet për kurrjë. S'ka pasur votim, ka dështuar votimi, pas gjashtë muajsh, urdhëro sille për së dyti ta votojmë. Ne po votojmë 15 herë për një çështje brenda një seance. Kjo është praktikë e jona, s'është praktikë e dikujt tjetër dhe unë s'mund ta ndryshoj, në qoftë se nuk e ndryshon Rregullorja.

Unë jam dakord që të vazhdojmë me debatin. Atëherë po vazhdojmë. Ata që duan të rrinë në debat, rrinë, ata që s'duan, s'kemi çka bëjmë.

Po vazhdojmë me pikën e 11-të:

## **11. Debat parlamentar, sipas kërkesës së deputetit Korab Sejdiu, lidhur me nevojën urgjente për vendosje të sanksioneve ekonomike (përfshirë embargon) dhe sanksioneve politike kundër Serbisë, si masë reciprociteti**

Deputeti Sejdiu i mbështetur edhe nga 12 deputetë nënshkrues ka parashtruar kërkesë për debat parlamentar lidhur me nevojën urgjente për vendosje të sanksioneve ekonomike (përfshirë embargon) dhe sanksioneve politike kundër Serbisë, si masë reciprociteti.

E ftoj zotin Korab Sejdiu që në emër të propozuesit ta paraqesë çështjen për të cilën është kërkuar debati parlamentar. Zoti Sejdiu e keni fjalën.

**KORAB SEJDIU: Faleminderit!**

Edhe një herë të dashur qytetarë,

Kryesues dhe kolegë të nderuar,

Para përafërsisht pesë muajsh, saktësisht më 19 nëntor 2018, bashkë me disa kolegë deputetë, kemi parashtruar kërkesën për debat parlamentar që më në fund po i vjen radha për diskutim. E kemi parashtruar si kërkesë para se të përmendet si çështje prej dikujt, sepse kemi menduar se veprimet shtetërore të një serioziteti të tillë, duhet të jenë të menduara dhe të analizuara mirë, dhe me qëllimin e vetëm që përfitimi nga veprimet e tilla të jetë i Kosovës dhe vetëm.

Kështu që bazuar në nenin 65 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 16.2 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës, me respekt parashtruar në emër të deputetëve nënshkrues, një kërkesë për mbajtjen sa më herët të një seance për një debat parlamentar lidhur me nevojën urgjente për vendosje të sanksioneve ekonomike, përfshirë embargon dhe sanksionet politike kundër Serbisë, si masë reciprociteti. Deputetët mbështetës përveç meje ishin edhe Vjosa Osmani, Albulena Haxhiu, Sami Kurteshi, Armend Zemaj, Besa Gaxherri, Mirjeta Kalludra, Visar Ymeri, Fatmire Kollçaku, Haxhi Avdyli, Arbërie Nagavci, Dardan Sejdiu dhe Sali Salihu. Do të thotë të gjithë deputetë të opozitës.

Kërkesa jonë arsyetohet si në vijim: Përkundër përkushtimit serioz të Republikës së Kosovës për normalizimin e plotë të marrëdhënieve me Serbinë, Serbia mbetet peng i të kaluarës së tyre të errët dhe vazhdon qasjen armiqësore ndaj Republikës së Kosovës. Për më tepër, kohëve të fundit kemi parë një intensifikim dhe ashpërsim të jashtëzakonshëm të veprimeve të Serbisë kundër Kosovës. Serbia nuk ka plotësuar në tërësi pothuajse asnjërën nga marrëveshjet e arritura me Republikën e Kosovës në procesin e dialogut në Bruksel. Përkundrazi deri më sot, Serbia ka investuar qindra miliona euro në destabilizimin e brendshëm të Republikës së Kosovës, duke financuar ndër të tjera edhe rrjete kriminale që për qëllim kanë krimin, përfshirë kontrabandën dhe frikësimin dhe terrorizimin e popullatës civile.

Pa reshtur fare ka ndërmarrë fushata përmbajtjesore kundër anëtarësimit të Kosovës në institucionet dhe organizata ndërkombëtare. Ajo në vazhdimësi ndërmerr hapa për shkatërrimin e shtetësisë së Kosovës, duke penguar njohjet e reja dhe duke keqpërdorur përfshirjen në dialog si pretekst për kërkimin e anulimit të njohjeve nga ato shtete që ende nuk e njohin Kosovën si shtet të pavarur.

Përpjekjet e tilla kanë për qëllim ta vendosin në pikëpyetje edhe statusin e Republikës së Kosovës si shtet i pavarur dhe integritetin territorial të saj. Dhe këto janë vetëm disa nga veprimet e dëmshme që Serbia ndërmerr në baza ditore kundër Republikës së Kosovës.

Në anën tjetër, disbalanca tregtare ndërmjet Kosovës dhe Serbisë është tejet e madhe dhe Serbia shumë herë radhazi i ka shkelur obligimet që kanë dalë jo vetëm nga CEFTA, por edhe nga marrëveshjet e Brukselit që kanë të bëjnë me lirinë e lëvizjes së mallrave, vulat doganore, dokumentet e AVUK-ut e kështu me radhë.

Pasur parasysh të tëra këto sulme të Serbisë, Republika e Kosovës si shtet i pavarur dhe sovran ka për obligim që të vetëmbrohet dhe të ndërmarrë masa konkrete kundër Serbisë, përfshirë për pa u kufizuar në imponimin e menjëhershëm të sanksioneve të përgjithshme ekonomike ndaj Republikës së Serbisë, përfshirë këtu edhe embargon e tërësishme ndaj çdo produkti dhe shërbimi të Republikës së Serbisë.

Kjo nënkupton edhe përcaktimin e ndëshkimeve serioze për të gjithë ata persona që cenojnë sanksionet.

E dyta, shqyrtimin e vazhdueshëm të sanksioneve të parapara në Ligjin për Sanksione Ndërkombëtare dhe në veçanti sanksionet politike.

Ky veprim ka bazë të mjaftueshme në të drejtën ndërkombëtare, veçanërisht në parimin e reciprocitetit dhe nuk dallon nga raste e tjera ku shtetet kanë përdorur këto metoda për ndëshkimin e shteteve që kanë ndërmarrë veprime në kundërshtim me interesat kombëtare të shtetit imponues apo ndonjë arsyeje tjetër legjitimime si për shembull: Shkeljet e të drejtave të njeriut, sigurisë, paqes e kështu me radhë.

Vlen të potencohet për shembull, SHBA kundër Iranit, Bashkimi Evropian kundër Burmës ose Mainmarit, SHBA dhe BE kundër Venezuelës e tjera.

Për më tepër me këtë veprim Republika e Kosovës vepron si shtet i pavarur duke ndëshkuar Serbinë për veprimet e saja armiqësore ndaj Kosovës dhe duke e zvogëluar kapacitetin ekonomik të Serbisë për të financuar veprimet armiqësore ndaj Kosovës, përfshirë këtu edhe financimin e rrjeteve kriminale dhe strukturave ilegale.

Kjo kërkesë është po ashtu e bazuar në Ligjin për Sanksione Ndërkombëtare që është në fuqi në vendin tonë, pra në Republikën e Kosovës. Prandaj, duke u bazuar në arsyet e lartpërmendura dhe arsyet e tjera që do të shtjellohen gjatë seancës plenare, kërkojmë që sa më parë që është e mundur të caktohet kjo seancë, ku deputetët do të kenë mundësi të debatojnë lidhur me nevojën urgjente për vendosje të sanksioneve ekonomike, përfshirë embargo të përgjithshme kundër Serbisë masë reciprociteti.

Pra, duhet shqyrtuar mundësinë për sanksione të tjera përfshirë sanksionet politike në përputhje me ligjin. Rekomandimet përfundimtare do të hartohen pas zhvillimit të debatit parlamentar dhe harmonizimit nëpërmjet grupeve parlamentare.

Në vijim të asaj që e thashë, propozoj që së bashku me përfaqësuesit e grupeve parlamentare të hartojmë një rezolutë lidhur me këtë çështje, e cila natyrisht do të votohet në këtë Kuvend.

Qëllimi i kësaj rezolute është që të detyrojë Qeverinë që reciprocitetin ta përdorë ndër të tjera si masë për disiplinimin e sjelljeve të Serbisë karshi Kosovës, si dhe vegël për përmirësimin e pozitës negociuese të Kosovës në dialogun me Serbinë.

Pjesë e kësaj rezolute të jetë të jetë edhe detyrimi për bashkëpunim të ngushtë me miqtë tanë ndërkombëtare me qëllim që zbatimi i reciprocitetit të ketë mbështetje të plotë si brenda ashtu edhe nga jashtë.

Ajo që e kemi parë deri sot është një tendencë nga kryeministri që me veprime ad hoc të implementojë masa me qëllim të mbulimit të skandaleve të njëpasnjëshme të kësaj Qeverie.

Nuk është çudi që në këtë vijë e kanë lënë vetëm edhe partnerët e këtij koalicioni, por çka është më keq, duke vepruar pa ndonjë analizë apo koordinim, me këto veprime ka acaruar marrëdhëniet edhe miqtë tanë më të mirë që kanë qëndruar krah Kosovës edhe në momentet më të vështira të saj. Kjo nuk guxon të ndodhë.

Prandaj, është përgjegjësi e jona si deputetë dhe si Kuvend që të kalojmë sot apo në mundësinë e parë një rezolutë e cila ndër të tjera kërkon analizë të mirëfilltë dhe të thellë të procesit si implementimi i një reciprocitetit të plotë ndaj Serbisë, përfshirë këtu edhe masat e nevojshme për zëvendësimin e produkteve me origjinë nga Serbia, krijimin e një komisioni ndoshta ndërinstucional që përcjellë veprimet antagoniste të Serbisë, lehtësira për prodhuesit vendor, afat të shkurtra tranzitore për kompanitë e mëdha transnacionale që mund të ndikohen, ndëshkimet për cenuesit e reciprocitetit e kështu me radhë.

Shpresoj që diskutimet sot, sado që prezenca e deputetëve është e mangët na ofrojnë bazë të mjaftueshme për hartimin e një rezolute të tillë e cila më pastaj do të bëhet udhërrëfyesi i

ekzekutivit lidhur me ndërmarrjen e masave reciproke për çdo veprim antagonist të Serbisë ndaj nesh. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Radha është e grupeve parlamentare. Në emër të LDK-së është paraqitur Armend Zemaj.

**ARMEND ZEMAJ:** Faleminderit!

Kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e ka analizuar dhe e ka shqyrtuar kërkesën e tillë për debat parlamentar si diçka e cila jo rrallëherë ka qenë edhe pjesë e debateve edhe politike, por edhe ngjarje që janë zhvilluar në raportin e brendshëm, por edhe në raportin me shtetin fqinjë.

Shtetin i cili akoma mbanë pozicion armiqësor ndaj Republikës së Kosovës, konkretisht Serbia.

Andaj, në emër të deputetëve të LDK-së pa dashur të hyjë në analiza, sepse pothuajse në tërësi u elaborua në mënyrë të saktë nga parashtruesi i debatit, zoti Korab Sejdiu dhe i përkrahur nga deputetët tjerë i japim përkrahje arsyetimit të paraqitur dhe nevojës që të kemi vendosje të masave të reciprocitetit në raport me shtetin fqinjë. Shtetin i cili çdo ditë shfaqë agresion edhe politik edhe ekonomik edhe në aspektin e pengesa të relacioneve apo të fuqizimit të subjektivitetit ndërkombëtar të Republikës së Kosovës, Serbisë. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zoti Memli Krasniqi, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së.

**MEMLI KRASNIQI:** Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Të them të drejtën, unë besoj që do të jem goxha i shkurtër sepse edhe serioziteti i kësaj seance për fat të keq nuk është në nivelin e duhur. Deri diku unë mendoj që edhe serioziteti i kërkesës për këtë debat nuk është në nivelin e duhur.

Është një kërkesë e tejkaluar tashmë, kur kihet parasysh që kërkesa është që t'i vendosen sanksione ekonomike Serbisë, gjë që ka ndodhur tash e gati gjashtë muaj.

Unë i dëgjova me vëmendje edhe propozuesin, po me më shumë vëmendje e dëgjova përfaqësuesin e LDK-së, sepse kërkesat që i dëgjova nga propozuesi disi, së paku krahasuar me deklaratimet publike të LDK-së, ishin një diskrepancë goxha të madhe.

Së paku nga deklaratimet zyrtare që i kemi parë në komunikata për shtyp e kështu me radhë.

Por, sidoqoftë për fat të keq ndonjëherë këtu në Kuvend, deputetët flasin ata çka ju duket për momentin e popullarizuar e jo atë çka e mendojnë apo cili është qëndrimi zyrtar.

Sido që të jetë për sa i përket qëndrimit tonë, çfarëdo debati që ndërlihet me këtë çështje, konsiderojmë që duhet ta ketë një nivel më të mirë, edhe të përgatitjes dhe të seriozitetit.

Rezoluta mund të përgatit, mund të dakordohet ose jo, por ajo që duhet ta theksojmë është se këto janë kompetenca që i ka Qeveria e Republikës së Kosovës e cila këto kompetenca tashmë i ka zbatuar.

Ju e dini që Qeveria i ka vendosur një taksë, tarifë doganore mallrave që vijnë nga Serbia edhe nga Bosnja e Hercegovina që nuk trajtohet në këtë kërkesë ky shtet i dytë, fillimisht prej 10% dhe pastaj është ngritur në 100%.

Nëse ky nuk është sanksion ekonomik, atëherë unë definitivisht nuk e di se çfarë janë sanksionet ekonomike. Dhe kjo është arsyeja që po e shoh si të tejkaluar në kuptimin kohor këtë debat.

E tash, nëse ka ndonjë kërkesë tjetër më eksplicite siç u tha për masën e reciprocitetit, ne besoj që duhet të jemi të hapur që ta diskutojmë. Ta përfshijmë ndoshta në rezolutë e pastaj ta lëmë atë si rekomandim për Qeverinë e Republikës së Kosovës që të vendosë.

Tarifa doganore e cila është vendosur muaj më parë, pa dyshim që ka pasur një impakt ekonomik, por mbi të gjitha ne të gjithë e dimë që vendosja e tarifës ka pasur një impakt politik dhe ka ardhur edhe ashtu si reagim ndaj politikës agresive të Republikës së Serbisë ndaj Republikës së Kosovës, jo vetëm në frontin diplomatik dhe atë ndërkombëtar, por edhe në fusha të tjera të cilat ndërlihen edhe me disa nga marrëveshjet të cilat nënshkruar në Bruksel dhe nuk janë zbatuar nga ana e Serbisë.

Si i tillë, ky vendim ka qenë vendim i drejtë. Një vendim i cili besoj e ka fuqizuar Kosovën dhe e ka dhënë mesazhin e duhur para së gjithash ndaj Serbisë si agresor në këtë raport mes dy shteteve.

Qëndrimet dhe deklaratimet për këtë çështje besoj se kanë qenë të numërta. Secili prej nesh, jo vetëm këtu, po besoj që edhe qytetarët e Kosovës e dinë se kush çka mendon. Por, meqenëse ne e filluam këtë debat, unë shpresoj që debati të nxjerrë diçka, shpresoj substanciale dhe siç e thashë, nëse ka hapësirë për ta dakorduar një rezolutë, ne do të jemi këtu.

Draftrezolutë nuk kemi. Të paktën në materiale nuk e kemi marrë një draftrezolutë siç e do rendi kur ka propozime të tilla, por nëse një gjë e tillë vjen, mund ta trajtojmë e ta diskutojmë bashkë edhe me kolegët nga grupet tjera parlamentare. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zoti Sveçla e ka fjalën.

XHELAL SVEÇLA: Faleminderit!

Po më vjen mirë që reciprociteti në raportet mes Kosovës dhe Serbisë po bëhet temë dhe kërkesë për të gjitha subjektet në Parlamentin e Kosovës.

U dashen të kalojnë disa vite, qindra arrestime e besa-besë edhe rrahje të aktivistëve të Lëvizjes vetëvendosje, por edhe miliona e miliona humbje në financa të Kosovës së varfër, e dështime të panumërta politike që logjike e barazisë mes shtetit të Kosovës edhe shtetit të Serbisë të mbizotërojë.

Nëse e përcjell tregun në Kosovë, sasinë e mallrave serbe në raftet e shitoreve gjithandej, por edhe çmimet e këtyre produkteve, kuptohet masa me taksën 100% nuk është e mjaftueshme. Lirisht mund të themi se pothuajse është e dështuar, duke e pasur parasysh që ne si Lëvizje Vetëvendosje në asnjë moment nuk dëshirojmë që të keqkuptohemi, domethënë ne e përkrahim taksën momentale e cila nuk mjafton për shkak edhe të dështimit në implementim, por edhe për shkak të nivelit që ajo prek.

Ne mendojmë dhe kërkojmë që të ketë reciprocitet të plotë në raportet mes Kosovës dhe Serbisë, të çfarëdo lloji dhe kjo është e vetmja mënyrë që ne të fillojmë të shihemi si një shtet i barabartë me Serbinë, por edhe me shtet në rajon.

Besoj se është e udhës që pari ne këtu në Parlament ta shohim e këtë ta ndiejnë edhe qytetarët e Kosovës dhe pastaj si të këtyrë të na pranojnë edhe të gjithë përreth.

Prandaj, çfarëdo iniciative që shkon në drejtim të reciprocitetit të plotë mes Kosovës dhe Serbisë, ne si Lëvizje Vetëvendosje e përkrahim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Ahmet Isufi.

AHMET ISUFI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Konsideroj se kjo kërkesë për debat lidhur me embargon dhe sanksionet që duhet t'i vihen Serbisë është e vonuar për shkak se është thirr me 9 nëntor 2018 e tani jemi më 12 prill të vitit 2019.

Sidomos kur kihet parasysh se Qeveria ka ndërmarrë veprimet e veta duke vënë tarifën qind për qind ndaj Serbisë, e plotëson këtë kërkesë duke e bërë një embargo në kuptimin e ekonomisë.

Në tjetrën anë, nëse thuhet se kjo embargo dhe kjo mënyrë e sanksioneve që duhet vënë Serbisë është mirë dhe duhet të ndodhë, atëherë pse kërkohet nga zoti Haradinaj si kryeministër i

Republikës së Kosovës që ta tërheq taksën ose madje të thuhet që po na i prishë marrëdhëniet edhe me ndërkombëtarët.

Nëse do ta bënim këtë tash, sikur të mos ishte taksa qind për qind, çka do t'i binte? Do t'i binte që do duhej të tërhiqej embargoja, të tërhiqeshin sanksionet, sepse po e kërkojnë ndërkombëtarët. Kështu do ta arsyetonte pikërisht edhe iniciuesi edhe të tjerët të cilët në vazhdimësi kanë kërkuar që të pezullohet ose të hiqet taksa ndaj Serbisë.

Nuk është mirë që të përdoren vetëm për interesa politike këto debate dhe këto seanca të jashtëzakonshme, por përkundrazi duhet ta kenë bazën e plotë se kur merren vendimet duhet edhe të qëndrohet prapa tyre.

Kryeministri Haradinaj dhe Qeveria e Kosovës e kanë marrë vendimin e mbajnë ende në fuqi nuk do at heqin, sepse është e drejtë sovrane e shtetit të Kosovës që të marrë vendime të cilat janë në interesin e qytetarëve të Kosovës dhe i kundërvihen politikës agresore të Serbisë e cila sidomos në diplomaci dhe në ndërhyrje në territorin e Kosovës duke manipuluar edhe me popullatën serbe në Kosovë, po dëshiron ta stabilizojë Kosovën.

Prandaj, konsideroj që mund të bëhet ndonjë rezolutë, por s' di çka mund t'i shtojmë kësaj përveç se kisha kërkuar edhe nga iniciuesi edhe nga partitë politike të cilat po e përkrahin këtë kërkesë, ta përkrahin taksën qind për qind, madje edhe veprimet tjera të cilat çojnë në reciprocitet, por të mos i tërheqin fjalët pastaj. Të qëndrojnë prapa vendimit kur merret në Qeveri dhe të mos bëjnë prapa ktheu. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zoti Salih Salihu e ka fjalën.

**SALIH SALIHU:** Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Edhe PSD-ja e ka shqyrtuar qysh në momentin kur e kemi nënshkruar kërkesën e kolegut Sejdiu për një rezolutë për debatin lidhur me reciprocitet të plotë apo sanksione ekonomike ndaj Serbisë.

Në parim ne e përkrahim, mbas dhe i kemi lexuar të gjitha pikat që janë qitur në rezolutë dhe unë mendoj që duhet përkrahur nga të gjitha subjektet politike, për faktin që e kemi një shembull, ku vetëm taksa 100% efektin ekonomik brenda Kosovës, nuk po flas për efektin negativ ekonomik në Serbi.



Mbase nuk më duket se përbën ndonjë shumë të madhe në Serbi për sa i përket eksportit, duke e pasur parasysh faktin se Serbia në fakt eksporton diku 80 miliardë euro, ndërkaq në Kosovë diku nga 3 deri në 4 % të eksportit të përgjithshëm që e bën Serbia.

Pra, për Serbinë më tepër është ndoshta një lojë politike që e bën dhe na qet në këtë pikë se Kosova nuk po e heq taksën dhe nuk mund të fillojmë dialogun. Ndërkaq për Kosovën përbën një masë shumë të rëndësishme, sepse kemi vërejtur një zhvillim shumë të madh të prodhimit të vendor brenda Kosovës dhe ju e dini që çdo ditë nëpër media dëgjojmë prodhuesit vendor që janë shumë të kënaqur sepse ka filluar të shitet prodhimi vendor.

Prandaj, si e tillë mbase taksa 100% e fatkeqësisht këtu ka edhe liderë politik, madje edhe presidenti që në vend që të jenë unik ndoshta me qëndrimin e kryeministrit, ata bëjnë presion bashkë me Serbinë dhe me disa shtete të tjera mike i bëjnë thjesht presion kryeministrit tonë që për herë të parë ndoshta është vënë një taksë, e që tregon se ne jemi shtet në këtë rast në raport me Serbinë.

Do duhej që në këtë rast, mbase Serbia po bën presion politik me vendet tjera mike ndaj Kosovës, ndaj kryeministrit, pra do duhej që të gjithë liderët e Kosovës, të gjithë liderët e partive politike, por edhe presidenti të bëhen të gjithë së bashku dhe të kthejnë kërkesën nga BE-ja, nga vendet e BE-së dhe nga SHBA-ja që të nisë presioni ndaj Serbisë.

Do duhej të bëhej e gjithë kjo në mënyrë që Serbia ta nisë dialogun dhe në rrugëtim e sipër gjatë dialogut, në qoftë se vërehet se ka përafrim të qëndrime që në fund do të rezultojë me njohje të ndërsjellë, atëherë shumë shpejt mund të suspendohet edhe taksa 100% dhe do të hiqen edhe masat tjera.

Përndryshe, nuk kemi kurrfarë interesi dhe është keq që ta humbim qysh në start lojën, lerë më që nuk duhet larguar taksën, por ne do duhej që ndoshta të shtojmë masa të tjera reciprociteti. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zoti Sherifi e ka fjalën.

**BILALL SHERIFI:** Faleminderit, zoti nënkryetar!

Duke e falënderuar Korabin dhe deputetët tjerë nënshkrues që kanë sjellë këtë temë edhe pse pak me vonesë ka arritur, më lejoni të them që taksa do të mbetet vendim i moderuar dhe besoni kryeministri dhe Qeveria do të ndjehen shumë mirë nëse kalojmë një rezolutë të tillë, sepse do të bjerë presioni për heqjen e taksës.

Se çka u kërkuar këtu, çka dëgjova që u kërkua këtu është reciprocitet i plotë. Që të harrohet presioni mbi taksën, që të harrohet kërkesa që të hiqet taksa duhet ta miratojmë këtë rezolutë dhe

unë prej tash ia siguroj Lidhjes Demokratike të Kosovë, Vetëvendosjes, Korabit si bartës i kësaj iniciative, votat e Nismës.

Nëse do që ta harrosh një veprim të vogël, atëherë bëjeni një të madh. Ky veprimi, rezoluta ku kërkohet reciprocitet i plotë bën që të zbutet madje të duket i moderuar vendimi për taksën 100%.

Mirëpo, e kam një kërkesë modeste. Nëse rastësisht kalon kjo rezolutë edhe pastaj merret vendimi në Qeveri, mos thoni pastaj se ky vendim u mor për ta mbuluar një skandal. Pra, të jemi korrektë.

Edhe kërkoni vendime të forta dhe pastaj të thoni, po e mori këtë vendim patriotik, këtë gjest patriotik, sepse e paska bërë Qeveria një skandal diku, atëherë është hipokrizi. Kjo pastaj hyn në rangun e hipokrizive “Creme de la Creme”.

Pra, keni mbështetjen e deputetëve që të shkojmë me një rezolutë, ku i vendoset reciprocitet i plotë Republikës së Serbisë deri sa ajo ta ndalë agresionin mbi Republikën e Kosovës, qoftë atë diplomatike. Të ndalë agresionin qoftë nëpërmjet strukturave të saj prezentë në Kosovë, qofshin ato politike, të drejtësisë, të sigurisë.

Natyrisht, të mos harroni se kësaj duhet t’i shtohet që rezoluta apo vendimet pastaj tërhiqen kur Republika e Serbisë ta njohë Republikën e Kosovës. E siç tha kolegu Ahmet Isufi, nuk po ia përmend për replikë, po veç po i referohem, s’ka pastaj të thuhet; ngadalë se po prishen këtu ose po prishen aty marrëdhëniet.

Duhet t’u qëndrojmë deri në fund vendimeve që i marrim. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Fjalën e ka zoti Nait Hasani.

**NAIT HASANI:** Faleminderit, nënkryetar!

Çështja e reciprocitetit me Serbinë është çështje që do duhej herët të vendosej, por kjo vendosje e taksës nuk them se e ka arritur një qëllim politik, po Serbisë mund të them edhe ndaj ajrit duhet t’i vëmë taksë, që të mos e lëmë të thithë ajër.

Serbia meriton, jo vetëm këto sanksione, po shumë e shumë të tjera. Së pari ajo nuk ka kërkuar asnjë falje për krimet dhe gjenocidin që e ka bërë në Kosovë. Prandaj, taksa është masë e vogël në raport me krimet dhe dëmet që i ka bërë dhe i bën Serbia.

Sikur të isha unë kryeministër, Serbisë do i kisha vërë taksë edhe për ajër që të mos mundte të thithë as ajër. Prandaj, zbatimin e kisha vendosur në oksigjen dhe e kisha lënë pa oksigjen. Pra,

ndaj Serbisë duhet të vendoset çdo taksë që të detyrohet të heqë dorë nga masat që po i merr dhe dëmet që po ia bën Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Para se t'ua japë fjalën të tjerëve, unë dua që t'i ftoj deputetët e Partisë Socialdemokrate si nënshkrues të kërkesës për debat që të vijë në seancë ose ne mbajmë pa qenë ata prezent hiq. Faleminderit!

Fjalën e ka zoti Sami Kurteshi.

SAMI KURTESHI: Faleminderit, zoti kryesues!

Çështja e reciprocitetit, në të vërtetë është një çështje të cilën Lëvizja Vetëvendosje në mënyrë parimore e ka ngritur para shumë e shumë vitesh, dhe nuk kufizohet vetëm me një taksë.

Nëse partitë e pozitës mendojnë se e përkrahim ose s'e përkrahim taksën, në të vërtetë taksa për mallrat serbe realisht ka qenë e papërgatitur mirë. Mirëpo, ne si Lëvizje Vetëvendosje e kemi përkrahur dhe e përkrahim edhe sot, sepse është njëri ndër veprimet që moti do të duhej ta ndërmernte Republika e Kosovës, vërtet nuk po e teproj nëse them se, zoti Sveçla e përmendi, aktivistët e Lëvizjes Vetëvendosje janë burgosur, janë arrestuar, janë torturuar edhe në mënyrë më të poshtër prej qarqeve të caktuara kriminale të policisë, në krye me kriminelin e tyre, Shpend Maxhunin, madje u është thënë: "A ju po na mësoni neve", e u është thyer këmba e krahu për reciprocitetin.

Kërkesa për reciprocitetin nuk ka të bëjë vetëm me taksën, ka të bëjë me të gjitha çështjet që hyjnë dhe janë pjesë e relacioneve mes dy shteteve.

Parimi, koncepti i reciprocitetit, vërtet edhe respektimi i këtij parimi tregon se dy shtete janë të barabarta, kjo ka të bëjë edhe me njohjen e dokumenteve, me njohjen e vendimeve gjyqësore, me njohjen e vulave në dogana, me njohjen e targave të veturave që hyjnë në Kosovë me targa serbe, e Serbia ende sot nuk i lejon.

Me njohjen e delegacioneve, me pranimin e delegacioneve, delegacionet serbe shkojnë aq larg, sepse ne jemi treguar inferiorë dhe nuk kemi kërkuar reciprocitetin, në takimet multilaterale çohen prej sallave për të mos pranuar të ulen me delegacionin e Kosovës.

Neve nuk na pranohen as dokumentet, tash e keni parë ju qysh me dokumente të prodhimeve kosovare "Republika e Kosovës" nuk ke mundur t'i dërgosh mallrat në territorin e Serbisë. Këto janë vetëm disa nga masat. Po një masë që do të duhej, e përmenda pak më herët, që do të duhej të ishte e domosdoshme si masë e reciprocitetit është kthimi i pronave të vjedhura të shtetasve të Republikës së Kosovës nga Republika e Serbisë, edhe ato janë pensionet. Nuk ka asnjë bisedim me Serbinë pa e kthyer pronën.

Kjo është masë e reciprocitetit, nuk është masa veç 100 milionë apo 200 milionë me mallra, e të bëhet mandej presion që të hiqet ajo se vërtet taksa nuk ka qenë masë e reciprocitetit, po ka qenë një veprim që është marrë emocionalisht me një moment të caktuar.

Nuk po themi që është i keq, po nuk është masë e vetme që e mbulon konceptin e reciprocitetit.

Ne kemi edhe çështje të tjera që do të duhej të merreshin parasysht, në të vërtetë, çdo veprim midis dy shteteve, a na pranon Republika e Serbisë a s'na pranon, ajo hiç nuk ka rëndësi, ata s'na pranojnë, ne s'i pranojmë, ky është reciprocitet. Po në çdo veprim tjetër që ka karakter objektiv Republika e Kosovës ka mundësi, e ka të drejtën e mund ta vërë ose ta zbatojë masën e reciprocitetit ndaj Serbisë, ndaj çdo gjëje, çdo veprim i Serbisë mund të përcillet me masa reciprociteti nga Republika e Kosovës, kjo është kërkesa themelore, unë mendoj thelbi i asaj që po kërkojmë me rezolutën, edhe këtu nuk ka tërheqje.

Nuk ka vend në botë, nuk ka institucion në botë që do ta vinte nën presion Republikën e Kosovës, nëse Republika e Kosovës thotë ne po e zbatojmë vetëm masën e reciprocitetit në raport me një vend, qysh e zbatojmë në raport me çdo vend tjetër. Kjo është ajo kërkesa themelore.

Prandaj, unë u bëj ftesë të gjithë deputetëve, kolegeve dhe kolegëve, votoni një rezolutë që kërkon diçka që është e mbështetur edhe në të drejtën ndërkombëtare, edhe publike, e besa edhe kur të na vijë edhe Ligji për të drejtën ndërkombëtare private, edhe aty, ju lutem, pranoni parimin e reciprocitetit që mundet dhe është e domosdoshme ta ketë Republika e Kosovës me çdo vend tjetër në botë. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Fjalën e ka zoti Nitaj.

**MUHARREM NITAJ:** Faleminderit, nënkryetar!

Nuk po dua të përsëritëm, se i thanë shumicën e gjërave kolegët, edhe Isufi, edhe Sherifi, edhe të tjerët, mirëpo unë realisht i kam disa paqartësi, nuk e kam shumë të qartë nëse po flasim për reciprocitetin me Serbinë apo për diçka tjetër.

E dëgjova me vëmendjen kolegun Sejdiu, i cili flet për një embargo të plotë ekonomike dhe politike, edhe kundërthënia në pohimet e zotit Sejdiu është që ai propozon edhe embargo të plotë ekonomike dhe politike ndaj Serbisë, dhe njëkohësisht thotë se këtë duhet ta bëjmë në koordinim të plotë me partnerët dhe miqtë ndërkombëtarë.

Realisht zoti Sejdiu dhe gjithë ju të tjerët e dini që ne edhe për taksën 100% kemi pasur bukur presion edhe nga partnerët, edhe nga miqtë ndërkombëtarë që ta heqim qoftë nga Brukseli, në raste të caktuara edhe nga Uashingtoni dhe unë nuk e di nëse zoti Sejdiu, në fakt, i ka zhvilluar

debatet, diskutimet ose është koordinuar me partnerët ndërkombëtarë në kohën që po e nxjerr një propozim për miratimin e një rezolute për embargo të plotë ekonomike dhe politike ndaj Serbisë.

Nëse arsyet janë të forta për ta miratuar një rezolutë të tillë, unë nuk kam fare problem që ta votoj, mirëpo unë do të frikohem se menjëherë, sapo ta miratojmë një rezolutë të tillë, do të fillojnë që të tërhiqen njëri pas tjetrit të gjithë kolegët deputetë edhe të partive të tyre edhe të thonë që kjo masë kaq drastike ndaj Serbisë, që është shumë e ashpër se sa taksa 100%, në fakt duhet të hiqet, sepse ne po e prishim partneritetin me ndërkombëtarët.

Prandaj, zoti Korab Sejdiu, ju lutem që ta sqaroni çfarë po kërkon nga Kuvendi i Kosovës, të miratojë një rezolutë për embargo të plotë ekonomike dhe politike, a i keni kryer diskutimet e partnerët ndërkombëtarë që të mos na vini në situatë që sapo ta miratojmë rezolutën, në fund të thoni 'jo se nuk i kishim pas kryer diskutimet me ta' dhe të mos vini në situatë që edhe ashtu taksën 100% ta cilësoni si një masë ad hoc të kryeministrit të Kosovës.

Ju nuk keni sjellë një propozim rezolutë, ju keni sjellë një dokument për arsye të miratimit të një rezolute dhe ju do të duhej që në këtë dokument t'i kishit propozimet konkrete, se çfarë kërkon taksativisht nga deputetët e Kuvendit të Kosovës.

Nëse është e mundur të na jepni sqarimet që mungojnë. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zoti Arbër Rexhaj e ka fjalën.

**ARBËR REXHAJ:** Faleminderit! Çështja e debatit të sotëm për reciprocitet të plotë tregtar e politik me Serbinë, sigurisht një temë e vjetër e Lëvizjes Vetëvendosje, dhe ju kujtohet që më 7 dhjetor 2011, e mërkurë, Lëvizja Vetëvendosje, po e lexoj, në bazë të nenit 44, paragrafi 4, pika 2 e Rregullores së Kuvendit, Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje fton deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës të votojnë mocionin me rekomandimet në vijim, pra, bëhet fjalë për vitin 2011.

1. Qeveria t'i marrë masat e reciprocitetit të plotë politik, ekonomik e tregtar ndaj Serbisë.
2. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë ta nxisë dhe ta udhëheqë bashkëpunimin me prodhuesit vendorë dhe ndërmarrjet tregtare për gjetjen e zëvendësimeve për produktet e importuara nga Serbia.
3. Qeveria t'i forcojë të gjitha mekanizmat shtetërorë për ta siguruar zbatimin e përpiktë të masave të reciprocitetit ndaj Serbisë.

Po flasim për vitin 2011.

Dhe, këtu pa dashur përnjëmend të replikoj me Naitin, i cili tha se ndaj Serbisë duhet të vendoset reciprocitet edhe ndaj ajrit, a ju kujtohet kur ne si Lëvizje Vetëvendosje, në mbrojtje të kësaj rezolute patëm organizuar protestë te Dheu i Bardhë, edhe në Merdar, me ç'rast aktivistët e Lëvizjes Vetëvendosje patën pësuar rrahje deri në arrestime e burgosje, e njëri prej tyre, e shumë prej këtyre këtu mbrapa që i kemi deputetë, kemi qenë edhe ne të arrestuar.

Pra, sa vjet kanë kaluar që atëherë që Lëvizja Vetëvendosje ju ka bërë thirrje juve si Qeveri edhe e atëhershme që të merrni masa për reciprocitet të plotë, edhe ekonomik, edhe politik ndaj Serbisë.

Në rregull, ne kemi qenë pro taksës 100%, vazhdojmë të jemi pro, mirëpo, jemi pra që plus kësaj mase, të shtohet edhe reciprociteti i plotë me Serbinë.

Duke mos harrua këtu, pra edhe çështjen e teksteve shkollore në Luginë, pra në Kosovën Lindore.

Kur flasim me kaq patetizma patriotikë, pa harruar këtë objektivizmin politik, të cilën e kemi parashtruar ne përherë, ju po harroni që keni ngritur një taksë, e cila ka qenë e ndërtuar aty për aty mbi baza të aspektit elektorale, keni nisur me 10%, e keni ngritur në 20, pastaj keni shkuar 30%, 50 e më në fund keni shkuar 100.

Edhe më pastaj këtë e keni kthyer në gara personale, po megjithatë ne si Lëvizje Vetëvendosje e mbështesim këtë taksë, mirëpo megjithatë kërkojmë që kësaj t'i shtohet edhe masa e reciprocitetit.

Këtu u tha që kjo masë kur të vihet, pra harrohet dhe lihet në harresë, megjithatë ulet edhe presioni për taksën. Jo, në asnjë mënyrë, ne mendojmë që e vetmja formë që Serbia ta njohë megjithatë ekzistencën e shtetit të Republikës së Kosovës është shtimi edhe i reciprocitetit.

Taksa pa reciprocitet nuk bën, dhe se ky Kuvend këtu duhet ta marrë atë masë.

Është mirë që të shihen edhe votat e deputetëve, të cilët kanë votuar kundër kësaj rezolute të Lëvizjes Vetëvendosje, e cila pati kaluar në protesta dhe në dhunë ndaj aktivistëve dhe qytetarëve të Republikës së Kosovës, sepse ata dhjetëra e mijëra vetë nuk kanë qenë vetëm aktivistë të Lëvizjes Vetëvendosje, kanë qenë qytetarë, të cilët kanë dalë ta mbrojnë një vendim, pra një rezolutë të Kuvendit, e që më pastaj përqeshej nga deputetët e PDK-së dhe të tjerëve, të cilët ishin kundër reciprocitetit.

Po flasim për një kohë para disa viteve dhe këtu po dëgjoj deputetë, të cilët sot e përkrahin këtë masë të reciprocitetit.

Pse sot? Pra, pse sot përkrahet kjo masë e reciprocitetit, pse më herët kur ka qenë koha e duhur për vendime, të cilat na kishin ndihmuar edhe në konsistencë kohore, edhe në rrjedha politike, po ashtu edhe në këtë dialogun e shtërkëqur, të cilin e keni, pse atëherë nuk është vendosur dhe sot do të ishte një kurs tjetër i politikës nacionale. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Shkumbin Demalijaj e ka fjalën.

SHKUMBIN DEMALIJAJ: Faleminderit, kryesues!

E mbështesim deputetin Korab Sejdiu dhe të gjithë deputetët nënshkrues të kësaj iniciative që është mbështetje për taksën 100% e ndërmarrë nga Qeveria e Kosovës, dhe kisha pasur dëshirë të jenë të gjithë deputetët e Kuvendit të Kosovës këtu edhe ta votojnë këtë rezolutë të propozuar nga ky grup iniciues në krye me deputetin Sejdiu.

Për historikun edhe për të na treguar histori e kopalla, nuk po na intereson shumë, se tash mund të mbrohet taksë dhe kufiri shtetëror, sepse e kemi vendim qeveritar, e jo vendime që merren nëpër qoshe edhe nëpër skuta të ndryshme anekënd Kosovës, po kur ka vendim shtetëror, atëherë duhet të mbrohet, kur nuk ka vendim edhe është e jashtëligjshme, gjithçka duhet të jenë në frymën e sundimit të ligjit dhe të gjitha veprimet ilegale duhet të ndëshkohen nga shteti i Kosovës.

E mbështetim këtë iniciativë, presim të votohet rezoluta.

KRYESUESI: Faleminderit! Replikë, po nuk ta ka përmendur emrin. Arbër Rexhaj, replikë.

ARBËR REXHAJ: Nuk e di unë a me kopalla dhe me këtë gjuhë, e cila nuk është parlamentare, po unë po dua pak t'i përmend edhe votat e asaj rezolute, sepse nuk kanë qenë kopalla.

Pra, po e them që komplet Grupi Parlamentar i PDK-së ka votuar, për jo.

Këtu po thotë që Grupi Parlamentar i LDK-së në masë të madhe paska votuar për.

Grupi i AAK-së paska votuar për, e ky po i thotë rezolutës së vet, të propozuar nga Lëvizja Vetëvendosje, të cilën e ka votuar partia e vet kopallë, unë nuk po mund ta kuptoj këtë qasje të tij dhe s'po hyj në vota të tjerëve.

Po, po dua të them që po ta kishit dëgjuar Lëvizjen Vetëvendosje me kohë, sot do të gjendeshim një pozicion më të qartë edhe gjeopolitik, por edhe kombëtar brenda instancave kohore në të cilat gjendemi.

Prandaj, jemi pro taksës 100 për qind, po e përsëris edhe një herë, taksës 100 për qind duhet t'i shtohet edhe masa e reciprocitetit, e cila nënkupton masë të plotë tregtare dhe politike.

KRYESUESI: Kundër-replikë, zoti Demaliaj.

SHKUMBIN DEMALIAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Edhe një herë po i them se krejt çka po flet deputeti i nderuar janë kopalla, jo vendimit edhe rezolutës, sepse ato janë votuar në Kuvendin e Kosovës, po na tregon histori të trishta sikurse janë dhunuar nga shteti. Kur nuk ka pasur vendim shtetëror, kur nuk ka mekanizëm shtetëror, nuk ka diçka ligjore, ato të gjitha janë të jashtëligjshme dhe janë të dënueshme.

Sot e kemi mundësinë. Faleminderit që po e përkrahni taksën dhe vendimin shtetëror, edhe atëherë 100 për qind e kemi përkrahur edhe si Aleancë, edhe pse s'kam qenë deputet.

Bile edhe unë jam arrestuar, po s'po vajtoj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Milaim Zeka e ka fjalën.

MILAIM ZEKA: Faleminderit, kryesues!

Unë sinqerisht kam menduar që kemi ardhur të debatojmë për ta hequr taksën, tash na doli një bela krejt tjetër, po më duket si plot deputetë çka shohin ëndrra natën, hajde të bëjmë debat. Ky ka qenë debat për studio televizive, një i PSD-së, një i Nismës, një i asaj, një i kësaj. Nuk udhëhiqet bre shteti me ëndrra të natës, i teket dikujt, për shembull, këqyr ti, Naiti tha t'i ndalohet edhe ajri Serbisë e tash unë them hajde të prodhojmë qebe, se veç me qebe të ushtrisë mund t'ia ndalojmë ajrin.

Ne po diskutojmë shpeshherë gjëra koti, pa bërë analiza të shtetit, marrëdhënie ndërkombëtare, pa u konsultuar me faktorin ndërkombëtar. Këto rezoluta nuk prodhojnë asgjë, sepse rezolutat e Kuvendit të Republikës së Kosovës janë vetëm këshilla. Pse nuk po e themi një të vërtetë.

Ne kemi nxjerrë rezoluta për hapjen e kufirit pa kontroll me Shqipërinë dhe, ju lutem, shkoni në Morinë e shikoni kufirin Kosovë-Shqipëri duke pritur me orë të tëra njerëzit të hyjnë në atë anë.

Ne nuk kemi qenë në gjendje të debatojmë, për shembull, pse u vu taksë nga ana e Edi Ramës, 5 euro andej e 5 euro këndej. Mua po më duket ku debat është sikur e miu e kruan elefantin. Tash patriotizëm ka qenë koha e luftës, të gjithë njerëzit e kanë treguar patriotizmin në kohën e luftës, sot është patriotizëm ne të ndërtojmë shtetin e Kosovës, të mos i fëlliqim lumenjtë, të mos i presim drunjtë dhe ne si deputetë t'i edukojmë qytetarët që të mos blejnë mall serb. Ajo është tjetër muhabet.



Po mua po ma merr mendja që PSD-ja fort ia ka huq sot dhe seriozisht unë kam menduar se po e nxjerrim një rekomandim dhe po i themi Qeverisë që ta heqë taksën kah qershori, a unë personalisht, publikisht po e them se kurrë s'e votoj këtë rezolutë, se është hajgare, unë hajgare nuk kam ardhur të bëj në Parlament.

KRYESUESI: Zoti Nait Hasani, replikë.

NAIT HASANI: Faleminderit, nënkryetar!

Por që e 'ka huq' Milaimi sot, e 'ka huq' këtu, se i ka 'përzie kabllat'. Po më vjen keq, unë thashë ajrin ia kisha ndaluar, po megjithatë po them, prapë ia kisha ndaluar, po them, ia kisha ndaluar ajrin. Ndërsa kufirin me Serbinë po të kisha mundësi e kisha bërë murin sikur Trampi me Meksikën.

Në asnjë moment nuk kisha hequr dorë pa e vendosur një mur, edhe muri kinez më duket i vogël.

Prandaj, ndaj Serbisë nuk duhet lëshohet pe në asnjë mënyrë. 20 vjet u bënë, për asnjë krim nuk është gjykuar, 20 mijë viktima janë të vrarë në Kosovë, një milion njerëz të depërtuar, mbi 100 mijë shtëpi, objekte materiale janë të dëmtuara, të shkatërruara, e tash kërkojmë ne sanksione.

Edhe muri po t'i vihet Serbisë është pak. Faleminderit!

KRYESUESI: Diskutimet janë publike, po puna është që ne po duam të hyjmë në Bashkimin Evropian, e Bashkimi Evropian po thotë o ju fusim të gjithëve përnjëherë, o s'ju fusim hiç. Domethënë, gjashtë shtetet e Ballkani Perëndimor. Zoti Sali Zyra e ka fjalën.

SALI ZYBA: Faleminderit, kryesues!

Do të jem tepër i shkurtër, po s'mund të mos i përmend disa gjëra.

Duke pasur për bazë që kolegu ynë, Arbëri, e lexoi rezolutën, rezolutën e vitit 2011, e cila ishte propozuar prej Lëvizjes Vetëvendosje, ndërsa ishte shfuqizuar atëherë prej një mazhorance arrogante për kah numrat.

Andaj, theksin që e vure te kolegu Shkumbin Demaliaj, kur tha se është vetëm histori e kopalla, unë atëherë nuk kam qenë deputet, po kam qenë aktivist mundësisht sa më i devotshëm e i përkushtuar për këtë rezolutë, për të cilin ia kujtoj Shkumbin Demaliajt, kam qenë i arrestuar, kam qenë i dënua, i maltretuar nga një pushtet vendor, do të thotë nga një qeverisje e padrejtë e atëhershme, për të cilin ky i quan kopalla, po nuk është ashtu.

Ka qenë një angazhim, një përkushtim i Lëvizjes, ka qenë një qëndrim, ka qenë një kërkesë, një rezolutë, e cila ka qenë reciprocitet i plotë politik, ekonomik e tregtar me Serbinë.

Edhe taksën në fuqi tash, Lëvizja Vetëvendosje e mbështet, po nuk është e mjaftueshme në përshkrimin e gjerë dhe në fushat që i mbulon që i përmendën shumë prej kolegëve tanë.

Nëse mund t'i referohem fjalës së Naitit, kur tha se edhe ajrin ia kisha ndaluar Serbisë, të keni parasysh këtu, në reciprocitet të plotë politik, ekonomik e tregtar, edhe puna e ajrit është e përfshirë këtu. Serbia tashmë kohë shumë më parë na e ka ndaluar edhe ajrin neve. Ne vijmë ajrore nuk e kemi të lejuar nëpërmes Serbisë, kështu që edhe këtu hyn reciprociteti i plotë me Serbinë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk është shfuqizuar asnjë rezolutë nga Kuvendi i Kosovës, ato janë zbatuar ose nuk janë zbatuar, ato që nuk janë votuar, s'ka arritur të fitohen votat, është në rregull.

Nuk e di ndonjë rast që është shfuqizuar ndonjë rezolutë, nuk e di, unë nuk e di, e the, po unë nuk e di. Ndoshta ka ndodhur, po nuk është normale të shfuqizuar rezoluta kur të votohet. Parlamenti për moszbatueshmëri të rezolutës ka të drejtë t'i kërkojë llogari Qeverisë ose instancave për të cilat është bërë rezoluta.

KRYESUESI: Zoti Zeka, a ta ka përmendur emrin? Mirë!

MILAIM ZEKA: Kryetar faleminderit! Naiti tha "m'u kanë përzie kabllat", e këtij ia "kanë heq krejt kabllot prej shtekeri". Problemi është që ndoshta m'u kanë përzier kabllot, nuk ka rëndësi, por unë i kërkoj falje PSD-së, ata e paskan nënshkruar, po krejt fjala ime është adresuar te Korab Sejdiu. Unë kam respekt për Korabin dhe për çdo koleg këtu deputetë, por kësaj here s'ia ka qëlluar, se s'kemi pasur nevojë as këtë debat as të bëjmë rezolutë përderisa është një vendim.

Mirëpo, është mendimi im personal, a po ta dëgjojmë Naitin, ky bash ashtu, muri, veç kur të flasë me Trampin një ditë dhe të ndërtojë ndonjë muri, e atje pse iu ka prishur rruga për Opojë, ky s'po diskuton, po hajt. Nait, faleminderit!

KRYESUESI: Fjalën e ka zoti Haxhiu.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar ministër i Arsimit,

Të nderuar qytetarë,

Edhe pse seancat tona po vazhdojnë me një numër jo të madh të deputetëve, nuk janë tema këto edhe të parëndësishme, të cilat ne vetëm duhet t'i përdorim sa për të bërë ndonjë batutë ose për t'ia plotësuar apetitet elektoratit tonë.

Janë tema shumë më të mëdha se sa që kalojnë apetitet individuale dhe apetitet e subjekteve politike apo vetëm të një subjekti politik. Dhe, vërtet, edhe pse ky debat si i iniciuar kohë më parë nuk është se ka humbur relevancën e saj dhe aktualitetin, para së gjithash ne duhet dhe kemi përgjegjësi si deputetë interesin e shtetit. Dhe, ky interes i shtetit duhet të jetë prioriteti ynë, pavarësisht subjekteve politike nga vijnë dhe përdorimin e këtyre debateve për ta atakuar njërin apo tjetrin. Po ju bëj me dije se Partia Demokratike ka qenë, ashtu siç e dini, edhe propozuese e takës për 100%. Dhe, gjithsesi si politikanë e kemi për detyrë mbrojtjen e interesit shtetëror. Taksa dikush ka thënë që s'mund të rezistojë më shumë se 24 orë, dikush ka thënë as një muaj, dikush edhe më pak, pra taksa ka dhënë efektin e saj, por taksa nuk bën asnjëherë të përdoret kundër Kosovës.

Dhe, gjithsesi në politikë duhet të jemi edhe pragmatikë, edhe të veprohet për interesin e shtetit. Këtu i keni 10 pikat e kryetarit Kadri Veseli për taksën dhe embargon nëse nuk zbatohen ato. Dhe, unë propozoj që pikat e propozuara nga kryetari Kadri Veseli të jenë pjesë e rezolutës, edhe kemi për ta ndihmuar Qeverinë për të zgjidhur situatën aktuale sa i përket taksës, edhe e ndihmojmë vendin, sepse pastaj është vërtet embargo dhe reciprocitet i plotë me Serbinë në çdo fazë, por jo duke e ndëshkuar Kosovën, por duke e faktorizuar Kosovën. Ani se subjektet politike edhe në të kaluarën kanë pasur do iniciativa, ashtu qysh tha edhe kolegu më herët për reciprocitet, edhe prej asaj periudhës kur është protestuar për reciprocitet e deri në kohën e vendosjes së taksës 100% kanë qenë po të njëjtit biznesmenë të asaj partie që kanë vazhduar të bëjnë biznes me Serbinë, por lëreni këto çështje të partive politike për t'ia bërë apetitin, a për t'ia plotësuar dëshirën ndonjë votuesi të partisë atje, se janë të njëjtë deputetë që atëherë u kam thënë këtu në Parlament që, po, kanë biznes me Serbinë, kanë dalë në protesta, kanë protestuar për reciprocitet, kanë vazhduar deri në vendosjen e taksës 100% ta bëjnë atë biznes me Serbinë derisa është ndaluar prej Qeverisë.

Pra, nuk ka pasur ndonjë seriozitet sa i përket asaj, përveç një kauze politike, por nëse dëshirojmë vërtet të prodhojmë efekt në interes të shtetit, t'i votojmë në rezolutë 10 kushtet e Kadri Veselit për pezullimin e taksës. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Zoti Sveçla e ka fjalën.

**XHELAL SVEÇLA:** Të nderuar qytetarë,

I dëgjuam do llafe koti paradite, tash edhe në mbrëmje, këtu u fol për vendime shtetërore prej parafolësve, nuk është mirë që tendenca për kërkesën për reciprocitet të plotë politik, ekonomik e tregtar ta përziejmë me taksën 100% për prodhimet serbe. Këto dy gjëra janë të ndryshme, reciprociteti është shumë më shumë dhe shumë më i drejtë, ku mund të flasim për reagim sovran qeverisë ndaj agresioneve të vazhdueshme të Serbisë ndaj Kosovës dhe për përpjekjeve tona për shtetndërtim, ku ndër të tjera, tash voni, Serbia ndërton lagje të tëra në Kosovë me qëllim të ndërrimit të përbërjes etnike të zonave të caktuara, si për shembull, në Veri të Kosovës.

Serbia ndërton lokalitete të tëra në Kodrën e Diellit, afër Kroit të Vitakut, kurse Qeveria nuk siguron rindërtimin e shtëpive të djegura të shqiptarëve në Kroin e Vitakut, por edhe në lagjet e tjera. Të kujtojmë se sipas ligjit, e drejta të ndërtimit të shtëpive të djegura gjatë luftës së fundit është e garantuar dhe s'ka nevojë për leje të tjera, por po ashtu s'ka nevojë as për leje për kthim të banorëve në shtëpitë e tyre, vetëm se Qeveria duhet ta garantojë këtë. Tash skandalet nuk duhet të mbulohen me disa vendime të tjera, qofshin edhe ato vendime të duhura. Sot ne u ballafaquam edhe me skandalin e radhës, pas emërimit të Adriana Hoxhiq në krye të Ministrisë së Administratës dhe Pushtetit Lokal nga kryeministri Ramush Haradinaj, shumë qytetarë të Veriut të Kosovës na kanë kontaktuar duke shprehur pakënaqësinë, por edhe mllëfin e tyre për këtë skandal të radhës nga Qeveria e skandaleve. Ajo zyrtarisht nuk është anëtare e Listës Serbe, mirëpo faktikisht është një ndër ideatorët dhe zbatuesit më të zellshme të politikave të tyre dhe, siç e dinë mirë banorët në Veri të Kosovës, ajo është një ndër bashkëpunëtorët më të mira e të bindura të Goran Rakiqit.

Adriana Hoxhiq, edhe pse e martuar me një burrë shqiptar, jetojnë në Veri të Mitrovicës...

KRYESUESI: Ju lutem, mos e ofendo personalisht askënd, pa burra, veç zyrtarët për çështjen që e kemi, nuk e kemi Adriana Hoxhiqin këtu, të lutem ndale fjalën, ta marr fjalën! Ofendim jo, ajo është grua, është shtetase e Kosovës, s'ka nevojë t'ia përmendim as martesën, as fejesën, ti e the mendimin tënd, e kanë thënë nëpër media sot, por jo të ofendohet personalisht.

Ne në qoftë se po reagojmë për mbrojtjen e të drejtave të grave, kur është në pyetje këtu dikush, atëherë edhe për atë që prej sot është ministre, ne do t'i mbrojmë edhe të drejtat e saj, të lutem! Vazhdoje fjalën, zoti Sveçla!

XHELAL SVEÇLA: Çka ofendova? Ma cito të lutem ofendimin që e thashë?

KRYESUESI: S'ka kuptim, ata e kanë bërë ministre.

XHELAL SVEÇLA: A, thashë ndonjë fjalë ofenduese deri tash për të? Unë thashë që ajo, edhe pse është e martuar me një burrë shqiptar, i cili mund të jetë i mirë...

KRYESUESI: S'kemi ne punë ne sot në këtë debat parlamentar me Hoxhiqin hiç.

XHELAL SVEÇLA: Fëmijët i çon në shkollë në gjuhën serbe, pra ata kanë zgjedhur rrugën e vet të asimilimit, po kjo është çështje e tyre, e rëndësishme për publikun është që le të dihen disa fakte të tjera për jetën e saj.

KRYESUESI: Ndalja fjalën, regjia!

Fjalën e ka Bekim Haxhiu. Biografite e kurrkujt s' duam t'i bëjmë këtu në Parlament.

BEKIM HAXHIU: Të nderuar, mbeta me obligim do të thotë të sqaroj, sepse vërtet...

KRYESUESI: Ju keni të drejtë të kërkonti sqarim prej kryeministrit për biografinë, po jo ta bëni ju biografinë.

BEKIM HAXHIU: Pra, të mos harrojmë që deri në vitin 2008 ikja nga veriu në jug e shqiptarëve ka qenë permanente, ka pasur shpërngulje masive. Prej vitit 2008, kur Partia Demokratike ka ardhur në qeverisje, ka filluar rindërtimi në Veri dhe sot, edhe parafolësi e di që është pjesë e pushtetit lokal në Mitrovicë dhe gjithsesi i duhet mbështetja për të mbështetur banorët e Veriut për të rindërtuar çdo shtëpi dhe çdo gjë në pjesën Veriore.

Le të vazhdojnë ata ku e ka lënë Partia Demokratike në vitin 2013, sepse asnjë projekt më tutje nuk e kanë dërguar. Përpara se të flasin për projekte të tjera, le të vazhdojnë atë që ka bërë Partia Demokratike në kthimin e banorëve në pjesën veriore, sepse më asnjë ‘çeremide’ më nuk e kanë vendosur. Prandaj, edhe u dhemb e vërteta dhe duhet ikur prej seancës sa herë të flitet e vërteta.

KRYESUESI: Zoti Kurteshi, fillon debati që e keni kërkuar ju ose përfundon debati këtu.

Atëherë, debati ka përfunduar, fjalën përfundimtare e ka zoti Korab Sejdiu, më fal Korab.

Le të jetë ajo kushdo, kryeministri e ka emëruar ministre dhe tash duhet ta ofendojmë me familje, me fis e me krejt çka i ka, s’ka kuptim. Le t’i kërkojë llogari kryeministrit, kushdo, nëse e ka biografinë e keqe, nëse është me akuza, çfarë unë s’e njoh hiç, as s’e kam parë kurrë besoj, por ai e ka emëruar dhe ne kemi të drejtë t’i kërkojmë llogari kryeministrit, jo familjes së zonjës Hoxhiq. Zoti Korab Sejdiu e ka fjalën.

KORAB SEJDIU: Faleminderit!

Ndoshta edhe lodhja po e bën të veten, por mora shënimet gjatë diskutimeve, shpresoj që s’i mbes borxh dikujt, fillimisht e vërtetë është që pak me vonesë po diskutohet kjo çështje, po në fakt, edhe vetë kërkesa e ka vulën e Kuvendit me datë 19 nëntor 2018. Dhe, po vjen gati gjysmë viti vonesë për diskutim, tash në njërin anë nuk e caktoni debatin parlamentar, në anën tjetër thoni me vonesë po diskutohet.

Kështu që nëse doni të diskutohet në kohë, si Kryesi është mirë që t’i caktoni gjërat me kohë dhe brenda një afati të arsyeshëm. Tash, po kjo pavarësisht faktit që është me 6 muaj vonesë, unë nuk besoj që e bënë këtë temë demode, sepse sa i kam përcjellë, nuk është që Serbia i ka ndaluar sulmet në të gjitha sferat ndaj Kosovës, por gjithashtu u kërkuar, në fakt u përmendën shumë terme, koncepte juridike, ekonomike dhe, në fakt përziheshin, në njëfarë mënyre nga diskutuesit dhe është mirë të dallohet reciprocitetin, si dhe sanksionet ekonomike, politike si masa, disa nga masat e reciprocitetit, si dhe taksën si një nga sanksionet ekonomike. Do të thotë, ka edhe çështje

të tjera, sanksione të tjera ekonomike, nuk është vetëm taksa. Edhe qëllimi i krejt kësaj është që fillimisht i kuptojmë si koncepte juridike e ekonomike dhe të mos i përziejmë në diskutimet tona. Tash, sa i përket rezolutës nëse është lexuar arsyetimi që është dhënë, por edhe diskutimin që e dhashë në fillim, qëllimi ka qenë që të propozohet edhe të ndërtohet një rezolutë bashkërisht në mes të grupeve parlamentare, besoj që ky ka qenë qëllimi, që ne të ulemi dhe të kemi një konsensus të përbashkët lidhur me këtë çështje.

Dhe, çështja e dytë sa u përket raporteve ndërkombëtare dhe reciprocitetit, në anën tjetër, unë nuk besoj që këto janë konfliktuoze njëra me tjetrën. Pse? Sepse, nëse nuk ke kapacitet ta mbrosh shtetin në njërin anë dhe të mbahen marrëdhëniet ose raportet ndërkombëtare, në anën tjetër, atëherë kjo reflekton thjesht mungesë shkathtësie të qeverisës, sepse këto nuk janë koncepte. Ne shpeshherë e kemi mbrojt interesin e Kosovës në bashkërendim me bashkësinë ndërkombëtare dhe me miqtë tanë më të mirë. Njëkohësisht edhe u përmend çështja e konceptit se kam qenë kundër taksës në të kaluarën, nuk jam shprehur as nuk kam thënë kurrë që jam kundër taksës, kundër reciprocitetit, embargos apo diçka e tillë, kam thënë që është e rëndësishme të ruhen raportet me miqtë ndërkombëtarë, që besoj që të gjithë jemi në pajtim me këtë dhe nuk besoj që duhet elaboruar kjo kërkesë si kërkesë e një grupi parlamentar, është thjesht kërkesë e një grupi të deputetëve nga radhët e opozitës, dhe nuk mundet as mendimet tona si deputetë t'i vishen një grupi parlamentar të caktuar, po as ato të grupeve të caktuara parlamentare neve që jemi nënshkrues të kësaj kërkesë.

Tash, qëllimi i krejt kësaj, unë natyrisht i dëgjova të gjithë me vëmendje, është që të ndërtojmë një rezolutë nga përfaqësuesit e grupeve parlamentare edhe të deputetëve ndoshta që janë pa grup që të shërbejë si udhërrëfyes për çështjen e reciprocitetit, për Qeverinë, e cila natyrisht edhe pajtohem që e ka këtë kompetencë, nëse është e nevojshme të bëhet. Çfarë masa të ndërmerren? Kur të ndërmerren ato? Pse? Me kënd? Në çfarë rrethana dhe kushtet për heqje të ndonjë mase të caktuar. Të gjitha këto që të mos na bien neve para një situatë, ku ne marrim vendime të shpejta, të pakoordinuara dhe, në fakt, të cilat i befasojnë edhe miqtë tanë ndërkombëtarë, të cilët natyrisht dalin kundër asaj dhe bëjnë presion, sepse ne nuk i kemi bërë, si të themi, detyrat e shtëpisë para se të veprojmë dhe qëllimi i kësaj rezolute është thjesht që t'i ndihmojmë edhe ekzekutivit në punën që e ka për t'i mbrojtur interesat e Kosovës karshi këtyre sulmeve që po i bën Serbia në baza ditore.

Prandaj, të mos merret kjo si një sulm apo një dëmtim i qëllimeve të Qeverisë, thjesht është një ndihmë që po synojmë me këtë rezolutë t'ia japim Qeverisë që, kur këto sulme që u patën intensifikuar goxha shumë para gjashtë muajsh, ndoshta kur është paraqitur kjo kërkesë, po që vazhdon në baza ditore, kur të ndodhin këto ne të kemi një arsenal të masave reciproke, të cilat në përgatitje të duhur t'ia kthejmë me të njëjtën metodë edhe Serbisë, natyrisht gjithmonë në bashkërendim me bashkësinë ndërkombëtare. Unë besoj që ne mund të arrijmë një gjë të tillë nëse e propozojmë, e bëjmë një grup prej përfaqësuesve dhe e bëjmë një rezolutë, të cilën e

sjellim në Kuvend për votim dhe të cilën pastaj Qeveria mund ta shfrytëzojë si udhërrëfyes për këtë qëllim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Konstatohet që debati është shteruar, kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës, që është pika e 10-të:

**10. Debat parlamentar, sipas kërkesës së deputetit Faton Topalli, në lidhje me mosekzekutimin e Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. KI 08/09, dt. 17 dhjetor 2010, Vendimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, nr. 04-V-799, datë 19 mars 2014, Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, nr. 08/186, datë 29 prill 2014 i hyrë në fuqi më 12 maj 2014 dhe të dy (2) udhëzimeve të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, nr. C-V-14-4099 dhe nr. C-V-14-4332, datë 13 qershor 2014**

Deputeti Faton Topalli, i mbështetur nga 11 deputetë nënshkrues, ka parashtruar kërkesë për debat parlamentar. Zoti Topalli nuk është këtu, por nënshkruesit sipas radhës, më duket është Salih Salihu, unë ia jap fjalën zotit Salihu që ta arsyetojë kërkesën për debat. Unë s'mund ta ndal, sepse si Kuvend kemi votuar me 70 vota për rendin e ditës sot.

SALIH SALIHU: Faleminderit, kryesues!

Mbase parashtruesi i kësaj kërkesë nuk është prezent, zoti Topalli, unë kërkoj që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për seancën e ardhshme, domethënë seancën e radhës, se nuk po më duket që ka kuptim, pasi nuk është vetë parashtruesi i kërkesës këtu, edhe duke e pasur parasysh që deputetët janë lodhur, në numër janë shumë pak, nuk ma merr mendja që është mirë të vazhdojë debati më tutje. Faleminderit!

KRYESUESI: Ne nuk kemi të drejtë ta shtyjmë, e kemi miratuar rendin e ditës, ne mund të mos diskutojmë dhe ta konsiderojmë të shteruar këtë çështje, mund të mos diskutojmë kurrkush, unë e kam futur në rend ditës. Ti je i autorizuar, je nënshkrues i kësaj, je i të njëjtit grup parlamentar, unë po ta jap të drejtën që ta shtrosh kërkesën tënde këtu dhe të debatojmë rreth kësaj çështje në qoftë se dëshiron, në qoftë se jo, atëherë ndoshta dikush tjetër do të debatojë, ka mjaft të interesuar për këtë çështje, kemi diskutuar shumë herë për këtë çështje dhe ne s'mund të votojmë tash, se s'kemi kuorum për ta shtyrë diskutimin e kësaj çështjeje. Zoti Salihu, e keni fjalën.

SALIH SALIHU: Kryesues, unë nuk e kam materialin me vete, se përndryshe do ta kisha lexuar, por mbasi s'e kam materialin, s'ka kuptim të vazhdojë unë tash. Unë po kërkoj të shtyhet debati dhe jo të konsiderohet që është kryer sot debati.

KRYESUESI: Ne e kemi miratuar rendin e ditës dhe në qoftë se do të vinte ai propozuesi dhe ne ta votonim mocionin e tij për ta shtyrë, është në rregull, ne s'jemi lodhur hiç, jemi duke punuar, e

keni çështjen e ngritur, nuk mund t'i shtyjme çështjet, kur të miratohet rendi i ditës në mëngjes, do të kryhet deri në fund. Jemi gjashtë anëtarë të Kryesisë, ndërrohem me rend, marrim një pauzë dhe e kryejmë këtë punë.

Në rregull! A dëshiron dikush fjalën nga deputetët për këtë çështje? Nga Qeveria me siguri jo, ku mbeti ministri tash, Bilall? Bilall, thirre ministrin!

Konsideroj që për pikën e 10-të të rendit të ditës është shteruar debati, pa marrë parasysh epilogun e mosprezencës së propozuesit të parë. Nuk shtyhet për seancën e ardhshme, sepse s'kemi të drejtë ta shtyjme, s'kemi kuorum. Debati mund të zhvillohet, e kemi thënë, pa prezencën e tjerëve.

## **12. Debat parlamentar sipas kërkesës së deputetit Ismajl Kurteshi, mbështetur edhe nga 7 deputetë të Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, në lidhje me përgjegjësinë e Qeverisë së Kosovës dhe institucioneve përgjegjëse mbi organizimin e arsimit parauniversitar në Kosovë**

Ftoj ministrin që konform kërkesës që e ka bërë Grupi Parlamentar i Vetëvendosjes, besoj që e ka të shkruar, ta japë njoftimin për deputetë dhe deputetët, në qoftë se dëshirojnë të diskutojnë, mund të diskutojnë. Zoti ministër Bytyqi, e keni fjalën.

MINISTRI SHYQIRI BYTYQI: Faleminderit, kryesues!

I nderuar kryesues,

Të nderuar deputetë,

Pra, bazuar dhe në kërkesën e deputetëve që të diskutohet për çështjen e organizimit dhe të menaxhimit të arsimit parauniversitar, së pari duhet të jemi të njoftuar se arsimit parauniversitar është i menaxhuar dhe i përcaktuar nga dy ligje: Ligji për arsimin parauniversitar dhe Ligjin për pushtetin lokal.

Pra, sipas këtyre dy ligjeve bëhet organizimi dhe menaxhimi i sistemit arsimor në Kosovë. Te Ligji për arsimin parauniversitar Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë ka obligim dhe ka përgjegjësi që të ndërtojë politika lidhur me organizimin e sistemit të përgjithshëm pra sistemit parauniversitar, duke filluar nga niveli zero deri në nivelin 12.

Ndërsa pjesën menaxhuese sipas këtij ligji dhe përfshirë pjesën e ligjit të pushtetit lokal menaxhimin e sistemit arsimor parauniversitar e ka obligim komunat, gjegjësisht drejtoritë komunale të arsimit. Ajo çka është vërejtur deri më tani, sipas asaj që ne e kemi rishikuar dhe e kemi vlerësuar, është bërë decentralizimi i sistemit arsimor nga pushteti qendror në pushtetin lokal, por në njëfarë mënyre ka mbetur përgjysmë decentralizimi sepse ky decentralizim ka mbetur në nivelin komunal dhe nuk ka kaluar tutje dhe një hap që do të ishte gjëja më e mirë te



pjesa e shkollave, pra që shkollave, gjegjësisht drejtorëve dhe këshillave të shkollave të kenë një menaxhim shumë më të drejtë të shkollave.

**KRYESUESI:** Milaim, edhe ju që jeni atje prapa, ose dilni jashtë, ose do t'ju nxjerr jashtë prej atje. Ju s'keni të drejtë të diskutoni me deputetët. Ne jemi në seancë, ju po bëni shaka atje. Nuk di çfarë detyre keni aty që jeni ulur. Ju lutem mos na pengoni seancën. Vazhdoni ministër!

**MINISTRI SHYQIRI BYTYQI:** Pra, bazuar në obligimet që dalin nga ligjet përkatëse për organizimin e arsimit parauniversitar, Ministria tashmë i ka të ndërtuar të gjithë politikat, përfshi tashmë edhe kurrikulën e re e cila është duke u zbatuar në tërë territorin e Kosovës, pra në të gjitha shkollat e Kosovës, dhe këto kurrikula që kanë një program të qëndrueshëm, të vlerësuar nga ekspertët ndërkombëtarë, të cilët tregojnë një qëndrueshmëri të tyre deri në vitin 2030.

Përveç kësaj është bërë një hap tutje, janë bërë trajnime të shumta të cilat i takojnë Ministrisë së Arsimit për mësimdhënës dhe për t'i kuptuar dhe për t'i zbatuar në praktikë kurrikulat e reja. Tutje kemi bërë hapa pozitivë sidomos në këtë vit, në vitin 2019, jemi në finalizim të teksteve të reja, të cilat do të jenë në përputhje të plotë me kurrikulat që tashmë janë të zbatuara. Pra Ministria e Arsimit ka bërë publikime, ka bërë thirrje publike për tekstet e reja, duke filluar në publikimin e parë për nivelin 0-1, 6-10, të cilat janë të finalizuara tashmë nga rishikimi i recensentëve si dhe për pjesën e dytë të nivelit 2-7 dhe 11, të cilat janë në fazën finale, në mënyrë që të kompletohet kurrikulat e reja me tekstet e reja.

Po ashtu, te pjesa e arsimit profesional, që është obligim i Ministrisë që të bëjë politika, jemi në ndërtim të standardeve të reja, 15 standarde do të jenë këtë vit, që do të aprovohen dhe do të ndërtohen në përputhje me kërkesat e tregut të punës, si dhe jemi në rishikim të plotë të të gjitha kurrikulave që kanë të bëjnë me standarde të cilat tashmë i kemi, por që kanë pasur një mospërputhje me standarde profesionale të kurrikulave.

Një hap tjetër që Ministria tashmë e ka bërë dhe jemi në finalizim, kemi çështjen e asaj që theksuam në fillim, ka mbetur pa decentralizuar deri në fund çështja e arsimit parauniversitar dhe ka sjellë mjaft probleme, sidomos në çështjen e qeverisjes së shkollave parauniversitare.

Ne si Ministri kemi marrë hapa në ndërtimin e akteve nënligjore, siç është udhëzimi administrativ për emërimin e drejtorëve të shkollave dhe konsiderojmë që pas finalizimi të këtij udhëzimi administrativ, do të kemi një qeverisje të shkollave shumë më mirë sesa i kemi pasur deri më tani, sepse emërimi i drejtorëve do të bëhet nga një pjesë e madhe e këshillit drejtues të shkollave, si dhe një pjesë e prindërve që do të jetë përfaqësues i secilës klasë, në mënyrë që të zgjidhet një drejtor profesional dhe pa ndikime të jashtme.

Tutje do të kemi edhe një hap tjetër për formën e re të emërimeve të mësimdhënësve, në mënyrë që të eliminohen edhe ndikimet e jashtme të emërimit të mësimdhënësve. Pra, kjo formë e re që pritet të aplikohet si qeverisje e re të shkollave, besoj që do të ketë një hap tutje edhe drejt marrjes së përgjegjësive të vetë menaxhuesve të shkollave si dhe do të jenë gardianë të mbrojtjes së cilësisë së arsimit. Pra, nëse Ministria e Arsimit krijon politika që e kanë për qëllim ngritjen e cilësisë në arsimin parauniversitar, këto politika kanë nevojë për menaxhim të mirë, kanë nevojë për ekzekutim të mirë. dhe këtë menaxhim dhe këtë ekzekutim tash për tash e kanë obligim drejtoritë komunale të arsimit, por që do të përkrahen dhe do të ndihmohen nga Ministria e Arsimit.

Hap pozitiv tashmë siç jeni të informuar të nderuar deputetë, e kemi edhe Ligjin për Inspektorat, i cili ligj na mundëson të kemi një qasje shumë më të mirë të menaxhimit nga ana e Inspektoratit të sistemit arsimor parauniversitar, krijimi i dy grupeve të inspektorëve që do ta luajnë një rol shumë të rëndësishëm, pra grupi i inspektoreve që nuk ka qenë deri më tani, që do të quhen inspektorë pedagogë dhe që roli i tyre do të jetë një rol jo vetëm monitorues, por së pari do të jetë një rol këshilldhënës, këshillues, edhe për mësimdhënësit, por edhe për drejtorët e shkollave, dhe tutje, pastaj pjesa tjetër e inspektoratit ta luajë rolin e inspektimit që do të jetë pra një mënyrë shumë më e mirë e gjithë rishikimit të sistemit arsimor, nga ana e Inspektoratit të Arsimit.

Veprim pozitiv që Ministria e Arsimit sipas obligimit që ka nga Ligji për arsimin parauniversitar ka bërë me fillimin e fazës së parë të vlerësimit të mësimdhënësve. Konsideroj që ky hap i cili është bërë për fillimin e vlerësimit të performancës së mësimdhënësve do të japë rezultate pozitive në përpjekjet tona të vazhdueshme për ngritjen e cilësisë në arsimin parauniversitar. Me këtë mundësi, tashmë të gjithë mësimdhënësit tanë do ta kenë të drejtën që të aplikojnë për gradimin e tyre, e cila i lejon sipas udhëzimit administrativ që të kemi deri në katër nivele të gradimit dhe në mënyrë automatike, me zhvillimin profesional të vetë mësimdhënësve do të kemi edhe në mënyrë indirekte edhe ngritjen në cilësi të arsimit.

Po ashtu, si Ministri janë zhvilluar politika që të jemi pjesë e shumë proceseve ndërkombëtare, përveç testit PISA e cila jemi pjesë nga 2015-ta dhe kemi pasur testin e parë, pra 2015-tën dhe pastaj testi i dytë, 2018. Tashmë për herë të parë do të jemi pjesë edhe e një testi tjetër ndërkombëtar po aq i rëndësishëm që është TIMS, pra do të jetë muaji prill, pra ky muaj që do të zbatohet edhe në Kosovë për herë të parë dhe do të shihet se çfarë rezultati do të marrë. Kryesisht do të jenë në shkenca, pra në matematikë dhe shkenca ekzakte, ku do të nxjerrë në pah shumë qasje, ndoshta edhe rekomandime për sistemin arsimor në Kosovë, siç ishte edhe ai për testin PISA që na dolën shumë rekomandime dhe shumë dobësi, që u shfaqën në sistemin arsimor për të cilin morëm masa për t'i eliminuar këto.

Në tërë këtë rrumbullakim, mund ta quajmë se kemi dhënie, strategji për arsimin parauniversitar që është PSAK-u, i miratuar nga Qeveria e Kosovës në vitin 2017, pra 2017-2021, por që këtu

vlen të theksojmë që pavarësisht një strategji është jashtëzakonisht e mirë dhe ka në vete shumë çështje që adresojnë problematikën e arsimit parauniversitar, ajo çka mbetet shqetësuese, e kemi mungesën e buxhetit për realizimin e PSAK-ut 2017-2021. Që nga momenti kur kjo strategji është miratuar nga Qeveria, është miratuar me mungesë të buxhetit. Po e bëj një përkufizim të tërësishëm të mungesës së buxhetit, pra 48 milionë euro kanë qenë të nevojshme për realizimin e kësaj strategjie, që në fakt shpërndarë nëpër vite, për secilin vit është dashur të ketë 18 milionë euro buxhet shtesë. Por, në fakt kanë kaluar tashmë dy vjet dhe ky buxhet ka munguar. Pra, deri më tani pothuajse 30 milionë euro kanë munguar për zbatimin e kësaj strategjie.

Pavarësisht se këtë vit, pra në buxhetin aktual kemi një rritje prej 12 milionë euro, por është një rritje që nuk është vetëm për pjesën e planit strategjik, përfshirë pra gjithë pjesën e sistemit arsimor. Pra, do të kemi prapë vështirësi në buxhetin arsimor, mirëpo që kemi arritur që me pjesën shtesë që është realizuar nga donatorët e ndryshëm, nga partnerët ndërkombëtarë, sado kudo ta zbatim gjendjen për realizimin e objektivave që ka ky plan, pra ky plan strategjik mjaft i rëndësishëm.

Ajo çka ndoshta nga ky debat që mund të zhvillohet dhe mund të dalë me rekomandime, unë do të mendoja që dot ishte mirë të mundohemi për një lloj zbrazëtire që ekziston në mes pjesës së ligjit, ose obligimeve që dalin nga niveli qendror dhe nga niveli lokal dhe kjo më së shumti u shpërfaq të themi kohëve të fundit me problematikën që na doli me çështjen e kompensimit të orëve me rastin e grevës së organizuar nga SBASHK-u. Pavarësisht pra një obligimi që Ministria kishte për të nxjerrë një vendim për kompensimin e orëve, në mungesë të mekanizmave për të detyruar edhe DKA-të, por edhe shkollat për ekzekutimin e këtij vendimi, pra jemi në një situatë të papërshtatshme që Ministria nuk mund të marrë masa ndaj askujt, sepse nuk është punëdhënës dhe nuk ka ingerenca direkt në arsimin parauniversitar. Pra konsideroj që duhet të ketë mekanizma që në raste të veçanta, Ministria, pra qendra, të ketë mundësi të reagojë, pra nëse do të shohë një risk të moszbatimit të politikave që dalin nga ligjet të cilat ia kanë mundësuar Ministrisë të jetë mbikëqyrës i arsimit parauniversitar.

Pra, shpesh flasim për cilësinë e arsimit parauniversitar, shpesh debatohet qoftë në shoqëri, qoftë nëpër debate televizive, po shpesh edhe këtu në Parlament dhe gjithmonë kërkohet përgjegjësia nga Ministria se ku jemi me cilësinë e arsimit parauniversitar, por duhet ta kemi të qartë, një përgjegjësi shumë të madhe të cilësisë të arsimit parauniversitar e mbajnë komunat, gjegjësisht drejtoritë komunale të arsimit. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit zoti ministër! Tani është radha e diskutuesve. Zonja Valentina Bunjaku-Rexhepi në emër të GP të LDK-së është paraqitur.

**VALENTINA BUNJAKU-REXHEPI:** Përshëndetje, kryesues!  
Përshëndetje për ministrin e Arsimit,

Dhe për ju pak kolegë që jeni këtu,

Sinqerisht mua më vjen keq se ndodhi kjo situatë kështu, sepse ky debat do të duhej të diskutohej normalisht kur është në sallë edhe propozuesi i këtij debati. Realisht ju ftuat ministrin. Nuk po e kuptoj a ka të drejtë pa qenë propozuesi këtu. Por, sido që të jetë ne jemi të përgatitur dhe do ta themi fjalën tonë si Lidhje Demokratike e Kosovës.

Ministri pak më herët, po ndërlihem në fjalën e ministrit, pak më herët the që përgjegjësia bie mbi DKA-të për arsimin parauniversitar. Realisht përgjegjësia bie mbi Qeverinë dhe mbi Ministrinë fillimisht, mandej edhe mbi DKA-të, sepse DKA-të kanë kërkuar rritjen e buxhetit të DKA-ve, dhe ne si deputet kemi bërë shumë dhe kemi kërkuar rritjen e buxhetit për DKA-të nëpër komuna dhe DKA-të e kanë të pamjaftueshëm buxhetin dhe nuk mund të zhvillohen realisht ashtu si dinë, po kanë nevojë për rritje të buxhetit. Ne këtu kemi potencua shumëherë edhe për kërkesat të cilat janë adresuar te ne si komision nga DKA-të dhe asnjë mos të them nuk është marrë parasysh.

Në Kosovë më së shumti ka pasur debate për arsimin parauniversitar, por jo edhe për atë parauniversitar. Pa krijimin e shprehisë, motivimit dhe cilësisë në arsim parauniversitar, ne nuk mund të flasim për cilësinë në universitete. Deri më tash, Qeveritë e Kosovës kanë ndërtuar shkolla, por Kosova ka nevojë për investime për rritje të buxhetit të arsimit parauniversitar, rreth cilësisë, programeve dhe aktiviteteve arsimore, ekskursioneve mësimore e zhvillimin e aftësive të nxënësve në praktikë, duke ndarë fonde më shumë për arsimin parauniversitar.

Qeveria e Kosovës ka shpenzuar kot miliona euro për udhëtime jashtë vendit, por nuk ka pasur vullnetin për të rritur buxhetin nëpër drejtoritë komunale. Nëes ka shkolla që mbajnë mësim me tri ndërrime, atëherë kjo duhet të hiqet dhe të mos mbingarkohen shkollat dhe këto shkolla të cilat e mbajnë mësimin në tri ndërrime normalisht që edhe mësimi nuk ka efekt.

Duhet që koeficienti i mësimdhënësve të ciklit klasor sipas kërkesës së SBASHK-ut patjetër që duhet të ndryshojë, sepse vetë fakti që janë diskriminuar mësimdhënësit e ciklit klasor e të cilët e kanë koeficientin dhe pagën më të ulët sesa mësimdhënësit lëndorë, atëherë është shumë e kuptueshme që është bërë diskriminim ndaj këtyre mësimdhënësve të ciklit klasor.

Është më se shqetësuese numri i përdoruesve të drogës në moshë të re në arsimin parauniversitar. Dihet që kjo Qeveri nuk ka investuar më shumë lidhur me programet dhe trajtimet kundër përdorimit të drogës nga nxënësit.

Ka pasur pak investime në projektet e shkollave për të luftuar këtë dukuri negative. Shkollat duhet të kenë më shumë bashkëpunime dhe partneritete me qendrat për trajtimin profesional të përdoruesve të drogës, organizata të ndryshme joqeveritare etj.

Trajtimi joadekuat i abuzimit të nxënësve nga mësimdhënësit, në vend se të ndahej buxhet shtesë për psikologët dhe pedagogët nëpër shkolla. Vetëm pas rastit të rëndë, janë sjellë disa rekomandime nga MASHT në Kuvendin e Kosovës, por jo dhe kërkesa serioze e shumë të mëhershme të cilat i kemi potencuar se shkollat tona kanë më se nevojë për psikologë dhe pedagogë.

Organizimi i arsimit parauniversitar po ashtu duhet të ndryshojë në aspektin e investime në laboratorë, punë praktike të nxënësve dhe në këtë drejtim ka mungesa të mëdha të laboratorëve nëpër shumë shkolla tona të Kosovës.

Duhet të investohet më shumë në organizimin e aktiviteteve shkencore sikurse e parasheh kurrikula e re e Kosovës. Ato nuk mund të bëhen pa mjete financiare, pa riorganizim të mënyrës së punës së mësimdhënies dhe mësimnxënies në arsimin parauniversitar.

Kemi kërkuar po ashtu disa herë që orët shtesë të kujdestarisë, përkatësisht të mësimdhënësve si kujdestarë klase të kenë trajtim të veçantë edhe në Ligjin për pagat. Mësimdhënësit kujdestarë humbin më shumë kohë dhe energji për t'i zgjidhur problemet dhe për t'u konsultuar dhe duhet të kenë konsultime reale me nxënësit. Prandaj, ata shpenzojnë kohë dhe duhet të stimulohen me një kod të veçantë, apo me një nënkategori të veçantë, dhe të rregullohet kjo kategori të cilët për kujdestarë të klasave.

Për të rritur cilësinë në arsimin universitar duhet t'i kushtohet rëndësi, sidomos në Fakultetet e Edukimit që të prodhojnë edukatorë e mësimdhënës të suksesshëm. Pa investime në cilësi në këto fakultete, do të ketë më pak cilësi edhe në kuadrin e stafit parauniversitar. Prandaj, është pak kjo të thuhet se ka probleme ka në sektorin e arsimit parauniversitar dhe ju ministër i përmendët disa përparime apo disa të mira që i keni organizuar rreth këtij arsimit parauniversitar, mirëpo them sinqerisht edhe nëpër komunat e Kosovës ka nevojë jashtëzakonisht për rritje të buxhetit dhe me këtë rast t'u kushtohet rëndësi të veçantë arsimit parauniversitar, sepse pa arsimin parauniversitar nuk mund të kemi edhe arsim universitar të mirë dhe adekuat dhe nuk do të dalin quadro të mira dhe të mjaftueshme në vendin tonë dhe mandej normalisht që vijnë rezultatet edhe te PISA e dobët, edhe te kuadri i dobët i studentëve tanë dhe mandej vajtojmë tërë ditën këtu se të rinjtë tanë po ikin. Ata kanë arsye, sepse edhe nuk janë të përgatitur, po edhe nuk kanë mundësi të përgatiten sepse ka shkolla thash në tri ndërrime dhe nuk është investuar aq sa duhet në DKA-të në Kosovën tonë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Luljeta Gutaj-Veselaj e ka fjalën.

LULJETA GUTAJ-VESELAJ: Faleminderit kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar ministër,

GP i PDK-së konsideron se sistemi i arsimit asnjëherë nuk guxon të jetë në nivelin e njëjtë, por në çdo kohë kërkon ndryshim dhe reformë për t'i shërbyer në mënyrë më të mirë dhe për t'iu përshtatur sa më shumë ndryshimeve të cilat ndodhin në shoqëri në kuptimin pozitiv. Sistemi arsimor në Kosovë edhe përkundër punës së madhe që është bërë, aktualisht po ballafaqohet me disa problematika, duke filluar nga ai i arsimit parashkollor e deri te ai universitar.

Për të sjellë ndryshimin, ne konsiderojmë se duhet bërë një analizë e thellë, duke filluar nga kurrikulat e arsimit parashkollor dhe duke bërë ndryshime në bazë të nevojave që ka një vizion të qartë me pritshmëri të arritshme.

Fillimisht ofrimi i shërbimeve dhe i standardeve për mësim dhe zhvillim të hershëm për mirërritjen e fëmijëve dhe përkujdesjen duhur ndaj tyre nuk është në nivelin e kënaqshëm nga institucionet. Ka shumë sfida dhe shumë problematika të cilat po hasen gjatë këtij procesi.

Qasja në çerdhe, në kopshte, dhe në shkollimin e hershëm, konsiderojmë që është me rëndësi jetike për dhënien e mundësive të barabarta të fëmijëve. Pra, çerdhja dhe grupi i lojës janë ndër faktorët më vendimtarë për fazat e mëvonshme të të mësuarit dhe për zhvillimin e fëmijëve në përgjithësi.

Problematikë tjetër mbetet ngritja profesional e personelit në përputhje me kurrikulat shkollore e deri te përgatitja e nxënësve për tregun e punës në mënyrë që ndryshimet të jenë të pranueshme dhe lehtë të zbatuar në praktikë.

Problem i veçantë dhe shqetësues, potencova edhe në pjesën e parë, në pyetjet parlamentare, janë çantat e nxënësve, mbingarkesa me libra dhe fletore të cilat po e dëmtojnë seriozisht shëndetin e fëmijës. Kjo nuk është se është duke ndodhur tani, po është një problem i cili ka vazhduar.

Në shumë raste përmbajtja dhe tekstet shkollore të papërshtatshme, të theksuara nga formalizmi dhe verbalizmi.

Po ashtu, mësimdhënësit kanë nevojë të theksueshme të rikualifikohen dhe të motivohen për lëndët të cilat ata i ligjërojnë. Në këtë rast, nxënësit janë ata që do të kenë rezultate pozitive, ose do të ndodhë e kundërta, fëmijët nuk do të arrijnë të përfitojnë as minimumin e mundshëm në procesin e tyre mësimor, në kuadër me disa nga tekstet të cilat janë përpiluar nga botuesit dhe që lënë shumë për të dëshiruar.

Infrastruktura shkollore ende mbetet me mungesë të theksuar të pajisjeve shkollore zoti ministër. Kemi shkolla në nivel të vendit që mungojnë mjetet elementare didaktike për të punuar në klasë, e me theks të veçantë te klasat e para që duhen shumë letra, që duhen shumë elemente didaktike, që kërkojnë librat, tekstet e tanishme dhe që mësuesit detyrohen t'i paguajnë ose t'i blejnë këto

mjete didaktike me të holla personale apo edhe të kërkojnë nga prindërit, që ndonjëherë gjejnë mirëkuptim dhe në shumë raste nuk gjejnë mirëkuptim.

Shumica e klasave dhe kabineteve profesionale nuk i plotësojnë po ashtu standardet e nevojshme për qëndrim dhe punë normale të nxënësve në procesin mësimor. Ka mungesë edhe të orendive shkollore dhe didaktike dhe që krejt këto ndikojnë negativisht në procesin edukativo-arsimor.

Mungesa e një stafi profesional për një trajtim dhe edukim më të mirë nëpër shkolla, siç është pedagogu, psikologu, sociologu, po reflekton dita-ditës negativisht dhe edhe kjo po vlerësohet dhe po shihet me cilësinë e procesit mësimor që unë konsideroj që është një nevojë imediate përfshirja e tyre dhe funksionalizimi i këshilltarëve profesionalë nëpër shkolla.

Pastaj, parimi i orientimit profesional. E kemi diskutuar edhe një herë tjetër. Kam pasur një pyetje parlamentare. Është një ndër parimet e sistemit të ri arsimor, që ka të bëjë me zhvillimin dhe përdorimin efikas të aftësive, të shprehive dhe të sjelljeve të individit për aktivizimin e potencialeve dhe intelektuale si dhe fizike që janë të nevojshme që ato të zbulohen gjatë kohës, po ashtu edhe të kultivohen, duke filluar nga çerdhet, kopshtet e deri te orientimi shkollor apo klasa e nëntë që jep drejtim apo përcaktim individit, se në bazë të aftësive të tij të intelektit, ai ta marrë edhe drejtimin e duhur, ose orientimin e tij profesional, i cili do ta përcjellë gjatë gjithë jetës.

Si pasojë e gjithë këtyre faktorëve të lartcekur, shumë të rinj në këtë kohë të tranzicionit po përballen me shumë të papritura, me krizë ekonomike sociale. Po ashtu, këta fëmijë janë lënë thjesht në rrethana të fatit dhe rastësisë dhe përcaktimi i tyre mungon në orientimin profesional institucional dhe përcaktimi i tyre në orientimet profesionale bëhet në bazë të ndikimeve familjare, sociale apo edhe faktorëve të tjerë që ata mund t'i gjejnë.

U përmend zoti ministër edhe decentralizimi i pushtetit lokal për të cilin ju jeni duke punuar. Ne i japim mbështetje kësaj pjese, po duke pasur parasysh që komunat nuk p arrijnë të zhvillojnë dhe të zbatojnë politika arsimore në të gjitha segmentet e fushën, brenda kompetencave të komunës, këtu duhet Ministria të ketë një veprim më të shpejtë dhe më seriozë karshi politikave orientuese të cilat i kanë komunat.

Unë ju përgëzoj për iniciativat dhe për punën, por mendoj që të gjithë faktorët duhet të bëjnë përpjekje, si Parlamenti, si Ministria, si komunat, të gjithë bashkërisht të punojmë seriozisht dhe ta ndërtojmë një sistem të mirë arsimor në vend, për të kërkuar pastaj edhe cilësinë nga organet kompetente. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Teuta Haxhiu e ka fjalën.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Numri i paktë i deputetëve në seancë, edhe iniciuesi i seancës nuk është mirë që nuk është këtu për shkak të vetë rëndësisë së debatit. Megjithatë, faleminderit ministër që je këtu!

Të diskutojmë për arsimin parauniversitar kurdo, nuk është pak. Andaj, duke i ngritur disa shqetësime, pastaj për të dhënë edhe disa sugjerime të tjera, që konsideroj në qoftë se nuk kemi mundësi për të bërë rezolutë, atëherë le t'i marrë edhe ministri, në mënyrë që të ndikojmë sadopak që të ngremë cilësinë në arsimin parauniversitar. Duke filluar nga buxheti që ne nuk mund të themi sot. Mund të vendosim për një rritje të buxhetit. Megjithatë, një rritje ka ndodhur. Është 12 për qind, pra rreth 300 milionë euro. Edhe pse është rritja më e madhe që ka ndodhur, megjithatë konsideroj se nuk është e mjaftueshme, për shkak se kam propozuar edhe mandatin e kaluar, rritja e buxhetit nuk duhet të shkojë në nivelin lokal, duke u llogaritur për paralele, por duhet të llogaritet për kokë të nxënësit, ngase ne dimë që në shumë pjesë të Kosovës, pra në fshatra të thella kemi pak nxënës dhe pagesat, pra buxheti që shkon në nivelet lokale, nuk është i njëjtë sikurse në komunat ose shkollat që kanë një numër më të madh të nxënësve.

Pos buxhetit që normal duhet të kërkojmë vazhdimisht sa herë të na jepet mundësia që të kemi buxhet më të madh, unë nuk e heq përgjegjësinë, qoftë nivelit lokal apo nivelit qendror, me një problem që e kemi problem të theksuar dhe ende nuk e kemi të zgjidhur.

Konsideroj që ata më së shumti po humbin në këtë rast, normal që janë nxënësit, mirëpo them me vetëdije të plotë që mësimdhënësit janë në lajthitje. Pra, a do të mbajnë orët, apo nuk do t'i mbajnë orët? Këtë unë nuk e di. A do të përfundojë viti shkollor me 185 ditë pune apo nuk do të përfundojë? Tani edhe unë këtu i kam dilemat këtu, a llogaritet pra vit i përfunduar viti që është i plotë me 185 ditë pune apo jo. Për të mos diskutuar meqë nuk e kemi tani edhe pjesën, ndoshta është jo etike po megjithatë duhet ta përmend, të themi politikën të cilën po e ushtron sindikata, në këtë rast duke dalë edhe jashtë kontekstit, ngase siç e theksuat edhe ju, ne e kishim një marrëveshje krejt tjetër në komisionin, ku i ftuar për herë të tretë, në mënyrë që ta gjejmë në mes, megjithatë krejt diçka tjetër u deklarua në media dhe kjo për mua është shumë shqetësuese.

Për ta bërë shumë publike të vërteten që problemi i mësimdhënësve të nivelit 1-5 nuk ka qenë asnjëherë problem i sindikatës. Nuk e ka ngritur asnjëherë sindikata në komision përkatës, pra për Administratë Publike, ku është shtjelluar ligji.

Pra, unë kam biseduar me kryetarin me Naitin po edhe me stafin administrativ, pra asnjëherë të vetme në takime nuk është ngritur ky problem. Pra, që është diskriminues.

Mësimdhënësit e nivelit 1-5 vërtetë janë të diskriminuar, por ky shqetësim ka ardhur duke iu falënderuar atyre, por me vonesë.



Megjithatë, ne duhet ta shikojmë mundësinë sesi mund ta rregullojmë këtë çështje, por kjo mbetet ta diskutojmë bashkërisht. Problem tjetër, që unë konsideroj që ndikon shumë në ngritjen e cilësisë në arsim është numri i vogël i inspektorëve që janë duke punuar aktualisht.

E kemi miratuar Ligjin për Inspektoratin. Ne jemi një grup punues që udhëhiqet nga unë, pra për ta monitoruar këtë ligj, kemi shkuar në Departamentin e Inspektoratit dhe ministri aty na ka thënë që janë 32 vende për inspektorë.

Pse nuk po hapen konkurset? Pse nuk po veprohet? Sipas drejtorit, siç na tha ai që tri udhëzime administrative që derivojnë nga ky ligj, janë në pritje të miratimit tuaj. Pse nuk veproni më shpejt?

Pra, ky numër i paktë i inspektorëve në komuna vërtet është shqetësues, dhe nuk mund një inspektor sado që konsideroj që po nuk i kemi inspektorët e fushave përkatëse, asnjëherë nuk do të kemi efektivitet të monitorimit të punës së mësimdhënësve.

Megjithatë, problem tjetër në vete konsideroj që është vonesa shumë e madhe. Ministër jemi dakorduar, ngase unë jam pjesë e grupit punues në hartimin e udhëzimit administrativ për përzgjedhjen e drejtorëve. Ashtu siç kemi biseduar ka qenë fundi i shkurtit që ky udhëzim administrativ të finalizohet.

Puna në grup ka përfunduar ka mbetur çështje teknike, tani jemi në muajin prill. Të gjithë kandidatët të cilët për nëntë vite rresht janë diskriminuar, duke iu mohuar e drejta zgjedhjes drejtor edhe pse janë mesë të kualifikuar, pra me master udhëheqje arsimore, program i akredituar nga institucioni më i lartë i cilësisë së arsimit, pra Agjencia për Akreditim dhe që nga ajo ditë, sot jemi më 2019 dhe prej 2010 kur është hapur ky program këta kandidatë nuk kanë pasur të drejtë për të aplikuar për drejtor përderisa kanë aplikuar kandidatët të cilët kanë pasur një trajnim të organizatave të ndryshme.

Ka pasur edhe nga ministria, por e kam përmendur shumë herë ka pasur nga organizata joqeveritare që kanë qenë tema dhe tash sinqerisht, për mua shqetësimi më i madh është se ata kanë përfituar dhe tash pse po vonohemi.

A po pritet prapë, ngase këtu kemi edhe disa trajnerë të sindikatës, kryetar i sindikatës trajner i programeve për menaxhim e udhëheqje, sekretari apo kush është ai Ymer Ymeri që ishte më se i pasur, edhe ai trajner. Domethënë tri programe trajnimi që ju i keni aprovuar si MASHT. Në fakt, ministria në kohën tuaj apo ajo para jush.

Pra, po mbetet një master për tre semestra duke mos e llogaritur edhe kohën se sa të merr përgatitjen e një teme të diplomës, llogaritet se ajo i merr minimumi dy vite. Pra, nuk vijmë në

shprehje dy vite sa merr kohë përgatitja e temës së diplomës, por vjen një shprehje një trajnim treditör apo njëzetënjë ditor. Ministër, kjo po ndodh në Kosovë, prandaj të lutem ndale.

Tjetra, tekstet shkollore. Tekstet shkollore me përmbajtje që, po dua ta di se a janë gati ministrat dhe a do të fillojë viti i ri shkollor me tekste të reja që nuk do të ketë më, qoftë diskriminim, qoftë edhe përmbajtje që shumë herë janë ngritur, qoftë nga organizata apo edhe nga vet mësimdhënësit.

Pra, këto gjëra janë publike dhe shpresoj që viti shkollor të fillojë me tekste të reja që nuk kanë përmbajtje diskriminuese.

Një problem tjetër i cili mendoj se do të ndikojë është depolitizimi e depolitizimi konsideroj që vjen nëpërmjet atij udhëzimi administrativ, një hap, pastaj edhe veprimi i inspektorëve. Pra, zgjedhja e inspektorëve dhe veprimi i tyre.

Ajo që më së shumti, po kthehem edhe njëherë të inspektorët, konsideroj që mundësisht në regjione të jetë një inspektor profesional. Të paktën një matematikan, një fizikan. Një i lëndëve të tjera ngase nuk mundet që një inspektor i cili ka të kryer pedagogjinë apo një gjuhëtar të vijë dhe të asistojë në orën e një mësimdhënësi të lëndës së matematikës.

Pastaj, problem tjetër në vete, që unë konsideroj që për t'i paraprirë testeve është edhe një problem shumë i madh i mësimdhënësve që janë me sëmundje. Pra, sa unë kam informata janë më shumë se 400 mësimdhënës që janë me sëmundje të rënda dhe obligohen të dalin në punë.

Sa unë kam informata këta kanë të drejtë që ta marrin deri në tre muaj 70% të pagës e të qëndrojnë në shtëpitë e tyre. Pra, do të ishte mirë në qoftë se këta mësimdhënës do t'i pensiononim para kohe apo nëse aktualisht ende nuk mund ta bëjmë këtë, ta kemi një profesionist, një student që i ka përfunduar studimet e Fakultetit të Edukimit të jetë si ndihmesë, duke u paguar ai që e ka sëmundjen me 70%, kurse 30% pra një mësimdhënës, një konditat i cili është në pritje dhe nuk po i vjen radha që të punësohet.

Kjo të ndodhë për një kohë të caktuar derisa ne ta nxjerrim një ligj për këta mësimdhënës për një pension të parakohshëm, ngase sinqerisht unë besoj që as ata nuk janë të pajtimit që ët shkojnë në shkolla në gjendjen të cilën janë.

Pra, çështja e sigurimit të mësuesve rezervë për secilën komunë do të ishte shumë me rëndësi që ta kemi nga një mësimdhënës për secilën lëndë të fushës. Një për klasën e parë, një për klasën e dytë e kështu me radhë. Për fushën e gjuhës, komunikimit e të tjera. Që i bie si ide që mund ta plotësoni, ta plotësojmë qoftë me udhëzime administrative apo nëse është nevoja dhe t'i ndryshojmë ligjet.

Duke i përfshirë këta...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Bilalli Sherifi e ka fjalën.

BILALL SHERIFI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Së pari më lejo të them diçka tjetër, nëse me lejon meqë je bërë i rreptë dhe po e ndalë fjalën. Ju edhe Samiu na i keni marrë sot krejt titujt e portaleve. Nuk ka qenë fer kjo nga ana juaj.

Veç ju të dy keni qarkulluar nëpër portale, qysh njëherë jeni përplas e pastaj keni qesh. Po ne jse.

Tash po dalim në temë.

KRYESUESI: Pse a për portale jemi ne këtu? Në qoftë se jemi për portale, eja po i paguajmë sepse janë disa që po i paguajnë rregullisht. Kështu që...

BILALL SHERIFI: Po dalim te tema. Mendoj që mirë që sot e vazhduam seancën, sepse zakonisht seancat i kemi ndërprerë kur ka pasur dakordim mes deputetëve. Nëse 61 deputetë kanë votuar për ta miratuar rendin e ditës, zakonisht jemi votuar në fund për ta ndërprerë seancën.

Përderisa nuk ka pajtueshmëri, seanca duhet të vazhdojë qoftë edhe me 3, 5, 7, 10 deputetë të cilët janë të interesuar të marrin pjesë në debate. Është mirë që sot kemi vepruar kështu. Le të merret si precedent për të ardhmen, sepse fatkeqësisht po rrimë deri në orën 3, 4 në seanca dhe pastaj ato 15 pika, 16 pika të tjera të cilat nuk po arrijmë që t'i trajtojmë po barten në seancën e radhës.

Kështu po përcillet mesazhi që deputet nuk po punojnë asgjë. Pra, le të dihet që ka deputetë që duan të punojnë dhe ka nga ata që nuk duan të punojnë. Ne që duam të punojmë do të qëndrojmë në sallë derisa të përfundojë i gjithë rendi i ditës.

Tash, unë rreth kësaj pike nuk kam se çka të shtoj, pos ta inkurajoj ministrin që të vazhdojë me reformat me përmirësim e infrastrukturës, qoftë të kuadrove, qoftë të mësuesve nëpërmjet trajnimeve, qoftë shkolla, në çdo rrafsh.

Të kërkohet edhe buxhet shtesë për strategjinë që u tha, sepse ka një diskrepancë ministër këtu. Si mund të miratohet një strategji pa një deklaratë financiar, pra pa mbulesë financiare. Këto janë çështje të cilat duhet të trajtohen besoj dhe të inkurajoj që të vazhdojmë në këtë drejtim.

E dimë nivelin e arsimit ku e kemi dhe si e kemi, por kjo nuk duhet të na zbrapsë.

Sa i përket arsimtarëve, mësuesve të klasave prej 1 deri 5, ne kemi pasur, besoj të gjitha grupet parlamentare edhe unë një takim me ta dhe u kemi premtuar se do të bëjmë çmos, gjithçka që është në dorën të që gabimin që është bërë gjatë procesit të hartimit dhe të miratimit të ligjit në Kuvend për koeficientin e tyre, gabimin që është bërë, pra nuk po bëhet rishikimi i ligjit po përmirësohet një gabim, ku ata do të barazoheshin me mësimdhënësit nga 5 deri 9.

Do të shikojmë të gjitha mundësitë që kjo të bëhet, pra të përmirësohet ky gabim ashtu siç e tha edhe kolegja nga AAK-ja dhe kolegët nga partitë tjera politike.

Prandaj, kjo gjë duhet bërë dhe duhet të vazhdojmë çdo ditë, sepse sfida për një arsim cilësor asnjëherë nuk fitohet. Gjithmonë duhet të luftohet për arsim cilësor. Madje edhe vendet që e kanë arsimin në nivel mjaft të lartë, vazhdojnë të kërkojnë që ta përmirësojnë atë.

Vazhdojnë të mos pajtohen me atë që e kanë, por ët bëjnë diçka më shumë. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Fjalën e ka zoti Bekim Haxhiu.

**BEKIM HAXHIU:** Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Sigurisht që po kërkojmë që ta kompensojmë mungesën e parashtruesve të këtij debati. Edhe pse ne edhe në mandatin e kaluar, pothuajse të njëjtën temë e kemi diskutuar, por me ministrin e Arsimit nga mandati i kaluar.

Po diskutojmë për arsimin parauniversitar. Edhe atëherë e kam thënë dhe po e përsëris. Depolitizimi i arsimit parauniversitar është çelës i suksesit.

Këtë mund ta bëjmë me një ligj të ri për arsimin parauniversitar, ku drejtorët e shkollave nuk i cakton kryetari i komunës. Derisa drejtorët e shkollave do të emërohen nga kryetarët e komunave, vështirë se mund ta presim ndonjë cilësi në arsimin e lartë.

Nëse ne me ligj e bëjmë ashtu siç e kanë vendet e zhvilluara të cilat kanë edhe një arsim cilësor. Për shembull në Gjermani e Finlandë për t'u zgjedhur drejtor shkolle, duhet të kesh së paku 15 vite përvojë punë në arsim. T'i kesh të kaluara disa teste, sepse drejtori i shkollës konsiderohet edhe një vlerësim i jashtëm për cilësi në arsim dhe monitorimin e mësimdhënësve.

Për të qenë inspektor i arsimit, gjithashtu duhet ta kesh një përvojë të lartë në arsim dhe jo të punësohen militantë partiakë, të partive politike në Inspektoratin e Arsimit, apo edhe drejtorë të shkollave.

Pra, kur flasim për këtë nivel, bazament kryesor, themeltar për arsimin parauniversitar atëherë duhet bërë depolitizimi i tij. A presim që do të ndodhë një gjë e tillë? Mund të vendosim vet, por pritjet janë të vogla.

Sot, kolegja Luljeta e pati një pyetje parlamentare për çanta, për peshën e rëndë të çantave të fëmijëve shkollorë. Unë disa herë e kam ngritur këtë çështje dhe tashmë kam hequr dhe më nuk e bëj as pyetje parlamentare, sepse prej se jam bërë deputet të njëjtën pyetje e kam pasur.

Derisa sistemi ynë arsimor, ministrat tanë nuk kanë qenë në gjendje që për 20 vjet ta zvogëlojnë peshën e çantave të fëmijëve shkollorë, çfarë presim më tutje. Ne mund të flasim dhe të debatojmë sa të duam, por nëse peshën e çantave nuk kemi mundur që ta zvogëlojmë për 20 vjet, përkundrazi kemi shkuar duke e rënduar atë peshë.

I kemi futur në librat e historisë të fëmijëve shkollor edhe njerëz jomeritorë atje. Po nuk kemi futur në librat shkollor të historisë që të mësohet për Adem Jasharin. E kam thënë këtu më 2011, libri i historisë së klasës pestë, vetëm tre rreshta i ka për luftën e UÇK-së dhe për Adem Jasharin.

Ndërkaq, ka në atë libër fakte sesi është zgjedhur Kuvendi i Republikës së Kosovës pas luftës, kush ka qenë deputetë, kryetar Kuvendi. Cila është më e rëndësishme; të mësojnë fëmijët për historinë tonë të lavdishme të UÇK-së për Adem Jasharin dhe familjen e tij apo se kush është bërë deputet e kush është bërë kryetar i Kuvendit pas luftës.

Pra, për shkak se politizimi i ka bërë këtë punë. Kërkesë që ta kemi një arsimim cilësor është që të bëhet depolitizimi i arsimit. Dhe këtë mund ta bëjmë me ligj.

Nëse nuk e ndryshojmë ligjin, debate mund të bëjmë këtu, flasim sa të duam, po efektet do të jenë të vogla. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zoti Daut Haradinaj e ka fjalën.

**DAUT HARADINAJ:** Faleminderit, nënkryetar!

Unë nuk do ta zgjasë shumë. Është e vërtetë që tema e arsimit është një temë tepër me rëndësi dhe tepër serioze.

Por, shpresoj që nuk i kemi lodhur së pari qytetarët dhe shpresoj që edhe deputetët tanë që na shohin nëpërmjet televizionit. Kështu që edhe ata janë mërëzitur duke na parë neve.

Gjithsesi, ministri do ta ketë përkrahjen edhe të Aleancës edhe timin si deputet që të bëhet më e mira për arsimin, qoftë për atë parauniversitar, qoftë atë universitar, për shkak se jemi të

vetëdijshëm që nuk jemi në nivelin të cilin e pretojmë, qoftë si shoqëri dhe si Kosovë, e aq më tepër kur dihet që ne e kemi një të kaluar jo të lehtë në këtë drejtim.

Dihet se e kemi pasur një pauzë pothuajse 10-vjeçare, por gjithsesi përkrahja jonë nuk do të mungojë. Do të jemi të gatshëm edhe në rishikim të buxhetit t'i japim përkrahje si deputetë. Pra, ta rrisni buxhetin, të keni kushte më të mira, por natyrisht që edhe do të kërkojmë cilësi dhe do të kërkojmë zbatim të ligjit në të gjitha nivelet. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Unë desha vetëm të ndalem te dy-tri çështje shkurt. Ne kemi shumë mësues që janë invalidë të punës dhe nuk do të duhej që të jepnin mësim, veçanërisht në ciklin e ulët.

Unë mendoj që njeriu që e arrin moshën 55 vjeç nuk është në gjendje ndoshta që ta edukojë edhe fëmijën e vet e lerë më 30 ose 40 nxënës në një klasë. Kemi informata që një pjesë e madhe e mësuesve janë edhe me probleme shëndetësore të mëdha dhe ju duhet që të shkojnë në klasë për arsye se duhet të marrin rrogë dhe nuk jepet statusi i të pensionuarit, e as i invalidit.

Pra, unë mendoj që një komision i Ministrisë së Arsimit për të vlerësuar secilin në të gjitha nivelet se a është i aftë për ta ushtruar profesionin e vet do duhej të ishte. Kështu është edhe për punë fizike e lerë më për punë mendore që duhet siç ka thënë ai më thuaj se si po mëson sot se të tregoj se kush do të jesh nesër.

Ne e kemi këtë situatë. Nëse dëgjon edhe në programet në emisionet televizive në takime e kështu me radhë, unë dëgjoj fëmijët, nxënësit edhe të shkollave të mesme që flasim diametralisht ndryshe nga njëri-tjetri.

Flasin sipas gjuhës së regjionit që flitet dhe jo në gjuhën letrare. Pra, unë nuk e di a janë në nivel të detyrës mësuesit së pari, pastaj arsimtarët e gjuhës shqipe dhe profesorët e gjuhës shqipe nëpër shkolla të mesme të cilët duhet t'i përgatisin studentët për të ardhur në universitet.

Unë nuk e kuptoj sesi një student i Universitetit të Prishtinës nga cilido fakultet që nuk është gjendje t'i shkruaj tri fjali pa gabime. Kjo është shqetësuese. Po e lëmë pastaj çështjen e matematikës dhe çështjet e lëndëve që janë më të vështira dhe të cilave duhet t'ju kushtojmë rëndësi të veçantë.

Pra, unë mendoj zoti ministër dhe ju kolegë deputetë që vërtetë duhet të shqetësohemi për nivelin e arsimit që e kemi në Kosovë.

Ne duhet të konkurrojmë me regjionin, por duhet të konkurrojmë edhe me vendet e Bashkimit Evropian.

Sot e lexova që ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës kishte kërkuar dhe kishte propozuar që t'i ndihmojë studentët e mirë që studiojnë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Unë mendoj që është një nismë e jashtëzakonshme për të interes të vendit tonë, por e para e së parës, unë mendoj që përveç luftës me sindikatat se a do të paguhet dhe a nuk do të paguhet, sa është rroga sa nuk është rroga, ne duhet të investojmë shumë që të kemi një nivel të duhur të mësuesve klasor së pari dhe pastaj të tjerëve.

Duhet të shpenzojmë sa më shumë buxhet dhe ta rritim buxhetin për arsimin duke sakrifikuar buxhet të madh për mësuesit dhe për arsimtarët të cilët duhet t'i çojmë në Finlandë, duhet t'i çojmë atje ku është arsimimi i ulët, arsimimi i mesëm më i mirë se në çdo vend të botës.

Kam pas ndenjtur njëherë me një mësues, s'po i jap emër në një qytet të Kosovës dhe bisedonim atëherë për reformën në arsim. Ai tha se ne reformën në arsim e kemi bërë në vitet '60 dhe pse po kërkon tash që të bëhet reformë në arsim.

Është e vërtetë që ndoshta në vitet '60 është bërë një reformë por reforma në arsim nuk domethënë vetëm se si do duken bankat dhe çantat e nxënësve në shpinë, por sa do të nxënë dije ata dhe kë do të jenë konkurrues me dijen që e zënë në shkolla.

Faleminderit zoti ministër! Tash është paraqitur edhe Ganimete Musliu, me sa duket. Zonja Musliu, e keni fjalën.

**GANIMETE MUSLIU:** Faleminderit, i nderuar nënkryetar Haliti!

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Ministër, nuk desha të përsëritëm në ato që u thanë nga parafolësit e mi, vetëm se kur jemi te arsimi e kam një brengë. Kam qenë gjatë këtyre ditëve të fundit bukur shumë terren. Kam parë shkolla, objekte faktikisht të shkollave që kanë qenë si paralele të ndara dhe tash ka filluar mbyllja e atyre shkollave, sepse ndoshta nxënësit janë koncentruar në shkolla më të mëdha.

Mendoj që nuk është sqaruar sa duhet për komunitetet ose për qytetarët mbyllja e atyre paraleleve të ndara, e para. E dyta, ato objekte që janë shumë funksionale, sepse të gjitha janë nderuar pas luftës në Kosovë, kanë mbetur në një gjendje shumë të mjerueshme. Gjithandej ku kam shkuar qytetarët kanë shprehur shqetësim.

Deshat, ndoshta më shumë për qytetarët sesa për mua sot, të thoni një sqarim ose të tregoni pak se ato objekte në pronësi të kujt janë, ose nën administrim ose çfarë statusi kanë. A ka mundësi që ato objekte të shndërrohen në ndonjë objekt kulturor ose t'i dhurohen atij komuniteti që t'i

shfrytëzojë për diçka apo thjesht duhet të lihen ashtu në mëshirë të kohës dhe në mëshirë të qytetarëve që jo gjithherë dimë të jemi të kujdesshëm ndaj objekteve shoqëror.

Dihet se kemi parë pamje të shumta të atyre shkollave të cilat janë shkatërruar totalisht. U janë thyer dritaret. U janë thyer dyert. Janë vjedhur ndoshta edhe gjësendet që kanë qenë brenda.

Unë mendoj që pavarësisht që në ato shkolla është ndërprerë mësimi, Kosova nuk e ka luksin që t'i shkatërrojë ato objekte. Edhe njëherë po e përsëris, objekte të cilat janë të ndërtuara pas luftës dhe kanë kualitetin dhe mund të jenë jetëgjata që të shfrytëzohen për dobi të qytetarëve në ato vende ku është ndërprerë shkollimi për arsye që mund të jenë shumë të drejta dhe objektive. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti ministër, e keni fjalën për fund.

MINISTRI SHYQIRI BYTYQI: Faleminderit, kryesues!

Atëherë, unë do të mundohem që t'i jap disa përgjigje për ato që u shprehen si shqetësime nga ana e deputetëve.

Do të filloj me zotin Haxhiu, ngase kam merak që të diskutojmë bashkë. E para, nëse ne flasim që për 20 vite nuk është zgjidhur problemi i çantave, zoti Haxhiu ta ketë të sigurt që do të zgjidhet këtë vit.

Pra, paska qenë nevoja që të pritet Nisma që të jetë në pushtet, përndryshe nga shtatori do të jetë shumë i sigurt që kjo problematikë e çantave do të zgjidhet. E thamë edhe në përgjigjet e pyetjeve, do të jenë tre hapa të cilët do t'i ndërmarrim.

Hapi dhe i dytë do të ndërmerren në shtator, pra do të jenë tekstet e reja së pari që do të jenë në koherencë me kurrikulat dhe me moshën e fëmijëve. E dyta, do të jenë orët bllok që të mos ketë ngarkesë në çantë. Dhe pastaj hapi i ardhshëm përfundimtar, në momentin kur do ta shndërrojmë në mësimin tërëditor do të zgjidhet si problematikë.

Pra, nga shtatori fëmijët më nuk do të vuajnë nga çantat me peshë të rëndë. Pas 20 vjetëve do të zgjidhet ky problem.

Shkurt, e nderuara deputete Ganimete Musliu, të gjitha shkollat, të cilat për arsye të mungesës së numrit të nxënësve mbyllen, është obligim edhe i mbajtjes, po edhe pronësi e komunave, pra komunat kanë përgjegjësi t'i mirëmbajnë, t'i shndërrojnë në objekte të tjera, nëse kanë nevojë, ajo çka ne jemi duke planifikuar dhe kemi kërkuar nga DKA-të, kemi tri prioritete kryesore në vitin 2020, e para shkollat të cilat braktisen dhe kanë mundësi të shndërrohen në çerdhe, nëse



është nevoja për rrethin, ne do t'i përkrahim t'i shndërrojmë në çerdhe, sepse do të jenë prioritet çerdhet.

E dyta, pastaj do të kemi mundësi edhe investime në laboratorë, që po ashtu është projekti kryesor për vitin 2020.

Valentina nuk qenka këtu, por ajo e shtroi një çështje që tha Ministria e Arsimit është përgjegjëse, jo DKA-ja, është mirë që për opinion të jemi të qartë. Ne jemi përgjegjës për ndërtimin e politikave, sepse kështu e thotë Ligji për arsimin parauniversitar. Ndërsa menaxhimin e shkollave e kanë obligim DKA-të, nuk është çështje që ne po duam t'u ikim përgjegjësive, përkundrazi ne jemi gjithmonë në përkrahje të DKA-ve, por realisht ato e kanë përgjegjësitë dhe ato duhet të merren.

Drejtoritë Komunale të Arsimit janë në kuadër të komunave, një përgjigje që kishte të bëjë me drejtorët e shkollave që tash aktualisht janë të politizuar zgjidhen nga kryetarët. Unë konsideroj që zgjedhjet nga kryetarët e komunave ka qenë e padrejtë, sepse edhe në ligjin i cili është në fuqi, nuk e obligon ose nuk ja lejon që kryetari i komunës ta zgjedhë një drejtor.

Sipas tij, është dashur që Këshilli Komunal ta zgjedhë komisionin, që nuk ka ndodhur asnjëherë, por gjithmonë është përcaktuar nga kryetari, me Udhëzimin administrativ që shumë shpejt do të futet në fuqi, atë të cilën e ka merak edhe Teuta, se po frikohet mos po ndalet ky udhëzim, udhëzimi nuk do të ndalet, është i finalizuar. Ka qenë në pyetje vetëm shqyrtimi i tri ligjeve, sepse janë tri ligje që bien ndesh njëri me tjetrin. Pra e kemi Ligjin për arsimin parauniversitar, Ligjin për pushtetet lokal që flet për të dy ligjet për zgjedhjen e drejtorëve të shkollave dhe, po ashtu për herë të fundit që është votuar në Parlamentin e Kosovës Ligji për zyrtarë publikë që i ka futur në kategori edhe çështjen e sistemit arsimor.

Ne i kemi shqyrtuar, kemi angazhuar ekspertë dhe i kemi shqyrtuar tri ligjet se a bien ndesh me Udhëzimin administrativ, të cilin ne po duam ta finalizojmë. Tashmë e kemi marrë përgjigjen pozitive që nuk bie ndesh dhe shumë shpejt udhëzimi do të nënshkruhet, çka do të thotë kjo se drejtorët do të zgjidhen nga Këshilli Drejtues i shkollave dhe nga prindërit e shkollave apo përfaqësuesit e prindërve të shkollave. Do të thotë, do të minimizohen çështjet e ndikimeve të jashtme, nuk po i quaj vetëm politike, se pa dyshim që ka pasur ndikime të mëdha politike, por do të bëhet eliminimi edhe i ndikimeve të tjera.

Po flasim për buxhet, për kërkesën që DKA-të kanë nevojë për drejtoritë komunale të arsimit ta rritin buxhetin, sa për sqarim që besoj deputetët duhet ta dinë. Ne si ministri bëjmë propozime për programe specifike për pjesën e sistemit, pra të arsimit parauniversitar për DKA-në.

Kërkesat tona në grante specifike gjithmonë janë shumë të mëdha, por mundësitë buxhetore për aprovim janë shumë më të ulëta dhe normalisht kjo është arsyeja pse ndodh aprovimi i buxhetit më i ulët se sa që ka nevojë sistemi arsimor.

Jo vetëm për pjesën e pushtetit lokal, por e njëjta gjë ndodh edhe për pjesën e pushtetit qendror.

Mirëpo, pajisja me laboratore, mirëmbajtja e shkollave, që u mendua që është vetëm e DKA-së, jo Ministria e Arsimit vazhdimisht i përkrah DKA-të, qoftë me mirëmbajtje, qoftë me pajisje laboratorike apo edhe çfarëdo forme tjetër me pajisje dhe me banka dhe me gjëra të tjera shkollore, e kjo bëhet sipas mundësive dhe me kapacitetet të cilat i ka buxheti i Ministrisë së Arsimit.

U tha që nuk është bërë asgjë për praktikën, jo, për herë të parë ne në vitin e kaluar, po flasim 2018, kemi futur buxhet një milion euro për praktikë për shkollat profesionale. Ndërsa këtë vit, më 2019, kemi tre milionë euro për praktikë profesionale. Por është bërë një punë goxha e mirë lidhur me mundësinë që nxënësit të cilët janë në shkolla profesionale të kenë mundësi dhe të kenë praktikë.

Po ashtu kemi bërë disa marrëveshje edhe me biznese të ndryshme që të kemi lidhshmëri mes shkollave profesionale dhe bizneseve.

Shto kësaj që ishte një mungesë e orientimit në karrierë, ne si ministri kemi ndihmuar shumë shkolla dhe kemi vendosur qendra të orientimit në karrierë, ku kanë mundësi që të rinjtë tanë të ofrohen në këto qendra, e qendrat janë nëpër shkolla të mesme dhe të marrin informacione lidhur me orientimin e tyre në karrierë. Nuk do të thotë që është bërë mjaft, ka nevojë të bëhet shumë më shumë, por ajo çka ne jemi duke bërë vazhdimisht është përpjekje që të krijojmë mundësi që vërtet sistemi arsimor të bëhet një sistem modern.

Ajo çka dua të theksoj, ne vazhdimisht flasim për ndryshime të nevojshme që të kemi një cilësi më të lartë në sistemin arsimor, vazhdimisht është bërë përpjekje edhe në të kaluarën, po bëhet edhe sot. Mirëpo, nuk mund të bëjmë mrekulli, në sistemin arsimor nuk mund të bëhen gjërat për një vit, për dy vjet, por na duhen shumë vjet që të ndryshohet i tërë sistemi arsimor që t'u përshtatet nevojave të zhvillimit, siç po ndodh në sisteme të tjera të zhvilluara, por shto kësaj që edhe rezultatet nuk priten të jenë të menjëhershme, për çfarëdo hapi pozitiv që ne i bëjmë sot, do të na duhet shumë vjet për të pritur për të marrë rezultate.

Megjithatë, ne nuk do të ndalemi në asnjë moment të ndërtojmë politika, në mënyrë që të japim mundësi që DKA-të të kenë shumë më lehtë ekzekutimin e këtyre politikave për të sjellë rezultate pozitive.

Nuk është gjithçka zi, siç nganjëherë interpretohet, por nuk është edhe në nivelin ku kemi dëshirë për të shkuar dhe pajtohem plotësisht se për të pasur një sistem arsimor në nivelin që duhet, duhet të kemi një angazhim të përgjithshëm shoqëror, por jo vetëm as Ministria e Arsimit dhe Pushteti Lokal, por këtu duhen të jenë edhe shoqëria civile, edhe shoqëria në përgjithësi, në veçanti prindërit duhet ta luajnë një rol shumë të rëndësishëm, e për të cilën ne jemi duke bërë përpjekje maksimale që t'i inkuadrojmë si përgjegjës brenda secilës shkollë, dhe prindërit do të jenë ata që do të marrin edhe vendime. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjala përfundimtare, zonja Haxhiu.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, nënkryetar!

Po, ministër, edhe një herë çështja e inspektorëve, jam nënshkruese, e inspektorëve kur do të hapen konkurset dhe çështja e mësimdhënësve me sëmundje. Ministri nuk m'u ka përgjigjur në këto pyetje.

KRYESUESI: Më fal, e ke kryer!

Konsideroj që debati ka përfunduar. Zoti ministër, faleminderit për korrektësinë dhe përgjigjet që ua ke dhënë deputetëve.

### **13. Raporti i Komisionit Hetimor Parlamentar në lidhje me shpenzimet për lobim nga Presidenca dhe Qeveria e Republikës së Kosovës**

Komisioni Hetimor Parlamentar në lidhje me shpenzimet për lobim nga Presidenca dhe Qeveria e Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 23 të Ligjit 03/L-176 për hetim parlamentar e ka dorëzuar raportin përfundimtar.

Zoti Dardan Sejdiu është kryetar komisioni, nënkryetar është zoti Lumir Abdixhiku, anëtarët s'di kush janë. Por, me sa kam informacion, askush nuk është i autorizuar nga kryetari për të raportuar.

Meqenëse duhet miratuar ose nuk duhet miratuar këtë deklaratën e komisionit, unë mund ta hap diskutimin, por nuk e di sa është i arsyeshëm. Sidoqoftë, unë do ta lus zotin Abdixhiku që ta marrë përsipër që t'i thotë 2-3 fjalë në emër të komisionit dhe pastaj e ka qëndrimin e vet në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike. Zoti Abdixhiku, e keni fjalën.

LUMIR ABDIXHIKU: Faleminderit, kryesues!

Më 16 mars të vitit 2018, pak më shumë se një vit nga sot, si Lidhja Demokratike e Kosovës kishin paralajmëruar këtu në Kuvend mbledhjen e nënshkrimeve për themelimin e një Komisioni Hetimor që do të merrej me hetimin e miliona eurove saktësisht që jepeshin nga Presidenca dhe Qeveria në emër të lobimit për Kosovën.

Iniciativa ishte mbështetur mbi raportimet e shumta se fondet në fjalë përdorëshin jo me qëllim të promovimit të Republikës së Kosovës, por drejt promovimit individual të zyrtarëve të lartë shtetërorë.

Saktësisht një muaj më pas, më 17 prill të vitit 2018, Grupi Parlamentar i LDK-së kishte deponuar 40 nënshkrime të deputetëve të Kuvendit dhe me këtë kishte nisur procedurën për themelimin e Komisionit Hetimorë në fjalë. Më 1 qershor, ndërsa Kuvendi i Kosovës kishte votuar me shumicë votash për formimin e këtij komisioni.

Pra, ishin dashur tre muaj për të kaluar nga paralajmërimi i iniciativës në akt të plotfuqishëm parlamentar. Na ishin dashur edhe gjashtë muaj të tjerë për të përmbyllur procesin hetimor në komision. Por, që nga përmbyllja e hetimit, plot pesë muaj më parë, na është dashur të presim që Kryesia ta sjellë këtë raport në seancë.

Kujtoj se më 2 dhjetor të vitit të shkuar komisioni me vota shumicë e konsensus të partive politike përjashton vetëm PDK-në, pra me konsensus të LDK-së, Vetëvendosjes, AAK-së, Nismës dhe grupeve parlamentare të tjera kishte votuar për rekomandimet e raportit final.

Raporti ishte përcjellë në Kryesi më 2 dhjetor të vitit 2018 dhe për pesë muaj të tjerë nuk ishte përcjellë në seancë.

Unë fjalimin tim dua ta nis me një kritikë ndaj udhëheqjes së Kuvendit që këtë raport e kanë mbajtur për pesë muaj në tavolinë dhe nuk e ka adresuar në seancë.

Kujtoj se ushtrimi i ndikimit politik në këtë formë në një proces hetimor parlamentar është i dëmshëm për principet më bazike demokratike parlamentare që provojnë të ushtrojmë sot.

E kam përshtypjen se obstrukcioni i Komisionit Hetimor nuk është praktikë e rastësishme, në fakt dhe përkundrazi e shoh të njëjtën mirë të koordinuar dhe të shpërfaqur në të gjitha fazat hetimore të komisionit tonë. Nga themelimi i vetë komisionit, kur dështonin seancat qysh në fillim te qasja në dokumente zyrtare intervistimi i dëshmitarëve, e deri tek trajtimi i tij final nëpër seancë.

Pra, ka pasur një qëllim konsekuent dhe konsistent që puna të mos përfundojë asnjëherë, që puna të vështirësohet, dokumentet të mos dorëzohen, intervistat të ndryshohen, rezultatet dyshohen, procesi të politizohet e raporti të mos votohet, e në rast se votohet, të shtyhet sa më shumë që është e mundshme.

Dhe është pikërisht obstrukcioni ndaj Komisionit Hetimor Parlamentar konkludimi i parë i raportit tonë.

Më 4 korrik të vitit 2018, ne kemi dërguar letër zyrtare institucioneve të Kosovës për të marrë të gjitha kontratat e fondeve për lobim. Na janë sjellë katër kontrata.

E para, nga “Alston & Bird”, në vlerë 780 mijë euro.

E dyta, nga “Patton Boggs” në vlerë prej 1,3 milion euro.

E treta, nga “Ballards and Partners”, në vlerë prej 1,2 milion euro, dhe

E katërta, një kontratë në vlerë prej 40 mijë eurosh.

Dokumentet e pranuar nga Qeveria dhe Presidenca kanë qenë të pakompletuara për pjesën më të madhe të saj, por mbi të gjitha kanë qenë të paplota.

Ne kemi kërkuar qasje në të gjitha dokumentet, në të gjitha kontratat, nuk na janë ofruar të gjitha kontratat.

Në verifikimin tonë në “Foreign agents registration act” të Departamentit të Drejtësisë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës shpërfaqen shumë më tepër kontrata të Kosovës se sa që na ka dhënë Qeveria jonë.

Dhe, unë kam përshtypjen se ky obstrukcion i qëllimshëm është ofendim edhe ndaj Kuvendit të Kosovës, ku një Komisioni Hetimor Parlamentar i pamundësohet qasja në dokumente bazike si e drejtë bazike e punës tonë hetimore.

Pra, fshehja e kontratave të lobimit ka qenë evidente gjatë procesit tonë.

E dyta, në raportet e punës që janë dërguar kanë qenë të paplota, në kontratën për “Alston & Bird” në kohëzgjatje 12 mujore, komisioni ka marrë raportin e punës për vetëm tetë muaj, katër muaj të tjerë nuk janë dorëzuar.

Kontratën “Patton Boggs” kohëzgjatje 36 mujore, pra në 36 muaj, në 36 raporte, vetëm shtatë raporte janë dorëzuar te komisioni.

Në kontratën “Ballards and Partners”, kohëzgjatje 24 mujore, vlerë 1,3 milion euro, asnjë raport nuk ekziston, as s’është dorëzuar, as nuk ekziston.

Në intervistat tona që i kemi pasur me përfaqësues të presidentit, na është thënë se disa prej tyre që raporte të tilla nuk ekzistojnë. Pra, paramendoni jepen 1,3 milion euro, nuk ka raporte të shkruara që janë obligim ligjor edhe i Presidencës.

Dhe, në raste të tjera na është thënë se raportimi dhe relacioni me kontraktuesin bëhet në formë gojore. Pra, takohen diku dhe pajtohen se kjo kontratë është realizuar ose jo.

Për më tepër, kontrata 1.3 milion euro për çështje lobimi, që s'ka kurrfarë raporti, pra që se dimë çka është bërë, i ka vetëm dy faqe, dy faqe për 1,3 milion euro dhe asnjë raport, asnjë raport se si janë shpenzuar këto pra nuk ekziston në institucionet e Kosovës. As nuk është dorëzuar e as nuk është dokumentuar në intervistat e vazhdueshme në Komisionin Hetimor Parlamentar.

Pjesa e dytë e obstrukcionit ndërlidhej me intervistat. Ne kemi pasur problem serioz përkundër përsëritjes së vazhdueshme të ftesave të marrim në intervistim ministrin e Punëve të Jashtme, zotin Pacolli, ka refuzuar intervistimin. Pra, refuzon një institucion të këtij Kuvendi.

Dhe, ka refuzuar edhe presidenti i vendit zoti Thaçi, të cilit i kemi dërguar ftesë që të intervistohet, meqenëse në atë kohë ka qenë ministër i Punëve të Jashtme dhe kontratat janë nënshkruar nga ai.

Të dy këto refuzime përbëjnë edhe shkelje të rëndë të vetë Ligjit për hetim parlamentar. Unë këtu besoj që bëjnë pjesë në një hetim të ardhshëm të prokurorisë së vendit.

Konkludimi i dytë, i pari kishte të bënte me obstrukcionin e Komisionit Hetimor, ka të bëjë me shfrytëzimit e fondeve. Pra, dyshimet se fondet janë përdorur edhe për çështje individuale janë vërtetuar.

Përkundër mungesës së dokumenteve, pra përkundër faktit që 70% e raporteve nuk i janë dorëzuar komisionit, në ato 30% që janë dorëzuar kemi gjetur shkelje të rënda.

Në bazë të dokumenteve të prezantuara nga Ministria e Punëve të Jashtme, më 18 korrik të vitit 2017, kjo është fatura, kompania "Alston & Bird" ka dërguar faturën e punëve të kryera për muajin paraprak, për qershor të vitit 2017, fatura ka numrin 10900134, ka titullin Strategic Advice and Consul, ka datë 18 korrik 2017, ka numrin e klientit 065886, ka numrin e lëndës 10999134, shuma e faturës në fjalë 65 mijë euro, përshkrimi i faturës është edituar dhe reviduar fjala hyrëse në librin e ardhshëm të presidentit Thaçi, 65 mijë euro në bazë të faturës të dorëzuar nga Ministria e Punëve të Jashtme, për fjalën hyrëse të librit të presidentit Thaçi. Kjo faturë është paguar në korrik të vitit 2017.

Përveç faturës në fjalë, komisioni ka pasur si konkludim të tretë edhe angazhimin e avokatit Xhefri Najs.

Xhefri Najs tregon se në vitin 2015 është kontaktuar nga zoti Petrit Selimi, ish- zëvendësministër i Punëve të Jashtme dhe është pyetur nëse do të punonte për Qeverinë e Kosovës.

Zoti Najs, nëpërmjet letrës në fjalë dhe dëshmisë së tij tregon se është pajtuar me kushtet financiare të prezantuara nga zëvendësministri i Punëve të Jashtme.

Zoti Najs tregon për punët e bëra me Qeverinë e Kosovës, ndër të tjera tregon se si pjesë e angazhimit në fjalë, me kërkesë të Qeverisë e Ministrisë së Punëve të Jashtme ka asistuar shkrimtarët e biografisë të zotit Thaçi.

Gjatë letrës së zotit Najs është treguar se ai është paguar nga Qeveria e Kosovës dhe në një pikë pagesat janë ndërprerë.

Dhe thotë kemi shqyrtuar sistemin e Kosovës për pagesën automatike të faturave të pakontestueshme, gjë e cila kërkon pak kohë, vetëm se kemi një proces të bllokuar në fazën e fundit pa shpjegim, shfajësim apo justifikim.

Pra, zoti Najs dëshmon se është kontraktuar nga Qeveria e Kosovës, nga Ministria e Punëve të Jashtme, ka pasur një kontratë dhe ka pasur pagesa nga Qeveria e Kosovës në drejtim të tij.

Qeveria e Kosovës, në anën tjetër, nuk pranon që ka pasur një kontratë dhe nuk e dorëzon një kontratë në Komisionin Hetimor. Pra, kemi dëshmi kontradiktore dhe po besoj që prokuroria i takon të hetojë, meqenëse janë bërë pagesa në llogari të zotit Najs, bash mirë të dihet cila qenka kontrata e pagesës në fjalë.

Dhe, mbi të gjitha shihet se edhe me këtë kontratë ka pasur punë për biografinë e zotit Thaçi, rrjedhimisht dyshimet se mjetet e lobimit janë përdorur për çështje individuale, puro individuale, janë të dëshmuara.

Dhe konkludimi i fundit, ka pasur mungesë të saktësisimit të temave të referencës, kontrata milionëshe jepen me dy faqe dokument.

Ka pasur mungesë të vlerësimit të punës në fjalë, siç është kontrata me “Ballards and Partners”, jepen 1,3 milion euro, nuk ka vlerësim të punës, askush nuk e di çfarë është bërë.

Madje në një rast, zëvendëskryeministri zoti Hoxhaj, thotë se kompania lotuese merr merita për punë që s’i ka bërë. Pra, ka pasur rast që kompania ka faturua në shuma më të mëdha 50 mijë, 60 mijë dollarë punën që ministri thotë që s’e ka bërë ajo.

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESI: Regjia, vazhdojani fjalën që ta përfundojë raportin.

LUMIR ABDIXHIKU: Faleminderit, kryesues!

Pra, ka pasur punë që kompanitë i kanë faturuar, e ministri thotë që i ka bërë vetë, dhe është habitur kur i ka parë si të raportuara. Në Ministrinë e Punëve të Jashtme nuk ka pasur kurrfarë verifikimi, a e dini pse, sepse nuk ka pasur raporte. Pra, kur themi këshilltari i presidentit thotë që të gjitha raportimet i bën në formë gojore, jo të shkruara, kur takohen nëpër hotele të Uashingtonit dhe flasin për punët që janë bërë dhe dakordohen, thotë mirë është kjo punë, natyrisht se s'ka verifikim të punëve prej institucioneve të Kosovës. I kemi dhënë paratë me dy faqe kontratë, paratë janë përdorura për qëllime individuale, në anën tjetër s'ka verifikim të këtyre punëve.

Dhe e fundit, ka pasur koncentrim në disa aktorë politikë, në promovimin e tyre, në intervistat e tyre, në shkrimet e tyre, në paraqitjet e tyre. Më vonë në kontrata që nuk kemi marrë, por e kemi gjetur nëpërmjet qasjes në Fara është vërtetuar gjithashtu që një pjesë e lobimit është bërë edhe për çështjen e korigjimit të kufijve dhe temave që i trajtojmë sot. Edhe në Qeverinë e tanishme ka kontrata të nënshkruara nga Ministria e Punëve të Jashtme që i shërbejnë Presidentit, e që prodhojnë shkrime për korigjim të kufirit.

Pra, këto janë gjetjet e raportit, unë ju ftoj ta votoni, kurdo që mbahet ky votim, meqenëse ka marrë 7 vota për të të gjitha partive politike, përveç PDK-së, e cila nuk ka marrë pjesë në votim, për arsye jo të qarta. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Ishte raporti i komisionit ky, tani në emër të LDK-së zonja Vjosa Osmani e ka fjalën, a po? Me kartelë të Armend Zemajt, në rregull.

VJOSA OSMANI: Faleminderit!

Më lejoni që në radhë të parë të them që Lidhja Demokratike e Kosovës s'pajtohet me të gjitha të gjeturat e Komisionit Hetimor, të cilat edhe i prezantoi sot në këtë seancë nënkryetari i atij komisioni. Do të ishte e udhës që kur të diskutohet një raport për një temë kaq të ndjeshme, që ministri i Punëve të Jashtme të ishte prezent, që së paku të jepte përgjigje për disa prej çështjeve, të cilat i ka mbajtur fshehtë nga Komisioni Hetimor për muaj të tërë.

Siç e dini, përbërja e këtij komisioni dhe mandati i tij janë miratuar nga pothuajse të gjithë deputetët e të gjitha partive politike në këtë seancë dhe qëllimi ka qenë për të parë jo sa mjete saktësisht janë shpenzuar, por në qoftë se ato që janë alokuar nga ana e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe, më konkretisht nga Qeveria në tërësi, kanë devijuar dhe janë keqpërdorur nga ndokush për qëllimet personale apo promovime personale, në vend se të shfrytëzoheshin për promovimin e interesave të Republikës së Kosovës. Do ta sqaroj edhe një herë që asnjëherë nuk është kontestuar që Republika e Kosovës, shkaku i sfidave të veta në fuqizimin e shtetësisë, natyrisht që ka nevojë për lobim të fuqishëm, megjithatë ato para të taksapaguesve kosovarë, të



cilat ndahen për një lobim të tillë, edhe duhet të shfrytëzohen për Kosovën, e jo për interesa të individëve të caktuar.

Pra, ajo që ka ndodhur me obstrukcionin e punës së Komisionit Hetimor Parlamentar ka qenë e paprecedent, ku siç u tha edhe nga vetë nënkryetari i komisionit, përkundër faktit që është thënë që ka dhjetëra kontrata të nënshkruara nga Ministria e Punëve të Jashtme, Komisioni Hetimor ka pranuar gjithsej katër kontrata, vetëm tri nga MPJ dhe një nga Presidenca, dhe paramendojeni edhe ato që dërgohen nga ana e Ministrisë së Punëve të Jashtme, shumica prej tyre janë kopje të palexueshme, me shpresën që anëtarët e Komisionit Hetimor nuk do të mund t'i shohin provat që janë të përfshira në ato kontrata. Madje dhe në ato që janë dërguar, ka kontrata, sidomos kjo me "Ballards and Partners", e lidhur me Presidencën, ku përgjegjësitë e përcaktuara për kompaninë e lobimit janë jashtëzakonisht të gjera dhe përkundër faktit që përmenden 3-4 përgjegjësi, kontrata thotë që nuk kufizohen, që nënkupton që i lejon në këtë rast Presidencës që të angazhojë kompaninë edhe për çështje që bien jashtë qëllimeve për të cilat edhe do të duhej të lidhej kontrata e lobimit.

Kontratat e dorëzuara, siç e përmenda, asnjëherë nuk kanë qenë të kompletuara, përkundrazi ka ndodhur që një faqe e kontratës të përsëritet disa herë, kurse faqet e tjera, ku do duhej të paraqiteshin raportet e punës, në shumicën dërrmuese të rasteve kanë munguar dhe, siç u tha, kontrata me "Ballard and Partners", një kontratë 24-mujore, nuk është dorëzuar asnjë raport pune dhe ka pasur deklarata kontradiktore ndërmjet dëshmitarëve që janë ftuar të dëshmojnë para Komisionit Hetimor Parlamentar, ku disa kanë thënë që raportet kanë qenë gojore, disa që nuk ekzistojnë fare, kurse disa të tjerë kanë thënë që thjesht kanë marrë urdhra nga Kabineti për ta bërë pagesën, pa marrë parasysh se a ekziston apo jo raporti për ta, për punën që është bërë.

Prandaj, duke pas parasysh gjithë këtë obstrukcion të punës së komisionit, ne si LDK besojmë që ka hapësirë të mjaftueshme dhe ky Kuvend nuk do duhej të kishte asnjë hezitim që të kërkonte një hetim nga ana e prokurorisë, pra në dy drejtime, e para për të hetuar pse është bërë gjithë ky obstrukcion i punës së komisionit, përkundër faktit që Ligji për hetime parlamentare bazohet edhe në Kodin e Procedurës Penale dhe, e dyta, në drejtim të sigurimit të dokumentacionit që ka të bëjë me këto kontrata, sepse institucionet në fjalë dhe në veçanti Ministria e Punëve të Jashtme do të duhej të kishte për obligim që t'i dërgojë kopjet e secilës kontratë që nënshkruan, pavarësisht shumës së saj, në mënyrë që të dëshmohet në qoftë se ka pasur keqpërdorim të këtyre fondeve, apo jo.

Sa i përket shfrytëzimit të fondeve, është një vështirim i përgjithshëm në të cilin ka ardhur si konkluzion komisioni, ku thuhet që vërehet që shumica e fondeve janë të përcaktuara për disa persona, pra nuk është që mund të themi që një shumë e madhe e tyre shfrytëzohet vetëm në MPJ, por kryesisht ato janë të fokusuara te Presidenti, në disa raste ministri i Jashtëm, mirëpo nuk mund të shohim shfrytëzim, për shembull nga ana e Qeverisë ose e kryeministrit dhe kjo ka

zgjatur me vite të tëra, përkundër faktit që, siç e thashë, në mungesë të raporteve është vështirë që të vijmë në një konkluzion. Sa u përket shërbimeve të kompanisë lobuese “Alston and Bird”, u lexua qartë na ana e nënkryetarit të komisionit edhe fatura që është bërë që lidhet drejtpërdrejt me një libër të shkruar për Presidentin e vendit, pastaj në ndërkohë është prezantuar në komision një letër që është nënshkruar nga kjo kompani, në të cilën thuhet që kjo punë është bërë pro-bono, mirëpo kjo është dërguar post festum dhe komisioni ka konstatuar që megjithatë nuk mund t’i anulohet pagesat e bëra, sepse në raportin e lëshuar thuhet që pagesa është bërë për atë punë. Pra, këtu është e qartë që mund të ketë pasur edhe keqpërdorim të besimit të njerëzve, të cilët e kanë bërë këtë punë të tillë, megjithatë është patjetër një dëshmi, e cila duhet të hetohet për të ardhur deri te e vërteta.

Siç e dini, një prej arsyeve themelore pse ky Komision Hetimor Parlamentar është formuar ka qenë edhe dëshmia e bërë publike e avokatit Xhefri Najs, e cila edhe është bërë pjesë e këtij hetimi, megjithatë, meqenëse ai ka kërkuar që pyetjet t’i dërgohen me shkrim dhe nga stafi është konstatuar që një gjë e tillë nuk mund të bëhet shkak i dispozitave të Kodit të Procedurës Penale, dëshmia e vetme që ka mundur të hetohet nga ana e komisionit është ajo e cila tashmë është publike, e cila dëshmon që ai është paguar nga ana e Qeverisë së Kosovës dhe që shumë nga këto punë lidhen jo vetëm me librin, por lidhen edhe, siç thuhet aty, me argumente që do të përgatiteshin lidhur me lëndë potenciale në Gjykatën Speciale. Pra, të gjitha këto duhet të hetohen në mënyrë që të vihet deri te e vërteta. Pra, është e domosdoshme që Prokuroria të hetojë llojin e kontratës, pagesat e bëra, autoritetin kontraktues të zotit Najs, natyrën e punës së zotit Najs në lidhje me shkrimin e autobiografisë së zotit Thaçi, si dhe natyrën e punës së tij që ka të bëjë me aktakuzat rreth Gjykatës Speciale, të gjitha këto, të cilat janë përmendur në vetë letrat e dërguara nga ai drejtpërdrejt në Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe këto janë dëshmuar zyrtarisht edhe në Qeverinë e Kosovës.

Pra, për shkak të këtyre dëshmive të qarta që tregojnë që Ministria e Punëve të Jashtme qëllimisht po fsheh dëshmi nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe po ashtu, për shkak të dokumentacionit ekzistues, i cili krijon dyshim të bazuar se mund të ketë pasur devijim të përdorimit të fondeve për promovim dhe interesa personale, në vend se të përdoren ato për promovim të Republikës së Kosovës, kërkohet që ky raport i Komisionit Hetimor të votohet, në mënyrë që t’i hapet rrugë Prokurorisë, e cila do të duhej të hetonte edhe obstrukcionin e punës së komisionit, por edhe dëshmitë, të cilat, edhe pse të pakta, kanë krijuar dyshime, siç e thashë, të bazuara se mund të ketë pasur keqpërdorime. Prandaj, ne e përkrahim këtë raport dhe shpresojmë që do të marrë përkrahje edhe nga grupet e tjera parlamentare. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Unë kisha kërkuar falje për nja dy minuta dhe vazhdojmë pastaj, se kam takim.

Zonja Musliu e ka fjalën.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, nënkryetar!

Unë do të flas e autorizuar nga tre anëtarët e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës që kanë qenë pjesë e këtij komisioni, zonja Safete Hadërgjonaj, Hajdar Beqa dhe Mërgim Lushtaku, të cilët kanë përpiluar disa pika, ku edhe kanë kontestuar disa çështje çka u thanë nga parafolësit ose nga ato çka janë paraqitur në raportin e Komisionit Hetimor.

Deputetët e Grupit Parlamentar të PDK-së, anëtarë të këtij komisioni, pra edhe një herë po e përsëris, Safete Hadërgjonaj, Hajdar Beqa dhe Mërgim Lushtaku, kontestojnë raportin e komisionit dhe e konsiderojnë të papranueshëm për arsyet, si në vijim: draft-raporti ka ardhur i kontrabanduar në komision, thonë ata, kjo do të thotë se dorëzimi i draft-raportit ka ardhur pa respektuar procedurat e rregullta. Drafti në e-mail-at e deputetëve është dërguar pas orarit të rregullt të punës në mbrëmjen e datës 29.11.2018, në orën 19:47 minuta, kurse në kutitë e postës është dorëzuar pas orës 10:00 të datës 30.11.2018, ndërkaq mbledhja e komisionit është mbajtur më datën 30.11.2018 në orën 14:00, çka do të thotë se është kërkuar që draft-raporti të miratohet i paanalizuar nga anëtarët e komisionit dhe duke shkelur procedurat. Pra, nuk ka pasur gjendje emergjente që të justifikohet koha dhe veprimet jashtë Rregullores.

Draft-raporti i ofruar për votim ka qenë tendencioz dhe paragjykses, si anëtarë të komisionit kemi kërkuar kohë për të analizuar raportin, për të dhënë vërejtjet dhe për të gjetur konsensus për miratim të raportit mbi bazën e faktit. Në pamundësi konsensusi, ne atëherë jemi detyruar ta lëshojmë mbledhjen dhe të japim opinion kundër këtij raporti.

Nën 3, draft-raporti nuk ka pasqyruar në mënyrë objektive rrjedhën e procedurës, sipas nenit 23, pika 1, konkluzionet e hetimeve janë nxjerrë mbi bazën e perceptimeve, shkrimeve mediale dhe jo të bazuara në fakte. Provat nuk i janë bashkëngjitur draft-raportit që ka ardhur në komision për t'u votuar sipas dispozitës ligjore.

4. Në draft-raport theksohen çështje, të cilat nuk kanë qenë publike për tërë anëtarët e Komisionit Hetimor, nuk janë bërë dokumente zyrtare të Komisionit siç janë raportet e Fara-s në Departamentin e Drejtësisë në SHBA, në draftraport thuhet që i është bashkëngjitur draft-raportit, e që në fakt nuk i është bashkëngjitur në ditën e votimit, ashtu siç nuk janë bashkëngjitur edhe shumë dokumente të tjera, siç është theksuar në raport.

5. Janë disa çështje thelbësore që i bëjnë konkluzat e raportit krejtësisht të padrejta dhe, në fakt, e transformojnë punën e Kuvendit nga një institucion ku kërkohet llogaridhënia prej qeverisë, në një institucion që për motive politike prodhohet njollosja e institucioneve shtetërore, ku tentohen të dëmtohen proceset e konsolidimit ndërkombëtar të pozitës së Kosovës dhe ku ofendohen edhe disa nga miqtë më të vjetër dhe më të çmuar të Kosovës, siç është senatori Bob Doll.

Sipas draftraportit thuhet se komisioni ka gjetur që Kosova, sidomos Ministria e Jashtme ka pasur dhe ka të angazhuar lobistë në SHBA. Kjo gjetje nuk është e jashtëzakonshme dhe as nuk përbën shkelje ligjore. Kosova që nga vitet e hershme, sidomos nga vitet 1990 e tutje, ka pasur lobistë në SHBA, falë këtij lobimi ka arritur të bëjë SHBA-në, si dhe tërë bashkësinë ndërkombëtare të mësojë të vërtetën për Kosovën. Edhe në periudhën pas pavarësisë ka pasur lobistë që e kanë ndihmuar të gjitha institucionet kosovare me këshilla strategjike, si dhe ka pasur një ndërveprim të koordinuar me Uashingtonin. Në asnjë deklaratë apo kontratë dhe në asnjë dëshmi nuk është vërtetuar që ka pasur shkelje ligji në angazhimin e këtyre kompanive. Që është e vërteta, angazhimi i miqve të Kosovës, si senatori Bob Doll, apo ambasadori Frank Uizner, është veprim i mençur, pasi janë të njohur me çështjen e Kosovës, por edhe në mënyrën se si funksionon administrata amerikane, madje kjo ka shkaktuar shumë tensione tek armiqtë e shtetit të Kosovës në Beograd, të cilët pavarësisht mundësive më të mëdha buxhetore dhe angazhimit të madh, asnjëherë nuk kanë arritur të thyejnë miqësinë në mes të Kosovës dhe SHBA-së me propagandën e tyre të rrejshme.

7. Asnjë raport i dorëzuar te komisioni dhe asnjë dëshmi e siguruar nga cilido dëshmitar apo zyrtar nuk ka konfirmuar pretendimet e disa anëtarëve të komisionit për shfrytëzimin e mjeteve për lobim për agjendën personale të presidentit Thaçi apo cilitdo zyrtar tjetër të institucioneve shtetërore, ç'është e vërteta, të gjitha raportet e dorëzuara flasin për një marrëdhënie profesionale dhe të përgjegjshme në mes të kompanisë lobuese dhe të institucioneve të Kosovës. Prandaj, konkluzat e raportit janë krejtësisht të pabazuara në vetë gjetjet e komisionit, në dëshmitë e dhëna me shkrim dhe raportet e punës. Komisioni ka vendosur të injorojë të gjithë dëshmitarët, të gjitha dëshmitë dhe të japë rekomandime që janë thellësisht të bazuara në çfarëdo dokumenti që është dorëzuar në komision. Në asnjë nen të Ligjit për hetim parlamentar nuk shkruan se komisioni mund t'u drejtohet organeve kompetente të shtetit apo t'i ftojë ato të nisin hetime. Organet kompetente të shtetit mund të shohin cilindo raport të Kuvendit dhe nëse gjejnë fakte, mund të nisin hetimet.

9. Raporti i komisionit rrezikon seriozisht kredibilitetin e Kuvendit të Republikës së Kosovës, duke dhënë opinione të pabazuara dhe, në këtë formë e rrezikon edhe reputacionin e Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe potencialisht e lë derën hapur që kushdo nga personat e apostrofuar të kërkojë përgjegjësi ligjore dhe kompensim nga Komisioni i Kuvendit.

10. Komisioni ka qenë selektiv në zgjedhjen e fakteve, i anshëm dhe paragjykues në interpretimin e fakteve të mbledhura, gjë që shihet qartë se motivet kanë qenë politike. Nga nxitimi për të dhënë konstatime politike, anëtarët e komisionit kanë shkelur edhe mandatin e vetë të dhënë me Ligjin nr.03/L-176 për hetim parlamentar, nenin 2, pika 1 duke cenuar pavarësinë dhe duke penguar veprimtarinë e organeve të tjera. Neni 2., pika 3, duke dështuar të konstatojnë dhe të përshkruajnë rrjedhën e ngjarjeve me qëllim të qartësimit të asaj se çfarë ka ndodhur. Neni

2. pika 4, duke dështuar të informojnë e rekomandojnë dhe të ushtrojnë mbikëqyrje parlamentare, se raporti është krejtësisht me motive politike tregojnë edhe këto dëshmi.

10.1. Deputeti Ilir Deda në intervistën e dhënë në Klan Kosova më 30 tetor ka akuzuar pabazë Presidentin Thaçi se, citoj: “Ka blerë njerëz nëpër Perëndim për të thënë që ky është opsion i mirë, marrëveshja përfundimtare për paqe me Serbinë që si pikë ka edhe korrigjimin e kufirit në mes të dy vendeve”. Pra, Ilir Deda paragjykon të gjeturat e Komisionit për Hetim Parlamentar shumë kohë para se të përfundojë punën komisioni dhe para se të dëgjohen dëshmitarët dhe të mblidhen faktet dhe ka formuluar opinionin e tij me motive krejtësisht politike, shumë kohë para se komisioni të përfundojë punën hetimore.

Linku ku mund të dëgjohet deklarata e deputetit Deda është më poshtë në draft raportin kontestues që e kanë ofruar deputetët e Partisë Demokratike, pjesë të këtij komisioni.

Deputetja Arbërie Nagavci, anëtare e komisionit, më datën 17 nëntor, pra përsëri shumë kohë para se komisioni të përfundojë punën e vet hetimore, paragjykon të gjeturat e komisionit. Në një intervistë për KTV-në ajo është shprehur se: “Besoj që do të ketë material që kjo çështje të trajtohet prej prokurorisë”, përsëri pa i dëgjuar të gjithë dëshmitarët, pa u mbledhur të gjitha faktet, pa u përpiluar raporti i Komisionit për Hetim Parlamentar, deputetja Nagavci konstaton se duhet të përfshihet prokuroria. Kjo është bërë për motive politike, e jo në bazë të fakteve apo dëshmive të mbledhura, edhe për këtë deklaratë linku është në raportin dhe ne mund t’ia ofrojmë secilit që dëshiron ta shohë ose të ketë qasje.

10.3. Senatori Bob Doll ka sqaruar pozicionin e tij edhe përmes një letre, ku e bën të qartë se parathënien për librin biografik për Presidentin Thaçi e ka shkruar pro-bono, pra pa pagesë, dhe jo si pjesë e kontratës që ka kompania e tij lobuese në MPJ në Kosovë. Raporti megjithatë konstaton se parathënia është bërë si pjesë e kontratës dhe vetëm në fund dhe jo si argument përfundimtar për letrën e senatorit Bob Doll.

11. Është i papranueshëm refuzimi i komisionit të merret me substancë, për shembull me punën e raportuar zyrtarisht nga këto kompani, në letrën e dërguar nga senatori Bob Doll, apo të merret me përgjigjet me shkrim nga ish-krye prokurori i Hagës, zoti Xhefri Najs, i cili ka qenë i përgjegjshëm dhe u është përgjigjur e-mailave të Kuvendit të Kosovës. Për më shumë kemi arsytet të besojmë se kryetari i komisionit me qëllim nuk iu ka përgjigjur kërkesave të zotit Xhefri Najs për të dhënë përgjigje me shkrim, duke pamundësuar daljen e të vërtetës në shesh.

Ky raport nuk është profesional, por është tentim për njollosje dhe si i tillë është i papranueshëm. E keqja e raportit është se njolla nuk mbetet vetëm në protagonistët dhe institucionet politike kosovare, por ka implikime serioze ndërkombëtare për Kosovën. Këto do të nxitojnë t’i keqpërdorë Serbia në fushatën e saj kundër shtetit të Kosovës. Dëshira e madhe dhe krejtësisht

absurde për të gjetur me çdo kusht çfarëdo që thotë pa u faktuar se kompanitë e mirënjohura dhe miqtë e Kosovës nuk paskan punuar për të mirën e Kosovës, krijojnë mundësi që Serbia dhe mediat serbe dhe ato ruse të keqpërdorin vetë Kuvendin e Kosovës për të sulmuar Qeverinë e Republikës së Kosovës.

13. Me punë të papërgjegjshme, konkluzat të pamatura dhe të pabazuara përmes këtij raporti rrezikohet të dëmtohet përpjekja e Kosovës për të penguar luftën hibride me lajme të rrejshme që zhvillon Serbia dhe Rusia...

*(Ndërprerje nga regjia)*

**KRYESUESI:** Regjia, ta përfundojë raportin!

**GANIMETE MUSLIU:** ...kundër Kosovës dhe kundër Perëndimit në përgjithësi, veprimet e papërgjegjshme e cenojnë shtetin e Kosovës në themele. Puna e tillë e disa anëtarëve të komisionit në fjalë njollos dhe ofendon punën e shumë miqve të Kosovës, duke hedhur dyshime të pabaza në punën e tyre për Republikën e Kosovës që përgjatë dekadave ka qenë e papaguar dhe e bazuar në respektin ndaj Kosovës, që nga ish-kandidati presidencial amerikan, zoti Bob Doll, nga kryenegociuesi i pavarësisë së Kosovës, zoti Fran Vizner, e deri te ish-kryeprokurori i rastit kundër Milosheviqit në Tribunalin e Hagës, zoti Xhefri Najs, i dekoruar nga mbretëresha për punën e tij në Hagë dhe i cili është botërisht i njohur si kundërshtues i rreptë i aktakuzave të pabaza të Karla del Pontes ndaj Limajt dhe Haradinajt në Hagë.

Për më shumë, sjellja dhe veprimet e disa anëtarëve të komisionit dhe raporti përfundimtar rrezikon parimet kryesore të konfidencialitetit dhe e projekton Kosovën si të paafte për të mbajtur konfidenciale dhe profesionale marrëdhëniet që ka me kontraktuesit dhe me miqtë, si dhe të tregojë respekt për punën që e bëjnë për Kosovën jashtë syve të opinionit. Këto sjellje dhe këto veprime cenojnë shtetin e Kosovës, përpjekjen për konsolidim ndërkombëtar të shtetit të Kosovës, sulmojnë promovuesit dhe mbrojtësit e Kosovës, si dhe u jep armë në dorë armiqve të shtetit të Kosovës, në rend të parë Serbisë dhe Rusisë.

Si anëtarë të Komisionit, bazuar në nenin 23, pika 4, nuk pajtohen me konkluzionet dhe përmbajtjen e raportit përfundimtar, prandaj ndaj mendim të veçantë me shkrim, duke kërkuar që në bazë të ligjit t'i bashkëngjitet raportit përfundimtar dhe ky raport yni dhe ndoshta pajtohemi me votimin e këtij raporti në seancën e radhës.

Kjo ishte analiza që i është bërë ose thjesht përgjigjja e anëtarëve të grupit parlamentar ndaj raportit, i cili u prezantua nga parafolësi im. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Fjalën e ka zoti Sherifi.

BILALL SHERIFI: Faleminderit zoti kryesues!

Nisma ka pasur përfaqësuesin e saj në Komision dhe kemi qenë në vazhdimësi të informuar dhe meqë anëtari ynë në këtë komision ka përkrahur mesa di unë edhe siç u tha në raport, edhe Nisma gjithsesi që mbështet, përkrah këtë raport. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Korab Sejdiu, urdhëro!

KORAB SEJDIU: Përshëndetje edhe një herë!

Është interesant të diskutohet një temë kaq madhore ku një komision hetimor i institucionit më të lartë të vendit jep informacione potenciale për vepra penale të kryera nga një institucion që me kushtetutë njihet si kreu i shtetit. Ne pak që kemi mbetur këtu, po mundohemi të kuptojmë se çka ka ndodhur, por prapë po e theksoj që këto debate të gjitha janë të rëndësishme, po disa ndoshta janë pak më të rëndësishme se të tjerat dhe kjo kisha thënë që arrin kulminacionin e rëndësisë, veçanërisht për shkak të implikimeve potenciale që mund t'i ketë ky raport.

Tash, unë e pashë këtë raport me kujdes dhe prapë është shqetësim i madh, sidomos për ne që i takojmë opozitës, kur çështjet të cilat ne i ngremë, edhe pak kjo kryesi ka për t'i zhvendosur në legjislaturën e ardhshme. Nëse vazhdon me këtë shtyrjen pesë muaj, gjashtë muaj e kështu me radhë, në tentativë për t'ua humbur efektin. Po, sidoqoftë, unë e shikova këtë raport me kujdes edhe i pash thjesht që në punën e këtij komisioni ka pasur mungesë të dy natyrave. Fillimisht kontrata ose dokumenti që janë dorëzuar, të cilat kanë qenë të pakompletuara dhe pjesë të saj po e bëj edhe raportimin mbi ato kontrata, që kanë qenë të dyshimta ose kontradiktore në vete nga dëshmitarët që janë paraqitur.

E dyta, në mungesën e raporteve të punës për ata të cilët kanë pasur obligim kontraktual. Tash ka qenë për mua shumë absurde ai arsytimi i çështjes që kanë qenë dokumente sekrete, sepse në anenë tjetër, si mund të jetë diçka sekret kur pala tjetër e ka obligim ta publikojë në ueb-sajt të institucioneve federale të SHBA-së, d.m.th. është e qasshme për çdokënd. Por, njëkohësisht përveç nëse klasifikohen si të tilla, dhe dihet qartë kur klasifikohen edhe në çfarë mënyre, është edhe çështja tjetër që edhe një qytetar i thjeshtë ka të drejtë për qasje në dokumente publike e lëre më një komision hetimor i Kuvendit. E dyta, e kanë për obligim që të japin informata edhe në bazë të ligjit për përgjegjësinë për shpenzimin e parasë publike, që në fakt garantohet edhe me Kushtetutë.

Kështu që është e paqartë nëse shikohet ky raport se si mundet një prokuror kur e sheh këtë raport, ta arsyetoj veten mos ta cilësoj që ka së paku dyshim të arsyeshëm për të filluar hetimet lidhur me arë se çka ka ndodhur në dy nivelet. Do të thotë në njërin anë me shpenzimet që janë bërë për kinse lobim dhe e dyta për veprimet e disave karshi obligimit të tyre për t'i zbatuar kërkesat e Komisioni. Do të thotë në të dy anët ka dyshim të arsyeshëm se janë kryer vepra penale që në fakt mjaftojnë për prokurorët tanë sikur ata të ishin neutralë edhe sikur të ishin të

bindur ndaj obligimeve ligjore e jo ndaj ndërhyrjeve të ndryshme, që ata në fakt të fillojnë hetime për potencialisht kryerjen e veprave penale.

Në fakt, unë mendoj që pas analizimit të këtij raporti këtu ka edhe dyshim të bazuar mirë që është standardi për të ngritur aktakuzë. Po sidoqoftë kjo mbetet që të forcohet edhe tutje nga ndonjë hetim eventual për kryerjen e veprave penale. Duhet të potencohet qartë që çfarëdo imuniteti që mund të kemi, qoftë ne, qoftë Presidenti apo dikush tjetër, si pjesë e institucioneve, ajo nuk e mbulon nga përgjegjësia penale për kryerjen e veprave penale dhe unë mesa e pashë këtu fondet janë harxhuar pa asnjë procedurë të ndjekur që janë të obliguar në bazë të ligjeve të aplikueshme në Kosovë, përfshirë edhe Ligjin e Prokurimit. Dhe ato për dy gjëra që janë shumë të dyshimta. Në njërën anë për rikuperimin e personalitetit të një personi, që nuk e di a kemi mjaft fonde për ta rikuperuar atë personalitet, ose edhe diçka më keq në anën tjetër, për promovimin e idesë për ndarje të Kosovës. Mesa e kuptova këto janë qëllimet si të themi të shpenzimit të këtyre fondeve, mes rreshtave. Kështu që prapë po them që është shumë çështje serioze për t'u diskutuar me 10-15 deputetë këtu, sepse ishte dashur të ketë një trajtim pak më serioz, edhe të diskutohet në një moment pak më afër fillimit të ndonjë seance jo në fund të premtën në orët e vona.

Po e kuptoj edhe qëndrimet e juaja që thoni që nuk mundemi ne të mbetemi ne peng i atyre që nuk janë këtu, po sidoqoftë e shfrytëzoj këtë rast që vërtet punën fillestare që e ka bërë ky Komision tash ta marrin përsipër organet e rendit. Fillimisht Prokuroria e pastaj të shohim se ku shkon kjo punë.

Faleminderit për vëmendjen e me shpresë se zvogëlohen arsyet për të pasur komisione hetimore të kësaj natyre e të shtohen debatet për çështje pozitive edhe si ta nxjerrim vendin nga kriza aktuale. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Sa për njoftim, se meqenëse po gjuan nga pak nga Kryesia. Kryesia e Kuvendit, në Kryesinë e Kuvendit, Lidhja Demokratike e ka një anëtar të Kryesisë dhe e ka përherë kryetarin e Grupit Parlamentar dhe unë besoj që nuk ka asnjë rast që kanë kërkuar që një pikë e rendit të ditës të dalë përpara ose prapa se që është miratuar. Edhe Lumiri u ankua pse është vonuar. Unë se kam vonuar personalisht, bile as s'e kam ditur që ka përfunduar raporti sepse është dorëzuar me vonesë ndoshta, por edhe në Kryesi të Kuvendit, nuk ka pasur debat a të hyjë pikë e 13 që është këtu apo të hyjë pikë e katërt e rendit të ditës.

Por e drejta e deputetëve, e drejta e grupit parlamentar është për të kërkuar debate prapë. Nuk është ndonjë problem se kërkojnë një debat tjetër shtesë për një çështje të caktuar. Por neve sot jemi të autorizuar ta përfundojmë rendin e ditës, kjo është e jona.

Fjalën e ka, po. Replikë? Po! Urdhëro, çka keni mbetur me një kartelë tre vetë?



AVDULLAH HOTI: Faleminderit!

Veç për informim, nënkryetar. Kjo seancë e rregullt, edhe ajo vazhdimi i disa seancave janë caktuar nga Kryesia pa prezencën e kryetarit të grupeve parlamentare, që është hera e parë në fakt që ka ndodhur. S'ka ndodhur asnjëherë kështu. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Muharrem Nitaj e ka fjalën. Unë nuk jam i qartë. Nuk e di edhe kur është caktuar ajo. Po, rregullat unë po i shpjegoj si i kemi në Kryesi, e ke qenë apo s'ke qenë nuk e di.

MUHARREM NITAJ: Faleminderit, nënkryetar!

Unë po flas edhe në cilësinë e anëtarit të Komisionit hetimor për mjetet e shpenzuara nga Presidenca dhe Qeveria e Republikës së Kosovës dhe në cilësinë e përfaqësuesit të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës. Dua të them që në fillim se vlerësimet e shprehura nga kolegu Abdixhiku se ka pasur obstrukcion në punën e komisionit hetimor, ose ka pasur përpjekje për të mos nxjerrë raportin në seancë plenare të Kuvendit të Kosovës, janë vlerësime të tij, edhe nuk janë vlerësime të Komisionit. Unë nuk dua të gjykoj nëse ka pasur obstrukcion ose jo, mirëpo dua të them që puna ka qenë bukur e vështirë, bukur e ngatërruar, edhe Komisioni gjatë punës së vetë ka pasur shumë vështirësi në verifikimin ose në trajtimin e informacioneve ose pretendime që kanë qenë në vazhdimësi në punën e Komisionit.

Kemi pasur shumë pak kontrata. I përmendi edhe Abdixhiku kanë qenë tre ose katër. Kemi pasur një seri dëshmitarësh. Njerëz që kanë qenë të përfshirë në procese të dhënies së mjeteve financiare gjatë viteve me qëllim të lobimit nga ana e Presidencës dhe e Qeverisë së Kosovës. nuk kemi arritur që në komisionin hetimor ta kemi Presidentin e vendit. Nuk kemi arritur ta kemi as ministrin e Jashtëm. Në fakt, ka pasur një kërkesë që në këtë komision të raportonte ose të dëshmonte edhe ish-kryeministri Mustafa, meqenëse nuk ishte në kushte shumë të mira shëndetësore, ose ta intervistonim në shtëpinë e tij, ose kryeministri aktual i Kosovës, Ramush Haradinaj. Mirëpo, asnjëra prej këtyre intervistave nuk janë realizuar. Kemi pasur po ashtu disa intervista, ku njerëzit nga Presidenca kanë refuzuar të japin përgjigje në pyetje shumë të rëndësishme, me arsyetimin se dokumentet ose informacionet kanë qenë të klasifikuara dhe ata nuk mund të ofrojnë informacione që do të ishin me interes në zbardhjen e kësaj çështjeje nga ana e komisionit hetimor.

Unë personalisht kam dhënë votën pro, jo për ta përfaqësuar votën e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, por kam dashur që t'i jap shans këtij raporti, që në fakt të vijë në seancë plenare dhe të mbetet në përcaktimin e të gjithë deputetëve nëse do ta votojnë pro ose jo. Të tregoj të drejtën, unë për vete nuk jam bindur në shumë pretendime që i ka raporti, mirëpo nuk kam mundur as të pranojë qëndrimin e deputetëve të Partisë Demokratike të Kosovës që të refuzohet çdo dyshim lidhur me keqpërdorimet eventuale të mjeteve nga ana e Qeverisë ose e Presidencës së Republikës së Kosovës. Prandaj edhe e kam votuar thash për t'i dhënë një shans raportit dhe deputetëve që të gjykojnë dhe të votojnë sipas kokës së tyre të ftohtë.

Sa u përket padive dhe prokurorisë, unë mendoj që kjo nuk është fare çështje e jona. Nëse Prokuroria gjen ose vlerëson se mund të ketë një rast, ata në mënyrë të pavarur mund ta iniciojnë rastin, mund të fillojnë hetimet, ose eventualisht duhet të ketë një nismë nga kushdo qoftë në mënyrë që të procedohet. Nuk besoj që është detyrë e deputetëve për të vlerësuar nëse ka material për nisjen e hetimeve, ose jo.

**KRYESUESI:** Faleminderit! Fjalën e ka zoti Arben Gashi.

**ARBEN GASHI:** Të nderuar kolegë deputetë!

Mendoj se para vetes e kemi një dokument jashtëzakonisht të rëndësishëm i cili merr në hetim disa çështje që kanë të bëjnë me shpenzimin e dhjetëra milionë eurove të buxhetit të Kosovës dhe nga raporti na rezulton që ky buxhet, këto para të buxhetit të shtetit, pra para publike janë shpenzuar në interes të individit dhe kanë prodhuar rezultat negativ për interesin e vendit.

Nëse marrim dhe shohim gjetjet që kanë dalë nga ky raport, shohim që kemi shkelje në procedurën e tenderimit dhe të prokurimit, kemi shkelje në aspektin e lidhjes së marrëdhënies kontraktuale, kemi shkelje në aspektin e raportimit për marrëdhënien kontraktuale dhe mbi të gjitha kemi shkelje të kodit penal dhe të Ligjit për komisionet hetimore parlamentare, duke refuzuar që Presidenti i vendit apo personat nën hetim nga komisioni hetimor parlamentar t'i përgjigjen Kuvendit të Republikës së Kosovës si institucioni më i lartë ligjvënës dhe në këtë rast hetues.

Duke marrë parasysh këto elemente, ne lehtësisht mund të konkludojmë se institucionet përgjegjëse për këtë fushë, tashmë Prokuroria e Republikës së Kosovës ka për detyrë ex officio që të fillojë hetimet për gjetjet e këtij Raporti dhe të thellohet në çështjet, të cilat hetuesit në këtë rast Parlamentar nuk kanë mundur që të thellohen për shkak të mungesës së vullnetit ose të refuzimit nga ana e institucioneve, të cilat janë kërkuar që të japin llogari apo përgjegjësi për veprimet ose mosveprimet e tyre. Pra, ne e dimë që veprat penale bëhen me veprim ose mosveprim dhe në këtë rast kemi realizim të veprës penale nga zyrtarët institucional me mosveprim duke mos ju përgjigjur Kuvendit të Republikës, prandaj duhet të ndiqen penalisht personat, të cilët nuk i janë përgjigjur Kuvendit të Republikës së Kosovës, duhet të hetohet për abuzimet me buxhetin publik dhe duhet po ashtu, të ndiqen penalisht të gjithë ata persona që janë përfshirë në këtë proces.

Por, unë e shoh këtë çështje dhe përtej kësaj dhe ku fillon problemi. Nga këndvështrimi im unë mendoj se çështja është më e thellë, më problematike për interesin strategjik të vendit. Unë mendoj se problemi shkon përtej luftës ditore politike apo përtej interesit individual, unë mendoj se kjo thellësi e këtij problemi ka arrit deri në palcën e interesit shtetëror të Kosovës, duke dëmtuar përfaqësimin ndërkombëtar të Kosovës, duke i bërë Kosovës dëm reputacional të

pariparueshëm si rezultat i veprimeve të interesit individual, duke përdorur paratë e lobimit për interesa personale, individuale, grupore apo politike.

Dhe, po mundohem ta shoh pak nga këndvështrimi im, nëse marrim dhe shohim në dy sferat kryesore të interesit, angazhimit të këtyre parave apo kompanive lobuese në interes të caktuar. Asnjëherë nuk kemi qenë në këto 20 vjetët e fundit në raporte më të këqija me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe me Bashkimin Evropian. Kurrë më shumë se këto kohë nuk kemi shpenzuar para për çështje të lobimit dhe të interesit të supozuar të Kosovës, sepse po na rezulton nga raporti hetues që këto para janë shpenzuar për interesa individuale. Nëse e marrim dhe shohim nga aspekti strategjik se si jemi qasë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Qasja individualiste për përfitim personal duke shpenzuar paratë e buxhetit ka prodhuar pasoja negative dhe mosbesueshmëri të partnerët ndërkombëtarë, sidomos në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, sepse edhe atje kanë rrjedh informacionet se përfaqësuesit institucional të Kosovës po i bëjnë këto shpenzime për interesa individuale dhe e kanë jashtëzakonisht vështirë kryeministri, Kryetari i Kuvendit, Presidenti apo zyrtarët tjerë të lartë që të kenë takime të rëndësishme dhe të dinjitetshme në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Elementi i dytë i dëmit reputacional që i ka bërë Kosovës ka të bëjë me deaktivizimin e diasporës kosovare në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Duke parë diaspora kosovare që shpenzohen miliona euro në interesa të individëve për të bërë një fotografi apo për të kallëzuar një afirmimet me përfaqësues të institucioneve të Shteteve të Bashkuara të Amerikës janë deaktivizuar dhe asetit kryesor që ka qenë pro-bono si rezultat i vullnetit i diasporës shqiptare në Shtetet e Bashkuara të Amerikës është deaktivizuar dhe sot ne jemi në pozicion jashtëzakonisht të pafavorshëm Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Aseti i tretë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës shqiptarët në përgjithësi, jo vetëm shqiptarët e Kosovës në periudhën janar-shkurt të këtij viti kanë pasur tre ambasadorë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Uashington dhe dy ambasador në SHBA në Nju Jork pesë ambasadorë, miliona euro dhe një diasporë jashtëzakonisht të fuqishme ekonomike dhe raportet e Kosovës për Shtetet e Bashkuara të Amerikës asnjëherë nuk ka qenë në nivel më të ulët. Pra, ambasadorja e Kosovës në Uashington, ambasadorja e Kosovës në Nju-Jork, ambasadorja e Shqipërisë në Uashington, ambasadorja e Republikës së Shqipërisë në Nju-Jork dhe ambasadorja e Republikës së Maqedonisë në Uashington të gjithë shqiptarë dhe të gjithë në luftë me njëri-tjetrin, pa strategji, pa plan të interesit kombëtar, pa plan të interesit shtetëror, dhe pa plan të interesit të përfaqësimit të dinjitetshëm të shtetit.

Dhe, çka ndodh këtu? këtu ndodh një mungesë totale e organizimit, duke parë interesin individual, duke shpenzuar miliona euro, duke deaktivizuar resursin kryesor në Shtetet e Bashkuara të Amerikës që kanë qenë diaspora shqiptare dhe duke pasur diplomaci e cila është konfliktuale në vetvete dhe përfaqëson interesat individuale të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Nëse shohim, të njëjtin problem kemi edhe në nivel evropian. Pra, nga Buxheti i Kosovës shpenzohen miliona euro. Për këto miliona euro të shpenzuara nga Buxheti i Kosovës nuk jepet përgjegjësi.

Nuk ka një marrëdhënie të mirëfilltë kontraktuale. Nuk respektohet hierarkia institucionale. Nuk raportohet për shpenzimet e bëra. Nuk i raportohet një Komisioni Hetimor Parlamentar dhe në fund arrihet një produkt negativ në disa fusha.

Dëmi reputacional që i bëhet i Kosovës në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe në Bashkimin Evropian është jashtëzakonisht i madh. Dëmi juridik që bëhet Kosovës me besueshmërinë e lidhjes së kontratave të tilla është jashtëzakonisht i madh. Dhe dëmi politik që i bëhet Kosovës në aspektin e besueshmërisë së brendshme dhe të jashtme në fushën e angazhimit të politikës ndërkombëtare është jashtëzakonisht i madh.

Të gjitha këto përfundojnë në një akt kriminal. Në veprë penale. Pra, titullarët e institucioneve të Kosovës, zyrtarët institucionalë të Kosovës kanë realizuar veprë penale duke e dëmtuar interesin e përgjithshëm. Duke e dëmtuar Buxhetin e Kosovës dhe disa e kanë realizuar veprën penale me veprim dhe disa të tjerë e kanë realizuar veprën penale me mosveprim.

Pra, kemi realizimin e veprës penale me mosveprim, duke mos iu përgjigjur Komisionit Hetimor Parlamentar.

Kemi po ashtu realizimin e veprës penale me veprim, duke marrë veprime për lidhjen e kontratave me qëllim të përfitimit personal apo grupor, dhe duke mos i respektuar procedurat ligjore të cilat janë adekuate për këtë fushë dhe duke e dëmtuar interesin nacional dhe shtetëror të Kosovës.

Të gjitha këto rrethana të cilat janë krijuar flasin për ato të cilat shihen në raportet e Kosovës me Shtetet e Bashkuara të Amerikës në aspektin e pranueshmërisë të zyrtarëve të lartë shtetërorë të Kosovës. Këto raporte nuk kanë qenë asnjëherë më ulët në këto 20 vjetët e fundit.

Po ashtu raportet e titullarëve të institucioneve të Republikës së Kosovës, presidenti, kryeministri, kryetari i Kuvendit, ministrat, deputetët kanë probleme që të kenë takime bilaterale apo multilaterale të dinjitetshme në secilin institucion ndërkombëtar, qoftë në nivel evropian, qoftë në nivel global.

Ky problem po i përsëritet Kosovës, ky problem po thellohet dhe ky problem do të jetë i vazhdueshëm nëse ne nuk fillojmë të mendojmë në mënyrë më proaktive. Me qasje më përfshirëse. Me qasje më të dinjitetshme në aspektin e respektimit të ligjit dhe të standardeve demokratike për të cilat ne aspirojmë që t'i kemi në vendin tonë.

Pra, me anë këtyre standardeve ne aspirojmë që të angazhohemi dhe të anëtarësohemi në organizata ndërkombëtare. Prandaj, mendoj se institucionet e Republikës së Kosovës, siç është Prokuroria e Shtetit duhet të fillojë hetimin. Kuvendi i Kosovës ta bëjë punën e vet. Ta marrim përgjegjësinë, gjithsecili individ apo grup individësh të cilët janë të përfshirë në këto shkelje dhe të paraqiten para ligjit, para Komisionit Hetimor Parlamentar dhe para Prokurorisë dhe të marrin dënimin e merituar. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Nitaj, a jeni paraqitur prapë për replikë?

MUHARREM NITAJ: Një sqarim. E dëgjova kolegun Gashi, realisht koha kur Komisioni Hetimor Parlamentar e ka pasur në trajtim është shumë më e gjatë sesa mandati i fundit i Qeverisë së Kosovës.

Pretendimet kryesore kanë qenë të qeverive të kaluara dhe një pjesë e madhe e tyre edhe e kohës së ish-kryeministrit Mustafa ose kohës kur Hashim Thaçi ka qenë ministër i Jashtëm.

Prandaj, deklaratimet, ose personalizimi, ose përpjekja që e gjithë kjo të lidhet me qeverisjen aktuale të Kosovës, mendoj që është e pasaktë. Zoti Gashi duhet të jetë i saktë kur deklaron, se për cilën periudhë është fjala.

Fjala është për një periudhë shumë të gjatë edhe për pjesën më të madhe për qeveritë e kaluara. Ndërkaq, se cilat janë raportet e klasës politike të Kosovës me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, mendoj që kjo është më tepër çështje e perceptimit të zotit Gashi sesa e fakteve dhe e argumenteve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Kundër-replikë, zoti Gashi.

ARBEN GASHI: Po më vjen për zotin Nitaj, ndoshta për shkak edhe të lodhjes edhe të kohës, unë asnjëherë dhe as direkt dhe as indirekt nuk iu referova asnjërës qeveri dhe as kësaj të fundit, megjithëse kjo e fundit është niveli më i ulët i përfaqësimit politik dhe niveli më i padinjitetshëm i përfaqësimit të Kosovës.

Po ashtu duhet t'ia kujtoj se unë iu referova 20 viteve të fundit sesi institucionet e Kosovës kanë trajtuar raportet ndërkombëtare. Sesi është mbrojtur interesi i Kosovës. Sesi janë shpenzuar dhjetëra miliona euro. Komisioni Hetimor Parlamentar, pjesë e të cilit kanë qenë edhe zoti Nitaj me sa e di unë i ka kërkuar të gjitha kontratat që nga viti 2010.

Ministria aktuale nuk ia ka ofruar kontrata nga viti 2010. Ky është problemi. Nuk i ka ofruar raportet që nga viti 2010. Unë nuk jam për hetim selektiv, unë jam për hetim total. T'i shkohet deri në fund kësaj pune.

Ta shohim se kush e ka dëmtuar interesin e Kosovës. Ta shohim se deri në çfarë shkalle e ka dëmtuar interesin e Kosovës dhe të shihet se kush janë përfituesit në dëm të interesit të Kosovës dhe të marrin përgjegjësi të gjithë ata që janë përfitues. Të gjithë ata që janë dëmtues. Të gjithë ata që janë shkelës individual, grupor, klanor, klasor e si do që do t'i kualifikojmë.

Pra, unë nuk jam për qasje selektive. Nëse zoti Nitaj dëshiron të bëjë kallaballëk fjalësh këtu pa logjike dhe pa arsye, është në të drejtën e tij. Por, mendoj se asnjëherë dhe as direkt dhe as indirekt nuk e personalizova, por shpreha shqetësimin e thellë në mënyrën sesi trajtohen raportet e Kosovës me partnerët ndërkombëtare dhe sidomos me partnerët strategjikë, ku iu referova Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe vendeve të Bashkimit Evropian.

Pra, raportet po dëmtohen vështirë përmirësueshëm për një periudhë afatmesme. Ky është shqetësimi im. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit!

Kolegë të pranishëm, deputetë në numër jo të shumtë, por nga rëndësia edhe e temës besoj që interesimi nuk po mungon.

Nuk do t'i përsëris ato që thanë...

KRYESUESI: Rregulloje mikrofonin pak!

ARMEND ZEMAJ: Po, faleminderit!

Nuk do t'i përsëris ato që i thanë kolegët e mi. Ata saktësisht elaboruan, jo vetëm mënyrën e lobimit, por edhe të ruajtjes së partneritetit me ata që e kanë mbështetur Republikën e Kosovës në rrugëtimin tonë për liri dhe pavarësi.

Andaj, është mirë që t'i dallojmë këto tema. Çdokush që dëshiron t'i dallojë, sidomos në aspektin e keqpërdorimit të parasë publike që në gjuhën popullore quhet hajni dhe nuk ka ndonjë arsyeshmëri tjetër.

Tash, unë po ndalem vetëm në këtë pjesën e fundit, qoftë të involvimit të njerëzve të dyshuar, tash sipas raportit. Një raport edhe për nga puna e tyre sensitive, por e cila ka arritur ta marrë votën e shumicë së anëtarëve nga të gjitha grupet politike, përjashto tre anëtarët nga grupi i Partisë Demokratike të Kosovës, si e drejtë e tyre edhe kuvendore edhe elementare.

Andaj, në asnjë rresht të raportit, unë nuk pashë që komisioni ka akuzuar miqtë që ata janë përfitues të këtyre mjeteve dhe keqpërdorues të këtyre mjeteve. Komisioni në mënyrë të saktë ka

saktësuar nga ato pak raporte të cilat i kanë pasur në konsideratë sesi dyshohet për keqpërdorim të parasë publike.

Më lejoni që t'i lexoj vetëm dy apo tri ndërmjet rreshtave që të mos marr kohë. Sigurisht që këto do të jenë bazë shumë e rëndësishme dhe e shëndoshë që Prokuroria Republikës së Kosovës ta ndjekë këtë çështje edhe sipas Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale.

Komisioni saktëson që në njërin nga kontratat thuhet se kontrata ka qenë për kohëzgjatje 12 muaj. Që nënkupton edhe pagesën për 12 muaj, ndërsa për katër muajt e fundit të kontratës, raportet nuk janë dorëzuar fare.

Tash lindin pyetjet; ku ekzistojnë këto pagesa? Si janë arsyetuar? Kush i ka pranuar? Dhe si do të arsyetohen para Kuvendit pasi që nuk kanë arritur që të arsyetohen para komisionit? Sigurisht, shpresojmë që të arsyetohen para Prokurorisë së Shtetit.

Po ashtu edhe kontrata e dytë "Patton Boggs" e ka kohëzgjatjen 34 muaj. Komisioni Hetimor Parlamentar i ka pranuar raportet e punës vetëm për shtatë muaj të saj, pagesat janë për 27 muaj të tjerë. Po e lexoj ashtu siç është në raport.

E njëjta gjendje është edhe te kontratat tjera. Domethënë ka pagesa për 24 muaj me kohëzgjatje, por nuk ka pranim të raportit të plotë për asnjërën prej tyre. Andaj, kjo nuk do ndonjë koment shtesë. Nuk mund të anashkalohen edhe pretendimet edhe dyshimet se këtu kemi keqpërdorim të pastër të parasë publike.

Fshehja e dëshmive dhe e kontratave për shembull, edhe në vet Nefara dëshmohet që ka pasur kontratë me "Podesta Grup", i cili është mbajtur fshehur nga komisioni, ndërsa informata ka ardhur nga përfaqësuesit që kanë dërguar këto informacione direkt nga Uashingtoni.

Ata nuk fshehin, ata e tregojnë realitetin, sepse janë njerëz që kanë kredibilitet dhe nuk janë keqpërdorues si këta të brendshmit në Republikën e Kosovës dhe kjo është dëshmuar.

Të çështja e ruajtjes së konfidencës së dokumenteve edhe këtu potencohet saktë që komisioni iu është ofruar këtyre njerëzve me nënshkrimet e tyre që mund të jenë konfident në ruajtjen e këtyre raporteve. E kanë marrë këtë përgjegjësi, e cila nuk është pranuar. Është përdorur si instrument i keqpërdorimit nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Presidenca që të mos i sjellin raportet në fjalë.

Andaj, edhe këtu duhet të kemi hetim dhe qartësim të të gjitha dispozitave, dëshmive provave që bien në kundërshtim me ligjin dhe me hetimet parlamentare.

Të nderuar kolegë deputetë,

Raporti është i rëndësishë së veçantë, jo pse nxjerr në pah të gjeturat, por pse e tregon një element të dobësisë institucionale të institucioneve më të rëndësishme të Republikës së Kosovës, të njerëzve të involvuar të cilët hedhin baltë në institucionet e Republikës së Kosovës.

Këta njerëz duhet të ndëshkohen. Jo të përkrachen në asnjërën formë dhe për asnjërën arsye. Pavarësisht konfigurimit politik çfarë ekziston në Republikën e Kosovës, sepse po të lejohen që këta njerëz të vazhdojnë prapë me të njëjtën logjikë të arsyeshmërisë së lobimit në favor të Kosovës, por përfitimit persona dhe pasurimit personal në kurriz të taksave të qytetarëve të Republikës së Kosovës, kjo është përgjegjësi edhe për vetë grupet politike, edhe për vetë deputetët e Republikës së Kosovës.

Andaj, nuk është për t'u çuditur se shumica e apostrofuarve edhe herëve të tjera janë apostrofuar për dyshime korruptive. Për pasurim të paligjshëm. Për përfitim të parasë publike dhe për veprat tjera kriminale.

Më vjen mirë që komisioni ka arritur që në masë të madhe këtë temë ta hedh në një raport dhe ta sjellë para deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, por personalisht mendoj që duhet që çdonjëri të zotohemi që ky raport do të jetë në duart e organeve të drejtësisë dhe ata ta thonë fjalën përfundimtare.

Dashtë Zoti që këto dyshime të mos jenë reale, por nga praktika dhe nga ata që dyshohen për këto keqpërdorime, besoj që janë më tepër se sa reale. Janë të pakta kur thuhet dhe dëgjohet se çka bëjnë, si veprojnë dhe si i përdorin taksat e qytetarëve të Republikës së Kosovës. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Nuk ka të tjerë të paraqitur. Jo, veç dëshiron të diskutojë dikush që s'ka diskutuar, por për replikë nuk... Keni diskutuar edhe ju Bilall. Urdhëro? Emrin ia ka përmendur në kundër-replikë. Nuk ia ka përmendur emrin në diskutim.

Teuta ju s'keni diskutuar, në qoftë se dëshiron të diskutosh mund të diskutosh, por jo të merresh me Armendin, sepse Armendi nuk ia ka përmendur emrin askund hiç.

Bilall, e ke fjalën.

**BILALLA SHERIFI:** Faleminderit, kryesues!

Në cilësinë e kryetarit të grupit kam folur dhe jo të deputetit. Dhe, të lutem bëje këtë dallim.



KRYESUESI: Nuk mund të bëj përjashtim për ty, e për të tjerët jo. Kur të flasësh në emër të kryetarit të grupit, je më i rëndësishëm se krejt grupi. E përfundon fjalën. Mund të flasësh një minutë.

BILALL SHERIFI: Po, një minutë. Veç desha t'i them Muharrem Nitajt që pati të drejtë në vërejtjen që e ngriti. Muharremi pati të drejtë. Nuk po dua të polemizoj me Arbenin.

Unë në emër të grupit e mbështeta e raportin sepse deputeti im e ka mbështetur. Pikë! Kaq kjo dhe rreth kësaj nuk kam dilema. Por, mendoj që përgjithësimi pastaj, sidomos përfundimi e sidomos replika se kjo Qeveri është më e padinjitetshme, e ajo e dinjitetshme nuk është korrekte.

Nuk i shërben në fund të fundit punës së përbashkët të grupeve parlamentare për të ardhur deri te e vërteta.

KRYESUESI: Faleminderit! Edhe ti Muharrem përfundoje, e ke edhe një minutë, se bash asgjë s'ke çfarë t'i thuash më shumë se që i the në të parën herë.

MUHARREM NITAJ: Jo, më shumë nuk po them, po përpiqem ta them ndryshe.

Të nderuar kolegë deputetë,

Aty ka pasur dy përpjekje; një pjesë e anëtarëve të komisionit hetimor janë munduar që me çdo kusht që ta paraqesin presidentin e vendit Hashim Thaçin si keqpërdorues të fondeve publike për interesa personale, Dhe grupi tjetër i Partisë Demokratike të Kosovës që të përjashtojë çdo dyshim të mundshëm.

Në pozicionin më të keq kam qenë unë, përfaqësuesi i Nismës dhe disa deputetë të tjerë.

Prandaj, thashë se çështja ka qenë shumë e ngatërruar dhe deputetët duhet të vendosin me kokë të ftohtë. Tani sa u përket vlerësimeve për Qeverinë. Nuk është Kuvendi për perceptime, ju lutem! Flisni me fakte, me argumente.

Të mos i numëroj unë tani sukseset e Qeverisë. S'ka asnjë kuptim. Sot edhe Kurti bëri vlerësime me ato fjalimet e tij retorike. Me fjalimet e tij ritmike. S'ka asnjë kuptim.

KRYESUESI: Unë këtu e shoh gabimin e pozitës veçanërisht, se detyrë e opozitës është t'i kundërvihet me diskutime. Gjatë debatit, fjalimeve që janë kundër Qeverisë. Për këtë është Parlamenti dhe për këtë ka pozitë opozitë.

Këtu nuk shoh diçka të keqe. Unë e shoh të metën tek pozita që nuk i ka arsyetimet e veta, ose vjen e papërgatitur siç jemi sot. A e dëshiron fjalën zonja Musliu? Në rregull!

Atëherë, po e përfundojmë debatin. Në qoftë se ka rekomandime ose debat tjetër më pastaj. Këto pikat e tjera... Më falni se unë desha ta përfundoj krejt, pikat tjera janë në votim. Meqenëse nuk ka kuorum, ne nuk mund të votojmë. Në rregull. Faleminderit!

Desha t'i them dikujt që është përpjekur të më frikësojë, unë nuk frikësohen prej askujt se nuk i kam borxh askujt. Kështu që atij që ka menduar që mua tuta më vjen hak, mua nuk më ka ardhur kurrë frika hak. Se nuk më ka frikësuar askush.

Mirupafshim!

*E përgatiti:  
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*